

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

---

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 21



# ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË

## EUROPEAN AND SECURITY AFFAIRS

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**Bordi botues:**

Prof. Dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Prof. Asoc. Dr. Kristaq Xharo (anëtar)

Prof. Asoc. Dr. Arshi Çela (anëtar)

Dr. Eranda Gjomema (anëtar)

Elona Dhëmbo, Kandidate për Dr. (anëtar)

**Redaktor përgjegjës:**

Elira Hroni – MA

**Ndihmuan në përgatitje:**

Besiana Kuçi

Egest Gjokutaj

Zyra Xhafa

---

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** dhe **Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund**

## PËRMBAJTJA

Parathënie .....	7
<b>Chris SMITH</b> Marrëdhëniet midis Bashkimit Europian dhe NATO-s .....	9
<b>Michael F. Harsch</b> NATO dhe OKB: partneritet me potencial? .....	48
<b>Dorjan Gjozi</b> Kompetencat e Nato-s dhe të BE-së në sektorin e krimit kibernetik dhe terrorizmit kibernetik .....	73
<b>Anamaria Gheorghe</b> Roli i NATO-s në Mjedisin e Sigurisë të Azisë Qendrore .....	94
<b>Dr. Klaus Wittmann</b> Konferenca e Rigës .....	110
<b>Pëteris Veits</b> Roli global i NATO-s: me një fokus në Lindjen e Mesme .....	125
<b>Nga Edlira Osmani</b> Roli Global i NATO-s: Me një fokus në lindjen e mesme.....	134
<b>Abstracts .....</b>	<b>141</b>



## PARATHËNIE

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave mbi reformat dhe performacën e sektorit të sigurisë në përgjithësi, si: trendet europiane dhe globale të sigurisë, debati aktual dhe i ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera botërore. Ky numër i revistës për “Çështjet Europiane dhe të Sigurisë” vjen më një tematikë të veçantë mbi *“Perspektivat e Reformave në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri: Reforma dhe Sfidat të Strukturave Rregullatore, Ligjore dhe Kushtetuese”*.

Kjo fushë studimi, duke u përqendruar te sfidat dhe problemet e reformave ligjore në sektorin e sigurisë në vend, sjell njëkohësisht një panoramë më të gjerë të perspektivës europiane në qeverisjen e sektorit të sigurisë apo të aktorëve të tjerë që kanë një impakt domethënës mbi këtë sektor.





**Chris SMITH**

## MARRËDHËNIET MIDIS BASHKIMIT EUROPIAN DHE NATO-S

### **Abstrakti**

Ky shkrim, në kuadër të projektit “*Euro Broad Map*”, përqendrohet në marrëdhëniet midis NATO-s dhe BE-së. Në qendër të kësaj analize janë ndryshimet si rrjedhojë e përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe evolucionit të Politikës së Jashtme të Bashkimit Europian.

“Pranvera arabe” dhe ndërhyrja në Libi në veçanti, ndihmojnë për të nxjerrë në pah ndryshimet dhe pritshmëritë kryesore në lidhje me këto dy institucione. Gjithashtu, ndarja e detyrave (fuqi e fortë për NATO-n dhe fuqi e butë për BE-në) shqyrtohet në mënyrë kritike.

*“NATO dhe BE nuk janë miq të mirë. Megjithëse anëtarësimi në të dy institucionet është pothuajse identik, ato mezi flasin me njëri-tjetrin”*.

*(Valasek, T., 2007, Udhërrëfyesi për marrëdhëniet më të mira BE-NATO, Centre for European Reform briefing note, f. 1).*

### **Pikënisjet: matematika bazë**

Pyetjet në lidhje me natyrën e marrëdhënieve ndërmjet NATO-s dhe BE-së janë njëherazi, tërësisht të thjeshta dhe shumë të ndërlikuara për t’iu përgjigjur. Ato janë të thjeshta, sepse në kuptimin ligjor apo institucional marrëdhënia është e përcaktuar qartë, në fakt, në aspektin institucional, BE-ja nuk ka asnjë marrëdhënie me NATO-n, ndërsa Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes (PEMS<sup>1</sup>) ka marrëdhënie me NATO-n (në kuptimin e aktorëve dhe institucioneve të saj). Megjithatë, shfaqen ndërlikime, sepse marrëdhënia formale paraqet qartazi vetëm

---

<sup>1</sup> Që pas Lisbonës PEMS (Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë) është ripagëzuar si PPMS (Politika e Përbashkët e Mbrojtjes dhe e Sigurisë), do të përdoret ky emërtim vetëm në rast se bëhet një referencë e qartë historike për PEMS para Lisbonës.

një element të vogël në tërësinë e marrëdhënieve midis dy organizatave. Problemi është se marrëdhënia joformale është afirmuar në **historinë e**, dhe përbën një komentuar të vazhdueshëm të zhvillimit të marrëdhënies së gjerë trans-Atlantike në përgjithësi që nga viti 1945 dhe në veçanti për ndryshueshmërinë e natyrës së Politikës së Jashtme aktuale amerikane (sidomos fokusi i saj në Evropë).

Gjithashtu, ndonëse zyra e shtypit të NATO-s do të niste pa dyshim menjëherë, analizat kundrejt një deklarate inkurajuese që përshkruan arritjet e saj dhe dëshirën për të vazhduar punën së bashku me BE-në në disa fusha për arritjen e “multilateralizmit efektiv”<sup>2</sup>, do të ishte disi hipokrite të emërtohej kjo një “pikëpamje institucionale” plotësisht e jetësuar, pasi NATO është një organizatë ndërkombëtare e cila në fund të fundit pasqyron pikëpamjet (në shumës) të shteteve anëtare të saj<sup>3</sup>.

Përveç kësaj, situata është ndërlikuar edhe më tepër nga fakti se listat e anëtarësisë së NATO-s dhe BE-së, në pamje të parë, duken kaq të ngjashme ku 78% e anëtarëve të BE-së bëjnë pjesë gjithashtu në NATO, ndërsa 75% e anëtarëve të NATO-s bëjnë pjesë edhe në BE. Problemi është se, ndonëse kjo tingëllon inkurajuese dhe që favorizon zhvillimin e një pikëpamje institucionale të qëndrueshme dhe të përbashkët, realiteti është disi i paqartë për sa kohë që ndryshimet ndërmjet listave të anëtarësisë të të dyja organizatave mbeten më të rëndësishme sesa ngjashmëritë<sup>4</sup>. Për ta thënë hapur, njëri organ përmban

---

<sup>2</sup> Ideja e “multilateralizimit efektiv” u shfaq në diskutimet e politikave të jashtme Europiane në 2003 dhe u përdor nga Javier Solana si bazë për Strategjinë e parë të Sigurisë Europiane, *Një Europë e sigurtë në një botë më të mirë* (Këshilli Europian,

2003). Shih gjithashtu Gowan, R., (2008) “Objektivat globale të Strategjisë së Sigurisë Europiane: Multilateralizimi efektiv” të Biscop, S. dhe Andersson, J. J., Strategjia e Sigurisë së Këshillit Europian - formësimi i një Europe Globale, Londër, *Routledge*.

<sup>3</sup> Deklarata të tilla mund të gjenden në “NATO-BE: një partneritet strategjik” në faqen e internetit të NATO-s në: [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_49217.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49217.htm); dhe në “BE-NATO: kuadri për marrëdhënie të përhershme” në *websitin* e PEMS në: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/03-11-11%20Berlin%20Plus%20press%20note%20BL.pdf>

<sup>4</sup> 32 vende europiane (plus SHBA-ja dhe Kanadaja) janë anëtare të BE-së ose NATO-s. 21 janë anëtarë të të dyja organizatave: Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar. Pesë vende Europiane (plus SHBA-ja dhe Kanadaja) janë anëtarë të NATO-s, por jo të BE-së: Shqipëria, Kroacia, Islanda, Norvegjia dhe Turqia - të pesta janë anëtare të mundshme ose potenciale për anëtarësimin në BE.

“superfuqinë” e vetme të vërtetë globale dhe tjetri jo. Gjithashtu, njëri organ është me karakter tërësisht ndërqeveritar i mbështetur në konsensus për të krijuar politikën, ndërsa tjetri është shumë më pak, një strukturë tradicionale ku konsensusi mbetet i rëndësishëm, por nuk është e vetmja mënyrë e vendimmarrjes dhe ku përdoren shpesh negociatat ndërsektoriale<sup>5</sup>.

Për të ndërlikuar gjërat më tej, nëse nevojitej një ndërlikim i mëtejshëm, kandidatët e anëtarësuar në secilën strukturë nuk kanë gjasa të ndihmojnë në thjeshtimin e pamjes institucionale në masë të madhe. Ndërsa shumë nga ato vende Europiane që janë aktualisht anëtare të NATO-s, por jo të BE-së, ka gjasa të kërkojnë anëtarësim në BE në të ardhmen. Ato që janë anëtare të BE-së, por jo të NATO-s, për arsye të ndryshme, të gjithë, nuk ka gjasa që të duan të bashkohen me NATO-n. Kjo lë jashtë BE-së lojtarin kryesor të NATO-s, SHBA-të dhe një grup, të ashtuquajturit “ish-vende neutrale” në BE, të cilët nuk ka gjasa të bashkohen ndonjëherë me NATO-n. Kur përfshijmë në këtë përzierje Turqinë dhe procesin e pafundmë të aderimit të saj për në BE, mund të shohim se anëtarësia e NATO-s dhe BE-së nuk priret drejt bashkimit, së shpejti, të paktën, në kuptimin e lojtarëve të mëdhenj. Gjithashtu, tashmë është e qartë se “modeli i efektit zinxhir” (*conveyer-belt model*) që mbizotëroi pas Luftës së Ftohtë, sipas të cilit, aderimi në NATO çon në aderimin në BE, është shumë i kërcënuar. Ky model e paraqiste NATO-n dhe BE-në si dy anë të të njëjtit “projekt institucional të madh” për sigurinë europiane. Në lidhje me aderimin në BE, vetëm vendet nordike, joanëtare deri tani, kanë gjasa që të lejohen të aderojnë së shpejti dhe vendet e Ballkanit Perëndimor që në rastin më të mirë mund të aderojnë vetëm në një periudhë afatmesme, ndërsa pengesat politike, thellësisht të rëndësishme, mbeten në lidhje me çdo mundësi të anëtarësimit të Turqisë. Pjesërisht, për shkak të ngadalësimit të “efektit zinxhir” të aderimit

---

Gjashtë vende europiane janë anëtare të BE-së, por jo të NATO-s: Austria, Qipro, Finlanda, Irlanda, Malta dhe Suedia - anëtarësimi i ndonjërit prej tyre në NATO është cilësuar “si mjaft i pamundur” në të ardhmen e afërt.

<sup>5</sup> Për shembull, shih punën e redaktuar nga *Evans, P. B., Jacobsen, H. K., dhe Putnam, R. D.*, (1993) “*International Bargaining and Domestic Politics: Double-Edged Diplomacy*” (Berkeley: Gazeta e Universitetit të Kalifornisë) dhe sidomos kapitullin e Putnamit në këtë vëllim. “*Diplomacy and Domestic*”, “*Politics: The Logic of Two-Level Games*”. Në literaturën e BE-së dhe të NATO-s, *Janne Haaland Matlary* (2009) mbështetet kryesisht në punën e Putnamit në librin “*European Security Dynamics: In the new national interest*” (Basingstoke: Palgrave MacMillan).

në BE, edhe aderimi i ardhshëm në NATO duket se ka gjasa të kufizohet deri me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ka gjasa të përjashtojë përfundimisht zgjerimin, që ndoshta është parashikuar më parë në zonat e Detit të Zi dhe Kaukazit.

Pavarësisht rëndësisë së çështjeve të marrëdhënieve SHBA-BE që u përmendën më sipër, mungesës së një marrëdhënie të fortë institucionale mes NATO-s dhe BE-së dhe problemet që lidhen me planet kontradiktore të tanishme dhe të ardhshme për anëtarësimin në këto dy organe, duhet marrë në konsideratë edhe çështja e ekonomisë. Ndikimi specifik i krizës financiare dhe tensionet që ajo sjell në lidhje me shpenzimet e mbrojtjes europiane do të diskutohen më poshtë. Megjithatë, ndikimi i krizës së borxhit kombëtar në Eurozonë dhe ndikimi i tij në Integrimin European në përgjithësi, mbetet një faktor i rëndësishëm në marrëdhëniet më të gjera trans-Atlantike, sepse ai do të përcaktojë natyrën e procesit të integritit për gjeneratën e ardhshme<sup>6</sup>.

Së bashku, këto çështje të rëndësishme, Politika e Jashtme amerikane dhe ndryshimi i natyrës së angazhimit amerikan në Europë dhe integrimi e zgjerimi european, përcaktojnë kufijtë brenda të cilave është dhe do të formësohet marrëdhënia institucionale në rritje midis NATO-s dhe BE-së. Historikisht ato kanë qenë procese të ndara, por të ndërlidhura, ku europianët ishin shumë të interesuar për të inkurajuar dhe përkrahur angazhimin e SHBA-ve ndaj mbrojtjes dhe sigurisë europiane, ndërsa amerikanët ishin të vetëdijshëm për rëndësinë e Europës për mbrojtjen e tyre. Megjithatë, këto arsyetime të pranura tradicionalisht, po kërcënohen gjithnjë e më shumë tani. Europa nuk është më vendi i sigurisë së SHBA-ve, ndërsa europianët duket se janë ose të paaftë, ose jo të gatshëm qoftë për të paguar mbajtjen e një angazhimi të plotë të SHBA-ve në Europë, ose për të paguar që ta zëvendësojnë atë në mënyrë efektive.

### **Përfundimet dhe fillimet - nga periudha pas Luftës së Ftohtë në periudhën pas saj**

Që pas përfundimit të Luftës së Ftohtë “debati institucional” mbi sigurinë kishte të bënte *nën zë (sotto voce)* me çështjen nëse eventualisht Bashkimi European do të shndërrohej në një

<sup>6</sup> Pas planit të shpëtimit të Greqisë në mars të vitit 2010, mënyra se si u morën vendimet dhe implikimet për menaxhimin ekonomik në mbarë Europën, çuan në diskutime të mëdha për dominimin e mundshëm në rritje të Gjermanisë në të ardhmen e procesit të integritit. Shih, për shembull, *Paul Taylor (26/3/2010), “Euro zone deal points to a more German Europe”, Reuters.*

aktor politik mjaft të fortë dhe të qëndrueshëm që të zëvendësonte NATO-n si institucionin kryesor për sigurinë Europiane. Ky diskutim është pasqyruar nga një seri e gjerë debatesh politiko-ideologjike mbi “rënien” e SHBA-ve dhe “ngritjen e Europës” në shekullin e 21<sup>7</sup>.

Fundi i Luftës së Ftohtë e transformoi krejtësisht Europën dhe kufijtë e projektit Evropian. Pas “ndërprerjes” së integritit të viteve 1980 dhe gjatë viteve 1990 dhe pas fundit të shekullit u vu re një progres i qëndrueshëm në secilën prej katër fushave kryesore të integritit, ekonomik/monetar, qytetar/Europës sociale, politikës së jashtme dhe procesit të zgjerimit. Megjithatë, në një këndvështrim më të përgjithshëm, ndryshimi i ngadaltë dhe i vazhdueshëm në natyrën e shtetit, sipas *Bobbit*<sup>8</sup>, çoi në një metamorfozë nga sistemi i dominuar nga shteti-komb i shekujve 19 dhe 20 në shtetin e bazuar në sistemin e tregtisë së lirë të shekullit të 21. Kjo krijoi një botë shumë të ndryshme nga ajo që kishte ekzistuar para vitit 1989 dhe solli shumë probleme të reja.

Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik shënoi fundin e kërcënimit bërthamor “për mbijetesë”, por në vend të tij u shfaqën një mori konfliktesh të dorës së dytë dhe

---

<sup>7</sup> Për të parën, shih për shembull Kagan, R., (2002) *“Of Paradise and Power”: America and Europe in the New World Order* (New York: Knopf); Nye J.S., (2004) *Soft Power. The Means to Success in World Politics* (New York: Public Affairs); Vedrine, H., (2007) *History Strikes Back - How States, nations and conflicts are shaping the 21st century* (Washington DC: Brookings Institution Press); Darwin, J., (2007) *After Tamerlane: The Rise and Fall of Global Empires, 1400-2000* (London: Penguin); Kagan, R., (2008) *The Return of History and the End of Dreams* (London: Atlantic Books) dhe Chua, A., (2009) *Day of Empire - How Hyperpowers Rise to Global Dominance, and how they fall* (New York: First Anchor Books). Shiko gjithashtu Reid, T. R., (2004) *The United States of Europe* (London: Penguin); Rifkin, J., (2004) *The European Dream - How Europe’s vision of the future is quietly eclipsing the American Dream* (Cambridge: Polity Press); McCormick, J., *The European Superpower* (Basingstoke: Palgrave MacMillan); Leonard, M., (2005) *Why Europe will run the 21st Century* (London: Harper Collins); Cooper, R., (2007) *The Breaking of Nations - Order and Chaos in the 21st Century* (London: Atlantic Books) and Youngs, R., (2010) *Europe’s Decline and Fall - The Struggle against Global Irrelevance* (London: Profile Books).

<sup>8</sup> Për një ekspozim të teorisë se ndryshimet në natyrën e shtetit sjellin në një mënyrë progresive ciklike, ndryshime në natyrën e sistemit ndërkombëtar që ato përbëjnë, shih *Bobbit*, P., (2002) *The Shield of Achilles: War, Peace and the Course of History* (Londër: Penguin). Ndryshimi i natyrës së shtetit gjatë globalizimit është një çështje e gjerë, emërtime të tjera për formën e shtetit përfshijnë shtetin liberal dhe shtetin “në shërbim”. Shiko Laffan, *Brigid*, R. O’Donnell dhe M. Smith (2000) *Europe’s experimental union: Rethinking integration* (Londër: Routledge).

mosmarrëveshjes fetare, sektare, nacionaliste, etnike, socio-kulturore, ekonomike dhe mjedisore, të shtypura më parë nga sistemi i marrëdhënies ndërkombëtare gjatë Luftës së Ftohtë, të cilat shumë shpejt u bënë pjesë e “çështjeve të sigurisë” në kuadër të të ashtuquajturës “agjenda e sigurisë së re”<sup>9</sup>. Europa ishte tashmë e rrethuar nga “paqëndrueshmëri” potenciale nga Ballkani në Afrikën e Veriut, Lindjen e Mesme, Azinë Qendrore, Europën Lindore dhe Kaukazin. Rreziku ekzistencial, por i menaxhuar në mënyrë efektive i Luftës së Ftohtë, u zëvendësua me një sërë kërcënimesh ndaj paqes dhe sigurisë së përgjithshme në Europë të një niveli më të ulët, por krejtësisht të pamanaxhuar.

Megjithatë, i rëndësishëm është fakti se kjo ishte një botë në të cilën BE-ja pritej të rriste ndikimin e saj. BE-ja shihej si një fuqi ekonomikisht në rritje dhe gjithnjë e më shumë edhe politikisht, me një të ardhme të shkëlqyer në të cilën ishte pozicionuar mirë për të shfrytëzuar ndryshimin e natyrës së marrëdhënies ndërkombëtare pas vitit 1989. Fundi i “kërcënimit” ekzistencial i Luftës Bërthamore dhe shkombëtarizimi (*de-nationalisation*) dhe çterritorializimi (*de-territorialisation*) i sigurisë që pasoi, ndihmoi në zhvendosjen e fokusit nga shteti në drejtim të nivelit multilateral duke siguruar kështu “hapësirën” për një politikë funksionale të sigurisë të bazuar jo në mbrojtjen e atdheut, por në çështje më pak të prekshme të tilla si: të drejtat e njeriut dhe siguria individuale<sup>10</sup>. Për sa i përket aspektit të zhvillimit të “paradigmës së sigurisë njerëzore” të BE-së, qëllimi nuk ishte për të kërkuar “fitoren” në kuptimin tradicional, por në vend të saj të lehtësohej mundësia që “politika” të riafirmonte veten në një situatë konflikti. BE-ja, me fokusin e saj tradicional në një qasje multilaterale ndaj problemeve ndërkombëtare, duke reflektuar strukturat dhe mekanizmat e vet të brendshëm të përcaktuara për të nxitur konsultimet dhe kompromisin, të kombinuara me trashëgiminë tradicionale të saj të “fuqisë civile” në lidhje me Politikën e Jashtme, dukej se “përshtatet” plotësisht si një aktor në rritje në fushën e sigurisë pas Luftës së Ftohtë. Ky vizion i favorshëm u ekspozua shumë shpejt dhe rezultoi si i

<sup>9</sup> Dy punët “klasike” në këtë fushë janë Buzan, B., (1991) *People, States and Fear. An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era* (Hemel Hempstead: Harvester Wheatsheaf) dhe Ole Weaver et al. (1993) *Identity, Migration and the new Security Agenda in Europe* (Londër: Pinter Publishers).

<sup>10</sup> Shih Haaland-Matlary, J., (2009) *European Union Security Dynamics: In the New National Interest* (Basingstoke: Palgrave MacMillan) f. 23.

papërshtatshëm gjatë konflikteve që u krijuan nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, ku BE-ja e vuajti shumë faktin e të besuarit kaq shumë në retorikën e vet dhe, në fund të fundit, në paaftësinë e saj për të mbështetur këtë retorikë me veprime konkrete<sup>11</sup>.

Për sa i përket Politikës së Jashtme të BE-së, veçanërisht *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2008) përmbledhin në mënyrë të qartë fushat e tensionit që lindën në fund të Luftës së Ftohtë, duke identifikuar katër zgjedhje binare të cilat funksiononin si shqetësimet kryesore të “ngulitura në histori” në fushën e sigurisë Europiane deri në vitin 1989. Ato ishin zgjedhjet ndërmjet integritit European dhe solidaritetit Atlantik, fuqisë civile dhe fuqisë ushtarake, ndërqeveritarizmit (*intergovernmentalism*) dhe “Metodës Komunitare” dhe objektivave të jashtme dhe objektivat e ndërlidhura të integritit dhe identitetit<sup>12</sup>. Gjatë Luftës së Ftohtë u bënë zgjedhje të qarta në lidhje me solidaritetin e Atlantikut, fuqinë civile, ndërqeveritarizimin, integrimin dhe objektivat identitare. Megjithatë, këto zgjedhje tradicionale u vunë nën presion të madh gjatë periudhës pas Luftës së Ftohtë.

Ndonëse ky shkrim nuk ka për qëllim të bëjë një përshkrim historik të metamorfozës së gjendjes së sigurisë Europiane gjatë njëzet viteve të fundit, është e rëndësishme të theksohet se nuk është realizuar ende vizioni optimist i një Europe të çliruar nga detyrimet e Luftës së Ftohtë për t'i ndihmuar, për t'i dhënë formë botës pas Luftës së Ftohtë sipas imazhit të vet institucional-multilateral.

Në fakt, siç ka vënë në dukje Toje në fillim të shpërthimit të konfliktit të armatosur midis Ruisë dhe Gjeorgjisë:

*Për gati dy dekada, koha jonë u përcaktua si një shtojcë: epoka pas Luftës së Ftohtë. Shumë mendonin se ne po shkonim drejt një shoqërie globale të bazuar në ideale e përbashkëta*

<sup>11</sup> Për një llogari të krizës bashkëkohore shiko *Smith, C. J.*, (1996) *Conflict in the Balkans and the possibility of a European Union Common Foreign and Security Policy, International Relations*, XIII (2).

<sup>12</sup> *Keukeleire, S.*, dhe *MacNaughton, J.*, (2008) *The Foreign Policy of the European Union (Basingstoke: Palgrave MacMillan)*. Ndoshta impakti më domethënës i fundit të Luftës së Ftohtë ishte që shpërbërja e Bashkimit Sovjetik i dha fund idesë se Bashkimi European, mund të bëhej një shtet në kuptimin tradicional - edhe federatë shtetesh - duke kërkuar vendosjen e një kufiri të fortë në lindje dhe përjashtimin e përhershëm të Ruisë nga BE-ja. Anëtarësimi në BE i vendeve të Europës Lindore që pasoi në vitin 2004 i ndryshoi rrënjësisht llogaritjet e integritit. Ky argument është dhënë nga *Jean - Marie Gueherro* (1993: 77) in *La Fin de la démocratie* (Paris, *Flammarion*) quoted in *Majone, G.*, (2009) *Europe as the Would-be World Power - The EU at Fifty* (Kembrixh: CUP).

dhe të rregulluara nga institucionet mbikombëtare. Një botë ku “fuqia e butë” dhe tendencat ndërkombëtare do të ishin më të rëndësishme se interesat dhe burimet e fuqisë. Ka shenja që ne jemi duke ecur në drejtim të kundërt.

Toje, A., (2008) në BE, “NATO dhe Mbrojtja Evropiane - Një tren i ngadaltë që vjen”, *Occasional Paper*, no. 74, *European Institute for Security Studies*, f. 8.

Bota ndryshoi sërish. Mbështetja në Aleancën e Atlantikut nuk ishte e mjaftueshme dhe u bë i nevojshëm Evropianizimi, në njëfarë mase, të paktën i dispozitës së sigurisë dhe të mbrojtjes. Por, sapo Bashkimi Evropian miratoi mekanizmat për të qartësuar nga ana procedurale dhe institucionale qëndrimin e tij ndaj fuqisë civile apo “imazhit të korporatës” të metat e përdorimit, vetëm të kësaj qasje, u bënë të qarta. Në përgjigje të problemeve që u shoqëruan me ndarje politike ndaj luftës në Irak, Traktati Kushtetues dhe kompromisi i mëvonshëm i Traktatit Reformues të Lisbonës i dha fund strukturës së shtyllave të përdorura, që pas Mastrihtit me një konsolidim (për të mos thënë komunitizim (*communitisation*) të strukturave të politikës së jashtme dhe të sigurisë, i cili zëvendësoi marrëveshjet ekzistuese *ad hoc*. Së fundi, u bënë përpjekje reale për të siguruar që BE-ja të kishte një ndikim të dukshëm në çështjet konkrete të Politikës së Jashtme dhe jo thjesht të përdorej për të forcuar koordinimin e brendshëm evropian, duke u përpjekur të adresojë pyetjet e përhershme mbi “të qenët aktor” dhe “hendekun” kapacitete/ pritshmëri.

Data e saktë, e fundit e periudhës së Pasluftës së Ftohtë, mbetet çështje e disa hamendësimeve, efekti i një sërë zhvillimesh globale të tilla, si: luftërat në ish-Jugosllavi, sulmet e 11/9 dhe përgjigja evropiane ndaj tyre, “lufta kundër terrorit” që pasoi më vonë, fuqizimi i BRIC (Brazil, Rusi, Indi, Kinë) dhe i Kinës në veçanti, kriza financiare globale (edhe pse kryesisht perëndimore) e vitit 2007, kanë ndikuar të gjitha në mënyrë të konsiderueshme si në “pikëpamjen e qëndrueshmërisë” së sigurisë evropiane të *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2008) të parashtruar më sipër, ashtu edhe në vizionin optimist të Pasluftës së Ftohtë për vendin e ri të Europës në botë, të nxitur menjëherë pas Luftës së Ftohtë.

Ndërsa debati në lidhje me rënien e SHBA-ve mbetet i vazhdueshëm, është gjithnjë e më qartë se nuk janë përmbushur pritshmëritë në lidhje me shfaqjen e një aktori politik Evropian më të fortë. Por është e vërtetë që shumica e BE-së tani përdor Euro-n, dhe po BE-ja tani ka një Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, shërbimin e vet diplomatik dhe mundësinë për



të gjeneruar, mbështetur dhe drejtuar operacione të vogla me forca ushtarake<sup>13</sup> në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes; por, ndonëse mjetet mund të jenë teorikisht “në dispozicion” shpesh mungon konsensusi dhe miratimi politik për përdorimin e tyre<sup>14</sup>. BE-ja nuk e ka “mbushur hendekun” dhe “Perëndimi” bipolar, koncepti në qendër të shumicës së debatit në këtë fushë që nga fillimi i viteve 1990, nuk është materializuar.

Nocioni i BE-së, pas Luftës së Ftohtë, si një fuqi “në ngritje” me rëndësi të madhe ekonomike dhe si aktor kryesor në gjenerimin e normave ndërkombëtare, ashtu dhe në operacionet e paqes dhe stabilitetit, në nivel global dhe rajonal, pasqyrohet qartë nga Javier Solana në lidhje me Strategjinë Evropiane të Sigurisë:

*Meqenëse BE-ja rritet duke përfshirë 25 vende me rreth 450 milionë banorë, duke prodhuar një të katërtën e PBB-së në botë, ne kemi për detyrë të marrim përsipër përgjegjësitë tona në skenën botërore. Si një aktor global, Bashkimi duhet të përballet tani me përgjegjësinë e tij për siguri globale.*

Solana, J., (2003) “Strategjia e Sigurisë së BE-së: Implikimet për rolin e Europës në një botë në ndryshim”, fjalimi i EUHR, 12 nëntor, Berlin.

Qartazi, këto pohime tani duken paksa të cekëta. BE-ja shihet nga palët e treta si një forcë ekonomike gjithnjë e më shumë në rënie në terma relativë, gjenerimi i normave përmes “fuqisë së butë” ka rezultuar i vështirë, vendet e BE-së e kanë të vështirë të mbrojnë idenë se kontinenti i tyre “postmodern” mund të izolohet nga kaosi i botës së jashtme, dhe operacionet ushtarake të BE-së kanë dështuar që të sjellin risi në veprimet e politikave të mëparshme.

Prandaj marrëdhëniet aktuale BE-NATO duhen parë në këtë prizëm. Veçanërisht, për mënyrën se si kjo nxjerr në pah zhvillimet e brendshme evropiane dhe për mënyrën se si shihet dhe kuptohet konstruktiv evropian nga aktorët e tjerë joanëtarë të BE-së.

<sup>13</sup> Për informacion për të gjitha operacionet e BE-së deri në vitin 2007, shih monografinë e shkurtër nga Bastian Giegerich (2008) “European Military Crisis Management: Connecting ambition with reality” (IISS: Adelphi Paper 397) dhe për një analizë më të detajuar, Merlingen, M., and Ostrauskaite, R., (Eds) “European Security and Defence Policy: An Implementation Perspective”, (Londër: Routledge).

<sup>14</sup> Kjo është një e vërtetë e NATO-s edhe kur amerikanët zgjedhin që për çfarëdo arsyeje të mos udhëheqin, siç ne do ta shohim në kontekstin e “një rasti studimi” të krizës në Liban të përshkruar më poshtë.

## Mbrojtja dhe siguria e BE-së: Kuadri institucional, pas Lisbonës

Përpara se të paraqes shkurtimisht kuadrin institucional pas Lisbonës në lidhje me Politikën e Jashtme të BE-së dhe bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes është ndoshta e nevojshme të nënvizojmë çështjen kryesore këtu në lidhje me "sjelljen e BE-së" në kuadër të NATO-s. Shtetet e BE-së nuk veprojnë, madje as nuk përpiqen të veprojnë, si një grupim i koordinuar vendesh në këtë forum multilateral. Kur diskutohen çështjet e përgjithshme të NATO-s nuk ka një takim paraprak të "grupit të vendeve BE-së" i cili të përcaktojë një "qëndrim të BE-së" dhe të miratojë një pozicionim të vendosur që do të diskutohet me vendet anëtare të NATO-s dhe joanëtare të BE-së, kryesisht me SHBA-në, Kanadanë dhe Turqinë<sup>15</sup>. Gjithashtu, komisioni i BE-së luan një rol shumë të kufizuar në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, përveç lehtësimit të veprimeve të PPJS të cilat kërkojnë "mjetet" e KE-së (p.sh. në respektimin e sanksioneve, financimet që lidhen me tregtinë ose zhvillimin) - sërish ndryshe, për shembull nga situata në OBT, ku vetëm Komisioni ka të drejtën e ndërmarrjes së iniciativave për sa i përket përcaktimit të agjendës së politikave.

Megjithatë, në lidhje me politikëbërjen e jashtme të BE-së më gjerësisht, siç vjenë në dukje *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2008: 110):

Edhe pse formalisht shtylla e 2-të duket se është hapësira për Politikën e Jashtme të BE-së, në praktikë, meqenëse ka një disponibilitet më të madh të instrumenteve dhe linjave buxhetore të dobishme në shtyllën e parë, si dhe autonomi relative e Komisionit në Zbatimin e Politikave dhe Buxheteve të KE-së, do të thotë se shtylla e parë përfshihet më shumë në politikëbërjen e jashtme sesa pritet nga një pikëpamje thjeshtë institucionale.

PPJS nuk është tamam një politikë "e përbashkët" - në kuptimin që pritej të dilte në përgjithësi në lidhje me reformat e Traktatit të Mاستrihtit - por më tepër një "mekanizëm koordinues", e cila merr *input*-e si nga Shtetet Anëtare, ashtu edhe nga institucionet e Komunitetit. Gjithashtu, Shtetet Anëtare ndjekin paralelisht

<sup>15</sup> Kjo pikë është e bërë, për shembull, nga *Hanna Ojanen* (2011), *The EU as a security actor: in and with the UN and NATO* (p. 72) in *Blavoukos S and Bourantonis D (eds) The EU Presence in International Organizations* (London: Routledge). Shiko gjithashtu *Tomas Valasek* (2007) *The Roadmap to better EU-NATO relations* (Centre for European Reform briefing note) f. 5. "Nëse BE-ja ka insistuar që të ketë personalitetin e vet në NATO, përpara se Europa të mund të flasë me një zë, ai vetëm do t'i frustrojë amerikanët dhe do t'i dekurajojë që ta marrin NATO-n seriozisht".

politikat e tyre të jashtme kombëtare dhe ushtrojnë kontroll mbi burimet fiskale, diplomatike dhe ushtarake, që potencialisht mund të aksesohen nga BE-ja. Përgjithësisht, kjo e pengon BE-në nga të vepruarit në mënyrë të qëndrueshme dhe të parashikueshme me aktorët e tjerë ndërkombëtar<sup>16</sup>.

Sipas marrëveshjes së Mastroihtit, të strukturuar në shtylla, PPJS mbeti ndërqeveritare në natyrë, dhe për rrjedhojë institucionalisht dhe strukturalisht e ndryshme në krahasim me elementin e Marrëdhënieve me Jashtë të “Politikës së Jashtme”<sup>17</sup> të BE-së që është më tepër “komunitare”.

Në këtë kontekst, Gegout jep një tipologji të dobishme të “çështjeve të PPJS”, duke qartësuar llojet e ndryshme të Politikës së Jashtme të prodhuara nga BE:

- Çështje, ekskluzivisht të PPJS, të tilla, si: deklarata, qëndrime të përbashkëta, veprime të përbashkëta dhe strategji të përbashkëta (Politika Deklarative);

- Çështje të përziera të PPJS-KE, që do të thotë: çështjet e PPJS kanë nevojë për vendimet e KE-së që të implementohen (Çështjet e “Fuqisë së butë”);

- Çështjet e PEMS, që kanë të bëjnë tërësisht me Politikën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë (“Fuqi” e fortë)<sup>18</sup>.

Megjithatë, duhet theksuar edhe njëherë se Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së BE-së nuk e zëvendëson Politikën e Jashtme dhe të Mbrojtjes Kombëtare, por e plotëson më tepër atë. Ky realitet ruhet në lidhje me kompetencat e BE-së dhe ndarjes së pushtetit. BE-ja mund të veprojë vetëm brenda kufijve të kompetencave të dhëna nga shtetet anëtare me anë të traktateve. Në këtë mënyrë, kompetencat që nuk i janë dhënë i mbesin shteteve anëtare, siç e vënë në dukje *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2008: 99), ky parim është thelbësor për të kuptuar natyrën e Politikës së Jashtme të BE-së. Kjo nënkupton se Bashkimi Europian nuk ka baza të përgjithshme ligjore që ta

<sup>16</sup> Toje, A., (2010), “*The European Union as a Small Power - After the Post-Cold War*” (Basingstoke: Palgrave MacMillan), f. 16.

<sup>17</sup> Është e rëndësishme të theksoj se tërësia e “Politikave të Jashtme”, në një kuptim të gjerë, nuk mund të kufizohet me PPJS, pasi kjo do t'i jepte asaj një fokus të ngushtë. Në të fakt, gjatë viteve 1990, pas frenimit për një përjasje politike më ambicioze në Jugosllavi, Komisioni i BE-së u përpoq të zhvillonte dinamikat e veta “komunitare” për Politikën e Jashtme në lidhje me Politikën e Tregtisë, zhvillimin e bashkëpunimit, marrëveshje të ndryshme të asociimit dhe të zgjerimit etj., shih *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2008) f.12.

<sup>18</sup> Gegout, C., (2010) *European Foreign and Security Policy: States, Power, Institutions and American Hegemony* (Toronto: Gazeta e Universitetit të Toronts), f.10.

autorizojnë atë që të veprojë vis a vis me mjedisin e jashtëm. Prandaj kur vlerësojmë politikën e jashtme të BE-së, nuk duhet të presim asnjëherë që BE-ja të ketë një politikë të jashtme përjashtuese ose gjithëpërfshirëse. Në fakt, duke pasur parasysh kompetencat e saj institucionale, pritsshmëria duhet të jetë që BE-ja nuk do të veprojë në disa aspekte të Politikës së Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe e Mbrojtjes ishte qartazi një element i rëndësishëm në procesin e Traktati Reformues, ku më shumë se një e treta e ndryshimeve të bëra traktateve, lidhej në një mënyrë apo tjetër me këtë zonë të veçantë të politikës, ndërsa procesi i reformimit, në tërësi, u konsiderua se e bënte BE-në “një aktor global më efektiv”. Si i tillë, Traktati Reformues i Lisbonës u përpoq të sillte një sërë ndryshimesh të rëndësishme për mënyrën se si Politika e Jashtme operonte në kontekstin e BE-së, përkatësisht:

- Shpërbëri sistemin e shtyllëzuar dhe grupoi veprimtarinë e jashtme të Bashkimit nën një titull të vetëm (Titulli V)<sup>19</sup>;

- Bashkimi, si një i tërë, jo vetëm KE-ja, mori “personalitet juridik”;

- U krijua një përfaqësues i lartë për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (që kombinon postet e përfaqësuesit të PPJS-ës dhe komisionarin për Marrëdhënie të Jashtme) që drejton Shërbimin e ri të Veprimit të Jashtëm;

- U krijua një posti i ri i Presidentit të Këshillit Evropian; nxitja në mënyrë të konsiderueshme e “Detyrave të Peterburgut”<sup>20</sup>; krijimi i një “klauzole të re të solidaritetit të BE-së” dhe ngritja e Agjencisë Europiane të Mbrojtjes (që merret me çështjet e prokurimit të pajisjeve ushtarake);

---

<sup>19</sup> Dallimi *de facto*, midis shtyllave një dhe dy, gjithsesi mbetet në lidhje me marrëdhëniet e jashtme nga njëra anë, dhe në dorë të Politikave të Jashtme dhe të Mbrojtjes nga ana tjetër, si çështje që kanë të bëjnë me diskutimet e mëparshme në kontekstin e Marrëveshjes për Funkcionimin e BE-së (TFEU), ndërkohë që më pas është diskutuar në bazë të Marrëveshjes së Bashkimit Europian (TEU). Shih *Gegout*, po aty, *footnote* 1, f. 199.

<sup>20</sup> “Detyrat fillestare të Peterburgut” krijuan një formë të integruar të Politikave Europiane të Mbrojtjes dhe të Sigurisë (PEMS). Ato u përfshinë në mënyrë të qartë në Marrëveshjen e Bashkimit Europian (Neni 17) dhe mbulojnë veprime të ndryshme të lidhura me detyrat humanitare dhe të shpëtimit, paqeruajtjen, paqebërjen dhe menaxhimin e krizave. Këto detyra nuk ishin vendosur në Deklaratën e Peterburgut të miratuar nga Këshilli i Ministrave të Bashkimit Europian Perëndimor (BEP) në qershor të 1992-shit. Këtu, Shtetet Anëtare të BEP deklaruan gatishmërinë e tyre për të vënë në dispozicion të BEP, por edhe të NATO-s e Bashkimit Europian, njësitë ushtarake në të gjithë spektrin forcave të armatosura tradicionale të tyre.

- I shtoi listës fillestare të detyrave të tij çarmatimin e përbashkët, stabilizimin pas konfliktit dhe luftën kundër terrorizmit, duke zgjeruar listën e detyrave të Petërburgut;
- U krijua mundësia e bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar (PESCO).

Fokusi në detyrat humanitare dhe të shpëtimit, detyrat e paqeruajtjes dhe menaxhimit të krizave, duke përfshirë dhe paqebërjen nga deklarata fillestare e BEP nuk reflekton vetëm gjendjen ekzistuese të sigurisë europiane në vitin 1992, por gjithashtu një vlerësim të kryesimit të NATO-s në kuptimin institucional dhe të historisë së kompetencave të BE-së në fushën e Politikës së Jashtme, e lidhur specifikisht me traditën e “fuqisë civile”. Si e tillë, ndonëse të gjitha aspektet e mbrojtjes dhe të sigurisë duhet të trajtoheshin sipas këtij kuadri, ishte e qartë që mbrojtja tradicionale territoriale do të mbetej kompetencë e NATO-s, ndërsa çështjet e “agjendës së re të sigurisë”, në përputhje me përhapjen e çterritorializimit dhe shkombëtarizimit të mbrojtjes, u miratuan nga BEP/BE. Ky qëndrim u forcua më tej pas zgjerimit të BE-së në vitin 1995 me anëtarësimin e Austrisë, Suedisë dhe Finlandës. Në fakt, Suedia dhe Finlanda luajtën një rol kryesor në promovimin, miratimin dhe zhvillimin e potencialeve civile të BE-së për menaxhimin e krizave së bashku me ato të menaxhimit ushtarak të krizave, e theksuar që me formulimin fillestar të detyrave të Peterburgut<sup>21</sup>. Megjithatë, pavarësisht këtyre përparimeve, Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së BE-së dhe dispozitat e mbrojtjes, të cilat formojnë një pjesë të asaj fushe, politike, mbeten përfundimisht ndërqeveritare, në fakt, siç vë në dukje Toje: “Edhe pse, sigurisht një arritje, traktati është larg të bërit të BE-së një shtet me një ushtri, një kushtetutë dhe një politike të jashtme siç e ka quajtur *Joschka Fisher* në vitin 1998”<sup>22</sup>.

Ndërsa Verola e thekson në mënyrë të ngjashme:

*“Dispozitat e PPJS nuk i kufizojnë kompetencat e shteteve anëtare në çështjet e Politikës së Jashtme. Ato nuk i japin Komisionit European kompetencën e iniciativës dhe nuk e cenojnë natyrën specifike të Politikës së Përbashkët të Sigurisë së Shteteve Anëtare”*<sup>23</sup>.

<sup>21</sup> Suedia dhe Finlanda advokuan për përfshirjen e detyrës së menaxhimit të krizave të Peterburgut (detyrat humanitare dhe të shpëtimit, paqeruajtjen, paqebërjen dhe menaxhimin e krizave) në Traktatin e Amsterdimit të 1997, duke favorizuar forcimin e aftësisë së Evropës së pavarur për të vepruar në këto zona. Shih, për shembull, Toumioja, E., and Lindh, A., (30/4/2000) “*Katastrofhjalpen duget inte*”, *Dagens Nyheter*.

<sup>22</sup> Toje (2010), ibid p. 22.

<sup>23</sup> N. Verola (2010) “*The New EU Foreign Policy under the Treaty of Lisbon*” in F. Bindi (ed) “*The Foreign Policy of the European Union: Assessing Europe’s Role in the World*” (Washington DC: Brookings).

Tashmë duket e qartë që mbetet ndryshimi tradicional ndërmjet “metodës komunitare” të shtyllës së parë dhe ndërqeveritarizmit të shtyllës së dytë. Megjithatë, një linjë mendimi domethënëse sugjeron që kjo duhet parë më tepër si vazhdimësi sesa si një vijë ndarëse. *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2008: 66) argumentojnë se si formalisht, ashtu edhe në praktikë, ndarja ndërmjet shtyllave dhe metodave nuk është e qartë.

Në veçanti, kjo lidhet me diskutimin e përgjithshëm akademik të proceseve të dyfishta të “Europianizimit” dhe “Brukselizimit”, në lidhje me politikën e BE-së në tërësi.

Në përgjigje të kërkesave të ngritura për këtë, përgjatë viteve të fundit, kanë ndodhur ndryshime domethënëse për sa i përket mënyrës se si BE-ja trajton çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Ndonëse më parë, për shembull, çështja e mbrojtjes Evropiane ishte “tabu” dhe e anashkaluar qëllimisht nga BE-ja për të mos rrezikuar integritetin e aleancës së Atlantikut me SHBA-të. Ajo ndiqet tashmë në mënyrë aktive për të ruajtur marrëdhënien me Aleancën e Atlantikut dhe për të ndihmuar në mbajtjen e njëfarë niveli të angazhimit të trupave amerikane për mbrojtjen evropiane.

### **Marrëdhëniet NATO-BE (PEMS-NATO) - “Berlin Plus” dhe më tej**

Siç u theksua edhe më sipër, mbrojtja për një kohë të gjatë ka qenë një subjekt “tabu” për sa i përket integritetit evropian. Pas përfundimit të Luftës së Koresë, ShBA-ja zgjodhi që të përmbushte kërkesat e saj për sigurinë në Europë nëpërmjet NATO-s. Kësisoj, detyra e NATO-s siç u përkufizua shkurtimisht prej *Lord Ismay*-t (Sekretari i Parë i Përgjithshëm i NATO-s) ishte të “mbante rusët jashtë, amerikanët brenda dhe gjermanët poshtë.” NATO mbeti institucioni kryesor dhe i pakundërshtueshëm<sup>24</sup> për mbrojtjen dhe sigurinë evropiane deri në vitet 1990-të. Megjithatë, që prej atëherë, ndërthurja e përfundimit të Luftës së Ftohtë, natyrës së ndryshueshme të rreziqeve të sigurisë dhe daljes në pah e një

<sup>24</sup> Përrjashtim kryesor këtu bënte qëndrimi i Francës, e cila nën udhëheqjen e *De Gaulle*, kishte lënë strukturën e përbashkët të integruar (edhe pse jo aleancën politike) të NATO-s në vitin 1967. Politika Gaulliste u përpoq të orientohej në një rrugë të ndryshme nga ajo e amerikanëve në politikën globale, e cila përfshinte promovimin e një përpjekjeje shumë më të madhe të mbrojtjes evropiane (e cila do të bazohej rreth BE-së dhe logjikës së integritetit) në përpjekje për të promovuar Europën si një pol strategjik, balancues kundrejt dominancës amerikane.

BE-je, e cila pas *Maastricht*-it kishte ambicie të dukshme për Politikën e Jashtme, nxitën ndryshimet. Për më tepër objektivat e Politikës së Jashtme të BE-së për të cilat u ra dakord në *Maastricht* u përfshinë në objektivin e mëposhtëm: “për të siguruar identitetin e saj në skenën ndërkombëtare, veçanërisht me anë të zbatimit të një politike të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë edhe hartimin e kuadrit për një politikë të mundshme të përbashkët të mbrojtjes, e cila me kalimin e kohës mund të çojë drejt një mbrojtjeje të përbashkët”.

Megjithatë, kjo aspiratë duhet parë edhe në kontekstin e përplasjeve të vazhdueshme ndërmjet federalistëve dhe ndërqeveritaristëve brenda BE-së si edhe në kuadër të debateve brenda NATO-s ndërmjet “Gaullistëve” dhe “Atlanticistëve”. Siç u tha edhe gjatë seksionit të mëparshëm, dalja në pah e PPJS nuk shënoi ndonjë progres të dukshëm në terma praktikë të debatit. Për më tepër i gjithë procesi pësoi një ndalesë të fortë kur u përball me shpërthimet e dhunës në Ballkan, që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë. Politika e Jashtme Europiane, atëherë u qetësua sërish duke marrë karakter “strukturor”<sup>25</sup> dhe duke u promovuar nga Komisioni nëpërmjet të ashtuquajturave “mjete të shtyllës së parë.”<sup>26</sup>

Pafuqishmëria e vazhdueshme e BE-së në Ballkan, sidomos lidhur me krizën e Kosovës, bëri që amerikanët të merrnin sërish udhëheqjen në një krizë “europiane” në kohën kur debati i gjerë gjeostrategjik rreth rënies së ShBA-së dhe rritjes së Europës kishte arritur pikun e tij. Pikërisht, në këtë kontekst, Samiti Anglo-Francez në *Saint Malo*, i vitit 1998, shënoi një riafrim historik ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Francës lidhur me rolin e BE-së në arkitekturën e sigurisë europiane, që do të çonte

<sup>25</sup> *Keukeleire* dhe *MacNaughton* (2006) diferencojnë ndërmjet Politikës së Jashtme “konvencionale” dhe asaj “struktorore”. Ata e përkufizojnë Politikën e Jashtme Strukturore si një “Politikë e Jashtme, e cila, nëse zhvillohet në terma afatgjatë, kërkon të influencojë ose formësojë, struktura të qëndrueshme politike, ligjore, socio-ekonomike, të sigurisë dhe mendore. Këto struktura nuk janë karakteristike vetëm e marrëdhënieve shtetërore dhe ndërshtetërore, por edhe e shoqërive, pozicionit të individëve, marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe shoqërive si edhe të të gjithë sistemit ndërkombëtar në tërësi”, f. 25-26.

<sup>26</sup> Një fakt që ilustron më mirë këtë zhvillim, është zhvillimi i “Mekanizmit të Reagimit të Shpejtë” për menaxhimin e krizave ndërkombëtare e civile, i cili u zhvillua si një “Mekanizëm Komunitar” (Shtylla 1) për mbrojtjen civile. Shih *Council Decision of 23/10/2001 establishing a community mechanism to facilitate reinforced cooperation assistance interventions 2001/792/EC. Official Journal L297, 15 November 2011, Article 1.1.* Ky mekanizëm është përdorur në një sërë rastesh.

eventualisht drejt krijimit të PEMS (Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë). Kompromisi këtu ishte që, duke pasur parasysh ndryshimet në pikëpamjet e ShBA-së mbi NATO-n dhe mbi sigurinë europiane, për të mbajtur amerikanët të angazhuar në Europë, tashmë nevojitej krijimi i aftësive të shteteve të BE-së që do t'ju mundësonin atyre të vepronin “në mënyrë të pavarur” meqenëse dukej qartë se amerikanët nuk dëshironin më të ishin të vetmit që paguanin për kostot e sigurisë europiane.

Kjo nuk nënkupton se interesat kombëtare ishin lënë mënjanë dhe se Britania e Madhe dhe Franca tashmë kishin rënë dakord për taktikat dhe as se amerikanët ishin fillimisht të lumtur me ato që dolën nga *Saint Malo*. Në fakt u deshën dy vjet përpara se PEMS të përfshihej në BE (në vitin 2001 me Traktatin e Nicës) dhe mbi katër vjet përpara se të arrihej një kompromis me amerikanët dhe me anëtarët e tjerë të NATO-s që nuk janë pjesë e BE-së (kryesisht me Turqinë) mbi marrëdhëniet BE-NATO, i cili u quajt “Përshtatjet e Berlin Plus”.

Megjithatë, të shqetësuar për mundësinë potenciale të një BE-je të fuqishme dhe “Gaulliste” që do të sfidonte supremacinë amerikane në aleancën perëndimore, Sekretarja e Shtetit të ShBA-së në atë kohë, *Madeleine Albright*, ra dakord me PEMS-në dhe si rrjedhojë me një rol potencial më të madh të BE-së në mbrojtjen dhe sigurinë e Europës me tre kushte (të njohura më vonë si 3 D-të). Këto kushte u hartuan për tu siguruar se BE-ja nuk do të publikonte asetet e NATO-s, nuk do të diskriminonte në dëm të vendeve të NATO-s që nuk ishin anëtarë të BE-së, si dhe nuk do të kishte përpjekje për të ndarë BE-në nga NATO<sup>27</sup>.

“Përshtatjet e Berlin Plus” shënuan mbylljen e njërit prej tre debateve të ndërlydhura mbi sigurinë europiane që filluan që prej fundit të Luftës së Ftohtë. Më konkretisht, bëhet fjalë për diskutimin për “kuadrin e ri institucional” të sigurisë europiane<sup>28</sup>. Që prej takimit të *St Malo*, ndërmjet Francës dhe Britanisë së Madhe, kanë ndodhur një sërë zhvillimesh kryesore:

- 50-vjetori i NATO-s (prill, 1999);
- Zgjerimi i NATO-s, duke përfshirë Poloninë, Hungarinë dhe Republikën Çeke;

<sup>27</sup> *Madeleine Albright, The Right Balance Will Secure NATO Future, Financial Times, December 1998.*

<sup>28</sup> *Shih M. E. Brown, (forthcoming, 2011) European Security: The Defining Debates (Boston: MIT Press).* Sipas *Brown*, dy debatet e tjera përcaktues lidheshin me përgjigjen europiane ndaj kërkesave për ndërhyrje (kryesisht në Ballkan), dhe me pyetjen se deri ku duhet të zgjerohet NATO dhe BE.



- Takimi i Këshillit European në Këln (qershor, 1999), i cili përfshiu BEP (Bashkimin e Europës Perëndimore) në BE dhe deklaratën e kësaj të fundit se BE-ja do të kishte një Politikë të Mbrojtjes, funksionale brenda vitit 2001;

- Javier Solana u emërua Kryetar i BEP, krahas rolit të tij si Përfaqësues i Lartë i PPJS-së;

- Takimi i Këshillit European i Helsinkit (dhjetor, 1999) si reagim ndaj krizës së Kosovës, theksoi se BE-ja do të ishte e aftë që të dislokonte deri në 60 000 trupa brenda 60 ditëve dhe me një kohëzgjatje minimalisht njëvjeçare për sa i përket të ashtuquajturave operacione të “Detyrave të Petersburgut”;

- Për më tepër, një sërë strukturash të reja iu bashkëngjiten kuadrit të Këshillit European.

Atëherë, çfarë përfshinin konkretisht Përshtatjet e Berlin Plus? BE-së ju garantua akses te kapacitetet planifikuese të NATO-s për përgatitjen dhe zbatimin e operacioneve për menaxhimin e krizave të udhëhequra prej saj. BE-ja mund të kërkonte gjithashtu që NATO, të mundësonte një opsion të komandës europiane në kuadër të *DSACEUR*<sup>29</sup> duke mundësuar operacione të udhëhequra prej kësaj të fundit. Për më tepër, BE-ja kishte atë që u përkufizua si një “akses i supozuar” tek asetet dhe kapacitetet e NATO-s. Ky model uli nivelin e tensioneve që kishin dalë në pah në marrëdhëniet NATO- BE sipas traditës më të mirë diplomatike, duke “zgjeruar me efikasitet skuadrën” deri diku me anë të konfirmimit të integritetit të NATO-s nga njëra anë, si edhe njëkohësisht duke mundësuar progresin drejt një politike të përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë për BE-në. Frikërat për daljen në pah të BE-së si aktor potencial “i pavarur” i sigurisë, duke formuar një strukturë planifikimi jashtë NATO-s, u adresuan me vendosmëri dhe tashmë një gjë e tillë nuk pritej më të ndodhte. Megjithatë, pretendimet e NATO-s për “*supremaci*” u vunë në pikëpyetje, ndërsa legjitimiteti i ndërmarrjes nga BE-ja të një politike më autonome të sigurisë, pa dyshim që u zgjerua<sup>30</sup>.

Kjo marrëveshje u testua shpejt me fillimin, në mars të 2003-shit të operacionit të parë të BE-së dhe me zëvendësimin e operacionit të NATO-s “*Operation harmony*” me operacionin “*Concordia*” të udhëhequr nga BE-ja. Qëllimi kryesor i operacionit

<sup>29</sup> DSACEUR (*Deputy Supreme Allied Commander Europe*) është gjithmonë e përbërë nga një staf European, ndërsa SACUER përbëhet gjithmonë nga amerikanë.

<sup>30</sup> Shih J. Sperling (2011), “*The European Union and NATO: subordinate partner, cooperative pillar, competing pole?*” in Blavoukos, S., and Bourantonis, D., (eds) *The EU Presence in International Organizations* (London, Routledge).

“*Concordia*” ishte që sipas kërkesës specifike të bërë nga qeveria e Maqedonisë, të kontribuonte më tej për një mjedis me stabilitet dhe të sigurtë si dhe të lejonte zbatimin e kuadrit të Marrëveshjes së Ohrit, në gusht të vitit 2001<sup>31</sup>. Operacioni kontribuoi në përpjekjet për të pasur një shtet në paqe, demokratik dhe me prosperitet si pjesë e një rajoni vendesh të stabilizuar, që nuk kërkon më prezencën e forcave ndërkombëtare të sigurisë. Ky operacion përfundoi në 15 dhjetor 2003.

Në mënyrë të njëjtë, Këshilli i Bashkimit European vendosi në 12 korrik 2004 (*Council Joint Action 2004/570/CFSP*) ndërmarrjen e një operacioni ushtarak në Bosnjë Hercegovinë në kuadër të Politikës së Përbashkët European të Sigurisë dhe Mbrotjtjes (PPMS), duke iniciuar operacionin *EUFOR Althea* më 2 dhjetor 2004, i cili do të zëvendësonte SFOR-in e udhëhequr nga NATO. Në këtë rast, bashkëpunimi funksionon mirë me DSACUR-in e NATO-s i cili vepron si një komandant operacional i forcës së BE-së (*EUFOR Althea*) duke ndërvepruar rregullisht me NAC (Këshillin e Atlantikut të Veriut të NATO-s). Takime të rregullta mbahen në të gjitha nivelet e zinxhirit komandues nga niveli i Sekretarit të Përgjithshëm e duke vazhduar më poshtë, për të ardhur te kontaktet në terren ndërmjet zyrtarëve në Bosnjë. Megjithatë, siç thekson në një mënyrë perceptivë dhe *Howorth*:

*“Fakti që Bosnja është i vetmi shembull, nënvlerëson realitetin dramatik që mosmarrëveshjet politike ndërmjet vendeve anëtare (dhe sidomos ato ndërmjet Turqisë dhe Qipros) kanë mbajtur peng për vite me radhë marrëdhëniet NATO-PEMS. Ajo që funksionon në rastin e Bosnjës nuk lejohet që të funksionojë tërësisht as në Kosovë dhe as në Afganistan, duke përbërë kështu një dëm të konsiderueshëm për të gjitha palët<sup>32</sup>”.*

Megjithatë, duke qenë se Përshtatjet Berlin Plus u hartuan në kohën kur BE-ja po kërkonte të zgjeronte kapacitetet e saj fizike dhe ato për veprime të pavarura në lidhje me kontekstin strategjik të ndryshueshëm që e rrethonte, u perceptua se një veprim i tillë do të mund të ndërmerrej edhe pa amerikanët. Në fakt, ajo që ka ndodhur aktualisht në Ballkan, Afganistan dhe së fundmi në Libi, është që BE dhe NATO, janë përpjekur të punojnë krah për krah, disa herë në mënyrë bashkëpunuese (si në Afganistan) dhe disa

<sup>31</sup> Një marrëveshje paqeje e firmosur nga qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe përfaqësuesit e shqiptarëve etnikë, më 13 gusht 2001. Marrëveshja i dha fund konfliktit të armatosur ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe Forcave të Sigurisë Maqedonase dhe vendosi terrenin e përshtatshëm për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve etnikë.

<sup>32</sup> *Howorth, J., (2009) “NATO and ESDP: Institutional Complexities and Political Realities”* Politique étrangère (*English Edition* 4), p. 95.

herë të tjera në konkurrencë ndërmjet tyre (si në Sudan dhe Kosovë). Kësisoj, përdorimi i Përshtatjeve të Berlin Plus si në kontekstin e Bosnjës, mund të përbëjnë herën e dytë dhe të fundit ku kjo qasje për koordinim përdoret në këtë mënyrë.

Arsyeja kryesore për këtë nuk lidhet me çështje të zbatimit praktik (çështja e aftësive, por më tepër i përket ndryshimeve më prozaike politike dhe ideologjike ndërmjet europianëve dhe amerikanëve dhe, më konkretisht, zhvillimit të të menduarit europian mbi natyrën e një politike të sigurisë. Në ndryshim nga paraardhësi i tij, IESM (Iniciativa Europiane për Sigurinë dhe Mbrojtjen), i cili ishte një koncept i kufizuar për të ndihmuar BE-në që të fitonte akses tek aftësitë e NATO-s, PEMS është një projekt tërësisht i ri evropian, që përfshin rregullat e një “sigurie të kuptueshme” (denacionalizimin, deterritorializimin, ndarjen e sovranitetit dhe zëvendësimin e sigurisë tradicionale të bazuar te shteti me sigurinë shoqërore). Prandaj, ndërsa, deri diku, “përputhshmëria” ndërmjet NATO-s dhe BE-së (fuqi e fortë/fuqi e butë) duhet të jetë në nivelin e duhur, realisht situata nuk është dhe aq e lehtë. Vizionet amerikane dhe europiane të sigurisë Europiane aktualisht janë duke u ndarë dhe jo duke u shkrirë me njëra-tjetrën. Amerikanët, sidomos gjatë epokës së Bushit, e shohin NATO-n si të nxjerrë “jashtë zonës” ose “jashtë funksionit”, ndërsa BE-ja nuk ndihet mirë duke luajtur rolin e vartësit në Aleancën Perëndimore. Ndërsa në praktikë, të dyve ju nevojitet ndihma politike ose materiale e njëra-tjetrës, “përputhja” nuk është automatike, duke qenë se asnjëra nga palët nuk dëshiron të pranojë se një “ndarje e tillë punësh” si ajo që ka ndodhur në Ballkan dhe në Afganistan, duhet të jetë e përhershme.

### **Problemet NATO-BE, një marrëdhënie “e ngrirë”?**

Në këtë kuadër, pyetja më e shpeshtë është: A janë NATO dhe BE-ja institucione bashkëpunues apo konkurrues? Përgjigja për këtë pyetje presupozon se vendimet merren për një sërë çështjesh shumë më të gjera që lidhen me drejtimin dhe me destinacionin e fundit të procesit të integritit europian. Megjithatë, problemi qëndron në faktin se një vendimi i tillë mbi “përfundimin” e procesit të integritit është diçka që ka më shumë gjasa ta “zhbëjë” sesa ta “bëjë” Bashkimin Europian si një aktor global.

Marrëdhëniet NATO-BE duket se janë në njëfarë mase “të ngrira” dhe ky tipar ka qenë prezent që prej fillimit të shekullit. Në këtë kontekst mund të identifikojmë tri marrëdhënie problematike: BE-SHBA, BE-Turqi dhe Britani e Madhe-Francë.

Të marra së bashku, këto ndihmojnë në përcaktimin e problemeve kryesorë në marrëdhënien NATO-BE.

Marrëdhëniet NATO-SHBA<sup>33</sup> siç është theksuar tashmë janë faktori kryesor i mjedisit të ri të sigurisë europiane. Megjithatë, këto marrëdhënie nuk janë të thjeshta ose të drejtpërdrejta, dhe qartësisht nuk i shërben më mirë të qenit e tillë, duke u zhvilluar në një kontekst tërësisht të institucionalizuar NATO-BE. Pritshmëritë amerikane për sa i përket Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe të Sigurisë kanë ndryshuar në mënyrë dramatike që prej vitit 2003 kur u ra dakord për të ashtuquajturat “Përshtatjet Berlin Plus”. Pra, siç thekson edhe Toje, amerikanët tashmë duan më shumë, jo më pak, një politikë europiane të mbrojtjes<sup>34</sup>. Kësaj teme do t’i kthehemi në seksionin e fundit kur të flasim për krizën Libiane.

Kjo aspiratë (për më shumë dhe jo më pak mbrojtje europiane) është, megjithatë, më e lehtë për t’u promovuar sesa për t’u arritur për një sërë arsyesh. Me përjashtim të Britanisë së Madhe dhe Francës, vendet e BE-së janë në përgjithësi të papajisur (as fizikisht dhe as psikologjikisht) me kapacitetet për të luajtur rolin e një udhëheqjeje të fortë në politikat e mbrojtjes që shkon përtej mbrojtjes bazike territoriale. Pas diasa gjeneratash paqeje dhe stabiliteti, përqendrimit të ndërtimit të shtetit të mirëqenies sociale dhe të institucioneve të integritetit europian, fundit të erës së kolonializmit europian, demokratizimit të politikëbërjes së Politikës së Jashtme dhe vendosjes së shqetësimeve mbi fuqinë ekzekutive për “bërjen” e luftës ose paqes<sup>35</sup>, si dhe

<sup>33</sup> BE-ja ka njohur faktin se marrëdhëniet SHBA-BE duhen vendosur në një dimension të ri. Shih për shembull “*EU wants a new Atlanticism*” *EurActive.com* (29/3/10) downloadable at: <http://www.euractiv.com/en/priorities/eu-wants-new-atlanticism-news-391583>.

<sup>34</sup> Toje, 2008, *Ibid*.

<sup>35</sup> Kushtetuta e Gjermanisë përbën një shembull të mirë (nëse kemi parasysh kontekstin historik) për shqetësimet politike dhe ligjore që vendosen mbi shumicën e vendeve të BE-së ose, më saktë, mbi qeveritë e tyre kombëtare, të cilat thjesht nuk kanë aftësinë për të marrë vendime ekzekutive për çështje të luftës dhe paqes përtej kuadrit të ngushtë shumëpalësh të institucioneve të përbashkëta që ekzistojnë në Europë dhe në nivel global. Gjermania, së paku, nga një perspektivë franceze dhe britanike, gjithnjë e më shumë është përpjekur që të përdorur këtë realitet në avantazh të saj, për të pasur “dorë të lirë” për kontributet e mbrojtjes së të tjerëve. Kjo është qartësisht e dukshme në rastin e niveleve të saj. Dukshëm, më të ulëta se shpenzimet për mbrojtjen si pjesë e PBB-së (1,4% krahasuar me 2,5% për Francën dhe Anglinë), me kontributin e saj për konfliktin në vazhdim në Afganistan dhe, së fundi, me qëndrimin e saj në konfliktin Libian, i cili përfshin abstenimin e saj (së bashku me Kinën dhe Rusinë) për rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1973, e cila autorizonte marrjen e të gjitha masave të nevojshme për mbrojtjen e civilëve të kërcënuara nga regjimi i Gaddafit.

rënien e rreziqeve “ekzistenciale” për qytetarët, as shtetet dhe as shoqëritë e pjesës më të madhe të Europës nuk kanë një etikë me të vërtetë “ushtarake”<sup>36</sup>.

Për më tepër, buxhetet e mbrojtjes së shteteve moderne europiane janë të kufizuar dhe në rënie të mëtejshme në kuadrin e krizës financiare (duke përfshirë këtu edhe Anglinë dhe Francën). Ndërsa Britania, Franca, Gjermania dhe Italia renditeshin ndërmjet dhjetë shteteve me shpenzimet më të larta për mbrojtjen për sa i përket pagesave me para në dorë në vitin 2010 (Britania dhe Franca renditen në vendin e tretë dhe të katërt pas SHBA-së dhe Kinës, ndërkohë që Rusia ishte pak më poshtë se vendi i pestë) përqindja e PBB-së që shpenzohet për mbrojtjen në këto vende gjatë vitit 2010 ka rënë (Britania dhe Franca shpenzonin për mbrojtjen rreth 2,5% të PBB-së, ndërsa pjesa tjetër e vendeve të BE-së shpenzonin për mbrojtjen ndërmjet 1 dhe 1,8% të PBB-së së tyre).<sup>37</sup> Në të njëjtën kohë, fuqitë e reja globale ose vendet e BRIC, duket se janë duke rritur shpenzimet e tyre për mbrojtjen si përqindje të PBB-së (fuqitë e BRIC janë Kina në vendin e 5-të, Rusia në vendin e 9-të, India në vendin e 11-të dhe Brazili në vendin e parë të renditjes globale për shtetet që shpenzojnë më shumë për mbrojtjen).

Këto observime ekonomike dhe sociale janë të përbëra nga një avancim i vazhdueshëm në teknologjinë ushtarake që udhëhiqet prej amerikanëve dhe që po ndihmon për formimin e doktrinës së re ushtarake amerikane për shekullin XXI (së cilës i referohen shpesh shkurt si “Revolucioni në Çështjet Ushtarake” (RÇU))<sup>38</sup>. Kjo ka një sërë efektesh në marrëdhëniet SHBA-BE dhe në ato NATO-BE.

Ndërveprueshmëria e forcave të SHBA-së dhe atyre të Europës po bëhet gjithnjë e më e vështirë sidomos për shtetet e vogla

---

<sup>36</sup> Shih për shembull për këtë punimin provokues të *Peter van Ham* (2008) “*The power of war. Why Europe needs it. The Hague, Clingendael Diplomacy Papers, no. 19*, dhe për pjesën tjetër të debatit, *James Sheehan* (2007) *The monopoly of violence: Why Europeans hate going to war, London; Faber and Faber*.

<sup>37</sup> Të dhëna të marra nga SIPI. Rasti i Greqisë, e cila shpenzon 3,2% të PBB-së së saj për mbrojtjen, përbën një përjashtim të mirënjohur këtu.

<sup>38</sup> Ndoshta përkufizimi i cituar më shpesh jepet prej *Krepinevic, A.*, (1994) “*Cavalry to computer. The pattern of Military Revolutions*”, *The National Interest*, 37, p.30. “Kjo është ajo që ndodh kur aplikimi i teknologjive të reja në një numër domethënës sistemesh ushtarake kombinohet me koncepte operacionale inovative dhe me përshtatjen organizative në një mënyrë, e cila përshtat tërësisht karakterin dhe zhvillimin e konfliktit. Ky proces zhvillohet duke prodhuar një rritje dramatike në potencialin luftues, ose në efikasitetin ushtarak të forcave të armatosura.

europiane, duke bërë që roli i shumë prej tyre të reduktohet në “nxitës tifozez” për Politikën e Jashtme të SHBA-së. Shumë prej tyre ndihen gjithnjë e më shumë të paretshëm në këtë rol, duke pasur parasysh edhe shqetësimet e tyre të brendshme.

Shumë shtete europiane po detyrohen të “zgjedhin” ndërmjet shpenzimeve të buxheteve të tyre në rënie për mbrojtjen, për kapacitete luftarake të teknologjisë së lartë dhe afatgjatë, ose shpenzimeve për kapacitete afatshkurtra paqeruajtëse dhe të menaxhimit të krizave. Të dyja këto janë të nevojshme, por ajo që ka ndodhur në të vërtetë ka qenë një ndarje *de facto*, e cila ka parë një NATO të dominuar nga SHBA-ja që adreson kapacitetet e kategorisë së parë, ndërsa BE-së i është dashur kryesisht të merret me kapacitetet e kategorisë së dytë. Kjo nuk është e vërtetë për të gjithë vendet e BE-së, por qëndron për shumicën prej tyre.

Ky realitet vendos parametrat për një nga “problemet” më të mëdha NATO-BE dhe, më konkretisht, në lidhje me ekzistencën e listave paralele për pajisjet dhe kapacitetet. NATO vepron sipas *Prague Capabilities Commitment* (PCC) ndërsa BE-ja vepron në kuadër të *European Capabilities Action Plan* (ECAP). Ndryshimet janë sigurisht të dukshme dhe masive, por konkurrenca pa dyshim që dobëson kapacitetet e mbrojtjes. Si rrjedhojë, shpesh ndodh që qeveritë, duke pasur frikë nga niveli i kundërshtive të brendshme për shpenzimet për mbrojtjen, përdorin ekzistencën e dy listave konkurruese si një argument për të mos përbushur asnjërën (duke pasur frikë se përbushja e njëjës do të sillte pyetjen se përse kjo nuk u ndoq edhe nga përbushja e tjetrës?).

Këto fakte bazë vështirësojnë marrëdhëniet BE-NATO. Prioritetet globale të Amerikës po ndryshojnë, dhe për këtë arsye ka një dëshirë për më shumë mbrojtje europiane si edhe ka pranueshmëri më të gjerë për faktin e një Europe më të “pavarur” në këtë drejtim. NATO dhe BE pretendojnë se janë organizata që përbushin njëra-tjetrën, por praktikisht marrëdhëniet e tyre po bëhet gjithnjë e më e vështirë duke qenë se ato konkurrojnë për burime, kapacitete dhe misione<sup>39</sup>.

Grupi i dytë i problematikave në marrëdhëniet NATO-BE janë marrëdhëniet BE-Turqi. Turqia dorëzoi aplikimin e saj për anëtarësim në BE në vitin 1987 dhe ka pasur një marrëdhënie ekonomike të strukturuar me BE-në që prej fillimit të viteve 1960.

<sup>39</sup> Në vitin 2005, duke qenë se asnjë prej tyre nuk binte dakord për rolet më të përshtatshme, BE dhe NATO kanë rezultuar në çuarjen e misioneve të veçantë në Sudan.

Tashmë është bërë e qartë se vendet anëtarë të BE-së janë të ndarë, lidhur me aderimin e Turqisë. Megjithatë, Turqia është një lojtar sinjifikativ në NATO dhe ka sipërmarrjen ushtarake më të madhe në “NATO/BE Europë”. Gjatë viteve 1990, kur diskutohej për një “pol” europian më domethënës brenda Aleancës Atlantike (kryesisht në kuadër të Bashkimit të Europës Perëndimore (BEP), Turqia luajti një rol aktiv në këtë proces, por ajo u mënjanua më pas me lindjen e PEMS-ës.

Në nivel strategjik, Turqia shpreh pakënaqësi për reduktimin potencial të partneritetit të provuar dhe të testuar me SHBA-në dhe NATO-n dhe për zëvendësimin e tij me një partneritet të paprovuar më parë, dhe vende-vende suboptimal në kuadër të PPMS-ës. Përveç kësaj, ekziston një lidhje e qartë ndërmjet sjelljes së Turqisë në NATO dhe rrugës së saj plot tensione drejt anëtarësimit në BE, të cilin ajo e sheh si të bllokuar politikisht nga Franca dhe Gjermania. Për më tepër, anëtarësimi në BE i një Qiproje të ndarë në vitin 2004 acaroi më tepër Ankaranë.

Së fundmi, është gjithashtu e qartë se, që prej fundit të viteve 1990, Turqia ka gëzuar një lloj ringjalljeje strategjike, e cila ka bërë që statusi i vendit të ndryshojë nga një “kufi i harruar i Luftës së Ftohtë” në një “fuqi kryesore rajonale” në Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore. Pra, siç do të shohim përgjatë këtij seksioni edhe pse, modeli turk i “demokracisë islamike” mund të mirëpritet nga perëndimi si një kuadër i dobishëm për vendet e Afrikës Veriore dhe ato të Lindjes së Mesme, aktualisht, e ngërthyer në të ashtuquajturën “Pranverën Arabe”. Vetë Turqia nuk është domosdoshmërisht e lidhur me “kuadrin” eurocentrik, për sa i përket zhvillimit teologjik të “hapësirës” europiane për të arritur një zone paqeje të përhershme dhe integrimi social, ekonomik dhe politik, duke u bazuar vetëm në resurse europiane. Duke pasur “burime domethënëse të fuqisë së butë”, Turqia po promovon me efikasitet një “vizion” alternativ për rajonin krahas atij të BE-së (sidomos për sa i përket kulturës popullore) në mënyrë të ngjashme me atë që është promovuar nga Rusia që pas daljes së Putin-it<sup>40</sup>.

Këta faktorë historikë dhe strategjikë mundësojnë sfondin kryesor të problemit NATO-PPMS të shprehur në kontekstin e përplasjeve BE-Turqi. E nxitur nga këto shqetësime, Turqia ka kërkuar që përpara përfundimit të “Përshtatjeve të Berlin Plus” e deri më sot, (duke përfshirë dhe operacionin e fundit të NATO-s në Libi) të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për bashkëpunim në

<sup>40</sup> Në vitin 2005, duke qenë se asnjë prej tyre nuk binte dakord për rolet më të përshtatshme, BE dhe NATO kanë rezultuar në çuarjen e misioneve të veçantë në Sudan.

nivel praktik ndërmjet BE-së dhe NATO-s. Kjo përbën arsyet se pse bashkëpunimin NATO-PPMS kufizohet tek *Operacioni Althea* në Bosnjë, si edhe pse diskutimet NATO-PPMS për Kosovën dhe Afganistanin ishin të pamundura. Turqia ka bllokuar me efikasitet firmosjen e “Përshtatjeve Berlin Plus” për më se dy vjet, dhe kompromisi u arrit vetëm atëherë kur Qipro dhe Malta u përjashtuan nga marrëveshja me arsyetimin se këto vende nuk ishin anëtarë të Partneritetit për Paqe (PP) të NATO-s, dhe kështu Turqia argumentoi se informacioni sensitiv nuk mund të shkëmbehej me këto vende<sup>41</sup>.

Si hakmarrje, Qiproja dihet se bllokoi perspektivën e Turqisë në BE si për shembull pjesëmarrjen e Turqisë në Agjencinë Europiane të Armatimeve (AEA) ose në bashkëpunimin e ardhshëm BE-NATO për luftën kundër terrorizmit, duke theksuar se Turqia nuk ka përmbushur detyrimet e saj në kuadër të procesit të negocimit për të hapur portet e saj për anijet me flamur qipriot<sup>42</sup>.

Armatosja kështu me veto efikase (Turqia në NATO, por jo në BE, dhe Qiproja në BE, por jo në NATO) dëmton çdo iniciativë për një bashkëpunim më të madh NATO-PPMS nëse ata do të vendosnin për nevojën e një avantazhi taktik në përpjekjet e tyre përkatëse më të gjera për Qipron Veriore dhe për anëtarësimin e Turqisë në BE. Gjendja e përgjithshme dhe dobët e bashkëpunimit NATO-BE përbën një “dëm kolateral” efektiv në këtë rast<sup>43</sup>. Megjithatë, fakti tronditës mbetet (dhe aludohet në të gjithë literaturën përkatëse) që “problemi turko-qipriot” është bërë deri diku një tërheqës i dobishëm vëmendjeje nga realiteti, i cili thekson nevojën për adresimin si nga NATO ashtu dhe nga BE-ja të një sërë çështjesh të brendshme dhe të jashtme të cilat kështu shpëtojnë diskutimit real. Këto çështje përfshijnë: zgjerimin e vazhdueshëm të misioneve për NATO-n dhe përpjekjet e saj për të hyrë në “sigurinë e butë” si dhe mungesën e vazhdueshme të një “dëshire reale politike” të përbashkët

<sup>41</sup> Shih për shembull dokumentin informativ të prodhuar nga *Paul Cornish* për Parlamentin Europian “*EU and NATO: Co-operation or competition?*”, PE 348.586 (tetor, 2006), f. 10. Gjithashtu, kini parasysh se Malta iu ribashkua programit të Partneritetit për Paqe në vitin 2008 dhe kështu nuk është më pengesë për bashkëpunimin NATO-PPMS.

<sup>42</sup> Shih *J. Howorth* (2009), f. 97.

<sup>43</sup> Ana turke e mosmarrëveshjes trajtohet në *Sinan Ulgen* (undated). *The Evolving EU, NATO and Turkey Relationship: Implications for Transatlantic Security* (<http://www.acus.org/publications/us-turkey-relations-require-new-focus/ulgen>). Ulgen përdor këtë mundësi për të zhvendosur shumicën e fajit për natyrën e vazhdueshme problematike të marrëdhënieve NATO-BE/PPMS te Qipro.



brenda BE-së për të paguar kostot e dëshirës së shprehur prej saj për “aktrim në nivel global”.

Grupi i tretë dhe i fundit i problematikave për sa i përket marrëdhënieve NATO-PEMS është ai i marrëdhënieve ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Francës, dy vende të cilat tradicionalisht kanë përfaqësuar dy rrymat kryesore të mendimit për të ardhmen e mundshme institucionale të Europës në kuadër të arkitekturës së sigurisë<sup>44</sup>. Franca është përfshirë në “riafrimin” me Britaninë në vitin 1998 në *St Malo* (hap, i cili, siç u theksua më sipër çoi në formimin e PEMS-së) si edhe në vitin 2010 ra dakord që të ribashkohej me komandën ushtarake të NATO-s pas 43 vjetësh në gjysmëizolim. Ajo gjithashtu firmosi edhe një Traktat 50-vjeçar për Sigurinë me Britaninë, ku përfshiheshin një sërë çështjesh të aftësive të forcave dhe bashkëpunimi për testimin e armëve bërthamore<sup>45</sup>. Megjithatë, është e qartë se ka ende ndasi të dukshme ndërmjet pikëpamjeve franceze dhe atyre britanike mbi zhvillimin e ardhshëm të arkitekturës së sigurisë europiane.

Arsyeya për këtë është se, ndërsa pranohet parimisht si në Londër ashtu edhe në Paris, “gjërat nuk mund të ecin më si më parë”. Kjo është më e theksuar nëse konsiderohen ndryshimet që po ndodhin në Uashington dhe mënyrën si amerikanët e shohin botën e re shumëpolëshe që po lind gjatë shekullit XXI. Pra, në këtë kontekst riafrimi, që prej vitit 1998 ndërmjet Francës dhe Britanisë së madhe është pa dyshim pragmatist dhe bazohet më së shumti te domosdoshmëria sesa te një vizion më i gjerë i përbashkët për të ardhmen.

Britania e Madhe e ka të qartë se mbajtja e një vullneti amerikan për mbrojtjen europiane do të thotë se ekziston një nevojë urgjente për të krijuar një “pol” europian më të fortë në Aleancën Atlantike. Institucionalisht kjo mund të nënkuptojë vetëm një komponent europian të mbrojtjes më të fortë në kontekstin e sigurisë europiane (pra, me fjalë të tjera, konceptimi britanik i asaj, që do të ishte PEMS-ja shprehur në *St Malo*). Për sa i përket Francës, riintegrimi në NATO u pa si një çmim që ja

<sup>44</sup> Historia bazë e këtyre dy pikëpamjeve të ndryshme (Atlanticizmit dhe Europeanizmit) është e mirënjohur dhe nuk nevojitet që të trajtohet gjatë në këtë punim. Shih për shembull kapitujt mbi Britaninë dhe Francën, të shkruar nga Jolyon Howorth në Horowrth, J., and Menon, A., (eds) (1997) *The European Union and National Defense Policy* (London, Routledge), f. 146-60. Shih gjithashtu Lindley-French, J. (2010). *Britain and France: a dialogue or decline. Anglo-French Defence Cooperation and implications for the European and Euro-Atlantic Security and Defence Relationships* (London: Chatham House).

<sup>45</sup> Përveç referencës së mësipërme Lindley-French shih gjithashtu edhe Gomis, B., (2011), “*Franco-British Defence and Security Treaties: Entete ehile it lasts?*”, London, Chatham House.

vliente të paguhej për të siguruar përfshirjen e SHBA-së në Europë (sidomos, tashmë që retorika Gaulliste për “pavarësi” nga Politika e Jashtme e SHBA-së kishte marrë fund).

Po kështu bashkëpunimi bilateral për mbrojtjen ndërmjet këtyre dy vendeve është njësoj pragmatik<sup>46</sup>, duke pasur parasysh dhe natyrën e ashpër të raundit aktual të shkurtimeve të shpenzimeve për mbrojtjen në të dy vendet, i cili është një domosdoshmëri si pasojë e krizës financiare globale. Ndryshimet ndërmjet dy vendeve janë ngushtuar dukshëm lidhur me kërkesat për kapacitete dhe “*hardware*”. Ndërkohë, për sa i përket perceptimit të rreziqeve dhe hartimit të një doktrine të gjerë të mbrojtjes<sup>47</sup>, po vërehen edhe ngjashmëri. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Britania dhe Franca ndajnë pikëpamje të përbashkëta mbi objektiva më të gjera të Politikës së Jashtme, e sidomos për sa i përket përfundimit (*finalitee*) të integritit European.

Dy çështje mund të ilustrojnë problematikën në fjalë. Nga ana britanike u mohua menjëherë sugjerimi se bashkëpunimi anglo-francez për mbrojtjen, mund të shihej në kuadër të dispozitave të *Permanent Structure Cooperation (PESCO)* siç u theksua dhe në Traktatin e Lisbonës<sup>48</sup>. Me ardhjen në fuqi të qeverisë së koalicionit të ri në Britani, opinionet kundër ndonjë nocioni të një kuadri të mbrojtjes Europiane, të institucionalizuar, të theksuar në *St Malo*, u forcuan sërish. Për më tepër edhe veprimtaria e AEM-ës (Agjensia Europiane e Mbrojtjes) filloi të shihej me dyshim, duke e perceptuar si një agjente të Komisionit European<sup>49</sup>.

Nga ana franceze, pavarësisht riintegritit në NATO dhe të kuptuarit se NATO dhe BE duhet të punojnë së bashku për të

<sup>46</sup> Kjo pikëpamje pasqyrohej gjerësisht në shtypin britanik, sih për shembull artikullin në gazetën eurofile “*The Guardian*” (2/11/2010) “Anglo-french defence deal is a triumph of pragmatism over ideology” by Richard Norton-Taylor, downloadable at <http://www.guardian.co.uk/politics/2010/britain-france-defence-pragmatism-analysis?intcmp=239>.

<sup>47</sup> Shih Bickerton, C., (2010) “*Oh bugger, they’re in the tent*”: *British Responses to French re-integration into NATO, European Security*, 19 (1). Në veçanti, Bickerton thekson se “sipas një specialisti në çështjet e mbrojtjes Europiane, britanikët janë konsultuar rregullisht dhe janë pyetur për këshilla në kuadër të hartimit të *White Paper* të 2008-s. (Intervistë me Bickerton, 4/12/09), f. 117.

<sup>48</sup> “Samiti Anglo-Francez i nëntorit 2010 në Londër, rezultoi në një marrëveshje për bashkëpunimin bilateral në fushën e mbrojtjes, por nuk e vendosi këtë bashkëpunim në kontekstin më të gjerë të PPMS-ës.” Menon, A., (2010) *European Defense Policy from Lisbon to Libya, Survival* 53 (3) p. 88.

<sup>49</sup> Liam, Fox “*The EU should act only when NATO cannot*”, 11 February 2010, at [http://www.conservatives.com/News/Speecher/2010/02/Liam\\_Fox\\_EU\\_should\\_only\\_act\\_when\\_NATO\\_cannot.aspx](http://www.conservatives.com/News/Speecher/2010/02/Liam_Fox_EU_should_only_act_when_NATO_cannot.aspx).

mbajtur amerikanët “të përfshirë” në Mbrojtjen Europiane, mbetet ende ndjesia se qasja aktuale franceze nuk do të mbijetojë përtej Presidentit aktual, duke qenë se qëndrimet në Partinë Socialiste Franceze, ashtu si edhe ato në *Quai D’Orsay* shprehin elementë kritikë kundrejt qasjes së *Sarkozy*-së. Për më tepër, pikëpamja e ngushtë se NATO duhet të mbetet kryesisht një organizëm “i mbrojtjes bazë” sipas nenit 5 (dispozitat për vetëmbrojtjen kolektive) si edhe përpjekjet për të bllokuar adoptimin prej NATO-s të një qasjeje më gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë (*L’Approche Globale*), ndonjëherë nënkuptojnë “të kundërtën e Petersburgut”. (Në kuadër të këtij procesi jo vetëm që NATO do të jepte borxh asete dhe kapacitete për operacionet ku ajo nuk përfshihej drejtpërdrejt, por nënkuptohej se BE-ja do t’i huante gjithashtu NATO-s asetet e saj për menaxhimin e krizave civile në vende si Afganistani). Për më tepër, kjo reflekton shqetësimet aktuale britanike për BE-në si aktor të mbrojtjes.

Kësisoj, ndërkohë që janë bërë deklaratatë të mëdha për bashkëpunim në kuadër të marrëdhënieve NATO-BE dhe ka pasur një lloj bashkëpunimi të suksesshëm në Ballkan dhe, ndërsa janë identifikuar dhe pranohet nga të gjithë problemet kryesore që pengojnë një marrëdhënie më të mirë NATO-BE, ende janë evidentë probleme kryesore gjeostrategjike, administrative dhe politike. Ndërsa, disa prej tyre janë afër zgjidhjes (Britania dhe Franca kanë rënë dakord për nevojën, për mbajtjen e angazhuar të SHBA-së në mbrojtjen dhe sigurinë europiane, dhe për gjendjen e varfër aktuale të Buxheteve Europiane të Mbrojtjes), Çështje të tjera si problemi ndërmjet Turqisë dhe Qipros dhe ndryshimet strategjike ndërmjet Britanisë dhe Francës për mbrojtjen europiane dhe rolin e BE-së, duken se mbeten ende të pazgjidhura.

### **“Pranvera Arabe”, BE-ja, Libia dhe R2P: një rast për testim?**

Që prej përfundimit të epokës koloniale, institucionalizimi i politikës së BE-së lidhur me vendet e Mesdheut Jugor dhe Lindor, qoftë me anë të Marrëveshjeve të Asocimit tradicionale, qoftë me anë të Politikave Mesdhetare dhe të Fqinjësisë) fillimisht ka qenë e fshirë nga një vijë e kuqe e drejtë. Kjo ishte zgjidhja ndërmjet forcimit të demokracisë dhe blerjes së sigurisë. Sigurisht kjo nuk u promovua kurrë si e tillë dhe zgjidhja nuk ishte absolute, sepse të dyja këto pjesë janë deri diku komplementare të njëra-tjetrës. Pavarësisht kësaj, dalja në pah

e prerogativës së sigurisë për Europën (për sa i përket aksesit të burimet, kontrollit të imigracionit dhe, së fundi, luftës kundër radikalizmit Islamik dhe terrorizmit) ka mbizotëruar përgjithësisht kundrejt dëshirës për të ndihmuar lehtësimin e lindjes së regjimeve tërësisht demokratike në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme<sup>50</sup>.

Një analizë e tillë, dhe “Eurocentrizmi”, sigurisht që nuk është tërësisht e pakuptueshme. Përpyekja për “sigurinë energjetike” përbën aktualisht fokusin kryesor të Politikës së Jashtme. Ndërkohë që frika nga radikalizmi islamik dhe nga terrorizmi (pra dëshira për të mbyllur një sy ndaj regjimeve autoritare të cilët pretendonin se ishin e vetmja pengesë kundër pasojave të tilla) është një gjykim i cili është testuar që prej vitit 1992 me grushtin e shtetit në Algjeri gjatë fitores së imponuar të FIS në zgjedhjet kombëtare atje. Impakti potencial i çështjes së emigrantëve/refugjatëve, për më tepër, është theksuar fort edhe nga kriza aktuale në Libi që solli rritjen e numrit të “njerëzve të varkave” që përpiqeshin të kryenin udhëtimin nga Afrika e Veriut për në “Europë”, kryesisht nëpërmjet ishujve të Maltës dhe Lampeduzës<sup>51</sup>.

---

<sup>50</sup> Një studim i detajuar i ndërveprimit institucional të BE-së me vendet e Mesdheut Jugor dhe Lindor nuk është e arsyeshme që të kryhet këtu, duke pasur parasysh kufizimet në kohë dhe në burime të këtij studimi. Megjithatë, siç ilustron dhe nga analizimi i rastit të Libisë në fund të këtij studimi, kjo marrëdhënie institucionale ka qenë një faktor kryesor (në të mirë dhe në të keq) për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet BE-së dhe fqinjëve të saj jugorë. Për më tepër, këto marrëdhënie janë vënë seriozisht në pikëpyetje edhe nga ngjarjet e “Pranverës Arabe” që prej fillimit të vitit 2011. Një nivel i caktuar skepticizmi kundrejt këtyre instrumenteve të ndryshëm, megjithatë, nuk përbën një fakt të ri. Shih *Fröhlich, S., (2007), “The European Neighbourhood Policy: An adequate instrument for democratization in Warwick”, J., and Lang, K. O., (eds) European Neighbourhood Policy-challenges for the EU-Policy Towards the New Neighbours (Opladen and Farmington Hills: Barbara Burdich Publishers) and Bicchi, F., (2010), The impact of the ENP on EU-North Africa Relations: The Good, the Bad and the Ugly, in Whitman R.G. and Wolff S (eds) The European Neighbourhood Policy in Perspective-Context, Implementation and Impact (Basingstoke: Palgrave Macmillan)*. Për Bashkimin Mesdhetar shih Liberti, F., (2008), *The European Union and the South Mediterranean Partners: L’union pour la Mediterranee, a French attempt to refocus the EU Enlargement Towards the South in Delcour, L., and Tumlets, E., (eds) “Pioneer Europe: Testing EU foreign policy in the Neighborhood” (Munich, Nomos)*.

<sup>51</sup> Ndikimi i konfliktit libian në emigracionin ilegal drejt BE-së ka qenë i dukshëm si për sa i përket numrave bruto, ashtu edhe për numrin e viktimave. Simon Tsidal në *“The Guardian”* (11/5/2011), “Helping Libya’s refugees is the best way to beat Gaddafi” sugjeron në mënyrë të përmbytur se rreth 10% e atyre të cilët përpiqen të arrijnë Europën vdesin në rrugë e sipër (1 200 nga 12 000 në periudhën gjatë fillimit të marsit dhe mesit të majit 2011).

Në këtë kontekst ndoshta duhen kuptuar edhe reagimet fillestare franceze kundrejt daljes në pah të lëvizjeve të “Pranverës Arabe”<sup>52</sup>, që promovonin ndryshim, një hapje më të madhe dhe demokratizim në Tunizi. Duke qenë se protestat fillestare u përballën me dhunën e forcave tuniziane të sigurisë, ministrat francezë vazhduan të bënin një sërë komentesh, të cilat pa dyshim që favorizonin regjimin e Ben Ali. Ndërsa grupet për të drejtat e njeriut dënuan një sërë vrasjesh të kryera nga policia tuniziane, Ministria e Jashtme Franceze, *Michelle Alliot-Marie* tha se policia franceze do të ndihmonte forcat e Ben Ali që të mbanin rendin duke i ofruar “*savoir faire*” e saj për përballjen me protestat civile. Ministri francez i Kulturës *Frederic Mitterand* tha se “Tunizia nuk ishte një ‘diktaturë e padiskutueshme’” dhe Ministri i Bujqësisë *Bruno Le Maire* tha se Ben Ali kishte bërë “shumë për vendin e tij”.

Pas Tunizisë erdhi Egjipti, dhe sërish dështimet në marrëdhëniet publike të diplomacisë franceze dolën në pah ashtu sikundër edhe ekzistenca e lidhjeve të ngushta ndërmjet klasës qeverisëse franceze dhe elitave politike vendase (Hosni Mubarak, Presidenti i Egjiptit, i cili ishte perceptuar nga Franca si interlokutori kryesor jugor për projektin e tij të preferuar të Bashkimit të Mesdheut; më në fund, la zyrën e tij në 11 shkurt<sup>53</sup>). Fokusi i vëmendjes u zhvendos më pas me shpejtësi në Libi, por ndryshe nga Tunizia

---

Ai gjithashtu argumenton se forcat e *Gaddafit* mund të jenë duke përjashtuar me forcë, punëtorë emigrantë subsaharianë për t'i kujtuar Europës pasojat e ndryshimit të regjimit. Përpara konfliktit ishte normale që Italia dhe Franca u përpoqën që të “angazhonin” *Gaddafin* lidhur me rolin e perceptuar të Libisë si pengesa e fundit ndërmjet Europës dhe prurjeve të emigrantëve ekonomikë nga Afrika Qendrore. Shih për shembull: “*Lybia is bigger issue for EU than US*” që mund të shkarkohet nga: <http://www.europeaninstitute.org/February-2011/Lybia-is-bigger-issue-for-eu-than-for-us.html>. Për sa i përket ndikimit të brendshëm të BE-së, i gjithë kuadri i lëvizjes pa viza i *Schengen*-it është vënë në rrezik nëpërmjet një lufte fjalësh, kryesisht ndërmjet Italisë dhe Francës, por e cila u përhap edhe në të gjithë Zonën *Schengen*. Shih *The Telegraph* (11/5/2011) “*Denmark announces decision to reintroduce border controls ahead of Schengen meeting*”, *John Lichfield The Independent* (19/4/2011) “*France threatens to ‘suspend’ the Schengen Treaty*” si edhe *Michael Day “The Independent”* (14/5/2011), “*Flood of North African refugees to Italy ends EU passport-free travel.*”

<sup>52</sup> Në mënyrë mjaft interesante, Robert Fisk daton fillimin e “Pranverës Arabe” që në vitin 2005 në Liban, me reagimet e shoqërisë civile atje ndaj vrasjes së ish-kryeministrit Rafiq Hariri, te kërkesa për tërheqjen e ushtrisë siriane nga Libani. Shih Fisk, R., (15/4/2011) “*The Independent the Arab awakening began not in Tunisia this year but in Lebanon in 2005.*”

<sup>53</sup> Shih David Tresilian “*Friends in High Places*” in *Al Ahran weekly online* (17<sup>th</sup>-23<sup>rd</sup> Feb. 2011) downloadable at <http://www.weekly.ahram.org.eg/2011/1035/eg1902.htm>.

dhe Egjipti niveli i dhunës së shkaktuar nga regjimi si përgjigje ndaj kërkesave të demonstruesve në këtë vend u rrit më shpejt sesa ajo që cilësohej si “e pranueshme” prej komunitetit ndërkombëtar. Në 20 shkurt “protestuesit” u kthyen në “rebelë”, të cilët kishin kontroll nominal në Benghazi, qyteti i dytë më i madh i Libisë<sup>54</sup>. Në 22 shkurt, *Gaddafi* bëri fjalimin e tij famëkeq ku i citonte rezidentët e Benghazi si “horra” dhe si “minj” të cilët nuk meritonin të jetonin” dhe “për të cilët, ai nuk do të tregonte mëshirë” dhe do të shkonte “shtëpi më shtëpi” për t’i nxjerrë jashtë<sup>55</sup>.

Kur kishte ardhur momenti përkatës francezët ishin “në riparim e sipër” të reputacionit të tyre, i cili kishte marrë goditje të mëdha si rrjedhojë e përgjigjeve të tyre ambivalente për krizat e Tunizisë dhe Egjiptit, dhe Presidenti *Sarkozy*, kësaj, ishte i vendosur që të “vihej në ballë” të çështjes Libiane<sup>56</sup>. Duke ju bashkuar atij në krye të grupit ishte gjithashtu edhe Kryeministri Britanik *David Cameron*. Megjithatë, ai kishte arritur këtu me anë të një rruge të njëjtë dhe më të tërthortë. Sensi mbizotërues i “Pranverës Arabe” në Britaninë e Madhe ka qenë tërësisht pozitiv. Për më tepër kishte një sërë “skeletesh nëpër sirtarë”, lidhur me Politikën e Jashtme britanike për Libinë, të paktën që prej lëshimit nga burgu në Skoci të “bombëvënësit të Lokrebies”<sup>57</sup>. Gjithashtu, *Cameroon* ngriti zërin

<sup>54</sup> Duhet theksuar se Libia, e udhëhequr prej 40 vjetësh nga *Gaddafi*, është një rast krejt i ndryshëm nga Tunizia ose Egjipti. Shoqëria libiane ende bazohet gjerësisht te një sistem “tribal”, ndërsa strukturat e shtetit Libian janë gërryer me kalimin e kohës duke iu përshtatur filozofisë politike të *Gaddafi*-it. Shih për shembull artikullin e *Newsweek* nga *Dirk van der Valle* “After *Gaddafi*” (27/2/2011)

<sup>55</sup> Siç thekson dhe artikulli i “*The Economist*” (19/5/2011), “*The lessons of Libya*”, kjo ishte një gjuhë e cila të kujtonte në mënyrë rëqethëse transmetimet e *Radio Mille Collines*, të cilat nxorën në pah autorët e gjenocidit të Ruandës në vitin 1994.

<sup>56</sup> Nuk ka dyshim se rritja e shanseve për rizgjedhjen e *Sarkozisë*, u perceptua (së paku prej kundërshtarëve të tij) se u nxit nga procesi vendimmarrës i tij për Libinë. Shih *Joanathan Freeland*, *The Guardian* “*Libya crisis may save Nicholas Sarkozy from electoral humiliation*” (20/3/2011), i shkarkuar në <http://www.guardian.co.uk/world/2011/mar/20/libya-crisis-nicolas-sarkozy-electoral>. Ndërkohë, po e njëjta gazetë raporton gjithashtu pretendimet e njërit prej djemve të *Gaddafi*-it se Libia ka financuar fushatën elektorale të *Sarkozisë* dhe se tani ata duan mbrapsht paratë e tyre. Shih *Ian Black and Kim Willsher*, *The Guardian* “*Sarkozy election campaign was funded by Libya-Gaddafi-son*” (16/3/2011), e shkarkuar në [http://www.guardian.co.uk/world/2011/mar/16/sarkozy-election-campaign-libya-claim?CMP=tw\\_t\\_gu](http://www.guardian.co.uk/world/2011/mar/16/sarkozy-election-campaign-libya-claim?CMP=tw_t_gu).

<sup>57</sup> Edhe pse teknikisht përgjegjësit e qeverisë së decentralizuar skoceze (duke qenë se Skocia ka një sistem ligjor të ndryshëm nga ai që vepron në pjesën tjetër të Britanisë), kishte ndasi të dukshme rreth rethanave të lënies së lirë në maj të 2009-s të atentatorit të fluturimit Pan AM 103 të vitit 1998, *Abdellbaset Ali Mohamed al-Megrahi*. Shih për shembull *Jason Allardyce* “*Lockerbie bomber set free for oil*” *The Sunday Times* (30/8/09), downloadable at: <http://www.timesonline.co.uk/tol/news/politics/article6814939.ece>

me shpejtësi së bashku me Sarkozinë, duke kërkuar ndërhyrje ushtarake nëse masakra e civilëve në Libi nuk do të ndalej.

Sikleti i *Cameroon*-it për Libinë bazohej në prapësitë e së shkuarës dhe jo në ato aktuale, të cilat nuk ishin përgjegjësi të tij, por të Partisë së tij. Klasa politike britanike, dhe veçanërisht Partia Konservatore, u frikësuan nga kriza e Bosnjës në mesin e viteve 1990, dhe sidomos nga ngjarjet në Serbrenicë ku u vranë 8000 gra dhe fëmijë myslimanë boshnjakë, ndërkohë që forca paqeruajtëse e OKB-së u mjaftua thjesht duke parë. Në atë kohë, qeveria konservatore dhe udhëheqësit e saj ishin të qartë në qëndrimin e tyre “realist” se përfshirja në luftën civile në Bosnjë nuk ishte në të mirë të interesave kombëtare britanike (një pikëpamje kjo që për të qenë të saktë nuk kundërshtohet fort nga qeveritë e tjera nëpër Europë. Vetëm pas tmerrit të Serbrenicës dhe analogjive të kësaj ngjarjeje me “zgjdhjen finale”, për hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore ky pozicion filloi të ndryshonte. Kjo qasje pa dyshim që u ndryshua tërësisht nga ndërmarrja prej kryeministrit laburist *Tony Blair*, të një “politike të jashtme etike” dhe në vazhdim nga doktrina e “ndërhyrjeve liberale” gjatë tre mandateve të tij si kryeministër. Gjatë periudhës së tyre të gjatë në opozitë, konservatorët nxorën mësimet e duhura.

Edhe përpara transmetimit të turpshëm të *Gaddaf*-it që kërcënonte se “do të nxirrte jashtë” kundërshtarët e tij në Benghazi, “fantazma e Serbrenicës” ishte e dukshme në debatin publik britanik për Libinë<sup>58</sup>. Prandaj nuk ka dyshim se ky ka qenë një faktor kryesor “formësues” i politikës britanike ndaj Libisë.

“Pranvera Arabe” shtypi një sërë butonash në rrethet e Politikës së Jashtme Europiane, ndërsa “vala e demokratizimit” u përhap që nga Tunizi në Kajro dhe përnjëmend u duk se kjo përbënte një lloj hakmarrjeje ndaj qasjes së kujdesshme që u ndërmor prej shumicës së Europës kundrejt programit të epokës së Bushit për një inkurajim të fortë të demokratizimit të Lindjes së Mesme (sidomos në Irak). Megjithatë, që në fillimet e saj kjo qasje u përball me probleme. “Revolucionet” në Tuniz dhe Kajro megjithatë dukej se përfaqësonin fitoren përfundimtare të “fuqisë së butë”. Protestuesit donin ushqim, vende pune dhe liri prej shtypjes nga një aparat shtetëror arbitrar. Megjithatë, ata kishin edhe kërkesa më “abstrakte” si për shembull demokracinë dhe mundësinë për pjesëmarrje më të plotë në të gjithë nivelet e shoqërisë së tyre<sup>59</sup>.

<sup>58</sup> Shih për shembull, *economist.com* (15/3/11) “*Bosnia’s long shadow over British foreign policy.*”

<sup>59</sup> *Joe Nye Intervention into the “Arab spring” debate.*

Kësisoj u formua skena. Me kërkesën e BE-së për të luajtur një rol më të madh në punët botërore, ndryshimet e Traktatit të Lisbonës që u miratuan me synim aftësimin e një aktori të ri dhe të kushtueshëm (Shërbimi i Veprimit të Jashtëm European i kryesuar nga Përfaqësuesja e Lartë, Baronsha Ashton) i gatshëm për të qenë i dobishëm, si edhe për shkak të vullnetit të shprehur prej dy fuqive më të mëdha ushtarake në Europë (Britanisë dhe Francës) për të qenë “të përfshirë” edhe pse fillimisht me anë të KS së OKB-së, dukej se një krizë e madhe ndërkombëtare në afërsi të Europës do të përfaqësonte me siguri një mundësi për të parë se sa larg kishte shkuar Europa nga magjia e fjalimit të *Jacques Poo* “Kjo është ora e Europës” në shpërthimin e konfliktit Jugosllav rreth njëzet vjet më parë.

Për më tepër, NATO u pa si një mjet problematik potencial. Përgjigjja ndaj krizës, me anë të këtij instrumenti, kishte parasysht qasjen fillestare pozitive amerikane ndaj ndërhyrjes (për të cilën Sekretarja e Shtetit *Clinton* ishte në rastin më të mirë “mikpritëse”) ndërkohë që një tjetër anëtar i NATO-s (Turqia) ishte përfshirë në projektet e tij, dhe fillimisht nuk donte të perceptohej si palë në përdorimin e forcës ndaj Libisë. Për më tepër, Turqia argumentoi se përdorimi i NATO-s do të ishte “provokues” dhe do të dërgonte sinjalet e gabuara në rajon (sidomos pas karakterizimit si “kryqëzatë”, të ndërhyrjes që u bë nga ministri i Punëve të Brendshme francez *Claude Guean*<sup>60</sup>).

Përpara se të ndërmerrej ndonjë aksion, megjithatë, duhej marrë bekimi i domosdoshëm shumëpalësh në formën e një rezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Si pasojë e presionit të përbashkët anglo-francez, më 17 mars amerikanët ishin bindur që ndërhyrja ishte e domosdoshme dhe ata tashmë udhëhiqnin grupin që kërkonte një “zonë ndalim fluturimi” si elementin fillestar të qasjes që përfshinte “të gjitha masat e nevojshme”, për të mbrojtur civilët libianë dhe sidomos ata që rrezikoheshin drejtpërdrejt në qytetin e Bënghazit nga rrethimi që i ishte bërë qytetit prej forcave besnike të *Ghaddafit*.

Rezoluta e miratuar më parë (1973) u vijua prej rezolutës së 26 shkurtit, e cila vendosi sanksione mbi regjimin libian, por shkoi edhe më tej duke garantuar ndërmarrjen e “të gjitha masave të nevojshme” për mbrojtjen e civilëve. Neni justifikues që përdor për

<sup>60</sup> Shih *Delphine Strauss* në *ft.com* (24/3/2011), “Turqia sulmon Francën për kryqëzatën libiane”. Në fund, Turqia zgjodhi të shprehet në favor të një force të udhëhequr nga NATO sesa për një koalicion *ad hoc* të palëve që duan të marrin pjesë, e cila duhej të ishte fillimisht mënyra e preferuar e Francës.



legjitimitimin e veprimit ishte principi i riformuluar “R2P”<sup>61</sup> (*Right to Protect*) (kur një shtet sovran dështon në parandalimin e masakrave, qeveritë e huaja mund të ndërhyjnë për parandalimin e tyre). Shtetet europiane ishin në zemër të një procesi, duke nxjerrë në pah meritat e “një shumëpalshmëri efikase” në politikat globale.

Më pas erdhi shpërthimi i bombës. Edhe pse rezoluta më 1973 u kalua nga Këshilli i Sigurimit, ndërsa Rusia dhe Kina që kanë të drejtën e votës, thjesht abstenuan së bashku me anëtarë të tjerë të rëndësishëm të BRIC dhe me mbrojtësit e zjarrtë të “soveranitetit shtetëror”. Çuditërisht, këtij grupi iu bashkua edhe Gjermania, e cila theu radhët e BE-së duke vënë në pikëpyetje mbështetjen e këtij vendi për R2P, vullnetin e saj për një “shumëpalshmëri efikase”, dëshirën e PPJS-së për të “folur me një zë të përbashkët” si dhe, pa dyshim, të gjithë kuadrin e Politikës së Përbashkët për Mbrojtjen dhe Sigurinë, të bazuar te BE-ja. Çfarë nxititi këtë vendim, duke pasur parasysh se Sekretari gjerman i Jashtëm, *Guido Westerwelle*<sup>62</sup>, ka qenë ndër të parët që shfaqti solidaritet me ata që u përfshinë në “Pranverën Arabe”, duke shkuar vetë në sheshin Tahrir në qendër të Kajros.

Së pari, duhet të kemi parasysh qëllimin e PPJS-së. Ajo është hartuar për të mbuluar “të gjitha fushat e Politikës së Jashtëm

---

<sup>61</sup> Norma e R2P u miratua në Samitin Botëror të OKB-së të vitit 2005, dhe shënoi një përpjekje për “riformulimin” e normës “tradicionale” të ndërhyrjeve humanitare, e cila ishte përdorur deri atëherë. Kjo argumentohet në literaturë, por jo nga vetë shtetet, të cilët kanë pretenduar për “vetëmbrojtje” në tre raste të famshme gjatë viteve 1970: India në Pakistanin Lindor, 1971; Vietnami në *Kampuchea*, 1978 dhe Tanzania në Uganda, 1979. Ndërkohë që justifikimi kryesor për këto ndërhyrje u mundësua nga katastrofat humanitare masive, “konsideratat e ‘politikave të fuqive’ përbënin nxitësin kryesor të politikave të shteteve në secilin rast”. “Norma” për ndërhyrjen humanitare do të bëhej më pas aq e kontestueshme, saqë do të bëhej e papërdorshme dhe me intensifikimin e Luftës së Ftohtë. Në fillimin e viteve 1980 ajo u la mënjanë. Kjo çështje nuk do të vinte në vëmendjen ndërkombëtare deri në mesin e viteve 1990 me Ruandën, Serbrenicën etj. Libia ishte hera e parë ku “R2P” u përdor nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar. Megjithatë, në vitin 2008 Rusa e përdori atë si justifikim për konfliktin e saj me Gjeorgjinë për shkëputjen e Abkazit, si edhe në vitin 2008 Franca kërcënoi qeverinë e Mianmarit se do të përdorte këtë princip nëse ajo vazhdonte të bllokonte shpërndarjen e ndihmave ndërkombëtare, pas ciklonit që përfshiu vendin. Për më shumë, mbi R2P shih: <http://www.responsibilitytoprotect.org/index.php/about-rtop>.

<sup>62</sup> *Timothy Garton Ash* analizon në veçanti *Westervellen*-in dhe pasojat e politikës gjermane më në përgjithësi. Shih [www.guardian.co.uk](http://www.guardian.co.uk). (24/3/2011), “*France plays hawk, Germany demurs. Libya has exposed Europe’s fault lines*” e shkarkuar në: <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2011/mar/24/france-hawk-germany-demurs-libya-europe?INTCMP=SRCH>.

dhe të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e BE-së, duke përfshirë dhe progresin për hartimin e një kuadri për një politikë të përbashkët të mbrojtjes, që mund të çojë drejt një mbrojtjeje të përbashkët”. Pa dyshim që Libia përfaqësonte një ngjarje, magnituda e të cilës nuk mund të injorohej prej BE-së (sidomos duke pasur parasysh kontekstin e gjerë të “Pranverës Arabe”).

Nuk është e sigurt nëse BE-ja do të kishte marrë rolin udhëheqës në përgjigjen “Europiane” për krizën libiane, nëse Gjermania nuk do të vepronte ashtu si veproi në KS të OKB-së, si edhe për shkak se Britania e Madhe dhe Franca donin qartësisht pjesëmarrjen amerikane në vendosjen e një zone ndalim fluturimi mbi Libi, pasi asnjëra prej tyre nuk i kishte mjetet për të mbyllur me shpejtësi hapësirën ajrore libiane. Nga ana tjetër, është interesante të rikujtojmë shkurtimisht presionin e ushtruar nga Gjermania në këtë kohë, për të kuptuar se si prodhohej politika për Libinë e këtij shteti (si folëm më lart për politikën franceze dhe ato britanike).

Motivet për politikën gjermane janë të shumta dhe varjojnë. Nuk mund të mohohet se, sikundër Franca dhe Britania, Gjermania ka një sërë lidhjesh të dukshme ekonomike dhe biznesi me Libinë<sup>63</sup> (Gjermania merr 11% të naftës së saj nga Libia) dhe ndoshta ajo ka pasur presion për të mos shqetësuar një pozicion kaq të mirë të tregut<sup>64</sup>. Megjithatë, kjo duket se ka qenë një presion kundrejt të cilit Franca dhe Britania kanë rezistuar dhe ndoshta duhen marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë.

*Detke*, ndoshta është më afër të vërtetës kur thekson se kriza libiane erdhi në një kohë kur ekzistonin kushtet “perfekte për një stuh” për qeverinë gjermane (të kuptuarit se masat fillestare për borxhet sovraane europiane nuk do të mjaftonin për të ruajtur Euron dhe se taksapaguesve gjermanë do t’ju duhej që të “gërmonin më thellë” në xhepat e tyre për të financuar ndonjë propozim të ri, cunamit japonez dhe aksidentit nuklear të Fukushima-s që e pasoi atë, i cili duket se riktheu sërish një vend thellësisht skeptik kundër fuqisë bërthamore, dhe faktit se zgjedhjet

<sup>63</sup> Pra, BE-ja ka qenë partneri tregtar më i madh i Libisë në atë kohë, duke blerë 70% të eksporteve të saj. Libia ishte furnizuesi i tretë më i madh me energji i Europës dhe po bëhej gjithnjë e më i përfshirë në bashkëpunimin mbi emigrimin klandestin, duke marrë si shkëmbim rreth 60 milionë euro në vitin 2010. Shih *Simon McMahon* “Where is Europe on Libya?” (18/5/2011), *Europe on the Strand, and ideas on Europe blog* downloadable at: <http://www.europeonthestrand.ideasoneuropoe.eu/2011/05/18/ehere-is-europe-on-libya/>.

<sup>64</sup> Shih për shembull punimin e drejtpërdrejtë, por të balancuar në *Black Star News* “Quest for economic riches drove Germany’s Libya policy” downloadable at <http://www.blackstarnews.com/news/135/ARTICLE/7167/2011-03-02.html>.

vendore të vitit 2011 do të duhej të zhvilloheshin me një partner të ri në koalicionin e qendrës së djathtë, FRD-në e zotit *Westerwelle*, e cila po përpqej shumë për të mbajtur 5% e kërkuar për përfaqësimin në legjislaturat vendore<sup>65</sup>. Në këtë situatë qeveria gjermane ishte e paralizuar nga frika që kishte për elektoratin dhe pasojat afatshkurtra politike ndërmjet partive nga zgjedhjet vendore u ngritën sipër çdo nocioni të përkufizimit të interesit “kombëtar” duke mos i kushtuar shumë rëndësi bashkimit të gjerë në nivel europian dhe duke abstenuar mbi rezolutën 1973.

*Joschka Fischer* karikaturizon *Westerwellen*-in dhe thekson mungesën në qeverinë gjermane të çdo gjëje që i përngjan një kulture strategjike, kur thekson se “Politika e Jashtme nuk është thjesht të bësh një figurë të mirë në arenën ndërkombëtare por është diçka krejt tjetër me fokusim te zgjedhjet vendore. Politikë e Jashtme do të thotë marrja e përgjegjësive për zgjedhje të vështira, strategjike, edhe kur këto nuk janë shumë popullore brenda vendit”<sup>66</sup>.

Implikimet e vendimit gjerman ishin të menjëhershme. Në asnjë rrethanë tjetër nuk mund të mendohej se BE-ja do të ishte partneri udhëheqës në operacionet ndaj Libisë, për vetë faktin sepse nuk kishte pikëpamje konsensuale mbi çfarë mund dhe çfarë duhej bërë. Ndasitë në pozicionin europian kanë qenë të dukshme që prej Takimit të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së në 23 mars në Bruksel, ku u diskutuan sanksionet për Libinë dhe ku Malta, Italia dhe Qipro<sup>67</sup> kishin kundërshtime. Ndërkohë, një samit vijues i mbledhur me urgjencë nga *Cameroon* dhe *Sarkozy* që synonte vendosjen e rrezikut për shpalljen një “zone ndalim fluturimi” në zemër të deklaratës së BE-së në 11 mars u bojkotua me vendosmëri prej Gjermanisë dhe Suedisë<sup>68</sup>. Pas takimit në një konferencë të përbashkët për shtyp me kryeministrin hungarez Viktor Orban, presidenti i BE-së *Herman von Rompuy* theksoi se “ne nuk jetojmë më në një epokë koloniale ku fuqitë e huaja ndërhyjnë atëherë kur ju pëlqen atyre”<sup>69</sup>.

<sup>65</sup> *Dettke, D.*, 2011, *Germany says no again*, AICGS Advisor.

<sup>66</sup> *Fischer, J.*, 2011, “I feel ashamed”, *The German Times for Europe*, downloadable at: [http://www.germantimes.com/index.php?option=com\\_content&task=view&id=41470&Itemid=197](http://www.germantimes.com/index.php?option=com_content&task=view&id=41470&Itemid=197).

<sup>67</sup> Shih *EU business* (23/2/2011), “EU nations eye Libya sanctions but Italy, Malta object”.

<sup>68</sup> Shih *Nicholas Watt and Ian Traynor*, *The Guardian* (11/3/2011), “Libya no-fly zone setback for David Cameroon”.

<sup>69</sup> Shih *The Times of India*, 13/3/2011, “No military intervention in Libya, says European Council”, downloadable at: [http://www.articles.timesofindia.indiatimes.com/2011-03-13/europe/2865917\\_1\\_military-intervention-libya-options](http://www.articles.timesofindia.indiatimes.com/2011-03-13/europe/2865917_1_military-intervention-libya-options).

Rezultat i kësaj ishte se, në kohën kur u kalua rezoluta 1973, veçanërisht Franca ra dakord se nevojiteshin veprime të përshpejtuara për të ulur potencialin për ndonjë masakër të mundshme në Benghazi, i cili ishte në dorën e trupave të regjimit të *Gahddaf*-it. Në mes të takimit të Parisit, më 19 mars, ndërmjet palëve të interesuara se veprime të tilla do të ndërmerreshin nga avionët francezë, të cilët ishin tashmë në fluturim. Pra, ndërhyrja filloi e bazuar në mbështetjen e një “koalicioni të atyre që kishin vullnetin” (domethënë të atyre që donin të zbatonin rezolutën e KS-ës së OKB-së 1973). BE-ja nuk dukej gjëkund, ndërkohë që, për arsye operative, amerikanët morën udhëheqjen e *Operacionit Odyssey Dawn*<sup>70</sup>.

Edhe kur amerikanët filluan të tërhiqeshin nga të qenit kontribuuesit kryesorë të përpjekjes ushtarake (Obama u përball me një sërë presionesh të brendshëm për të mos u përfshirë në një tjetër konflikt në Lindjen e Mesme dhe me pikëpamjen mbizotëruese amerikane, se Libia ishte kryesisht një “shqetësim i Europës”) NATO dhe jo BE-ja, ose ndonjë grup *ad hoc* “vendesh anëtare të BE-së plus të tjerë” ishte ajo që mori kontrollin e operacionit.

Kritikat për BE-në si nga brenda saj, ashtu dhe nga jashtë, u intensifikuan. *Le Monde* shkruante:

*“Bashkimi Europian, për sa i përket kontributit të tij, ka dështuar në mënyrën më të turpshme. “Europa institucionale” nuk është përballur si duhet me sfidën. Në sagën e Afrikës së Veriut ajo nuk ekziston. Ajo është e paaftë për të rënë dakord mbi mënyrën si duhet vepruar, për faktin nëse duhet të njohë opozitën libiane dhe mbi të gjitha për legjitimitetin e përdorimit të forcës. Ndashia është totale dhe sidomos goditëse kur bëhet fjalë për të vendosur për luftën (me fjalë të tjera kur historia bëhet tragjedi dhe nevojitet të ecet përtej retorikave të vazhdueshme mbi të drejtat e njeriut.”*

*(Le Monde, 31/3/2011, cituar dhe përkthyer nga Menon, 2011 ibid.)*

Duket se diplomatët e BE-së ishin edhe më të ashpër. Në atë që ndoshta është citimi më i mirë i deri më sot mbi pasojat e konfliktit, duke parë rrëmujën në rritje të NATO-s mbi mënyrën

<sup>70</sup> *Operacioni Odyssey Dawn* ishte emërtimi i operacionit të udhëhequr nga ShBA në Libi. Ndërsa NATO, në vazhdim, morri përsipër e vetme të gjithë komandën e operacionit më 31/3/2011. Emërtimi i ri i tij ishte *Operacioni Unified Protector*. Për më tepër, pjesëmarrës individualë të koalicionit përdorën emërtimet e tyre për kontributet e tyre në operacionet ushtarake si për shembull: *Operacioni Allemy* (Britania e Madhe) dhe *Operacioni Harmattan* (Franca).

se si do të udhëhiqej ndërhyrja, një zyrtar i brendshëm i BE-së deklaroi thatë se: “PPJS-ja vdiq në Libi. Ne thjesht duhet të zgjedhim një dunë rëre nën të cilën ta varrosim”<sup>71</sup>.

Roli i Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Jashtme të BE-së, Baronessa Ashton, dhe i Shërbimit të Ri European të Veprimeve të Jashtme (EEAS) që ajo udhëheq, u bë pre e një numri të madh kritikash nga disa, për faktin se nuk po bënte mjaftueshëm, si edhe për faktin se po kërkonte të bënte më shumë<sup>72</sup>. Megjithatë, është e qartë se Ashton ishte e lënduar nga pasojat dhe nga fakti se nuk u arrit një pozicion i “përbashkët” ndërmjet vendeve anëtare. Ndërsa Traktati i Lisbonës i jep Përfaqësuesit të Lartë njëfarë “lirshmërie” për të ndërmjetësuar një kompromis në situata të tilla, ai nuk iu jep të drejtën për iniciativa individuale shteteve të veçanta.

Kjo pikë u theksua edhe më shumë kur, në fillim të prillit, Përfaqësuesi i Lartë më në fund doli me një plan për të shpërndarë asistencë humanitare në Libi kryesisht në qytetin e Misratës. Këshilli i Bashkimit European miratoi vendimin për iniciimin e një operacioni ushtarak të BE-së në mbështetje të përpjekjeve për asistencë humanitare në Libi. Vendimi i Këshillit, që u emërtua si EUFOR në Libi, vendosi kuadrin ligjor për misionin dhe rregulla për përfshirje dhe plane operacionale, të cilët duhet të zbatoheshin vetëm me kërkesë të OKB-së. Megjithatë, EUFOR në Libi mbetet ende i dështuar. OKB-ja nuk ka kërkuar zbatimin e misionit dhe ministrat e jashtëm të BE-së në vijim dështuan më 12 prill për aprovimin e një “koncepti bazë operacionale”<sup>73</sup>.

<sup>71</sup> *Alvise Armellini*, 24/3/2011, “Diplomatic mourn ‘death’ of EU defence policy over Libya” *Detusche Press-Agentur*, downloadable at [http://www.monstersandcritics.com/news/article\\_1628333.php/Diplomats-mourn-death-of-EU-defence-policy-over-Libya](http://www.monstersandcritics.com/news/article_1628333.php/Diplomats-mourn-death-of-EU-defence-policy-over-Libya).

<sup>72</sup> *Shih The Economist*, 27/5/2011, “Low ambition for the High Representative”. Këtu theksohen këndvështrimet e ndryshme që kanë vendet e mëdha dhe ato të vogla të BE-së për EEAS-në. “Për vendet e vogla ajo është megafon, ndërsa për vendet e mëdha kufizim”. *Shih gjithashtu Tob Vogel*, 24/5/2011, “Low ambitions for the High Representative”. *EuropeanVoice.com*, “Running out of friends”.

<sup>73</sup> Ministri i Jashtëm suedez *Carl Bildt* bllokoi miratimin e një plani operacionale të propozuar për misionin humanitar në takimin e 12 prillit të ministrave të Jashtëm të BE-së. *Bildt* argumentoi se miratimi i planit do të dërgonte sinjalin e gabuar, duke qenë se Kombet e Bashkuara ende kanë akses në qytetin libian të Misratës, i cili ndodhej në atë kohë nën rrethim të ashpër nga forcat besnike të *Gaddafi*-it. *Shih Ivy Mungca*, 15/4/2011, “EU divided over military mission for Libyan humanitarian response”, downloadable at [http://www.devex.com/en/articles/eu-divided-over-military-mission-for-libyan-humanitarian-response?source=ArticleHomepage\\_Center\\_3](http://www.devex.com/en/articles/eu-divided-over-military-mission-for-libyan-humanitarian-response?source=ArticleHomepage_Center_3).

Në realitet as NATO, dhe as BE nuk ka gjasa që të dalin nga kriza libiane me një reputacion të pacenuar. BE-ja thjeshtë nuk ishte e aftë për të arritur një kompromis ndërmjet pozicioneve konkurruese të ndryshme të vendeve anëtare. Traktati i Lisbonës nuk mundësoi mekanizma shtesë për këtë, dhe as nuk i mundësoi Përfaqësueses së Lartë ose Shërbimit Europian për Veprimet e Jashtme që të punonin paralelisht me vendet anëtare për gjetjen e zgjidhjeve alternative. *Ashton*-it iu mbyll goja kryesisht nga nevoja për gjetjen e emëruesit më të ulët të përbashkët ndërmjet vendeve anëtarë (një pozicion që të shkonte shumë më përtej sanksioneve dhe eventualisht të bazohej në asistencë humanitare. Për më tepër, procesi shpesh i ngatërruar i sigurimit për arritjen e një pozicioni konsensual sugjeron qartësisht se procesi i PPMS-së thjesht nuk është i përshtatshëm për ndërhyrjet me intensitet të lartë kur nevojiten vendimmarrje e shpejtë dhe me ndikime “në kohë reale”. Objektivi kryesor i bashkëpunimit në fushat e Politikës së Jashtme dhe të Mbrojtjes mbetet koordinimi i brendshëm i BE-së dhe jo zgjidhja e problemeve të jashtme. Qëllimi mbizotërues i “të folurit me një zë të vetëm” ndonjëherë nënkupton se qetësia është i vetmi option.

Pavarësisht lëvizjes drejt një “institucionalizimi” më të madh për sa i përket Politikës së Jashtme dhe asaj të Mbrojtjes dhe procesit të “brukselizimit” që shpesh shoqëron këtë proces, vendet anëtare mbeten lojtarët kryesorë në këtë fushë (për shtetet e vogla bashkëpunimi vepron si megafon, ndërsa për shtetet e mëdha ai është kufizues). Edhe pse është e qartë se pozicionet suboptimale miratohen për të gjithë BE-në. Ajo që mbizotëron këtu janë shqetësimet e brendshme të shteteve të mëdha të BE-së dhe jo koncepti i interesit të gjerë europian. Megjithatë, të gjitha vendet anëtare prirën të përdorin dhe të manipulojnë proceset vendimmarrëse në BE, për të marrë vlerësim në nivelin e debatit të brendshëm të tyre, duke theksuar shqetësimet e brendshme si një faktor që ndikon proceset e bërjes së politikave të tyre të jashtme.

Për sa i përket marrëdhënieve NATO-BE, Libia duket se ka bërë një rast “punësh të zakonshme”. Në terma administrativë, u zhvilluan një sërë takimesh si ai ndërmjet ambasadorëve të NATO-s dhe BE-së në Bruksel më 6 maj. Megjithatë, pavarësisht ankesave të Turqisë, takimi u përkufizua si “informal”, dhe si rrjedhojë gjatë tij nuk mund të merreshin vendime formale. Në nivel zbatues, karakterizimi tradicional i NATO-s si “fuqi e fortë” dhe i BE-së si “fuqi e butë”, duket se u rikthye me BE-në që u përmbajt te vendosja e sanksioneve dhe te bashkëpunimarrja

në misione për lehtësimin e krizës humanitare. Pra, siç theksohet dhe në *"The Economist"*: "ndërsa Britania e Madhe dhe Franca ndërmorën veprime kundër forcave libiane, zonja Ashton po përfshinte 'shoqërinë civile' në Benghazi. Shtetet e mëdha udhëheqin misionet luftuese, ndërsa BE-ja valëvit flamurin"<sup>74</sup>.

---

<sup>74</sup> *The Economist*, 27/5/2011, "Low ambition for the High Representative".

## Michael F. Harsch

### NATO DHE OKB: PARTNERITET ME POTENCIAL?

Gjatë dy dekadave të fundit, NATO dhe OKB kanë qenë partnerë të shpeshtë edhe pse të vështirë në menaxhimin e krizave. Ata kanë bashkëpunuar në rajone me probleme, si: Ballkani, Darfuri dhe brigjet e Somalisë. Që prej vitit 2003, ata janë përpjekur së bashku për stabilizimin e Afganistanit. Së fundi, nga marsi deri në tetor 2011, NATO dhe OKB i shtuan një kapitull tjetër historisë së tyre të stuhishme, kur Këshilli i Sigurisë autorizoi një operacion ajror për të mbrojtur civilët që ishin nën rrezikun e një sulmi në Luftën Civile të Libisë. Megjithatë, roli kryesor i NATO-s në përfundimin e udhëheqjes së kolonel *Gaddafi*-it, bëri që Rusia dhe anëtarë të tjerë të rëndësishëm të OKB-së të akuzonin aleancën si “rrëmbyese” të mandatit të Këshillit të Sigurisë, për të sjellë ndryshimin e regjimit në Tripoli.

Marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe OKB-së kanë ngelur një çështje delikate, pasi organizatat, ndonëse kanë pasur shpesh mbivendosje në histori, detyra dhe anëtarësi, ato kanë qenë veçanërisht të dallueshme. Pavarësisht premtimeve për të rritur përpjekjet për bashkëpunim në misionet e përbashkëta, të dyja palët kanë qenë të prirë për të mbrojtur pavarësinë e vendimeve dhe veprimeve të tyre. Si rezultat, NATO dhe OKB shpesh kanë punuar për qëllime të ndërthurura në menaxhimin e krizave, duke vepruar më shumë si ndërbllokuese sesa si institucione ndërlidhëse.

Duke marrë parasysh burimet komplementare të NATO-s dhe të OKB-së, një bashkëpunim më i ngushtë duket si një mjet i dukshëm që do të rrisë efektivitetin e të dyja organizatave në operacionet për forcimin e paqes dhe stabilitetit. OKB-ja mund t'i dhurojë legjitimitet dhe ekspertizë civile këtyre përpjekjeve. Kapacitetet ushtarake të parivalizueshme të NATO-s sigurojnë operacione me “muskuj dhe dhëmbë”. Një koordinim dhe një kombinim më i mirë i burimeve të NATO-s dhe OKB-së lejon për sinergji të reja, dhe është veçanërisht thelbësor tani, në një kohë që shumë vende po përballen me kriza ekonomike.



Kjo analizë e bashkëpunimit të NATO-s me OKB-në në Libi dhe në Afganistan, sugjeron se NATO-ja dhe OKB-ja ka të ngjarë të bëjnë përpjekje domethënëse për bashkëpunim, në kohën kur të dyja palët kërkojnë burimet e organizatës partnere për të arritur qëllimet. Megjithatë, nëse ekzistojnë alternativa të mundshme për bashkëpunim, ose nëse varësia nga burimet është e njëanshme, strukturat bashkëpunuese rrallë funksionojnë efektivisht dhe organizatat mbeten hezituese të vendosin veprimet e tyre në njëjtin drejtim. Në operacionet në Libi dhe në Afganistan, masa dhe balanca e varësisë së burimeve NATO-OKB promovoi modele të ndryshme bashkëpunimi: në rastin e Libisë, anëtarët e NATO-s fillimisht kishin një interes të madh të bashkëpunonin me OKB-në për të marrë një mandat të Këshillit të Sigurisë për të përdorur forcën. Pasi kishte filluar ndërhyrja “qëndroj vetëm”, OKB-ja u bë e varur nga NATO për të influencuar drejtimin e veprimeve ushtarake. Në Afganistan, ku misionet e NATO-s dhe OKB-së veprojnë “krahë për krahë”, një përqasje me fokus ushtarak për menaxhimin e konfliktit e vendosi NATO-n në pozita dominuese. Mungesa e balancës në burimet organizative i bën të dyja palët hezituese për t’u angazhuar seriozisht me njëra-tjetrën për çështje thelbësore, përtej mbështetjes për zgjedhjet.

Vendet anëtare mund të promovojnë bashkëpunimin më efektiv NATO-OKB, duke përcaktuar terma bashkërisht të pranuar për bashkëveprimin, duke përcaktuar detyrat e përbashkëta në operacione dhe duke i siguruar të dyja organizatave burime të mjaftueshme për të përmbushur mandatet e tyre.

Për të lehtësuar bashkëpunimin strategjik në ndërhyrjet ushtarake si në Libi, NATO, duhet të vazhdojë praktikën e viteve të kaluara dhe të përdorë forcën vetëm nën mandatin e Këshillit të Sigurisë. Do të jetë e vështirë për shumë vende anëtare të NATO-s të pranojnë zyrtarisht statusin si organizatë rajonale. Megjithatë, pajtueshmëria në mënyrë vullnetare me rregullat strikte të Kartës së OKB-së, për organizatat rajonale, do të forcojë sistemin e OKB-së për sigurinë e përbashkët, e cila është në mënyrë thelbësore një interes afatgjatë i anëtarëve të NATO-s. Aleanca gjithashtu duhet të jetë më shumë transparente dhe e përgjegjshme kur udhëheq ndërhyrjet “qëndroj vetëm”. Nga ana tjetër, anëtarë me ndikim të OKB-së - duke përfshirë Rusinë, Kinën dhe fuqitë në rritje si: India, Brazili, Afrika e Jugut - duhet të angazhohen për mbështetje politike në nivele më të larta në ndërhyrjet e NATO-s të mandatuar nga OKB-ja për të rritur stimujt për aleancën që të përfshihet në bashkëpunim.

Për të përmirësuar bashkëpunimet operacionale në operacionet e përbashkëta stabilizuese, NATO dhe OKB duhet të balancojnë detyrat dhe burimet në misionet e tyre sipas ekspertizës organizuese. Në Afganistan, personeli i madh i ISAF si dhe burimet financiare dhe logjistike e kanë margjinalizuar misionin e OKB-së dhe penguar në masë të madhe bashkëpunimin domethënës ndërmjet organizatave. Faza e tranzicionit drejt autoritetit të plotë të Afganistanit, ofron një mundësi të re për të krijuar një ndarje më efektive të punës ndërmjet NATO-s dhe OKB-së. Pas tërheqjes së forcave të ISAF në 2014, OKB-ja duhet të bëhet pika kyçe për përpjekjet ndërkombëtare për të promovuar pajtimin kombëtar, ndërtimin e kapaciteteve civile dhe të drejtat e njeriut. Një fokus i veçantë duhet të vendoset në ndërtimin e kapaciteteve afgane në sektorin e drejtësisë. NATO duhet të kufizojë aktivitetet e tij në trajnimin dhe në ngritjen e kapaciteteve në sektorin e sigurisë. Ai, gjithashtu, duhet të vazhdojë t'i ofrojë mbrojtje OKB-së në një mënyrë gjithnjë e më shumë diskrete dhe të përgjegjshme. Me pak fjalë, NATO-ja dhe OKB-ja duhet, si *Ban Ki Moon* tha në Samitin e NATO-s në 2008 në Bukuresht: "Të fokusohen në ato fusha ku secili prej nesh ka kapacitete dhe ekspertizë specifike, duke i shtuar vlerën punës së të tjerëve në vend të dublikimit së saj".

Kërkimi për kushte të reja për angazhimin në menaxhimin e krizave, duhet të mbështetet nga dialogu konstant dhe thelbësor ndërmjet zyrave qendrore institucionale dhe nga transferimi më i strukturuar i njohurive. Konkretisht, të dyja palët duhet të krijojnë përfaqësime me të drejta të plota të përhershme në Nju-Jork dhe Bruksel dhe të institucionalizojnë më tej dialogun në nivel të përfaqësuesve të lartë përmes një kalendari fiks. Përveç kësaj, NATO dhe OKB duhet t'i japin prioritet nënshkrimit të marrëveshjeve, të cilat mundësojnë shkëmbimin e informacionit konfidencial në të gjitha nivelet. Ndërkohë që NATO nuk do të jetë gati të shkëmbejë dokumentet e tij më sekrete, duhet të identifikohen marrëveshje për dosje, të cilat klasifikohen me nivel të ulët sigurie.

Bashkëpunim më efektiv NATO-OKB nuk siguron një ilaç për zgjidhjen e problemeve që pllakosi Afganistanin dhe vendet e tjera në krizë. Megjithatë, marrëdhëniet më të ngushta NATO-OKB dhe ndarjet komplementare të punës, mund të rrisin sinergjinë dhe të parandalojnë palët që të punojnë për një qëllim të përbashkët. Pasi Afganistani u përball me mundësinë e një lufte civile, duke ndjekur largimin e aleatëve në 2014, NATO dhe OKB duhet të bëhen më seriozë në lidhje me aderimin, për një përjasje më të unifikuar.

## Hyrje

Shtetet anëtare të NATO-s janë përballur që nga fillimi me pyetjen se si aleanca mund të bëhet e përputhshme me Kombet e Bashkuara. Gjatë Luftës së Ftohtë, NATO dhe OKB i ngjanin vajit dhe ujit: ato nuk u përzien<sup>1</sup>. Që në fillim të viteve 1990, marrëdhënia NATO-OKB ka ndryshuar thellësisht dhe të dyja palët janë angazhuar së bashku në kriza të shumta ndërkombëtare nga Ballkani në Afganistan dhe Libi. Arsyeja themelore për këtë zhvillim ka qenë rritja e ndërvarësisë së NATO-s dhe OKB-së në menaxhimin e krizave. Si një nga ndërtuesit e Konceptit Strategjik të NATO-s në 2010, ish-drejtori i Planifikimit të Politikave, *Jamie Shea* shpjegon: “Në të gjitha rastet e mëparshme kur NATO hartoi një Koncept Strategjik, objektivat e tij në thelb mund të arriheshin vetëm përmes punës së anëtarëve të vet. Partnerët ishin të dobishëm, por jo ndihmues thelbësor në këtë përpjekje. Sot, në kontrast, praktikisht gjithçka që NATO bën, kërkon aftësinë për të ndikuar përfshirjen dhe kontributin e të tjerëve”<sup>2</sup>.

Kështu, bashkëpunimi është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm për NATO-n dhe OKB-në për të përballuar kërkesat komplekse të menaxhimit të krizave bashkëkohore. Bashkëpunimi i organizatave ka ngelur i kufizuar në një numër të limituar operacionesh me interes të përbashkët. Megjithatë, këto veprime zakonisht janë kritike për sigurinë ndërkombëtare. Prandaj është e rëndësishme të kuptohet se në çfarë kushtesh NATO dhe OKB tentojnë të bashkëpunojnë efektivisht.

Ky shkrim argumenton se NATO dhe OKB bashkëpunojnë ngushtë kur të dyja palët perceptojnë nevojën për të pasur akses në burimet e jashtme për të përmbushur qëllimet e organizatës. Duke qenë se organizatat tentojnë të kenë një mospëlqim të madh kundrejt shkeljeve mbi lirinë e tyre të veprimit, ato gjithashtu duhet të mos kenë alternativa të mundshme politike dhe financiare për bashkëpunim. Alternativa potenciale janë sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme dhe i ekspertizës për të vepruar në pavarësi ose për të justifikuar “të qëndruarit vetëm” bazuar në pretendimet për domosdoshmërinë e veprimeve ose në imperativat morale. Së fundmi, duhen dy veta për tango:

<sup>1</sup> *Derek G. Bothby*, “Background Paper”, In *Cooperation between the UN and NATO: Quo Vadis?*, David M. Malone, New York, Akademia Ndërkombëtare e Paqes, 1999.

<sup>2</sup> *Jamie Shea*, “NATO at Sixty - and Beyond”, *NATO in search of a Vision*, Gulnur Aybet dhe Rebecca P. Moore, Washington DC: Georgetown University Press, 2010, 28-29.

bashkëpunimi mund të jetë efektiv vetëm nëse të dyja palët e realizojnë atë<sup>3</sup>.

Anëtarët e NATO-s zakonisht janë të interesuar në mandatet e Këshillit të Sigurisë së OKB-së për përdorimin e forcës, e cila tenton të rrisë mbështetjen e brendshme dhe ndërkombëtare për operacionet. Aleancës gjithashtu i mungon ekspertiza e OKB-së në organizimin e zgjedhjeve dhe në ndërtimin e institucioneve politike në shoqëritë postkonfliktuale. OKB-ja, nga ana e saj, ka një interes në aksesin ndaj kapaciteteve të avancuara ushtarake dhe logjistike të anëtarëve të NATO-s, për të adresuar krizat atje ku “nuk mund të mbahet paqja”. Ndërsa të gjitha vendet e NATO-s janë gjithashtu anëtare të OKB-së, aleatët kanë qenë hezitues në vendosjen e kontingjentit të trupave kombëtare nën komandën e OKB-së, që nga dështimi i misionit të OKB-së në mbajtjen e paqes në Bosnjë (UNPROFOR). Të dyja organizatat gjithashtu kanë njohuri komplementare në aspekte të ndryshme në Reformat e Sektorit të Sigurisë (SSR) dhe Çarmatimit, Çmobilizimit dhe Riintegritimit (DDR). Megjithatë, duke qenë se proceset e këtyre reformave në thelb janë politike, dobia e kapaciteteve të organizatave, së pari, varet nëse përfshirja e tyre mbështetet nga elita e vendit pritës dhe nga publiku i gjerë.

Stimujt për të kombinuar burimet NATO dhe OKB ekzistojnë sidomos në ndërhyrjet “qëndroj vetëm” dhe në veprimet e përbashkëta stabilizuese. Në skenarin e “të qëndruarit vetëm”, NATO drejton në mënyrë të pavarur veprimet ushtarake, kryesisht përmes përdorimit të forcave ajrore. Zakonisht, këto operacione janë të justifikuara me bazë humanitare. Në raste të tilla, NATO dhe OKB mbeten në mosmarrëveshje për çështje të rëndësishme: së pari, kur i kërkon aleanca mandat Këshillit të Sigurisë për ndërhyrje ushtarake? Së dyti, në çfarë mase NATO duhet të konsultohet me OKB-në gjatë një aksioni? Në Kosovë, NATO ndërhyri pa autorizimin e OKB-së. Në kontrast, aleanca mori aprovimin e Këshillit të Sigurisë për operacionet në Libi, por më pas u përball me akuzat e tejkalimit të mandatit.

Forma e dytë e bashkëpunimit, kanë qenë misionet paralele të tilla si: Kosova pas Luftës, dhe në Afganistan. Këto operacione stabilizuese komplekse përfshijnë një numër të madh aktorësh dhe një bashkëpunim të nevojshëm NATO-OKB në terren. Për shembull, NATO udhëheq veprimet e forcave të

---

<sup>3</sup> *Jeffery Pfeffer dhe Gerald R. Salanick, The external Control of Organization. A Resource Dependence Perspective, New York: Harper dhe Row, 1978. Michael F. Harsch, The power of dependence. NATO-UN cooperation in crisis management, DT Thesis, Berlin: Freie Universitat Berlin, 2011.*

ISAF krahë për krahë me misionin e OKB-së në Afganistan. Ende të dyja palët kanë dështuar që të ndërlihdhin në mënyrë efektive veprimet e tyre në vend. Me pak fjalë, NATO-ja dhe OKB-ja përballen me stimujt për të bashkëpunuar në ndërhyrjet ushtarake dhe operacionet e përbashkëta stabilizuese, por përpiqen të identifikojnë terma efektivë të bashkëveprimit. Dy pjesët në vazhdim analizojnë pengesën, për më shumë përpjekje uniteti në të dy skenarët. Shkrimi përfundon me rekomandime për terma më efektivë të bashkëpunimit NATO-OKB.

### **Bashkëpunimi NATO-OKB në veprimet e “të qëndruarit vetëm”:** nga Kosova në Libi

Më shumë se 60 vjet pas krijimit të NATO-s, roli i aleancës brenda sistemit të sigurisë kolektive të OKB-së mbetet i paqartë. Aleanca nuk ka dashur të përjashtojë mundësinë e ndërhyrjes në konflikte në mungesë të mandatit të Këshillit të Sigurisë së OKB-së. Shumë anëtarë të OKB-së ngelen të shqetësuar për veprimet e pasanksionuara të aleatëve dhe janë ankuar për konsultimet e tyre të pamjaftueshme në veprimet e udhëhequra nga NATO. Këto konflikte ndërmjet organizatave gjatë ndërhyrjeve “qëndrojnë vetëm” u nënvizuan pas periudhës së veprimeve në Libi. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s *Rasmussen* argumentoi se miratimi i veprimeve të aleatëve nga Këshilli i Sigurisë ishte i dëshirueshëm, por jo shumë i domosdoshëm.<sup>4</sup>

Ky seksion ekzaminon se deri në çfarë mase NATO-ja dhe OKB-ja varen nga burimet e njëra-tjetrës në ndërhyrjet ushtarake, dhe se si kjo varësi luhet në rastin e Libisë. Një shikim më i afërt i dispozitave të Kartës së OKB-së dhe Traktatit të NATO-s tregon se aleanca ka një interes të madh në mandatet e Këshillit të Sigurisë për arsye ligjore dhe arsye thelbësore strategjike. Operacionet në Libi treguan se marrëveshja NATO-OKB për ndërhyrjet ushtarake në konfliktet civile është e mundur. Ende organizatat duhet të zhvillojnë terma të qartë dhe përfshirëse të bashkëpunimit, e cila pajis Këshillin e Sigurisë me mundësinë për të rritur shqetësimet dhe të parandalojë vetë mposhtjen e polemikave publike ndërmjet NATO-s dhe fuqive joperëndimore gjatë operacioneve.

<sup>4</sup> *Joachim Zepelin, “Nato will ohne Uno-Mandat in den Krieg” Financial Times Deutschland, 27 tetor 2011.*

## OKB, NATO dhe përdorimi i forcës

Karta e OKB-së e 1945-s i jep Këshillit të Sigurisë përgjegjësinë primare për mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare për të parandaluar një tjetër luftë botërore ose një konfrontim ushtarak në një shkallë të gjerë, në të cilën çdo palë deklaron një qëllim të drejtë. Kapitulli VII i Kartës, specifikon se forca që nuk i shërben qëllimeve individuale ose kolektive të vetëmbrojtjes mund të përdoret vetëm në bazë të një mandati të Këshillit të Sigurisë. Kështu, Këshilli i Sigurisë zotëron monopolin *de juro* për autorizimin e përdorimit të forcës jo vetëmbrojtëse.

Megjithatë, krijimi i NATO-s më 1949, dhe në njëfarë mase ekzistenca e tij e vazhdueshme pas rënies së Bashkimit Sovjetik, ka qenë një shprehje e dëshirës së shteteve Perëndimore për një institucion, i cili siguron më shumë besueshmëri në garantimin e sigurisë sesa OKB-ja. Anëtarët e NATO-s kishin frikën e bllokimit në Këshillin e Sigurisë në raste të sulmit nga Sovjetikët, dhe ndërtuan aleancën rreth principit të musketierit të mbrojtjes kolektive: një sulm i armatosur kundrejt një anëtari është konsideruar një sulm kundrejt të gjithëve, duke rezultuar në koordinimin e kundërmasave nga të gjithë aleatët<sup>5</sup>.

Themeluesit e NATO-s ishin të prirë të vendosnin Traktatin e Atlantikut të Veriut brenda kornizës së sistemit të OKB-së për të shmangur përshtypjen se ata po zëvendësonin OKB-në me një aleancë ushtarake të dalë jashtë mode<sup>6</sup>. Kështu, Traktati i NATO-s i referohet gjerësisht Kartës së OKB-së. Neni 7, në mënyrë të qartë pohon se ekzistenca e NATO-s nuk do të ndikojë “në asnjë mënyrë [...] përgjegjësinë kryesore të Këshillit të Sigurisë për mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”<sup>7</sup>.

Megjithatë, Traktati i NATO-s me qëllim nuk e përmend Kapitullin VIII të Kartës së OKB-së ose ndonjë prej artikujve, i cili merret me “marrëveshjet rajonale” (sot zakonisht i referohemi si organizata rajonale). Deri më sot, anëtarët e NATO-s frikësohen se detyrimet e Kapitullit VIII do të dëmtojnë lirinë e veprimeve të NATO-s. Siç thuhet në Kapitullin VIII të organizatës, NATO-s do t'i kërkohet të mbajë Këshillin e Sigurisë së OKB-së “në çdo kohë [...] plotësisht të informuar për aktivitetet e ndërmarra ose në suditje [...] për mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”<sup>8</sup>. NATO

<sup>5</sup> Traktati i Aleancës së Veriut, neni 5.

<sup>6</sup> Lawrence S. Kaplan, *NATO and UN: A Peculiar Relationship*; Columbia: University of Missouri, 2010, chapter I.

<sup>7</sup> Traktati i Aleancës së Veriut, neni 7.

<sup>8</sup> Karta e Kombeve të Bashkuara 1945, neni 54.

gjithashtu duhet të ndërmarrë veprime përforcuese vetëm “nën autoritetin” e Këshillit të Sigurisë së OKB-së. Kështu, NATO duhet t’i kërkojë leje Këshillit të Sigurisë përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim ushtarak. Kjo do t’i mundësonte Rusisë dhe Kinës të vërë veten në vendimet e aleancës<sup>9</sup>, në mënyrë që të shmangë shqyrtimin e Këshillit të Sigurisë së OKB-së, Traktati i NATO-s i referohet nenit 51 të kësaj Karte. Ky nen e detyron NATO-n që thjesht të raportojë te Këshilli i Sigurisë, pasi janë ndërmarrë masat për vetëmbrojtje.

Në rastin e Kosovës, NATO drejtoi veprimtarinë ajrore të 1999-s pa autorizimin e OKB-së. Anëtarët e NATO-s vunë përpara shumë justifikime ligjore dhe morale për ndërhyrjen, më e dukshme ishte përdorimi i forcës si zgjidhja e fundit për të shmangur një katastrofë të menjëhershme humanitare. Megjithatë, shumë studiues të ligjeve ndërkombëtare miratuan se ndërhyrja e NATO-s ishte joligjore, sepse i mungonte mandati i OKB-së<sup>10</sup>. Ndërhyrja e palejuar në Kosovë krijoi tensione të mëdha ndërmjet anëtarëve të NATO-s dhe shkaktoi rezistencë të brendshme dhe ndërkombëtare kundrejt ndërhyrjeve.

Koncepti Strategjik 2010 i NATO-s, thekson se “aleanca është e angazhuar në mënyrë të vendosur ndaj qëllimeve dhe principeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara”, duke pohuar “përgjegjësinë kryesore të Këshillit të Sigurisë për mbajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare”<sup>11</sup>. Ai gjithashtu pohon se NATO do të plotësojë detyrat e veta “gjithnjë sipas ligjeve ndërkombëtare”<sup>12</sup>. Megjithatë, koncepti strategjik i aleancës as nuk e pranon NATO-n si një organizatë rajonale ashtu siç ishte përcaktuar në Kapitullin VIII të Kartës së OKB-së, as në mënyrë eksplicite nuk përjashton NATO-n që të ndërmarrë veprime ushtarake sulmuese pa autorizimin e OKB-së.

<sup>9</sup> Karta e Kombeve të Bahkuara 1945, neni 53 (1). Shiko gjithashtu *Dan Sarooshi*, “Autorizimi i Këshillit të Sigurisë për Marrveshje Rajonale për Përdorimin e Forcës: Rasti i NATO-s.” në *Këshilli i Sigurisë së Shteteve të Bashkuara dhe Lufta*, Vaughan Lowe, Oxford: Oxford University Press, 2008, 226-247.

<sup>10</sup> Steven Haines, “Influenca e verpimeve të Forcave Aleate në Zhvillimin e Jus ad Bellum”, *International Affairs* 85 (3), 2009, 477-490

<sup>11</sup> Kryetarët e qeverive të NATO-s dhe Qeveritë, “Përfshirje aktive, mbrojtje moderne: Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut,” Lisbonë, 19 nëntor 2010, <http://www.nato.int/lisbon2010/straegic-concept-2010-eng.pdf,para.2.12>.

<sup>12</sup> *Ibid.*, para. 4.

## Libia dhe ndikimi i saj në marrëdhënien NATO-OKB

Operacionet e NATO-s në Libi nga marsi në tetor të 2011-s kanë dy implikime të rëndësishme për marrëdhënien NATO-OKB në ndërhyrjet ushtarake. Së pari, ajo ilustron se është e mundur për aleancën të marrë miratim për ndërhyrje humanitare nga Këshilli i Sigurisë së OKB-së. Më 17 mars 2011, Këshilli autorizoi përdorimin e “mjeteve të nevojshme” për të mbrojtur civilët nën rrezikun e një sulmi në vend.<sup>13</sup> Rezoluta e OKB-së e 1970-s dhe e 1973-shit reflekton momentet historike të Pranverës Arabe dhe mosbindjen e hapur të regjimit të *Gaddafi*-it ndaj të gjitha thirrjeve për kufizim të reagimeve të tij ndaj revoltave popullore kundër udhëheqjes së tij. Rezolutat e OKB-së ishin gjithashtu të rëndësishme, pasi ato i referoheshin për herë të parë përgjegjësisë për të mbrojtur popullin ndaj mizorive masive. Kjo normë ligjore është në konflikt me mbështetjen e Kinës dhe Rusisë për principin e sovranitetit kombëtar dhe mosndërhyrjen në punët e brendshme. Gjithsesi, Kina dhe Rusia, së bashku me Indinë, Brazilin dhe Gjermaninë, abstenuan me votën dhe lejuan rezolutën të kalojë. Kjo bëri që OKB-ja të sanksionoj ndërhyrjet ushtarake, e cila u mor shpejt përsipër nga NATO dhe me shumë gjasa parandaloi një masakër në bastionin rebel në Bengaz.

Së dyti, ndërhyrja në Libi tregoi sfidat e mbajtjes së marrëdhënieve bashkëpunuese ndërmjet NATO-s dhe OKB-së në rrjedhën e veprimeve ushtarake. NATO u përball me pak stimuj për t’iu përgjigjur kërkesës së OKB-së në kohën që aleanca kishte marrë një mandat për përdorimin e forcës. Anëtarët e Këshillit të Sigurisë Kina, Rusia, India, Brazili dhe Afrika e Jugut akuzuan aleancën për tejkalimin e kufijve të mandatit të OKB-së. Këto shtete argumentuan se veprimet ushtarake të NATO-s ishin të njëanshme dhe synonin ndryshimin e regjimit, një qëllim që shkonte shumë larg mandatit origjinal të OKB-së për të mbrojtur civilët libanezë. Megjithatë, në OKB kritikuesit e ndërhyrjes ngelën qëndruar të papushtetshëm. Pas eksperiencës në Libi, Rusia dhe Kina ka të ngjarë të jenë më hezituese për t’i dhënë NATO-s një mandat të OKB-së, duke u frikësuar se ato do të mënjanohen gjatë veprimeve ushtarake. Kështu, mungesa e transparencës së NATO-s dhe mosgatishmëria për të adresuar shqetësimet e vendeve të fuqishme të OKB-së gjatë veprimeve në Libi, ka rritur kufirin për të fituar mbështetje për veprimet e ardhshme në Këshillin e Sigurisë në OKB.

<sup>13</sup> Këshilli i Sigurisë së OKB-së, “Rezoluta 1973”, S/RES/1973, 17 mars 2011, para. 4. Shiko gjithashtu Këshilli i Sigurisë së OKB-së, “Rezoluta 1970”, S/RES/1970, 26 shkurt 2011.



Guxim i NATO-s në shtrirjen e mandatit të Libisë deri në limit, dhe ndoshta përtej tyre, gjithashtu ka komplikuar një përgjigje të OKB-së ndaj dhunës në Siri, ku Forcat e Sigurisë më 2011 reaguesh ndaj protestave joqeveritare me një dhunim të gjerë të të drejtave të njeriut. Nuk ka dëshmi se NATO e ka konsideruar seriozisht një ndërhyrje në Siri, duke i shtuar rrezikun që vendi mund të bëhet më pas vend beteje për fuqi të ndryshme rajonale.<sup>14</sup> Lidhjet e ngushta politike dhe ekonomike të Moskës me regjimin e Asadit e bëri të dukshme që në fillim që Moska nuk do të mbështeste sanksionet e OKB-së kundrejt vendit. Megjithatë, në tetor 2011, Rusia dhe Kina votuan për të dobësuar rezolutën e OKB-së të sponsorizuar nga anëtarët e Këshillit të Sigurisë Europiane që dënuan dhunën dhe paralajmëruan që Këshilli do t'i merrte parasysht “masat e targetuara” nëse do të vazhdonte dhuna ndaj civilëve. Ambasadori i Rusisë në OKB deklaroi se një arsye e refuzimit të rezolutës nga Rusia ishte eksperiencia në Libi. Ai paralajmëroi se Libia po bëhej “një model për veprimet e ardhshme të NATO-s në zbatimin e përgjegjësisë për të mbrojtur [R2P].”<sup>15</sup> Në fund të tetorit 2011, anëtarët e NATO-s adresuan disa nga këto shqetësime, duke mbështetur iniciativën e Rusisë për një rezolutë të OKB-së, e cila e mbaroi në mënyrë zyrtare mandatin për ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare në Libi.<sup>16</sup> Megjithatë, ndërhyrja në Libi ilustron që veprimet ushtarake të NATO-s, të cilat nuk janë tërësisht të mbuluara nga mandatet e OKB-së, do të vënë në pikëpyetje legjitimitetin e operacioneve dhe do të provokojnë rezistencë ndërkombëtare. Prandaj seksioni përmbyllës sugjeron terma të rinj të bashkëpunimit NATO-OKB në operacionet “të qëndruarit vetëm”, e cila do të balancojë marrëdhëniet dhe do të krijojë incentiva për përpjekje më të forta uniteti.

### **Bashkëpunimi NATO-OKB në operacione paralele: rasti i Afganistanit**

Në dekadën e kaluar, Afganistani ka qenë rasti më i rëndësishëm për aftësinë e NATO-s dhe OKB-së për të punuar krahë për krahë në operacione. Në nivel doktrine, NATO-ja dhe

<sup>14</sup> *International Crisis Group*, “*Uncharted Waters: Thinking through Syria’s Dynamics*”, *Middle East Briefing*, nr. 31. Damask/Bruksel, 24 nëntor 2011.

<sup>15</sup> Këshilli i Sigurisë së OKB-së, “Takimi i 6627”, Dokument i OKB-së S/PV. 6627, 4 tetor 2011.

<sup>16</sup> Këshilli i Sigurisë së OKB-së, “Rezoluta 2016”, Dokument i OKB-së S/RES/2016, 27 tetor 2011.

OKB-ja e kanë pranuar se ato “nuk janë asnjëherë vetëm në teatër” dhe duhet të angazhohen me organizatat e tjera për të plotësuar misionin e tyre.<sup>17</sup> Megjithatë, si ish-komandant i forcave udhëheqëse të NATO-s në Afganistan (ISAF), gjenerali *Stanley McChrystal* vëzhgoi: “Ajo çfarë ndodh është se, ndonjëherë në kryqëzimin e qëllimeve, ti ke një dorë që bën një punë dhe një dorë që bën një punë tjetër, të dyja përpiqen të bëjnë gjënë e duhur, por punojnë pa pasur një produkt të mirë.”<sup>18</sup> Një nga paraardhësit, gjenerali anglez *David Richards*, shumë troç u shpreh se mungesa e unitetit për punë kolektive e organizatave ndërkombëtare ka krijuar situata “të afërta me anarkinë” në Afganistan, dhe paralajmëruan se kjo ishte një recetë për dështim.<sup>19</sup>

Ky seksion ilustron se NATO-ja dhe OKB-ja kanë dështuar në zbatimin e një përqasjeje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e konflikteve në Afganistan, sepse një ndarje disfunktionale e punëve dhe shpërndarje e pabarabartë e burimeve ul incentivat për bashkëpunim.<sup>20</sup> Kjo ka qenë kryesisht e dukshme në fushën e qeverisjes dhe rindërtimit. Në transferimin aktual të përgjegjësisë ndaj autoritetit afgan, NATO-ja dhe OKB-ja, si pasojë, duhet të zhvillojnë një ndarje të punëve, e cila bazohet në fuqitë krahasuese të organizatave.

## Një ndarje jo e drejtë e punëve

Kur NATO dhe OKB filluan të punonin së bashku në Afganistan në 2003-shin, ndarja e punëve mes tyre dukej sikur ishte definitive.

<sup>17</sup> *Claudia Major* dhe *Christina Molling*, “More than wishfull thinking? The EU, UN, NATO and the Comprehensive Approach to Military Crisis Management,” *Studia Diplomatica* 62 (3), 2009, 21-28, 26

<sup>18</sup> *McChrystal* citoi te *Richard A. Opiel* dhe *Rod Norland*, “Shtetet e Bashkuara janë frenuar nga forcat speciale në Afganistan”, *New York Times*, 15 mars 2010. Gjenerali *McChrystal* i referohej koordinimit ndërmjet forcave ushtarake ndërkombëtare dhe forcave speciale të Shteteve të Bashkuara në Afganistan, por thelbi i vërejtjes së tij, gjithashtu mban vërtetësi për bashkëpunimet ndërmjet aktorëve të tjerë ndërkombëtarë në vend.

<sup>19</sup> *David Richards*, “NATO in Afghanistan: Transformation on the Front Line”, “Gazeta Rusi”, 151. nr. 4 2006, f. 10-14, 12.

<sup>20</sup> *Shiko gjithashtu Michael F. Harsch*, “NATO and the UN in Afghanistan Partners or Competitions?”, in *the UN and NATO: Forward from the Joint Declaration*, ed. *Brook A. Smith-Windsor*, Romë: NATO Defense College, 2011, 76-111; *M. J. Williams*, “(Un) Sustainable Peacebuilding: NATO’s Suitability for Postconflicts Reconstruction in Multiactor Environments”, *Global Governance* 17 (1), 2011, 115-134.

UNAMA (*United Nations Assistance Mission in Afghanistan*) mori një mandat të kufizuar politik në 2002-shin. Detyra e saj ishte të përqendrohej në procesin politik të filluar në Bon, të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe çështjet gjinore. Për më tepër, iu dha mandati për të përkrahur pajtimet kombëtare dhe të koordinonte përpjekjet humanitare të OKB-së.<sup>21</sup> ISAF ishte kryesisht përgjegjëse për sigurimin e një ambienti të sigurtë në të cilin mund të zhvilloheshin proceset politike dhe zhvillimi ekonomik<sup>22</sup>. Forcat veprojnë në bazë të mandatit të OKB-së të përsëritur çdo vit, e adoptuar nga kapitull VII i Kartës së OKB-së<sup>23</sup>.

Në kontrast me misionin e Pasluftës në Kosovë, nuk ka pasur detyra të përbashkëta mes NATO-s dhe OKB-së, të tilla si sigurimi i sigurisë publike. ISAF dhe UNAMA janë misione paralele me zinxhirë të veçantë komande. Kjo kërkon një formë të komplikuar të koordinimit johierarkik, ku asnjë organizatë nuk ka autoritet formal ndaj tjetrës.

Zyrtarët e UNAMA-s dhe ISAF-it marrin pjesë në takime të panumërta të niveleve të ndryshme, por prioriteti dhe koordinimi kuptimplotë kanë ngelur të vështirë për t'u arritur. Pjesëmarrësit në forumet e koordinimit shpesh kanë bërë “pak më shumë sesa përsërisin linja të politikave dhe pika veprimi.”<sup>24</sup> Zyrtarët kanë filluar t'i referohen ironikisht “fjalës C” Koordinimi është bërë sinonim i një rryme të vazhdueshme me takime të mundimshme pa asnjë produkt të qenësishëm.

Organizimi i politikave është komplikuar edhe më tej nga fakti se Përfaqësuesit e Veçantë të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (SRSG) nuk kanë autoritet mbi agjenci të ndryshme vepruese në Afganistan. Afganistani ka numrin më të madh të agjencive të OKB-së që janë përqendruar në një vend të vetëm dhe secila është e interesuar të ruajë autonominë e vet<sup>25</sup>. Përveç kësaj, çdo vend i ISAF-it tenton të udhëheqë operacionet sipas preferencave dhe prioriteteve kombëtare.

<sup>21</sup> Sekretari Përgjithshëm i OKB-së, “Situata në Afganistan dhe implikimet e saj për sigurinë dhe paqen ndërkombëtare”, Dokument i OKB-së A/56/875-S/2002/278, 18 mars 2001, para. 97.

<sup>22</sup> Këshilli i Sigurisë së OKB-së “Rezoluta 1386”, Dokument i OKB-së, S/RES/1386, 20 dhjetor 2011.

<sup>23</sup> Që nga tetori 2011, dymbëdhjetë rezoluta të Këshillit të Sigurisë kanë kaluar (Rezoluta 1386, 1413, 1444, 1510, 1563, 1623, 1707, 1776, 1833, 1890, 1943 dhe 2011).

<sup>24</sup> *International Crisis Group*, “Afganistan: Nevoja për zgjidhje ndërkombëtare”, 6 shkurt 2008, f. 14.

<sup>25</sup> Shiko shënimet nga *Michael Keating*, UNAMA's Deputy SRSG for Relief, Recovery and Reconstruction, Oslo, 4 tetor 2011, [http://media01.smartcom.no/Microsite/dss\\_01.aspx?eventid-6375](http://media01.smartcom.no/Microsite/dss_01.aspx?eventid-6375).

Së fundmi, mbiklasifikimi i informacionit, edhe atij joushtarak, ka penguar në mënyrë të përsëritur bashkëpunimin. Për shembull, një Grup i Rindërtimit të Provincave (PRT) në Afganistan, refuzoi një herë kërkesën e OKB-së për të ndarë planin për përmblytjet emergjente, sepse ai ishte i klasifikuar<sup>26</sup>. Në një bisedë private me autorin, një gjeneral i NATO-s me ironi u shpreh se NATO dhe OKB nuk mund të flasin as për motin, sepse ISAF në mënyrë rutinë klasifikon parashikimin e motit.

Me pak fjalë, mungesa e detyrave të përbashkëta, autoritetit të OKB-së për të koordinuar çështjet joushtarake dhe mekanizmave për të ndarë informacionet e klasifikuara, komplikon marrëdhënien ISAF-UNAMA dhe krijon pak iniciativa për bashkëpunim. Brenda këtij kuadri, si ka evoluar bashkëpunimi në pikat kyçe politike?

### **Qeverisja dhe Rindërtimi: duke punuar për mosmarrëveshjet**

Një nga zonat më të rëndësishme të ndërveprimit ISAF-UNAMA ka qenë rindërtimi dhe mbështetja e qeverisjes efektive. Krijimi i Grupit të Rindërtimit të Provincave (PRT) i udhëhequr nga NATO në 2003-shin e në vazhdim, kishte si synim të fillonte rindërtimin në ato zona ku autoritetet afgane kishin influencë të vogël ose nuk kishin fare influencë.<sup>27</sup> ISAF pohon se disa aktivitete joushtarake të PRT-së si përmirësimi i shërbimeve publike bazë, duke përfshirë infrastrukturën, kujdesin shëndetësor dhe edukimin, janë thelbësore për arritjen e qëllimeve ushtarake dhe mund të realizohen vetëm nga ushtria për momentin.

Megjithatë, OKB-ja dhe shumë organizata të tjera joqeveritare (OJQ) kanë qenë të shqetësuara për aktivitetet e PRT-së në fushën e rindërtimit dhe qeverisjes, pasi këto detyra shkojnë përtej misionit origjinal të ISAF-it për arritjen e sigurisë.<sup>28</sup> Vendet e NATO-s promovuan PRT-të si mjete për të forcuar sigurinë dhe rindërtimin në nivel province, por kontributi dhe impakti

<sup>26</sup> Intervistë me *Scott Smith*, zyrtar i lartë i çështjeve politike (zyrat e Afganistanit), Departamenti i OKB-së për operacionet paqeruajtëse, Nju-Jork, tetor 2008.

<sup>27</sup> Literatura për PRT-ën është e gjerë, p.sh. *Carter Malkasian dhe Gerald Meyerle, Provincial Reconstruction Teams: How do we know they work?*, Carlise: Instituti i Studimeve Strategjike, mars 2009, <http://www.strategicstudiesinstitute.army.mil/pdf/FILES/PUB911.pdf>.

<sup>28</sup> *Bas Reijnders et al.*, "Enhancing the Footprint: Stakeholders in Afghanistan Reconstruction", *Parameters* 39 (1), 2009, 22-39, 22.

kryesor i PRT-së ka qenë politik.<sup>29</sup> Drejtuesit e PRT-ve dhe Drejtuesit Rajonal (RC) u bënë pika kryesore dhe më e rëndësishme për personat me influencë lokale, të cilët dobësuan autoritetin e qeverisë në Kabul<sup>30</sup>.

OKB-ja ka qenë gjithashtu e shqetësuar se ushtria ka qenë e përfshirë direkt në aktivitetet rindërtuese ose ka qenë e mbështetur në kontraktuesit ndërkombëtarë për zbatimin e projekteve, të cilat nuk ishin në përputhje me planet provinciale dhe kombëtare për zhvillim. Qëllimet e ushtrisë kanë qenë të përshpejtojnë zbatimin e projekteve dhe të mbrojnë paratë që të mos përfundojnë në drejtime të paligjshme. Megjithatë, në të njëjtën kohë, qeveria lokale ka qenë e privuar nga burimet dhe nuk mund të zhvillohej në shumë fusha.

UNAMA ka qenë e përjashtuar kryesisht nga vendimmarrja e PRT-së. Ajo nuk ka pasur asnjë rol në koordinimin e aktiviteteve civile të PRT-së, as nuk mori informacion për këto aktivitete, si pjesë e mandatit të koordinimit të përgjithshëm. Gjithashtu, puna e OKB-së në disa fusha si promovimi i stabilizimit të qeverisë dhe strukturat e sigurisë në nivel lokal nuk është njohur.<sup>31</sup>

Kundrejt sfondit të përkeqësimit të sigurisë, zhvillimit ekonomik të ngadaltë dhe rritjes së zhgënjimit të afganëve për mungesën e progresit, komuniteti ndërkombëtar përforcoi rolin koordinues të OKB-së në 2008-n. Këshilli i Sigurisë zgjeroi dhe theksoi mandatin e UNAMA-s.<sup>32</sup> Vendet e ISAF-it pranuan në mënyrë publike rolin udhëheqës të UNAMA-s në koordinimin e përgjithshëm të përpjekjeve civile ndërkombëtare. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së gjithashtu vendosi të rrisë buxhetin dhe numrin e stafit të UNAMA-s.<sup>33</sup>

Në Afganistan, ISAF-i dhe organizatat e ndihmës humanitare, duke përfshirë dhe agjenci të OKB-së, miratuan një numër

<sup>29</sup> Barbara J. Stapleton, "A Means to What End? Why PRTs are Peripheral to the Bigger Political Challenges in Afghanistan", *Journal of Military and Strategic Studies* 10 (1), 2007, 1-49, 2.

<sup>30</sup> Paul Fishstein dhe Andrew Wilder, *Winning Hearts and Minds? Examining the Relations between Aid and Security in Afghanistan*, Medford: Feinstein International Center, Tufts University, janar, 2012.

<sup>31</sup> Michael Aaronson, "An Outsider's View on the Civil-Military Nexus in Afghanistan", in *Comparative Perspectives on Civil-Military Relations in Conflict Zones*, ed. Michael J. Williams dhe Kate Clouston, London, RUSI, 2008, 10-19, 16.

<sup>32</sup> Këshilli i Sigurisë së OKB-së, "Rezoluta 1806", Dokument i OKB-së S/RES/1806, 20 mars 2008.

<sup>33</sup> UNAMA, "Konferencë për shtyp nga Kai Eide, Prezantim i veçantë i Sekretarit të Përgjithshëm për Afganistanin", Kabul, 17 dhjetor 2008, <http://www.reliefweb.int/node/290871>.

udhërrëfyesish për ndërveprimin dhe koordinimin e aktorëve civilë dhe ushtarakë në 2008-n<sup>34</sup>. UNAMA shpresonte se udhërrëfyesi i koordinimit civilo-ushtarak do të ruante “hapësirën humanitare” në të cilën OJQ-të dhe agjencitë e OKB-së mund të operonin në mënyrë neutrale. ISAF, nga ana tjetër, priste të mernte më shumë informacione të rëndësishme të sigurisë dhe të mësonte më shumë për planet dhe projektet e agjencive humanitare.

Më në fund, udhëheqësit e NATO-s i kërkuan Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së *Ban Ki Moon* mos ta vonojë më tej nënshkrimin e Deklaratës së Përbashkët të OKB-së për bashkëpunim, që është lënë pezull. Më 23 shtator 2008, Sekretari i Përgjithshëm nënshkroi marrëveshjen e parë zyrtare ndërmjet NATO-s dhe Sekretariatit të OKB-së.<sup>35</sup> Dokumenti përmban një angazhim të përbashkët për bashkëpunim dhe thekson fusha të mundshme të bashkëpunimit, por mbetet e paqartë në zhvillimin e masave specifike për zhvillimin e marrëdhënieve<sup>36</sup>. Deklarata ishte shumë e diskutueshme brenda OKB-së, sepse shumë shtete anëtare dhe stafi ishin të frikësuar se një mbështetje më e fortë në mjetet e NATO-s do të reduktonte pavarësinë e operacioneve të OKB-së. Veçanërisht agjencitë dhe strukturat humanitare të OKB-së ishin të shqetësuara se një bashkëpunim më i afërt me NATO-n do të rrezikojë neutralitetin e tyre në zonat e konfliktit dhe do ta vendosë stafin e tyre në rrezik. Megjithatë, autoriteti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të nënshkruar deklarata të përbashkëta pa marrëveshje zyrtare të anëtarëve të shteteve, bëri të mundur shmangien e votimit në Këshillin e Sigurisë ose Asamblenë e Përgjithshme, ku dominojnë kritikët e NATO-s. Megjithatë, ministri i Rusisë *Sergey Lavrov* akuzoi *Ban Ki Moon* për “fshehtësi”, duke përfunduar një marrëveshje pa konsultimet e duhura me anëtarët e Këshillit të Sigurisë<sup>37</sup>.

<sup>34</sup> Grupi i punës civilo-ushtarak në Afganistan, udhërrëfyes për ndërveprimin dhe bashkëpunimin e aktorëve humanitarë dhe aktorëve ushtarakë në Afganistan, 20 maj 2008, <http://ochaonline.un.org/OchaLinkClick.aspx?link-ocha&docId-1091345>.

<sup>35</sup> *Jaap de Hoop Scheffer dhe Ban Ki Moon*, “Joint Declaration on UN/NATO Secretariat Cooperation”, Nju-Jork, 23 shtator 2008.

<sup>36</sup> *Michael F. Harsch dhe Johannes Varwick*, “NATO dhe OKB”, *Survival* 51 (2), 2009, 5-12.

<sup>37</sup> *Steve Gutterman*, “Russia Official Blasts ‘Secretive’ UN-NATO deal”, *The Associated Press*, 9 tetor 2008. Sekretariati i NATO-s dhe i OKB-së argumentuan, megjithatë, se ata mbajtën dosje të mjaftueshme dhe se deklarata e përbashkët e Sekretarit të Përgjithshëm nuk kërkonte miratimin e anëtarëve të OKB-së.

Shtysa e NATO-s për një marrëveshje formale duket se ka qenë kryesisht një përpjekje për të rritur mbështetjen e brendshme dhe ndërkombëtare për misionin në Afganistan. Vendet e NATO-s nuk supozuan se Deklarata e Përbashkët do të bindte shumë vende jashtë aleancës të angazhoheshin dukshëm në stabilizimin ushtarak dhe rindërtimin e Afganistanit. Megjithatë, ata ishin të interesuar në mobilizimin e mbështetjeve të forta politike nga vendet myslimane për misionet e ISAF-it<sup>38</sup>. Deklarata e Përbashkët ishte ashtu siç e përcaktoi një zyrtar lartë i NATO-s, një mënyrë për “përmirësimin e imazhit”<sup>39</sup> të aleancës. NATO shpreson se do të jetë tani më e lehtë të përmirësojë marrëdhëniet me organizata joqeveritare dhe rajonale, të tilla si Bashkimi Afrikan dhe Shoqata e Shteteve Arabe<sup>40</sup>.

Megjithatë, kjo periudhë e rritjes së bashkëpunimit mes NATO-s dhe OKB-së ishte jetëshkurtër. Në 2009-n administrata e Obamës vendosi të forcojë angazhimin në Afganistan. E ashtuquajtura “vala e madhe” nuk u kufizua në rritjen e numrit të ushtarëve të ISAF, por gjithashtu pati një dimension të rëndësishëm civil. Nga janari 2009, deri në fillim të 2010, qeveria e Shteteve të Bashkuara trefishoi stafin e saj civil në Afganistan. Një pjesë e madhe e “valës së madhe civile” ishte planifikuar për të mbështetur njësitë ushtarake me ekspertizë civile. Iniciativa shumëfishoi stafin civil të Shteteve të Bashkuara te PRT-ja dhe bazat e para operative të Shteteve të Bashkuara<sup>41</sup>. ISAF u fokusua në forcimin e çështjeve politike të tilla si: antikorrupsioni dhe qeverisja e mirë.

Anëtarët e NATO-s iu përgjigjën “valës së madhe” të Shteteve të Bashkuara, duke zgjeruar rolin e Përfaqësuesve të Lartë Civil

---

Një zëdhënës i OKB-së thekson se marrëveshja ishte në linjë me marrëveshje të ngjashme me organizatat të tjera rajonale të ngjashme, dhe kjo bëri “moszbatimin e marrëveshjeve me të gjitha politikatat e NATO-s”. Shiko *Michele Montas*, “*Highlights on the Noon Briefing*”, UN Headquarters, Nju-Jork, 3 dhjetor 2008, [http://www.un.org/News/oss/g/hilites\\_arch\\_view.asp?HighID-1227](http://www.un.org/News/press/docs/2008/081118a.html).

<sup>38</sup> Shiko intervistën me Përfaqësuesin e Lartë Civil, *Daan Everts: Aunohita Mojumdar*, “*Afghanistan Needs Muslim Aid Effort*”, *Al Jazeera*, 31 dhjetor 2007.

<sup>39</sup> Intervistë me zyrtarin e lartë të NATO-s, Bruksel, qershor, 2010.

<sup>40</sup> *Jaap de Hoop Scheffer*, “*Keynote Address at the 54<sup>th</sup> Annual Session of the of the NATO Parliamentary Assembly*”, Valencia, 18 nëntor 2008, <http://www.nato.int/docu/speech/2008/s081118a.html>.

<sup>41</sup> Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara, “*Report of Inception: Embassy Kabul, Afghanistan*” Raporti nr. ISP-I-10-32A, Washington DC, 2010. <http://oig-state.gov/documents/organization/138084.pdf>, 4.

(SCR) në 2010, e cila e mbaroi në mënyrë efektive rolin e UNAMA-s si ndihmës koordinator. Emërimi i një diplomati të lartë Britanik për postin krijoi një pozicion civil lidhës me influencë brenda ISAF-it, megjithëse SCR-ja vazhdon t'i ngjajë një vartësi më tepër sesa një homologu diplomatik të komandës së ISAF-it.<sup>42</sup> Anëtarët e NATO-s, në mënyrë jozyrtare, ranë dakord që CSR-ja e re të bashkohet me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara për të marrë koordinimin e përpjekjeve civile. Anëtarët e NATO-s mbështetën në mënyrë zyrtare UNAMA-n në krye të ndihmës për koordinim, sepse përfshirja e OKB-së siguroi një mbrojtje legjitime politike për aktivitetet e NATO-s.

Sa për UNAMA-n, burimet e reja erdhën ngadalë dhe provuan pamjaftueshmëri për ta kthyer atë në një partner të aftë për ISAF-in. Përveç kësaj, sulme direkte kundrejt zyrave dhe personelit të OKB-së kanë reduktuar aftësinë e UNAMA-s për të vepruar dhe kanë dëmtuar marrëdhënien e saj me ISAF-in. Në tetor të 2009-s, talebanët lëshuan një sulm kundër një shtëpie pritjeje në Kabul, duke vrarë pesë anëtarë të stafit të OKB-së dhe duke plagosur pesë të tjerë. Në tetor të 2010-s, bombardime vetëvrasëse sulmuan zyrat e UNAMA-s në Herat dhe në prill të 2011-s, protestues të dhunshëm pushtuan kompleksin e UNAMA-s në Mazari-Sharif, duke vrarë tre pjesëtarë të stafit ndërkombëtar dhe katër roje. UNAMA argumenton se në asnjë nga incidentet, ISAF nuk reagoi në mënyrë kuptimplotë, pavarësisht marrëveshjes ndërmjet UNAMA-s dhe ISAF-it për “mbështetje në momente ekstreme”. Masat paraprake për sigurinë, tani e kanë reduktuar më tepër lirinë e lëvizjes së personelit të OKB-së. Njëkohësisht, një numër i konsiderueshëm i personelit janë hequr nga puna për arsye sigurie, duke lënë UNAMA-n me staf shumë të vogël.

Kështu, ndërsa OKB-ja po dobësohej, ushtria ka forcuar pozitat e veta si një aktor mbizotërues në shumë zona në Afganistan. Roli i përfshirjes së ISAF-it ishte i qartë gjatë operacioneve të vitit 2010-2011 në Afganistanin jugor. Ushtria identifikoi një vakum në qeverisjen dhe në sektorin e zhvillimit dhe ka qenë e interesuar ta mbushë atë. Në kontrast me udhërrëfyesin e miratuar bashkërisht për koordinimin civilo-ushtarak, roli i ushtrisë në promovimin e “qeveria në një kuti” i tejkaloi masat e mbushjes së boshllëqeve<sup>43</sup>.

<sup>42</sup> Mark Landler dhe Thom Shankner, “British Diplomat Takes Key Afghan Role” *New York Times*, 15 maj 2010.

<sup>43</sup> Megjithëse udhërrëfyesi nuk u nënshkrua asnjëherë, ato shërbejnë si një referencë për ISAF-in dhe organizatat humanitare në Afganistan, shiko *Wolfgang Weisbrod-Weber*, “Vereinte Nationen und NATO in Afghanistan”, *Vereinte Nationen*, 59 (3), 2011, 105-113, 106.



ISAF planifikoi dhe drejtoi veprimet e saj në fortesat kryengritëse pa konsultime me UNAMA. Agjencitë e OKB-së dhe shumë organizata të tjera ndihmëse u tërhoqën për shkak të mosgatishmërisë për të punuar në mbështetje të një strategjie ushtarake<sup>44</sup>. Zyrtarët afganë që ishin zgjedhur për të shpërndarë shpejt shërbimet nuk kishin eksperiencë, kapacitet dhe ishin shpesh jopopullorë për popullsinë lokale. Si rezultat, ISAF u mbështet në kapacitetet e veta civile dhe puna zhvillimore po rritej dhe zbatej nga ushtria.

Shërbimet publike, të cilat priteshin të siguroheshin për popullsinë në Afganistanin jugor ende duhet të materializohen. Mbetet e paqartë se sa kapacitete do të kishin qenë të afta t'i shtonin përpjekjeve humanitare dhe përpjekjeve për rindërtim, agjencitë e OKB-së dhe OJQ-të. Lidhur me këtë, strategjia zëvendësuese e ISAF-it ka dështuar në mënyrë të qartë, në përmbushjen e pritshmërive të popullit afgan në provincat jugore dhe më tej. Ish-komandanti i ISAF-it, gjeneral *McChrystal*, së fundmi pranoi se ushtria vazhdonte të mbante një "pikëpamje të thjeshtë frikësuese" të situatës në Afganistan dhe i mungonte njohuria lokale.<sup>45</sup>

Me pak fjalë, një rol më gjithëpërfshirës i NATO-s në qeverisje dhe zhvillim, ka anashkaluar OKB-në dhe ka dështuar në fuqizimin e zyrtarëve kompetentë afganë. Duke qenë se ndarja e punëve reflektoi disbalanca të burimeve dhe fuqive sesa forca të krahasueshme, ajo ka reduktuar impaktin e përpjekjeve ndërkombëtare në fushën e qeverisjes dhe zhvillimit. Performanca e dobët në këto zona duhet të përbëjë një shqetësim të madh, sepse nuk ka të ngjarë që situata në Afganistan të mund të përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme pa progresin e dukshëm të shpërndarjes së shërbimeve bazë publike. Prandaj vendet e NATO-s duhet të konsiderojnë shpërndarjen e detyrave dhe të burimeve ndërmjet ISAF-it, UNAMA-s dhe zyrtarëve afganë gjatë tranzicionit dhe më tej në 2014-ën.

### **Transferimi i përgjegjësive: mundësi për bashkëpunim?**

Bashkëpunimi ndërmjet ISAF-it dhe UNAMA-s do të mbetet një çështje kritike në tranzicionin e përgjegjësive ndaj

<sup>44</sup> UNAMA, "UN Humanitarian Coordinator Press Conference," Kabul, 17 shkurt 2010, <http://unama.unimissions.org/Default.aspx?tabid-1761&ctl-Details&mid-1892&ItemID-7810>.

<sup>45</sup> Declan Walsh, "US Had 'Frighteningly Simplistic' View of Afghanistan, *thotw McChrystal*", *Guardian*, 7 tetor 2011.

autoriteteve afgane deri më 2014-ën. Në këtë pikë, pyetjet kryesore janë: çfarë rolesh mund dhe duhet që NATO-ja dhe OKB-ja të luajnë në tranzicionin ndaj vetëqeverisjes së Afganistanit dhe si mund të rrisin organizatat unitetin e përpjekjeve të tyre? Sfida do të jetë ta rikthejë nga fushatë me drejtim ushtarak kundrarebeluese, në një udhëheqje civile me përjasje ndërkombëtare të zgjidhjes së konfliktit, e cila bazohet në fuqinë krahasuese të NATO-s dhe OKB-së.

Deri tani, dominimi i ISAF-it ka zvogëluar më tej gatishmërinë e organizatave për të bashkuar përjasjet e tyre. Organizatat kanë ndjekur politika të veçanta në ndërtimin e kapaciteteve institucionale për qeverisjen dhe sigurinë në nivel kombëtar. NATO dhe OKB gjithashtu kanë dështuar në koordinimin e përpjekjeve të tyre në promovimin e procesit të paqes me talebanët.

UNAMA fokusohet gjerësisht në çështje strukturore afatgjata si: promovimi i pajtimit dhe reformat politike. Për shembull, UNAMA advokon për transferimin e autoriteteve politike dhe financiare nga Kabuli në provincat e Afganistanit. Kjo do të siguronte qeverisjet provinciale me mjetet për të filluar projektet zhvilluese pa hyrë në proceset e vështira, për të marrë miratimin nga qendra ineficente e burokracisë. Sfida kryesore në zbatimin e këtij plani është se kompetencat dhe integriteti i udhëheqësve varion në mënyrë domethënëse përgjatë Afganistanit. Korrupsioni është përhapur gjerësisht. Deri tani, përpjekjet kanë dështuar që t'i japin këshillit të provincës autoritetin për të ushtruar këqyrjen e kujdesshme, në mënyrë që të bëjë administrimin lokal më llogaridhënës për veprimet e tyre. Megjithatë, reformat strukturore të promovuar nga UNAMA mund të përmirësojnë shpejtësinë dhe cilësinë e shërbimeve dhe të rrisin pranueshmërinë lokale të qeverisë.

Në kontrast, ISAF është fokusuar në termat afatshkurtër të trajnimit dhe në masat e ndërtimit të kapaciteteve në sektorin e sigurisë. Kjo politikë është ndërtuar mbi supozimin se forcat e sigurisë kërkohen menjëherë, pasi vendi përballet me një luftë civile që kërcënon të gjitha strukturat ekzistuese politike. Ndërkohë që përpjekjet e ISAF-it kanë prodhuar një numër të madh të forcave të sigurisë, cilësia dhe besnikëria e tyre janë në pikëpyetje. Duke i dhënë Afganistanit të ardhura të pakta, është gjithashtu e qartë se qeveria afgane nuk do të jetë në gjendje për financime të mëdha, ISAF-i ndërtoi organet e sigurisë për të parashikuar të ardhmen pa mbështetje masive të huaj.

Në procesin e tranzicionit në tërësi, ka një lidhje dhe

koordinim të vogël ndërmjet përfaqesjes afatgjatë të UNAMA-s dhe përfaqesjes afatshkurtër të ISAF-it. UNAMA, madje, e mori vendimin e paramenduar për të vepruar vetëm si një “observues” në Bordin e Përbashkët **Inteqal** Afgan-NATO, i cili vlerëson gatishmërinë e provincave Afgane për tranzicionin e përgjegjësive të sigurisë. Roli pasiv i UNAMA-s në proces është dritëshkurtër, sepse aftësia e shtetit për të ofruar siguri është parakusht vendimtar për reforma politike domethënëse. Sa për ISAF-in, trajnimi i forcave të sigurisë duhet të fokusohet më shumë në cilësi sesa në sasi, dhe duhet të kombinohet me ndërtimin e kapaciteteve në sektorë të tjerë. Më e rëndësishmja, OKB dhe NATO së bashku kanë neglizhuar përpjekjet për reformimin e sektorit gjyqësor, megjithëse shumica e mbështetjes për talebanët në vitet 1990 ishte ndërtuar nga reputacioni i lëvizjeve për promovimin drakonian, por të efektshëm të “ligjit dhe rendit”.

Disa analistë e shikojnë fokusin e ngushtë të UNAMA-s në reformat politike dhe në çështjet e të drejtave të njeriut si rezultat i kufizimeve praktike: monitorimi dhe advokacia mund të jenë rolet e vetme të zbatueshme të OKB-së në ambientin e pasigurt të Afganistanit. Megjithatë, dekadat e kaluara të ndërhyrjeve ndërkombëtare gjithashtu kanë treguar se NATO, si një aleancë ushtarake e vendeve perëndimore, ka deficitet e veta strukturore në veprimet paqësore. Ajo nuk zotëron as ekspertizën civile, as legjitimitetin që OKB-ja i ka.

OKB-ja duhet të rifitojë rolin e saj si pikë kryesore për angazhimet ndërkombëtare në periudhën pas vitit 2014, ku në iniciativat civile duhet të dominojnë politikat ndërkombëtare. OKB-ja duhet të koordinojë përpjekjet ndërkombëtare në promovimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, reformave në polici, drejtësi dhe qeverisje, dhe ndihmën humanitare. Ajo gjithashtu duhet të ofrojë “zyra të mira” për ringjalljen e procesit të paqes, që të përfshijë fqinjët e Afganistanit. Të gjitha politikat duhet të zhvillohen gjatë dialogut konstant me qeverinë afgane dhe me parlamentin. Bashkimi Europian dhe Banka Botërore gjithashtu kanë kapacitete të rëndësishme plotësuese, që i mundëson ato të udhëheqin përpjekjet për të nxitur zhvillimin ekonomik. Në të kundërt, roli i NATO-s duhet të fokusohet në detyrat që kërkojnë ekspertizën e saj ushtarake: trajnimi i forcave të sigurisë, ndërtimi i një administrate përgjegjëse për mbrojtjen dhe detyra teknike ende të rrezikshme si çminimi. Ndërtimi i forcave të veçanta nga NATO dhe OKB, mund të rrisë efektivitetin e një angazhimi ndërkombëtar të reduktuar, por ende të rëndësishëm në Afganistan.

## **Konkluzione:**

### **Drejt një bashkëpunimi më efektiv**

Veprimet e OKB-së dhe të NATO-s në menaxhimin e krizave janë rrallë në harmoni natyrore për shkak të origjinës së tyre të ndryshme institucionale, detyrave dhe interesave. Pavarësisht rritjes së pavarësisë së organizatave nga burimet e njëra-tjetrës, NATO dhe OKB kanë vepruar shpesh me qëllime të ndërthurura në operacione, në Afganistan dhe Libi. Ndërkohë që diferencat strukturore dhe interesat organizative në ruajtjen e pavarësisë ka të ngjarë të zhduken, anëtarët e shteteve duhet të përqendrohen në identifikimin e termave efektivë të bashkëpunimit: NATO duhet ta bëjë atë një rregull të pashkruar që të ndërhyjë në konflikte, pasi të ketë marrë autorizimin nga Këshilli i Sigurisë. Mandatet e OKB-së duhet të përcaktojnë një ndarje të qartë të punëve dhe të vendosin rregulla jo të paqarta për konsultimet në operacione. Shtetet anëtare duhet nxisin një shpërndarje të balancuar të burimeve ndërmjet misioneve në terren të NATO-s dhe OKB-së, për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet të barabartësh. Së fundmi, organizatat duhet të ndërtojnë lidhje më të forta ndërmjet selive të tyre dhe të institucionalizojnë dialogun strategjik dhe shkëmbimin e informacionit.

### **Pranimi i nevojës për mandatet e OKB-së**

Një hap i rëndësishëm për bashkëpunimin e mëtejshëm NATO-OKB do të jetë që aleanca në mënyrë vullnetare të pranojë nevojën për autorizimin e OKB-së për të autorizuar përdorimin e forcës. NATO ka më shumë interes në marrjen e një mandati nga OKB-ja për ndërhyrjet ushtarake, sesa të ruaj aftësinë e saj për të vepruar në mungesë të miratimit nga Këshilli i Sigurisë për çështjet e rralla, kur kjo është në fakt e rëndësishme dhe e dobishme. Në mënyrë të veçantë, Shtetet e Bashkuara nuk do të jenë gati të pranojnë në mënyrë zyrtare kërkesën për një mandat të Këshillit të Sigurisë. Megjithatë, aleanca duhet të vazhdojë praktikatat aktuale të veprimit nën mandatet e OKB-së dhe ta bëjë atë një rregull të pashkruar për veprimet e ardhshme.

Mandatet e OKB-së reduktojnë kundërshtitë ndërkombëtare dhe do të nxisin bashkimin e qëllimeve midis aleatëve. Një praktikë e qëndrueshme e NATO-s, dhe retorika në lidhje me çështjen e mandatit, do të ulë shqetësimet ndërmjet anëtarëve joperëndimorë të OKB-së për motivet e aleancës, për

ndërhyrjet ushtarake dhe do të lehtësojë bashkëpunimin e organizatave. Në shumë shtete anëtare të NATO-s mandatet e OKB-së janë gjithashtu të nevojshme, megjithëse jo të mjaftueshme për të krijuar një mbështetje të brendshme për veprimet ushtarake. Mbështetja në justifikime të diskutueshme për ndërhyrje si “përgjegjësia për të mbrojtur” do të hedhë dyshime mbi legjitimitetin dhe ligjshmërinë e veprimeve të NATO-s. Konfliktet ndërmjet aleatëve të NATO-s për ndërhyrjet e palejuara ka të ngjarë të bëhen edhe më shumë intensive në të ardhmen. Në mënyrë të veçantë, forcimi e Turqisë dhe insistimi i saj i përgjithshëm mbi mandatet e OKB-së do t’i bëjë ndërhyrjet e paautorizuara ushtarake më të diskutueshme brenda aleancës.

Ndërhyrjet pa mandatin e OKB-së vendosin precedentë të rrezikshëm dhe do të bëjnë të mundur për vendet e tjera të justifikojnë veprimet ushtarake të palejuara kundrejt vendeve të tjera ose rivalëve vendas. Zyrtaari i OKB-së, Sekretari i Përgjithshëm *Annan* kishte paralajmëruar më 1999 se përdorimi i forcës në mënyrë të palejuar mund të dëmtojë “sistemin joperfekt të sigurisë, ende elastik, të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore” dhe të krijojë “precedentë për ndërhyrjet e ardhshme, pa një kriter të qartë për të vendosur se kush mund t’i invokojë këto precedentë dhe në çfarë rrethanash”<sup>46</sup>.

Është e vërtetë se një angazhim për kërkesën e një autorizimi nga OKB-ja do të thotë se NATO nuk mund të ndërhyjë ushtarakisht në një konflikt kur nuk është e mundur të arrihet një marrëveshje me Rusinë dhe Kinën. Ende skenarë të tillë kanë qenë jashtëzakonisht të rrallë. Që nga lufta e Kosovës, NATO ka marrë mandate të OKB-së për pothuajse çdo operacion të tij. NATO tani vepron *de facto* si një organizatë rajonale në Afganistan. Në raste të rralla, të një sulmi kundrejt një shteti anëtar, aleanca mund të përdorë forcën e bazës ushtarake me të drejtë, për vetëmbrojtje kolektive<sup>47</sup>. Deri tani, NATO ka përdorur nenin V të Traktatit të NATO-s, vetëm një herë - pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit kundër Shteteve të Bashkuara. Kështu, ajo është e mundur dhe interesin afatgjatë të NATO-s për të marrë mandate të OKB-së për operacionet në menaxhimin e krizave.

<sup>46</sup> *Kofi Annan*, “*Annual Report to the General Assembly*”, Nju-Jork, 20 shtator 1999.

<sup>47</sup> *Alexis Vahlas*, “*Dispelling Misperceptions for a Renewed Synergy between the United Nations and for the Atlantic Alliance*”, in the *UN and NATO: Forward form Joint Declaration*, ed. *Brooke A. Smith-Windsor*, Romë: Kolegji i Mbrojtjes së NATO-s, 2011, f. 53-75, 56-57.

## **Rënia dakord mbi kushtet gjithëpërfshirëse dhe të balancuara të bashkëpunimit**

Mandatet e ardhshme të Këshillit të Sigurisë për veprimet e NATO-s “qëndrojnë vetëm” do të duhet të adresojnë sfidat e pavarësisë së OKB-së nga NATO gjatë fushatave ushtarake. Interesi i NATO-s në punën me OKB-në, shpesh përfundon pasi aleanca ka marrë nga Këshilli i Sigurisë mandatin për përdorimin e forcës.

Për ndërhyrjet e ardhshme ushtarake, NATO dhe OKB duhet të identifikojnë kushtet e bashkëpunimit që janë më gjithëpërfshirëse dhe lejojnë vendet joanëtare të NATO-s të ngrenë shqetësimet e tyre. Kushtet e angazhimit për ndërhyrjet ushtarake duhet të ruajnë fleksibilitetin e operacioneve të NATO-s dhe Këshilli i Sigurisë nuk duhet të angazhohet në mikromenaxhimin ushtarak. Megjithatë, NATO do të duhet të bëhet më përgjegjëse dhe transparente për të larguar frikën e “rrëmbimit” të mandatit të OKB-së, pasi ato janë dhënë. Një mundësi do të jetë që mandatet e OKB-së të rinovohen nga Këshilli i Sigurisë. Mandati i ISAF-it është një rast i tillë. Një autorizim që vendos një kufi të qartë kohor për operacionet, do të ulë shqetësimet e OKB-së për zgjerimin e angazhimeve të NATO-s dhe kufirin për vendet joanëtare të NATO-s për të lejuar përdorimin e forcës nga aleatët.

Në Afganistan, bashkëpunimi ISAF-UNAMA ka gelur një martesë komode, më tepër sesa ndërtim i një partneriteti mbi pikat e forta krahasuese. Qeveritë e NATO-s duhet të krijojnë dhe të balancojnë pavarësinë ndërmjet ISAF-it dhe UNAMA-s. OKB-ja duhet t'i ofrojë UNAMA-s burimet e nevojshme për ta bërë një partner të aftë për ISAF-in dhe për ndarjen e punëve ndërmjet organizatave. Kjo do të nxisë bashkëpunimin më të afërt në kalimin e përgjegjësive në duart e Afganistanit dhe në fazën pas 2014-s.

Në operacionet e ardhshme postkonfliktuale, ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet duhet të jenë prioriteti kryesor i përbashkët për NATO-n dhe OKB-në që nga fillimi.

Kjo do të krijonte bazën për më shumë trajektore të rrjedhshme për përgjegjësinë lokale dhe do të lejonte organizatat të largohen nga një vend pas konfliktit, përpara se prania e tyre e tejzgjatur të nxisë pakënaqësitë lokale.

### **Institucionalizimi i bashkëpunimit**

Marrëdhëniet NATO-OKB gjithashtu do të përfitojnë nga një institucionalizim më i fortë i bashkëpunimit. Që në fillimet e viteve

1990, bashkëpunimi *ad hoc* ka dominuar marrëdhëniet NATO-OKB. Ndërkohë që ushtarët e NATO-s dhe personeli i OKB-së kanë punuar gjithnjë e më shumë krahë për krah, bashkëpunimi ndërmjet selive të organizatave ka ngelur i limituar në kontaktet rastësore në tavolina. Shkëmbimet e limituara ndërmjet selive të NATO-s dhe OKB-së kanë reflektuar padurimin e organizatave për të ruajtur autonominë dhe fleksibilitetin. Deklarata e Përbashkët OKB-NATO siguron tani një bazë të rëndësishme për zgjerimin e bashkëpunimit institucional.

Impakti praktik i deklaratës ka qenë shumë modest deri tani. Duke ndjekur nënshkrimin e deklaratës, bisedime më të rregullta të stafit janë mbajtur në nivele të ndryshme. Organizatat gjithashtu kanë drejtuar “ditë edukative” të përbashkëta për stafin, për të rritur njohuritë për organizatat partnere. Por qëllimi i këtij dialogu është i kufizuar: agjenda e “ditës edukative” u realizua si “e lexuar si kurs parauniversitar i vitit të parë mbi bazat e mandatit dhe strukturës NATO-OKB”<sup>48</sup>.

Rezultati më i rëndësishëm ka qenë përmirësimi i marrëveshjeve ndërlidhëse të NATO-s dhe OKB-së. Që nga 1993, NATO ka pasur vetëm një zyrtar ndërlidhës ushtarak me bazë në Nju-Jork. Në korrik të 2010-s, NATO rriti praninë e vet në OKB, duke emëruar një punonjës si ndërlidhës civil<sup>49</sup>. OKB-ja ishte e përfaqësuar vetëm te zyrat e NATO-s nga një zyrtar i zyrës së OKB-së për Koordinimin e Punëve Humanitare (OCHA) nga 1999-a deri në 2006-n. OKB-ja ka një zyrë në Bruksel, por ajo nuk fokusohet në çështjet e sigurisë, dhe ajo ka punuar kryesisht me BE-në dhe jo me NATO-n.<sup>50</sup> Vendet e NATO-s kanë nxitur përhapjen e prezencës së OKB-së në Bruksel për të fituar më tepër akses në njohjen dhe në gjykimin e konflikteve rajonale dhe për praktikat më të mira të organizatave në operacionet për ruajtjen e paqes. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në 2010-n miratoi fondin për stabilizimin e një njësie të vogël permanente të ndërlidhësit në Bruksel, për të lehtësuar komunikimin me BE-në dhe, si një detyrë dytësore, me NATO-n në çështjet e paqes dhe sigurisë.

<sup>48</sup> Brooke A. Smith-Windsor, “Misery Makes for Strange Bedfellows: The Future of NATO-UN Strategic Partnership”, in *the UN and NATO: Forward from Joint Declaration*, ed. Brooke A. Smith-Windsor, Romë, Kolegji i Mbrojtjes së NATO-s, 2011, f. 15-52, 17.

<sup>49</sup> Knet J. Killed and Ryan C. Hendrickson, “NATO and the United Nations: Debates and Trends in Institutional Coordination”, *Journal of International Organization Studies* 2 (1), 2011, 28-49.

<sup>50</sup> David S. Yost, “NATO and International Organizations”, Romë, Kolegji i Mbrojtjes së NATO-s, 2007, f. 66.

Anëtarët e NATO-s duhet të vazhdojnë të ndërtojnë Deklaratën e Përbashkët dhe të nxisin më shumë bashkëpunimin substancial institucional. Fakti se Rusia, kundërshtari më i fortë për bashkëpunimin e ngushtë NATO-OKB, duket se ka pranuar kushtet e deklaratës, i ofron aleatëve një hapësirë të re për të manovruar. Moska ka arritur një marrëveshje të ngjashme ndërmjet OKB-së dhe Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO) të udhëhequr nga Rusia. Më 18 mars 2010, Sekretari i Përgjithshëm Ban dhe Sekretari i Përgjithshëm i CSTO-s *Nikolay Bordyuzha* nënshkruan një Deklaratë të Përbashkët në Sekretariatit e Bashkëpunimit OKB/CSTO në Moskë. Ky hap ka zbutur tensionet ndërmjet NATO-s, Sekretariatit të OKB-së dhe Rosisë gjatë deklaratës NATO-OKB.

Lidhje të forta ndërmjet selive NATO-OKB kanë potencialin e nxitjes së një bashkëpunimi më efektiv strategjik dhe operacional afatgjatë<sup>51</sup>. Është e rëndësishme të mbahet në mendje se koordinimi institucional kërkon kohën e çmuar të stafit dhe burime organizative. Prandaj ajo duhet të shkojë përtej një demonstrimi të thjeshtë të dëshirës së mirë. Bisedimet duhet të fokusohen në çështjet e rëndësishme të interesit të përbashkët dhe takimet duhet të përdoren për të arritur konsensusin dhe të identifikojnë zgjidhjet e problemeve me rëndësi operationale. Zhvillimi i procedurave dhe i praktikave më të mira për veprimet e përbashkëta mund të shmangë “rishpikjen e rrotës” për çdo operacion, dhe kurset substanciale të trajnimit të përbashkët do të rrisin përgatitjet dhe të kuptuarin e përbashkët për krizat e ardhshme. Kështu duket e rëndësishme për zyrtarët e NATO-s dhe OKB-së të thellojnë marrëdhëniet e zyrave qendrore, megjithatë duke respektuar pavarësinë e organizatave partnere.

Do të mbetet gjithnjë një sfidë nxitja e bashkëpunimit ndërmjet një aleance ushtarake dhe një organizate universale. Ende NATO dhe OKB janë dy nga organizatat ndërkombëtare më të rëndësishme në menaxhimin e krizave dhe politikëbërjes, gjithashtu duhet të shqetësohen për marrëdhëniet e tyre disfunktionale. Krijimi i një partneriteti NATO-OKB më shumë efektiv dhe eficient në menaxhimin e krizave mbetet një përpjekje me vlerë.

---

<sup>51</sup> Friis Arne Petersen et al., “Implementing NATO’s Comprehensive Approach to Complex Operations”, in NATO Search of a Vision, ed. Gulnur Aybet dhe Rebecca R. Moore, Washington, DC: Georgetown University Press, 2010, 75-98.



## DORJAN GJOZI

# KOMPETENCAT E NATO-S DHE TË BE-SË NË SEKTORIN E KRIMIT KIBERNETIK DHE TERRORIZMIT KIBERNETIK

### 1. Abstrakt

Në ditët e sotme interneti dhe teknologjia informatike përbëjnë instrumentet kryesore jo vetëm për zhvillimin dhe administrimin e marrëdhënieve ekonomike dhe sistemeve të pagesave elektronike, por edhe për administrimin e marrëdhënieve me rëndësi strategjike defensive që lidhen me interesa të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pikërisht për rëndësinë thelbësore që ka në momentin aktual ky aspekt, sulmet kundër sistemeve informatike private, shtetërore dhe të organizatave ndërkombëtare, të organizuara në shumicën e rasteve nga organizatat kriminale transnacionale dhe gjatë konflikteve të “armatosura” ose situata tensioni, nga autoritetet shtetërore, i kanë dhënë çështjes së “*sigurisë kibernetike*” një rëndësi të veçantë në momentin aktual historik, për shkak të rritjes së probabilitetit që sulmet terroriste apo veprimet sulmuese në periudha konfliktesh të armatosura, të përqendrohen në sistemet informatike/informative të strukturave me rëndësi strategjike për mbrojtjen e vendeve anëtare të NATO-s dhe BE-së.

Në pjesën e parë të këtij punimi do të përqendrohemi në përkufizimin dhe analizën juridike të kategorive dhe koncepteve dogmatike të “*krimit kibernetik*” dhe “*terrorizmit kibernetik*”, duke u bazuar në aktet kryesore normative ndërkombëtare që rregullojnë kriminalitetin informatik dhe në veçanti në Konventën e KE-së për *krimin kibernetik* dhe aktet normative komunitare (V. 2005/222/GAI).

Në vazhdim analiza do të përqendrohet në rëndësinë që fenomenet e *krimit kibernetik* marrin në politikat strategjike të BE-së dhe të NATO-s dhe në individualizimin e bazës juridike në traktatet e këtyre organizmave që lejojnë ndërhyrjen e tyre. Në fakt, sulmet e fundit kibernetike që u kryen ndaj Estonisë (vend anëtar në atë kohë) dhe Gjeorgjisë (vend kandidat), nga njëra

anë, i dhanë çështjes së *sigurisë kibernetike* një dimension të ri, dhe nga ana tjetër, krijuan jo pak kontraste midis studiuësve dhe opinioneve të elaboruara në brendësi të institucioneve të NATO-s, në lidhje me karakteristikat dhe përmasat që duhet të ketë një sulm kibernetik, për t'u konsideruar si një kërcënim real për integritetin territorial, pavarësinë politike dhe sigurinë e një vendi anëtarë, në mënyrë që të justifikohet aktivizimi i mekanizmit konsultiv që parashikohet nga neni 4 i Traktatit të NATO-s.

Duke u bazuar në konfrontimin e opinioneve të ndryshme do të kërkojmë të vlerësojmë nëse është juridikisht e mundur që sulmet informatike, në shkallë të gjerë, kundër sistemeve të kontrollit dhe komandimit, ose rrjetit energjetik, ose të telekomunikimit të NATO-s, ose vendeve anëtare, mund të konsiderohen si sulm i armatosur dhe, si rrjedhojë, të legjitimojë, në perspektivë vetëmbrojtjeje, marrjen e masave të nevojshme, përfshirë këtu edhe përdorimin e forcave të armatosura në bazë të nenit 5 të Traktatit të NATO-s.

Në përfundim të këtij punimi, një vëmendje të veçantë do t'i dedikohet legjisllacionit dhe masave ligjore që ka marrë Shqipëria në luftën kundër krimit informatik, duke theksuar dhe ndryshimet kryesore që duhen bërë në sistemin normativ shqiptar dhe legjisllacionin kibernetik në mënyrë që, nga njëra anë, të përforcohen instrumentet ligjore dhe teknike kundër krimit informatik dhe, nga ana tjetër, të jepet një kontribut efektiv nga shteti shqiptar, si anëtar i Aleancës, në veprimet dhe politikat e reja që po ndërmerren nga NATO në sektorin e *sigurisë kibernetike*.

## **2. “Krimi kibernetik” dhe “terrorizmi kibernetik” si kategori dogmatike në shkencat juridike aktuale**

Individualizimi i një kompetence normative direkte ose indirekte për Bashkimin Europian dhe NATO-n në sektorin e krimit informatik, dhe në veçanti në fushën e terrorizmit klasik dhe atij informatik, implikon një analizë të domosdoshme të nocioneve kryesore dogmatike që lidhen me këto fenomene.

### **2.1. Terrorizmi në legjisllacionin ndërkombëtar**

Përcaktimi i kuptimit të termave “*akte terroriste*” ose dhënia e një përgjigjeje në lidhje me pyetjen se çfarë është sot terrorizmi (i konsideruar si kategori e përgjithshme dogmatiko-normative) dhe *cyberterrorism* - ose terrorizmi informatik ose kibernetik - si nënkategori të terrorizmit klasik, nuk është aspak i thjeshtë.

Vështirësia kryesore qëndron në faktin se në momentin aktual nuk ekziston një definicion unik dhe i pakundërshtueshëm<sup>1</sup> për fenomenin e terrorizmit, kuptimi dhe dimensionet e të cilit ndryshojnë në raport me pikëpamjen - politike, juridike, sociologjike, ideologjike, fetare, antropologjike etj., - nga e cila studiohet fenomeni.

Megjithatë, kohët e fundit, pjesa më e madhe e studiuesve në botën akademike dhe legjislacionet kombëtare duket se po i përshtaten njërit prej kuptimeve të terrorizmit më të pranuar në planin botëror: bëhet fjalë për përkufizimin normativ që përcaktohet në nenin 2, paragrafi 1/b të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së për Luftën Kundër Financimit të Terrorizmit, përkufizim që përsëritet ose më saktë konfirmohet pa ndryshime thelbësore, nga Rezoluta e datës 8 tetor 2004, nr. 1566 e Këshillit të Sigurimit. Sipas nenit 2, para. 1/b, konsiderohen akte terroriste të gjitha ato akte që kanë për synim të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë trupore të një civili ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në “armiçësitë e situatave të një konflikti të armatosur”, kur qëllimi i këtyre veprimeve, nga natyra ose konteksti ku verifikohen, është frikësimi i popullatës ose detyrimi i qeverisë, ose i një organizate ndërkombëtare që të kryejë ose të mos kryejë një veprim specifik.

Struktura e përkufizimit karakterizohet nga një sërë elementesh të cilët duhet të ekzistojnë bashkërisht për të kualifikuar si akt terrorist një veprim të caktuar. Si fillim, veprimet që kryhen duhet të kenë si objektiv kryesor shkaktimin e vdekjes ose dëmtimeve të rënda trupore ndaj subjekteve civile që nuk marrin pjesë në një konflikt të armatosur. Për ekzistencën e aktit terrorist nuk kërkohet që nga veprimi të shkaktohet efektivisht vdekja ose dëmtimet e rënda trupore të një personi civil, por mjafton që veprimi i kryer të ketë kapacitetin dhe potencialitetin për të shkaktuar një pasojë të tillë. Kërkohet, gjithashtu, që sulmi të drejtohet ndaj subjekteve që nuk janë përfshirë në konflikte të armatosura, si rrjedhojë përjashtohen nga kategoria e terrorizmit të gjitha ato veprime të dhunshme që realizohen gjatë një situatë konflikti të armatosur, pavarësisht nga dimensionet që ky i fundit ka marrë.

---

<sup>1</sup> Në doktrinën shqiptare mbi këtë aspekt A. Elezi, “Sfidat ligjore në luftën kundër terrorizmit”, në avokatura, viti VII, nr. 12/2011, f. 153; në doktrinën ndërkombëtare: R. Barberini, “*La definizione internazionale del terrorismo në Questione Giustizia*”, fasc. 6, 2002; A. C. Cronin, *Behind the curve: “Globalization and international terrorist”*, në *Int'l. Sec.*, v. 27, 2002, f. 30-32.

Përveç faktit që veprimet duhet të kenë një potencialitet shkatërrues ndaj interesave primare (jeta ose shëndeti) kërkohet që në planin subjektiv, realizimi i tyre të kryhet nga autori për qëllime specifike. E thënë ndryshe, aktet terroriste nuk ndodhin rastësisht, por realizohen ekskluzivisht për të krijuar një situatë paniku dhe frike të përhapur te popullsia e një vendi - apo te një grup i konsiderueshëm personash - ose kryhen për të detyruar një organizatë ndërkombëtare ose institucion vendimmarrës të një shteti, në veçanti qeverinë, që të veprojë ose mosveprojë në një mënyrë të caktuar. Shkaktimi i një situatë të përhapur paniku/frike ose influencimi i procesit vendimmarrës, si element kualifikues i akteve terroriste, nuk duhet të ekzistojnë bashkërisht sepse nuk janë kritere kumulative, por alternative; për kualifikimin e një veprimi si akt terrorist është e mjaftueshme që nga subjekti veprues të ndiqet njëri nga qëllimet e specifikuar nga neni 2, paragrafi 1/b i Konventës<sup>2</sup>.

Definicioni në fjalë edhe pse më i përdoruri nga studiuesit nuk ezauron llojin e akteve që mund të futen në kategorinë e terrorizmit. Në fakt, problemi kryesor i individualizimit të terrorizmit, konsiston në faktin se sipas Konventës Kundër Financimit të Terrorizmit, përveç akteve të parashikuara nga shkronja b) e nenit 2: "Përbëjnë akte terroriste të gjitha ato veprime që ndalohen nga disa konventa të listuara në aneksin e saj, të cilave u janë shtuar nga doktrina edhe një numër tjetër aktesh ndërkombëtare"<sup>3</sup>.

Franksionimi i parashikimeve normative kundër terrorizmit në akte të ndryshme ligjore ndërkombëtare, krijon probleme të shumta për efikasitetin e luftës për parandalimin e fenomenit si rrjedhojë e ekzistencës së boshllëqeve normative dhe vështirësive objektive për të koordinuar dispozitat ligjore që parashikohen në akte të ndryshme ndërkombëtare<sup>4</sup>. E vetmja

---

<sup>2</sup> D. S. Schwartz, "Environmental terrorism: analyzing the concept", nr. 35, *J. Peace Res.*, 1998, f. 483, 485.

<sup>3</sup> Disa nga konventat e specifikuar në aneksin janë: Konventa e Hagës për Luftën ndaj Rrëmbimit të Paligjshëm të Aeroplanëve, 16 dhjetor 1970; Konventa e Montrealit për Luftën ndaj Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, 23 shtator 1971; Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-Së; Konventa kundër Marrjes së Pengjeve, 17 dhjetor 1979; Konventa e Vjenës mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, 3 mars 1980 etj. Për konsultimin e plotë të listës shikoni VKM-në, nr. 645, datë 21.11.2001 që ka ratifikuar Konventën për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit.

<sup>4</sup> Në lidhje me problemet që hasen nga mungesa e një konvente unike kundër terrorizmit dhe *lacuna legis* që janë krijuar, J. Trahan, "Terrorism Conventions: existing gaps and different approaches në *New Eng. Int'L. & Comp. L. Ann.*, 2002, f. 215.

zgjidhje mbetet miratimi i një Konvente specifike për terrorizmin, e cila duhet të parashikojë në mënyrë të detajuar veprimet ose mosveprimet që kualifikohen si akte terroriste dhe të përcaktojnë shfuqizimin e akteve të tjera ndërkombëtare në këtë sektor.

## **2.2 Përkufizimi i terrorizmit në legjislacionin e Bashkimit European**

Legjislacioni i aprovuar nga BE në kontekstin e luftës kundër terrorizmit, karakterizohet për faktin se ka elaboruar një nocion të terrorizmit që paraqitet për disa aspekte: më inovativ dhe më i gjerë nga kuptimi i dhënë nga neni 2, paragrafi 1 i Konventës.

Vendimi (2002/475/JHA) i datës 13 qershor 2002, i adoptuar nga Këshilli në bazë të titullit VI të Traktatit për Bashkimin European (nenet 29, 31/e) dhe 34 par. 2/b) në nenin 1, përcakton se shtetet anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për të parashikuar si vepra penale terroriste të gjitha aktet e realizuara me dashje, të cilat, për natyrën e tyre ose kontekstin ku verifikohen, mund të shkaktojnë një dëm të rëndë për një vend ose një organizate ndërkombëtare, me kusht që ato të jenë kryer për një nga qëllimet e parashikuara në nenin 1.

Dallimi i parë që vihet re është fakti se për normativën e BE-së akti për t'u kualifikuar si akt terrorist nuk duhet të ketë potencialitetin për të vrarë ose shkakuar dëmtime të rënda për një subjekt civil, por duhet që të jetë i përshtatshëm për të pasur mundësinë që të shkaktojë një dëm të rëndë ndaj një vendi ose një organizate ndërkombëtare. Përveç kësaj, për të konsideruar veprime të caktuara si akte terroriste, kërkohet, gjithashtu, që ato të jenë realizuar me qëllim që të frikësojnë rëndë popullsinë, të detyrojnë forcat publike ose një organizatë ndërkombëtare për të kryer ose moskryer një veprim, të destabilizojnë rëndë ose të shkatërrojnë strukturat politike thelbësore, kushtetuese, ekonomike ose sociale të vendit ose organizatës ndërkombëtare, ose të jenë realizuar me synimin për të shkatërruar në shkallë të gjerë struktura strategjike - të specifikuara në këtë dispozitë - ose janë kryer me qëllim që të shkaktohet rrëmbimi, dëmtimi i integritetit fizik ose vdekja e një personi. Pra, për konfigurimin e një vepre penale terroriste është e nevojshme dashja direkte e subjektit veprues dhe realizimi, për një nga qëllimet e specifikuara nga dispozita, i veprimeve ose mosveprimeve që mund të shkaktojnë, për shkak të kontekstit kur kryhen ose për arsye

të natyrës së tyre objektive, një dëm të rëndë ndaj shtetit ose një organizate ndërkombëtare<sup>5</sup>.

### 2.3. “Krimi kibernetik” dhe “terrorizmi kibernetik”

Edhe pse numri i publikimeve shkencore mbi terrorizmin kibernetik dhe kriminalitetin informatik është rritur ndjeshëm, sidomos në revistat juridike amerikane, mungesa e një përkufizimi ligjor për këto terma dogmatike ka krijuar jo pak kontraste në individualizimin e fenomenit të krimit informatik dhe përcaktimin e masave që duhen marrë për parandalimin e tij<sup>6</sup>.

Konventa e Këshillit të Europës mbi “*krimin kibernetik*” nuk e përmban në nenin 1, që përcakton kuptimet e termave kryesorë, të cilët përdoren nga Konventa, një përkufizim të “*krimit kibernetik*” apo të “*krimit informatik*” dhe në kreun II, seksioni I, parashikon disa detyrime ligjore për palët kontraktuese që të inkriminojnë fakte specifike - futja abuzive ose e kundërligjshme në një sistem informatik, atentate kundër integritetit të të dhënave ose sistemeve informatike etj., - si vepra penale, pa u shprehur minimalisht mbi terrorizmin informatik<sup>7</sup>.

Në të njëjtën linjë vendoset edhe normativa e Bashkimit Europian për sa i përket mungesës së një kuptimi ligjor mbi “*krimin kibernetik*” dhe “*terrorizmin kibernetik*”. Megjithatë, normativa e BE-së ka theksuar lidhjen e ngushtë që ekziston midis terrorizmit dhe krimit informatik. Në konsiderimet paraprake për adoptimin e vendimit 2005/

<sup>5</sup> Në planin europian, ndryshe nga normativa ndërkombëtare, lista e qëllimeve paraqitet më e gjatë dhe më ezauruese, dhe kërkohet që impakti i veprimeve mbi vendin ose organizatën kundër të cilës drejtohen ato të jetë i rëndë. Përfshihen në qëllimet edhe ndërprerja e furnizimit me ujë, energji ose burime të tjera natyrore që ka si efekt vënien në rrezik të jetës, përhapja e substancave të rrezikshme, shkaktimi i zjarreve, përmytjeve ose shpërthimeve që vënë në rrezik jetën, rrëmbimi i avionëve, anijeve ose çdo mjeti tjetër për transportimin kolektiv të personave ose mallrave etj., (për një listim më të detajuar shikoni vendimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të KE, datë 22.06.2002).

<sup>6</sup> Mungesa e një instrumenti ligjor ndërkombëtar kundër *terrorizmit kibernetik* ka çuar në disa raste në përjashtimin e mundësisë për të konsideruar si akte terroriste fenomenet kriminale që kryhen nëpërmjet përdorimit të teknologjisë informatike. Kështu p.sh. M. Ward, *Cyber Terrorism “Overhyped”* në *BBC News*, 14, 2003, shprehet se “nëse terroristi do të sulmojë, do e bëjë një gjë të tillë duke përdorur bombat ashtu si kanë bërë gjithmonë ... shkatërrimi i faqeve të internetit ose nxjerrja jashtë përdorimit e një *e-mail*-i nuk është një akt terrori”.

<sup>7</sup> B. R. David, *Ending the cyber Jihad, combating terrorist exploitation of the internet with the rule of law and improve tools for cyber governance*, në *CommLaw Conspectus*, vol. 15, 2006, f. 162.

222/JHA, i datës 24 shkurt 2005, mbi sulmet informatike kundër sistemeve të informimit, evidentohet se një nga arsytet që imponon adoptimin e aktit është “rritja e shqetësimit konkret për verifikimin e sulmeve terroriste kundër sistemeve të informimit që përfshihen në strukturat kritike apo strategjike të një vendi (cons. 2). Në konsiderimin e 8-të të aktit theksohet gjithashtu se adoptimi i tij dhe përafrimi i legjislacioneve penale të vendeve anëtare në sektorin e sulmeve në dëm të sistemeve informatike ose informative është i domosdoshëm për të siguruar bashkëpunimin juridik dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe *terrorizmit*. Pavarësisht nga indikimi i terrorizmit si një ndër fenomenet e lidhura me kriminalitetin informatik, teksti normativ nuk përmban asnjë dispozitë ligjore që të ketë për objekt konkret rregullimin e terrorizmit kibernetik apo informatik.

Sipas doktrinës “*krimi kibernetik*”, përgjithësisht nënkuptohet ose kryerja e krimeve tradicionale duke përdorur si mjet për realizimin e tyre teknologjinë informatike, ose kryerja e një krimi që ka për objekt dëmtimin e sistemeve informatike ose kompjuterike<sup>8</sup>. Kategoria tradicionale e krimeve informatike si krime që kryhen nëpërmjet shfrytëzimit dhe përdorimit jo të drejtë të teknologjisë informatike ka pësuar dhe vazhdon të ndryshojë, si rezultat i transformimit të vazhduar të teknologjisë, duke regjistruar gjithmonë e më shumë lindjen e sjelljeve të reja, ndër të cilat dhe terrorizmi informatik, që duhen të sanksionohen penalisht.

*Terrorizmi kibernetik* është një nënkategori e krimeve informatike, kuptimi i të cilit sipas disa autorëve lidhet ngushtë me nocionin tradicional të terrorizmit, ndërsa për të tjerë terrorizmi informatik paraqitet si një fenomen i veçantë që nuk rregullohet nga asnjë nga konventat ndërkombëtare aktualisht në fuqi. Kështu, për shembull, disa autorë e kanë konsideruar terrorizmin kibernetik si “përdorimi i kompjuterëve si armë, ose instrument i përdorur nga grupe kombëtare ose ndërkombëtare të motivuara politikisht, të cilat kërcënojnë, ushtrojnë dhunë, ose shkaktojnë frikë me qëllim që të shkaktojnë një influencim të popullsisë, ose të detyrojnë qeverinë që të ndryshojë politikat e saj”<sup>9</sup>. Autorë të tjerë janë bazuar në përkufizimin klasik të terrorizmit për të identifikuar *terrorizmin kibernetik* si përdorimi i teknologjisë informatike në mënyrë që të

<sup>8</sup> N. K. Katyal, *Criminal Law in Cyberspace* në *University of Pennsylvania Law Review*, vol. 149, 1003 2001, R. M. Couch, *A Suggested Legislative Approach to the Problem of Computer Crime*, 38 *Washington and Lee Law Review*, 1194, 1981; Robert Ditzion et al., *Computer Crimes*, 40 *American Criminal Law Review* 285, 2003; J. A. Tower, *Hacking, Vermont's Computer Crimes Statute*, 25 *Vermont Law Review*, 945, 2001.

<sup>9</sup> H. *The battlefield of cyberspace: the inevitable new military branch - the cyber force*, në *ALB. L. J. SCI & TECH*, vol. 18, 2008, f. 301.

dëmtohen, ose të vihet në rrezik jeta e personave, ose të sabotohen infrastruktura me rëndësi kritike dhe strategjike për një vend. Me fjalë të tjera, edhe pse mungon një akt normativ ndërkombëtar kundër terrorizmit kibernetik, ndaj këtij fenomeni aplikohen të gjitha aktet normative ndërkombëtare që ekzaminuam më sipër.

Në fakt, rrëmbimi i një avioni duke përdorur armë edhe pse paraqitet i ndryshëm në planin ontologjik me rrëmbimin e avionit, duke marrë kontrollin e sistemit kompjuterik të tij, në planin normativ, ka të njëjtin efekt me atë. Vendosja e një bombe në një stacion metroje nga një terrorist mund të shkaktojë të njëjtat pasoja materiale dhe të ketë të njëjtin impakt në popullsinë e një vendi ose në proceset vendimmarrëse të tij, me shkaktimin e përplasjes së trenave, si rezultat i ndërhyrjes elektronike në sistemet kompjuterike të sinjalistikës ose nëpërmjet marrjes së kontrollit të trenave të teknologjisë së fundit të telekomanduar në distancë<sup>10</sup>.

Përkufizimi klasik i terrorizmit në legjislacionin ndërkombëtar dhe në normativën e Bashkimit Europian, përqendrohet kryesisht në rëndësinë e rezultateve që realizohen nga sulmet terroriste, ndërsa mjetet e përdoruara për arritjen e tyre mbeten të parëndësishme në planin ligjor, si rrjedhojë në kategorinë e *terrorizmit kibernetik* mund të përfshihen të gjitha sulmet kibernetike, drejtuar ndaj strukturave strategjike, të cilat mund të shkaktojnë “vdekjen ose plagosjen e rëndë trupore të një civili ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në konflikte të armatosura, kur qëllimi i këtyre veprimeve, nga natyra ose konteksti, është të frikësojë popullatën ose ta detyrojë qeverinë, ose një organizatë ndërkombëtare të kryejë ose të mos kryejë një veprim”, neni 2, par. 1/a Konv.

Edhe në kontekstin e akteve normative të BE-së me terrorizëm kibernetik, nënkuptohen të gjitha ato sulme informatike të cilat pavarësisht nga objekti i tyre material janë në gjendje që të shkaktojnë dëme të rënda për një vend ose për një organizatë ndërkombëtare, me kusht që sulmet të jenë kryer për një nga qëllimet e parashikuara nga neni 1, i vendimit 2002/475/JHA.

### **3. Kompetenca normative e BE-së në luftën kundër krimit informatik dhe terrorizmit**

Pas aprovimit të Traktatit të Lisbonës, Bashkimit Europian i njihet për herë të parë një kompetencë normative indirekte në sektorin e

<sup>10</sup> A. Cohen, *Cyber terrorism: are we legally ready?* në *Journal of International Business & Law*, 2010, f. 6.



të drejtës penale materiale. Në të vërtetë Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED), i ka njohur Bashkimit European një kompetencë të kufizuar penale për të adoptuar akte ligjore, në veçanti direktiva, me përmbajtje penale që në vitin 2005. Në vendimin e parë historik të marrë mbi këtë çështje, GJED theksonte se edhe pse në planin parimor legjislativ penal dhe procedural penal nuk futen në kompetencat e Komunitetit, ky konstatim nuk mund t'i ndalojë legjislatorit komunitar - "në rastet kur aplikimi i sanksioneve penale efektive, proporcionale dhe disuazive, nga ana e autoriteteve kombëtare, përbën një masë të domosdoshme në luftën kundër një fenomeni kriminal specifik" - që të adoptojë akte mbi të drejtën penale të shteteve anëtare, të cilat ai i konsideron të nevojshme për të garantuar efektivitetin e plotë të normave komunitare<sup>11</sup>.

Pas aprovimit të Traktatit të Lisbonës, kompetenca e BE-së në luftën kundër krimit informatik dhe terrorizmit projektohet në dy aspekte kryesore: në luftën për parandalimin e dhe luftimin e fenomeneve kriminale të parashikuara nga Traktati (neni 83), ndër të cilat përfshihet terrorizmi, krimi informatik dhe koordinimi i aktiviteteve policore, ndërsa profili i dytë lidhet me njohjen e një kompetence normative indirekte për adoptimin e akteve ligjore në sektorin penal-material.

Neni 83 i Traktatit për Funkcionimin e BE-së (TFBE) parashikon se Parlamenti European dhe Këshilli, nëpërmjet direktivave të aprovuara sipas procedurës së zakonshme ligjore, mund të përcaktojnë norma minimale për përkufizimin e veprave penale dhe dënimeve në fushën e krimeve, veçanërisht të rënda, që kanë një dimension transnacional si rezultat i karakterit, efekteve kriminale ose nevojës për t'i luftuar bashkërisht këto krime në planin komunitar.

Paragrafi i parë, neni 83 i TFBE-së, duke individualizuar kompetencat penale europiane *ratione materiae*, i jep mundësinë BE-së që të adoptojë akte normative (direktiva) për t'i imponuar shteteve anëtare që të arrijnë objektiva specifike brenda afatit të caktuar nga akti. Në sektorin e të drejtës penale, individualizohen *ratione materiae* nga pika 2, par. 1, neni 83 i TFBE-së, si vepra penale që përfshihen në kategorinë e krimeve, veçanërisht të rënda, edhe terrorizmi dhe kriminaliteti informatik<sup>12</sup>.

<sup>11</sup> GJED, Seksioni i Madh, datë 13 shtator 2005, çështja nr. 176/03. Komisioni i KE-së kundër Këshillit të UE-së, paragrafi 47 dhe 48 i vendimit.

<sup>12</sup> Për kompetencën penale të BE-ë, konsultoni A. Bernardi, "La competenza penale accessoria dell'Unione Europea, problemi e prospettive" në Revistën Juridike Online, "Diritto Penale Contemporaneo": C. Sotis, "Il trattato di Lisbona e le competenze penali dell'Unione Europea" në *Cassazione Penale*, nr. 3, 2010, f. 326.

Pra, në sektorin e terrorizmit dhe kriminalitetit informatik organet komunitare mund të adoptojnë direktiva, të cilat parashikojnë detyrime specifike për shtetet anëtare që të kriminalizojnë veprime të caktuara, ose mund të përkufizojnë vepra penale, të specifikojnë kuptimin e terrorizmit dhe krimeve informatike, apo të vendosin nivelet minimal ose maksimal brenda të cilave duhet të përcaktohen sanksionet penale nga shtetet anëtare.

Traktati i Lisbonës sjell një ndryshim radikal dhe efikas në luftën kundër krimit informatik dhe terrorizmit. Para hyrjes në fuqi të Traktatit, kompetenca penale e BE-së ushtrohej në shtyllën e tretë në të cilën mund të adoptoheshin, sipas procedurave klasike të bashkëpunimit ndërqeveritar, Konventa ose Vendime që nuk sillnin pasoja konkrete, nën profilin e përgjegjshmërisë, në rastet kur shtetet anëtare nuk i përshtateshin në legjislacionin nacional detyrimeve që kishin marrë nëpërmjet aprovimit të këtyre akteve në nivel evropian. Pas traktatit të Lisbonës masat në luftën kundër terrorizmit aprovohen me direktiva të cilat, edhe pse i japin shteteve anëtare një diskrecion të gjerë në lidhje me mjetet që mund të përdoren për arritjen e objektivave të përcaktuara nga akti, i imponojnë atyre një detyrim ligjor për të arritur rezultatet e përcaktuara nga direktiva, në të kundërt Komisioni ose një shtet tjetër mund t'i drejtohen GJED-së nëpërmjet procedurës së parashikuar nga neni 258 dhe 259 i TFBE-së për shkeljen e detyrimeve që rrjedhin nga Traktati.

Kuadri normativ plotësohet nga neni 84 dhe 85 i TFBE-së: Sipas nenit 84, Parlamenti Europian dhe Këshilli mund të marrin, duke aprovuar sipas procedurës së zakonshme ligjore, me një nga llojet e akteve juridike që parashikohen nga Traktati, masat e nevojshme për nxitur dhe mbështetur veprimet që ndërmerren nga shtetet anëtare në luftën kundër terrorizmit dhe krimeve informatike.

Në rastet kur krimet informatike dhe terrorizmi kanë dimension ndërkombëtar, Eurojust luan një rol të rëndësishëm në planin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare të vendeve të ndryshme që merren me hetimin e fakteve ose gjykimin e tyre. Me rregullore të aprovuar sipas procedurës së zakonshme, këtij autoriteti, përveç funksioneve koordinuese e bashkëpunuese midis autoriteteve kombëtare, mund t'i njihet kompetenca për të filluar procedimin penal, edhe pse marrja e akteve formale për fillimin e procedurës gjyqësore, *strictu sensu*, i përket autoriteteve kombëtare (neni 85).

Në planin e bashkëpunimit policor, autoritetet komunitare mund të adoptojnë masat e nevojshme jo vetëm për mbështetjen

dhe përforcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare të ngarkuara për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale për krimet informatike ose terrorizmin, por mund të adoptohen edhe masa të tjera, të cilat lidhen me mbledhjen, arkivimin, trajtimin, analizën dhe shkëmbimin e informacioneve, ose për shkëmbimin reciprok të mjeteve dhe personelit policor midis vendeve anëtare (neni 87).

Ndërthurja e të gjitha elementeve të sapoanalizuar e bën sistemin komunitar kundër luftës së krimit informatik dhe terrorizmit një ndër sistemet më efikase që aktualisht ekzistojnë në planin kombëtar ose ndërkombëtar, për faktin se ai përqendrohet në elaborimin e një sistemi normativ efikas dhe të përshtatshëm në planin penal, si dhe në koordinimin dhe përforcimin e instrumenteve të nevojshme për parandalimin dhe luftën kundër këtyre formave të krimit si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

#### **4. Kompetencat e NATO-s në luftën kundër terrorizmit dhe krimit informatik**

##### **A. Terrorizmi**

Në qëllimet kryesore që influencuan krijimin e “*North Atlantic Treaty Organization*” (NATO) me traktatin e Uashingtonit (1949), ishte dhe garantimi i sigurisë kolektive të palëve kontraktuese dhe asistencë reciproke në realizimin e sigurisë dhe paqes në rastet e sulmeve të armatosura të drejtuara ndaj njërit prej vendeve anëtare.

Baza kryesore juridike për ndërmarrjen e një veprimi konkret, të finalizuar në arritjen e objektivave për të cilat u krijua organizata, përbëhet kryesisht nga nenet 4, 5 dhe 7. Neni 4 i traktatit të Uashingtonit parashikon mundësinë për palët që, në bazë të një kërkesë individuale<sup>13</sup>, të aktivizojnë konsultimet në kontekstin e organizatës, në rastet kur konsiderojnë se integriteti territorial, pavarësia politike dhe siguria e njëres prej tyre është në rrezik. Konsultimi është një akt i domosdoshëm për të verifikuar paraprakisht rëndësinë e sulmeve dhe për të vlerësuar marrjen e masave ose veprimeve specifike nga NATO, për mbrojtjen e sigurisë individuale ose kolektive të palëve<sup>14</sup>.

<sup>13</sup> L. S. Kaplan, NATO 1948, “*The Birth of the Transatlantic Alliance* në *Rowman & Littlefield Publishers*”, Canham/MD 2007, f. 204.

<sup>14</sup> Për tekstin e Traktati konsultoni [http://www.nato.int/cps/en/natolive/official\\_texts\\_17120.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_17120.htm).

Siguria kolektive si interesi kryesor që kërkon të garantohet nga aktiviteti i NATO-s konfirmohet edhe nga neni 5 i Traktatit, sipas të cilit sulmi i armatosur kundër njëres apo disa prej palëve, në Evropë ose në Amerikën e Veriut, konsiderohet si sulm kundër të gjitha palëve. Verifikimi i një sulmi të armatosur ndaj njërit prej vendeve anëtare të Organizatës i lejon palët e tjera, që në përputhje me të drejtën ndërkombëtare zakonore, dhe në veçanti me të drejtën e vetëmbrojtjes kolektive ose individuale të parashikuar nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, të aktivizohen individualisht ose në grup për të ndihmuar shtetin e sulmuar duke “ndërmarrë menjëherë ato veprime që i vlerëson si të nevojshme, përfshirë këtu dhe përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur dhe ruajtur sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut”

Referimi që neni 5 i Traktatit të NATO-s i bën nenit 51<sup>15</sup> të Kartës, nuk është i rastësishëm, përkundrazi pothuajse unanimitisht doktrina konsideron se të dyja dispozitat ligjore janë identike dhe parashikojnë të njëjtat kushte për ushtrimin e forcës së armatosur në planin ndërkombëtar në kontekstin e organizimit të një rezistence vetëmbrojtjeje ndaj një sulmi të armatosur të kundërligjshëm.

Deri në momentin kur u kryen atentatet terroriste kundër SHBA-ve më 11 shtator 2001, doktrina dominuese kishte përjashtuar në mënyrë kategorike mundësinë e njohjes së një kompetence konkrete për NATO-n, në bazë të neneve 4 ose 5, në luftën kundër terrorizmit dhe si rrjedhojë përjashtojë *a priori* përdorimi i forcës së armatosur në prospektivën e realizimit të një vetëmbrojtjeje individuale ose kolektive kundër sulmeve terroriste.

Arsyet e një përfundimi të tillë bazoheshin në një interpretim të ngushtë të neneve 4 dhe 5 të Traktatit si dhe nenit 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Theksohej nga doktrina dominuese se, marrja e masave mbrojtëse, si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive, kërkon ekzistencën reale të një sërë kushtesh, të cilat përbëjnë *condicio sine qua non* për të legjitimuar ushtrimin e forcës së armatosur në planin e raporteve ndërkombëtare.

Kushti i parë që theksohet është fakti se vetëmbrojtja nuk mund të jetë preventive, por kontekstuale ose e mëvonshme

<sup>15</sup> Neni 51 i Kartës “Në rast të një sulmi të armatosur kundër një anëtare të Kombeve të Bashkuara, kjo Kartë nuk bie absolutisht ndesh me të drejtën natyrore të vetëmbrojtjes individuale apo kolektive, deri sa Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e paqes botërore dhe sigurinë ndërkombëtare (...)”.

nga sulmi ndaj të cilit reagohe kolektivisht apo individualisht me masa vetëmbrojtjeje.

Kushti i dytë i domosdoshëm që kërkohet për të ushtruar të drejtën natyrore për t'u mbrojtur është ekzistenca e një sulmi të armatosur, i cili i drejtohet vendit që vetëmbrohet (në rastin e vetëmbrojtjes individuale) ose një vendi tjetër (vetëmbrojtja kolektive). Në çështjen *Nikaragua vs. SHBA*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë theksoi se ekziston një e drejtë zakonore paralele me parashikimet e nenit 51 të Kartës, dhe si rrjedhojë edhe me nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, e cila i njeh çdo shteti të drejtën që të ushtrojë forcën e armatosur, me kusht që ushtrimi i saj të jetë i finalizuar për vetëmbrojtjen ndaj një sulmi të armatosur<sup>16</sup>.

Sipas orientimeve të izoluara doktrinare, kërkohet gjithashtu që sulmi i armatosur ndaj të cilit organizohet vetëmbrojtja duhet të jetë shkaktuar nga forcat e armatosura zyrtare të vendit kundër të cilit drejtohet kundërreagimi vetëmbrojtës.

Së fundmi, theksohet se nocioni sulm i armatosur nuk nënkuptonte çfarëdolloj përdorimi force, agresioni apo kërcënimi, pasi, siç është theksuar nga GJND, termi "sulm i armatosur duhet të interpretohet në mënyrë restriktive dhe kuptimi i tij është më i ngushtë se ai i agresionit apo kërcënimit, sepse përfshin vetëm ato forma "të rënda të ushtrimit të forcës" që mund të legjitimojnë marrjen e masave autodifensive<sup>17</sup>.

Konsiderimi unitar i kriterëve të ekzaminuara bënte të pamundur legjitimimin e ushtrimit të forcës në perspektivë vetëmbrojtjeje, sipas nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit ose nenit 51 të Kartës, pasi grupet terroriste veprojnë si organizma individuale të pavarur nga subjektet e të Drejtës Ndërkombëtare, *rectius* shteteve, dhe në shumicën e rasteve sulmet terroriste nuk kanë karakteristika dhe dimensione të tilla që të mund të kualifikohen si "forma të rënda të ushtrimit të forcës", të cilat konsiderohen nga e drejta ndërkombëtare si "sulme të armatosura".

<sup>16</sup> *Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and against Nicaragua, Nicaragua v United States of America, Merits*, "Nicaragua Case", 1986, ICJ Rep. 14, 194. Shikoni gjithashtu *Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory (Advisory Opinion)*, 9 July 2004, ICJ, 139. <<http://www.icj-cij.org/icjwww/idocket/imwp/imwpframe.htm>> at 20 July 2004, dhe çështjen *Case Concerning Oil Platforms, Islamic Republic of Iran v United States of America, Merits*, "Oil Platforms Case", November 2003, ICJ, 54.

<sup>17</sup> B. Simma, *The Charter of the United Nations: A Commentary*, Oxford University Press, 1994, 670.

## **B. Terrorizmi dhe riinterpretimi i nenit 5, pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2011**

Por sulmet terroriste të 11 shtatorit kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës konfirmuan shqetësimet e parashikuara nga një pjesë e doktrinës që konsideronte terrorizmin ndërkombëtar si një nga kërcënimet më reale dhe më të fuqishme në epokën aktuale kundër paqes dhe sigurisë globale<sup>18</sup>. Këto sulme sollën pasoja konkrete në planin juridik në një riinterpretim të nenit 4 dhe 5 të Traktatit.

Influencimi i fakteve në fjalë në riinterpretimin e nenit 4 të Traktatit të Uashingtonit është relativ, pasi edhe në mungesë të sulmeve të 11 shtatorit mund të arrihej në një përfundim të ngjashëm. Në fakt, sipas mendimit tonë, aktet terroriste kryhen me qëllim që të shkaktojnë një destabilizim të sistemit institucional të një vendi të caktuar dhe si rrjedhojë kanë në shumicën e hipotezave *potencialitetin për të kërcënuar*, të paktën *sigurinë e tij*, aspekt ky që përbën një nga tre kriteret që legjitimojnë aktivizimin e mekanizmit të konsultimit midis anëtareve të NATO-s sipas nenit 4<sup>19</sup>.

Më problematik paraqitet konsiderimi i sulmeve terroriste si “sulme të armatosura” në mënyrë që shteti i dëmtuar të ushtrojë të drejtën për t’u vetëmbrojtur nga sulmi sipas nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit.

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit, Këshilli i Sigurimit adoptoi Rezolutën 1368/2001, e datës 12 shtator 2001, nëpërmjet së cilës njihje ekzistencën e kushteve për ushtrimin e të drejtës individuale ose kolektive për t’u vetëmbrojtur në përputhje me kreun VII të Kartës kundër “këtij sulmi” si dhe çdo sulmi tjetër terrorizmi ndërkombëtar që kërcënonte ose vinte në rrezik paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Në të njëjtën datë “*The North Atlantic Council*” binte dakord se nëse do të verifikohej se sulmet e 11 shtatorit ishin realizuar nga jashtë dhe kundër SHBA-ve, atëherë sulmet duhet të vlerësoheshin si veprime të cilat përfshihen në fushën e aplikimit të nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit.

Për herë të parë në historinë e Aleancës, me ngjarjet e 11 shtatorit, sulmet terroriste të një dimensionit të caktuar

<sup>18</sup> A. Cohen, *Cyber terrorism: are we legally ready?* në *Journal of International Business & Law*, 2010, f. 11.

<sup>19</sup> Në praktikën e NATO-s aplikimi i nenit 4 për fillimin e konsultimeve është kërkuar vetëm një herë nga Turqia në vitin 2003; P. Gallis, *NATO’s Decision-Making Procedure, CRS Report for Congress, Order Code RS21510, 05 may 2003; online at <http://www.fas.org/man/crs/RS21510.pdf>*

konsiderohen si kompetencë e saj, duke legjitimuar marrjen e masave për vetëmbrojtje dhe përdorim individual ose kolektiv të forcave të armatosura kundër sulmeve terroriste.

Riinterpretimi i nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit dhe nenit 51 i Kartës, në mënyrë që të përfshihen edhe aktet terroriste në kategorinë e sulmeve të armatosura që legjitimojnë marrjen e masave të parashikuara nga të dy Traktatet, paraqitet në linjë me zhvillimet e fundit doktrinare mbi evolucionin që kanë pësuar kushtet që legjitimojnë ushtrimin e forcës si masë autodifensive në raportet ndërkombëtare<sup>20</sup>.

Kështu p.sh. është evidentuar se e drejta ndërkombëtare nuk përcakton një përkufizim konkret të nocionit “sulm i armatosur” dhe as nuk kërkon që të përdoren armët klasike në sulm për ta kualifikuar si të armatosur atë, prandaj mund t’i njihet një shteti e drejta që të kundërveprojë, duke përdorur forcën në mbrojtje të integriteti dhe sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare kundër akteve terroriste, me kusht që këto të fundit për nga konteksti ose dimensionimi i tyre të jenë të tilla që të kualifikohen si “sulme të armatosura” sipas të Drejtës Ndërkombëtare. Në fakt, në Çështjen Nikaragua, GJND evidenton se neni 51 i Kartës nuk i referohet përdorimit të ndonjë lloji arme specifike apo sulmeve tipike, prandaj kjo dispozitë aplikohet nëse është ushtruar një formë e rëndë force edhe pse mjeti i përdorur për sulmin, është si në rastin e 11 shtatorit: një avion dhe jo një armë klasike eksplozive.

Nga ana tjetër, kriteret që përdoren për të përcaktuar nëse ushtrimi i forcës është i një rëndësie të tillë për të lejuar kualifikim e saj si “sulm i armatosur”, përbëhen nga shkalla dhe efekti i sulmit. Një sulm terrorist mund të kualifikohet si “sulm i armatosur” nëse madhësia dhe intensiteti i tij janë të tilla që të realizojnë pasoja si “shkaktimin e dëmtimeve mbi objektiva shtetërore thelbësore, mbi popullsinë, ekonominë, infrastrukturën e sigurisë, apo dëmtimin e rëndë të autoritetit qeverisës, pavarësinë politike apo vënien në rrezik të integritetit territorial si dhe për të gjitha ato forma të ushtrimit të forcës që kanë si qëllim shkatërrimin ose vënien reale në rrezik të burimeve kryesore industriale dhe ekonomike të një shtetit që ka impakt të fortë në ekonominë e tij”<sup>21</sup>.

Doktrina e fundit ka theksuar gjithashtu, se nuk kërkohet domosdoshmërisht për të lejuar ushtrimin e forcës ndaj një shteti armik në kundërpërgjigje të sulmit terrorist, që sulmi të jetë

<sup>20</sup> A. S. Weiner, *The use of force and contemporary security threats: old medicine for new ills?*, *Stanford Law Review*, 2006, vol. 59, f. 416.

<sup>21</sup> A. Constantinou, *The right of self-defence under customary international law and article 51 of the UN Charter*, 2000, f. 63-64.

organizuar nga forcat e armatosura të vendit, por është e mjaftueshme që grupet të veprojnë nën drejtimin dhe kontrollin e këtij shteti.

Në vlerësim të këtyre kriterëve, Komuniteti Ndërkombëtar unanimisht pranoi se sulmet e një dimensionit dhe intensiteti të ngjashëm me sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 përbëjnë për të Drejtën Ndërkombëtare sulme të armatosura dhe si rrjedhojë aktivizimin e mekanizmave për vetëmbrojtje, përfshirë këtu dhe ushtrimin e forcës së armatosur, për të luftuar terrorizmin është në përputhje me nenin 51 të Kartës dhe me nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit.

Në mbështetje të kriterëve në fjalë, NATO ka përfshirë në kompetencat e saj operative pas vitit 2001 dhe luftën kundër terrorizmit<sup>22</sup>.

Duhet theksuar se jo çdo sulm terrorist i jep një kompetencë direkte Aleancës për të ndërhyrë me masa aktive në bazë të nenit 5 të Traktatit. Marrja e masave për të rivendosur sigurinë dhe paqen, përfshirë dhe përdorimin e forcave të armatosura kundër vendit në të cilin ndodhen grupet terroriste që kanë organizuar sulmin, kërkon që sulmi të plotësojë kriterin e rëndësisë për t'u konsideruar si i armatosur<sup>23</sup>, ndërsa aktet terroriste të një entiteti të vogël mbeten akte kriminale, por jo sulme të armatosura.

Si përfundim duhet theksuar se përdorimi i forcës së armatosur, në perspektiva e mbrojtjes, për të luftuar grupet terroriste që ndodhen në territorin e një shteti tjetër, legjitimohet jo vetëm në rastet kur sulmet terroriste janë kryer nga grupe joshtetërore mbi të cilat vendi armik ka kontrollin e tyre indirekt, por edhe në rastet kur këto grupe thjeshtë tolerohen, mbështeten ose strehohen nga ky i fundit (rasti i *Al-Qaeda-s* dhe Afganistanit)<sup>24</sup>. Bëhet fjalë për një interpretim *ad hoc* të nenit 51 (Karta) dhe 5 të elaboruar ekskluzivisht për terrorizmin, në mënyrë që të legjitimoheshin në planin ndërkombëtar masat që u ndërmorën në periudhën post 11 shtator. Në çdo rast reagimi vetëmbrojtës ose mbrojtja kolektive kundër akteve terroriste, duhet të respektojë parimin thelbësor të proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë.<sup>25</sup>

<sup>22</sup> U. Leanza, *Il diritto internazionale: da diritto per gli Stati a diritto per gli individui*, f. 374.

<sup>23</sup> K. M. Meessen, "Unilateral Recourse to Military Force Against Terrorist Attacks", 2003, 28 *Yale Journal of International Law*, 341, 353.

<sup>24</sup> M. E. O'Connell, "Lawful Self-Defense to Terrorism", 2002, 63 *University of Pittsburgh Law Review*, 889, 899-901.

<sup>25</sup> Për konsiderim më të detajuar në lidhje me aspektet ligjore të luftës kundër terrorizmit konsultoni: C. Stahn, "Terrorist Attacks as 'Armed Attack'", *The Right to Self-Defense, Article 51(1/2) of the UN Charter, and International Terrorism*, 2003, 27(2) *Fletcher Forum of World Affairs* 35;



### C. Terrorizmi kibernetik dhe sulmet informatike: drejt një kompetence të re në favor të Aleancës?

Pas operacioneve të ndërmarra nga NATO në Kosovë sistemet informative të saj kanë qenë objekt i vazhdueshëm i sulmeve informatike, të cilat përgjithësisht nuk e kanë kaluar nivelin kritik për të krijuar një shqetësim serioz politik të Aleancës. Për këto arsye politika difensive kibernetike e NATO-s përqendrohet kryesisht në predisponimin e strukturave të përshtatshme për mbrojtjen e sistemeve të telekomunikimit dhe informimit të Aleancës.

Në prill të vitit 2007, pas heqjes nga kryeqyteti i Estonisë i një statuje bronzi, monument dedikuar “çlirimtarëve rusë”, rrjeti informatik i vendit u dëmtua nga sulme kibernetike në shkallë të gjerë, që nxorën jashtë funksionit faqet e internetit të institucioneve të rëndësishme (ministri, banka, gazeta dhe televizione) dhe paralizuan sistemet informative të telekomunikimit, duke krijuar një situatë paniku.

Incident analog u regjistrua në 2009-n kundër Gjeorgjisë (atëherë vend kandidat) ku sulme informatike të organizuara në javën para se Rusia të ndërhynte me forcat e armatosura për të marrë kontrollin e Osetisë së Jugut dhe Abkhazit, nxorën jashtë funksionit sistemet informatike dhe faqeve *web*, të institucioneve kryesore (Presidencës dhe Bankës Kombëtare) duke detyruar ambasadorin gjeorgjian pranë NATO-s që t’i kualifikonte këto sulme si “sulme informatike” të koordinuara me operacionet ushtarake të ndërmarra nga Rusia me qëllim që të dëmtonin sistemin bankar dhe të sabotonin komunikimin në momentin e kulminant të konfliktit të armatosur<sup>26</sup>.

Pas verifikimit të këtyre incidenteve, ekspertët e sigurisë filluan të diskutonin nëse mund të aktivizohet sistemi i konsultimit që parashikohet nga neni 4 i Traktatit nëse kërcënimi vjen nga sulme informatike, ose nëse sulmet kibernetike mund të kualifikohen

---

M. Byers, “*Terrorism, the Use of Force and International Law After 11 September*”, 2002, 51 *International and Comparative Law Quarterly* 401; J. M. Beard, “*Military Action Against Terrorists Under International Law: America’s New War On Terror*”, 2002, 25 *Harvard Journal of Law and Public Policy* 559; C. Stahn, “*Terrorist Attacks as ‘Armed Attack’*”: *The Right to Self-Defense, Article 51(1/2) of the Y Arai-Takahashi*, “*Shifting Boundaries of the Right of Self-Defence - Appraising the Impact of the September 11 Attacks on Jus Ad Bellum*”, 2002, 36 *International Lawyer*, 1081.

<sup>26</sup> *Security and Defence Agenda, Cyber Security: a transatlantik perspective*, 2010, Bruxelles, [http://www.securitydefenceagenda.org/Portals/7/2010/Publications/Report\\_Cyber\\_security\\_Final.pdf](http://www.securitydefenceagenda.org/Portals/7/2010/Publications/Report_Cyber_security_Final.pdf).

si sulme të armatosura në mënyrë që të aplikohen parimet e përcaktuara nga neni 5 i Traktatit. Pavarësisht nga prospektivi i problemit, qeveria e Estonisë nuk kërkoi formalisht në 2007-n aktivizimin e konsultimeve dhe as aplikimin e nenit 5 të Traktatit, për faktin se sulmet nuk kishin dimensione të tilla për t'u konsideruar si një kërcënim real<sup>27</sup>.

Megjithatë, në raportin e grupit të ekspertëve mbi “*New Strategic Concept of NATO*” (2010), nuk përjashtohet mundësia për të konsideruar sulmet kibernetike të realizuara në shkallë të gjerë ndaj sistemeve informative dhe të komandës të mbështetura në instrumente teknologjike, kur tejkalojnë kufijtë e tolerimit, si kushte të mjaftueshme për të legjitimuar fillimin e konsultimit sipas nenit 4, ose marrjen e masave për garantimin e sigurisë individuale ose kolektive sipas nenit 5 të Traktatit.

Nuk mungojnë studiues dhe ekspertë të sigurisë, të cilët kanë prospektuar nevojën që siguria kibernetike të përfshihet ndër objektivat kryesore të Aleancës: thekson Presidenti i Komitetit Ushtarak të NATO-s se “ekziston një konsensus ndërmjet vendeve anëtare mbi faktin se hapësira kibernetike është një nga sfidat e reja të sigurisë së përbashkët dhe se NATO duhet të posedojë kapacitetin për t'u përballur me këtë sfidë. Neni 5 ka një formulim të qartë, megjithatë përcaktimi se çfarë përbën sulm i armatosur vendoset rast pas rasti.”

Në fakt, për përcaktimin nëse sulmet kibernetike mund të përfshihen në fushën operative të nenit 4 dhe 5, mund të përdoren të njëjtat arsytetime logjike që lejuan aplikimin e këtyre dispozitave ligjore për të ndërmarrë masa të rënda kundër terrorizmit ndërkombëtar. Edhe në lidhje me fenomenin e terrorizmit përjashtohej *a priori* mundësia e aplikimit të nenit 5 të Traktatit, megjithatë shkalla dhe efektet e sulmit të 11 shtatorit lejuan, në bazë të një interpretimi të zgjeruar, aplikimin e tij. Si rrjedhojë nuk mund të përjashtohet që verifikimi i një sulmi kibernetik të konsiderohet, për nga shkalla, rëndësia, dimensionin dhe efektet si sulm i armatosur, duke lejuar kështu aplikimin e dispozitave ligjore të Traktatit, në veçanti nenit 4 ose 5.

---

<sup>27</sup> Sipas *H. Laasme*, arsyeja për të cilën Estonia nuk kërkoi aplikimin e nenit 5 të Traktatit lidhet me faktin se Aleanca nuk kishte, dhe aktualisht nuk ka kualifikuar në mënyrë formale si sulme të armatosura sulmet kibernetike terroriste, *Estonia Cyber Window into future of NATO*, në *JQF/issue* 63, vol. 4/2011, f. 60.

## 5. Roli i Shqipërisë në luftën kundër “kriminalitetin informatik” dhe “terrorizmit kibernetik”

### Përfundime

Republika e Shqipërisë, në përputhje me aspiratat për anëtarësim, më parë në NATO dhe aktualisht në BE, ka reformuar vazhdimisht sistemin normativ për ta përshtatur atë me legjislacionin ndërkombëtar dhe europian në mënyrë që të sigurohet një luftë efikase kundër terrorizmit dhe kriminalitetit informatik.

Megjithatë, legjislacioni penal shqiptar në luftën kundër terrorizmit ka jo pak probleme edhe pse reforma e fundit e krimeve terroriste është realizuar me ligjin 23/2012. Mjafton të përmendet fakti se mënyra sipas së cilës është formuluar neni 230 që parashikon krimin e veprave me qëllime terroriste është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në paragrafin e parë, neni 230, shprehet se “kryerja e veprave të mëposhtme, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”.

Përkufizimi i terrorizmit në legjislacionin penal shqiptar paraqitet si një kombinim dhe gërshetim i normativës ndërkombëtare dhe europiane që analizuam në paragrafët më sipër, por ndryshe nga normativa ndërkombëtare, neni 230 nuk përcakton në mënyrë ezauruese të gjitha veprat që konsiderohen si akte terroriste nëse kryhen për qëllimet e përcaktuara nga paragrafi i parë i tij.

Edhe pse paragrafi i parë lë të kuptohet se vetëm kryerja e veprave të përcaktuara nga par. 2, neni 230 (në veçanti shprehja “veprat e mëposhtme”) mund të kualifikohen si vepra me qëllime terroriste, par. 2, nëpërmjet përdorimit të një formule që aludon respektimin e parimit të taksativitetit, specifikon se veprat terroriste përfshijnë, por nuk kufizohen në veprat e listuara nga norma në fjalë, pa përcaktuar kriteret që duhet të ndiqen për të individualizuar veprat e tjera, të ndryshme nga ato që parashikohen në mënyrë eksplicite, që mund të konsiderohen si akte terroriste.

Një formulim i tillë i dispozitave ligjore është në kundërshtim me parimin kushtetues të ligjshmërisë penale dhe në veçanti

me parimin e detyrimit të ligjvënësit për të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe taksative faktet që parashikohen si vepra penale<sup>28</sup>.

Në çdo rast, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, dispozitat ligjore penale duhet të formulohen dhe interpretohen në mënyrë të tillë që t'i sigurohet subjektit mundësia që, në bazë të një parashikimi të arsyeshëm të mbështetur në ligj, të kuptojë që veprimi i tij përbën vepër penale në momentin kur ai kryhet, në të kundërt duhet përjashtuar dënimi i tij për fakte që ky subjekt, për shkak të formulimit jo të qartë të ligjit, nuk e di me saktësi se ndalohen penalisht<sup>29</sup>. Edhe në lidhje me këtë aspekt, neni 230 nuk i përmbush standardet e kërkuara.

Për sa i përket luftës kundër krimit informatik, legjislacioni kombëtar parashikon një gamë të gjerë veprash penale, të cilat mbrojnë interesa të ndryshme ndaj krimit informatik. Në fakt, në përmbushje të detyrimeve të marra në planin ndërkombëtar, në veçanti me ratifikimin e Konventës Europiane mbi Krimin Kibernetik, ligji penal nr. 10023, i datës 27.11.2008, i konsideruar si akti normativ kryesor në luftën kundër krimit kibernetik, parashikon veprat penale të mashtrimit kompjuterik (143/b K.P.),<sup>30</sup> falsifikimit kompjuterik (neni 186/a K.P.)<sup>31</sup>, hyrja e paautorizuar kompjuterike (neni 192/b K.P.)<sup>32</sup>, përgjimi i paligjshëm i t<sub>u</sub> dhënave kompjuterike (neni 293/a K.P. - neni 3 i Konv.), ndërhyrja në të dhënat dhe sistemet kompjuterike (neni 293/b, neni 293/c K.P) etj.

Edhe pse Konventa Europiane nuk përmbante detyrime ligjore për të penalizuar veprimet e ndërhyrjes, përgjimit të paligjshëm apo dëmtimit të të dhënave dhe sistemeve informatike ushtarake, legjislatori shqiptar i vitit 2008 vendosi të mbronte penalisht, jo vetëm të dhënat dhe sistemet kompjuterike private, por i dedikoi një rëndësi të veçantë mbrojtjes së sistemeve elektronike të komunikimit me karakter ushtarak ose publik.

---

<sup>28</sup> Mbi këtë parim konsultoni: E. Bozheku, Parimi i legalitetit dhe nënparimet e tij, "Jeta Juridike", nr. 2/2009; D. Gjozi, Parimi i ligjshmërisë, E Drejta Penale sipas Gjykatës Kushtetuese, Jus & Justicia nr. 7/2012 dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare dhe Italiane mbi këtë aspekt.

<sup>29</sup> GJEDNJ, *Alimuçaj k. Shqipërisë*, nr. 20134/2005, datë 7 shkurt 2012.

<sup>30</sup> I formuluar në përputhje me nenin 8 të Konventës. Vepra penale e mashtrimit kompjuterik është kritikuar ashpër nga doktrina e huaj për faktin se elementët e saj përbërës nuk përputhen me kategoritë klasike të mashtrimit, nuk kërkohet përdorimi i gënjeshtërs si instrument për arritjen e përfitimit ose shkaktimin e dëmit. L. Picotti, *La ratifica della Convenzione Cybercrime del Consiglio d'Europa, Diritto Penale e Processo*, n. 6/2008, f. 700.

<sup>31</sup> Neni 7 i Konventës.

<sup>32</sup> Nenin 2 i Konventës.

Shqipëria është një ndër të paktat vende europiane, anëtare e NATO-s, e cila, me të drejtë mbron posaçërisht nëpërmjet një legjislacioni penal të përshtatshëm sistemet kompjuterike ushtarake ose të sigurisë kombëtare nga hyrjet e paautorizuara ose në tejkalim të autorizimit, përgjimet e paligjshme që kanë për objekt sistemet informatike ose të dhënat informatike ushtarake dhe të sigurisë kombëtare, dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike ushtarake dhe të sigurisë kombëtare si dhe çdo fakt tjetër konkret që ka për objekt prodhimin, mbajtjen, shitjen, dhënien në përdorim, shpërndarjen apo çdo veprim tjetër, për vënien në dispozicion të një pajisjeje, me qëllim kryerjen e veprave penale të sapoevidentuara.

Ekzistenca e një legjislacioni të mirë në luftën kundër krimit informatik dhe garantimit të efektivitetit të tij, kushtëzohet nga mungesa e një personeli të kualifikuar dhe strukturave të përshtatshme për të parandaluar, luftuar dhe garantuar aplikimin e dispozitave ligjore kundër sulmeve kibernetike.

Në përfundim, sfidat që perceptohen për vendin tonë, në planin e të drejtës penale materiale, lidhen kryesisht me reformimin e legjislacionit penal dhe parashikimin e krimeve mbi terrorizmin kibernetik, përdorimin e sistemeve informatike për mbledhjen e fondeve, propagandës, rekrutimin e subjekteve dhe përgatitjen e sulmeve terroriste, dhe parashikohen vepra penale e kanosjes për qëllime terroriste, e kryer me instrumente informatike, e ngjashme me kanosjen nëpërmjet sistemit kompjuterik të parashikuar nga neni 84/a për racizmin dhe ksenofobinë.

Por sfida kryesore e vendit tonë është krijimi i strukturave të specializuara ekskluzivisht në luftën e krimit informatik dhe terrorizmit kibernetik, të cilat duhet të kenë një personel të kualifikuar shkencor dhe mjetet teknologjike të përshtatshme për të siguruar efektivitetin e luftës për parandalimin e fenomeneve kriminale kibernetike dhe për të identifikuar dhe kapur autorët e krimeve të kryera në hapësirën kibernetike. Aspekti i fundit mbetet për momentin më problematik, për faktin se ekziston një kontroll i ulët nga ana e autoritetit shtetëror mbi format dhe mënyrat e përdorimit të teknologjisë informatike.

Si përfundim, krijimi i strukturave *ad hoc* për luftën kundër krimit informatik është një veprim i domosdoshëm për të krijuar struktura kombëtare paralele me strukturat *ad hoc* që ka krijuar NATO (p.sh. *Cyber Defence Center*) në mënyrë që të forcohet kapaciteti ushtarak i vendit për përballimin e sulmeve kibernetike dhe të rritet bashkëpunimi midis strukturave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare në këtë sektor.

## Anamaria Gheorghe

# ROLI I NATO-S NË MJEDISIN E SIGURISË TË AZISË QENDRORE

### Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë si janë zhvilluar përgjatë dy dekadave të fundit marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe pesë republikave të Azisë Qendrore. Kjo do të arrihet duke analizuar faktorët që formësuan agjendën e Aleancës kundrejt këtij rajoni, si edhe mënyrën sipas së cilës këta shtete kuptuan afrimin me NATO-n. Fillimi i luftës kundër terrorit ishte katalizatori kryesor për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet dy palëve, sidomos pas vitit 2003, kur NATO mori përsipër komandën e Forcës Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë në Afganistan (ang. ISAF). Megjithatë, organizata nuk mund të bazohej plotësisht te partnerët e saj të Azisë Qendrore, ashtu si treguan edhe ngjarjet e majit 2005 në Andijan, Uzbekistan. Krisja e Andijanit nxori në pah marrëdhëniet e brishta ndërmjet NATO-s dhe republikave të rajonit, si dhe theksoi nevojën për të rikonceptuar agjendën e Aleancës kundrejt Azisë Qendrore.

**Fjalët kyçe:** NATO, Azia Qendrore, Operacioni *Enduring Freedom*, Rrjeti Verior i Shpërndarjes.

### Hyrje

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe rënies së regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore, agjendës së NATO-s i duhej të përshtatej me mjedisin e ri ndërkombëtar. Ndërsa Federata Ruse, shteti pasardhës i BRSS-së, u përball me një sërë problemesh të brendshme dhe nuk mund të projektonte fuqinë e tij mbi ish-territorin sovjetik, shtetet e reja të pavarura të Azisë dhe ato të Evropës Qendrore dhe Lindore filluan të shihnin drejt perëndimit. Bashkëpunimi me NATO-n ishte një nga objektivat. Ndërsa shtetet evropiane ndërmorën hapa të rëndësishëm drejt anëtarësisë në NATO dhe deri në vitin 2004 të gjithë vendet ish-

komuniste të rajonit u anëtarësuan në Aleancë, rasti i ish-republikave sovjetike të Kaukazit të Jugut dhe Azisë Qendrore ishte i ndryshëm për shkak të një sërë faktorësh. Pavarësisht se këto shtete ishin pjesë e programit të Partneritetit për Paqe, asnjëherë nuk ka ekzistuar një lidhje e fortë ndërmjet NATO-s dhe partnerëve të saj nga kjo pjesë e botës. Për Aleancën, Azia Qendrore dhe Kaukazi ishin më pak të rëndësishëm sesa shtetet Evropiane. Për republikat e reja, NATO ishte më shumë një ideal sesa një realitet, sidomos në Azinë Qendrore ku udhëheqësit autoritarë nuk mund të perceptonin thellimin e reformave politike dhe demokratike në shkëmbim të bashkëpunimit ushtarak dhe të premtimit për stabilitet rajonal. Por kjo situatë do të ndryshonte pas vitit 2011 dhe fillimit të luftës kundër terrorit. Lufta në Afganistan thelloi bashkëpunimin ndërmjet NATO-s dhe Republikave të Azisë Qendrore. Afërsia e këtyre vendeve me frontin Afgan të luftës si dhe potenciali i tyre për destabilizim ka sjellë një përfshirje më aktive të NATO-s në rajon. Por siç do të shohim më tej, NATO nuk mundi të mbështetej plotësisht te partnerët e saj të Azisë Qendrore. Natyra e regjimeve të Azisë Qendrore dhe ndikimi i dy fuqive të mëdha fqinje me këtë rajon, Ruisë dhe Kinës, ka çuar drejt ripërshtatjes së agjendës së NATO-s për Azinë Qendrore.

Ky studim synon të analizojë mënyrën e zhvillimit të marrëdhënieve që nga viti 1991 ndërmjet NATO-s dhe pesë republikave të Azisë Qendrore (Kazakistanit, Kirgistanit, Taxhikistanit, Turkmenistanit dhe Uzbekistanit). Gjatë kësaj analize autori do të marrë në konsideratë faktorët relevantë, të cilët formësuan strategjinë e Aleancës kundrejt këtij rajoni si edhe kushtet specifike të vendeve të Azisë Qendrore. Një tjetër element kryesor i kësaj analize është lufta në Afganistan, përforcuesi kryesor i marrëdhënieve ndërmjet NATO-s dhe republikave të Azisë Qendrore.

## **NATO dhe shtetet e reja të pavarura të Azisë Qendrore**

Në vijim të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Azia Qendrore konsiderohej si një rajon me potencial të lartë për destabilizim. Së bashku me zonën në kufi të saj, Azia Qendrore formon atë që *Zbigniew Brzezinski* përshkruan si “Ballkani Euro-Aziatik”, “një zonë ku ka vakum të fuqisë”, një rajon i rëndësishëm nga perspektiva gjeopolitike, ekonomike dhe e sigurisë.<sup>1</sup> Mjedisi i

<sup>1</sup> *Zbigniew Brzezinski, Marea tablă de 'ah, Buchares, : Univers Enciclopedic, 2000, 139-140.*

sigurisë në Azinë Qendrore u perceptua si i paqëndrueshëm për shkak të tensioneve etnike dhe kufitare, rigjallërimit islamik, mungesës së reformave ekonomike dhe demokratike, niveleve të larta të korrupsionit dhe qeverive autoritare. Këtyre faktorëve të paqëndrueshmërisë së brendshme i duhen shtuar edhe rreziqet e “sigurisë së butë”, si për shembull “kalimi ndërkufitar tranzit i terroristëve, lëndëve narkotike, armëve të vogla dhe materialeve të asociuara me Armët e Shkatërrimit në Masë”<sup>2</sup>, si dhe përpjekjet për ndikim në rajon të fuqive të mëdha fqinje, Ruisë dhe Kinës. Megjithatë, pavarësisht gjithë faktorëve të mësipërm, Republikat e Azisë Qendrore nuk përbënin prioritet për NATO-n. Aleanca vazhdonte t’i shikonte këto shtete si pjesë të sferës Ruse të influencës dhe ajo nuk ndërmori ndonjë masë të veçantë për të arritur vendet e Azisë Qendrore. Duke mos pasur ndonjë opsion tjetër për sigurinë, republikat e rajonit mbajtën marrëdhëniet e tyre relativisht të ngushta brenda kuadrit të Komunitetit të Shteteve të Pavarura (KSHP), por ata përfituan gjithashtu edhe nga filozofia e NATO-s për të zgjeruar sigurinë dhe stabilitetin në lindje si një mjet për të balancuar ndikimin e Ruisë në Azinë Qendrore.

Vetëm pak muaj pasi fituan pavarësinë, pesë republikat e Azisë Qendrore u bënë pjesë e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (KBAV)<sup>3</sup>. Themeluar nga NATO në dhjetor të vitit 1991, KBAV u konceptua si forumi për dialog ndërmjet ish-anëtarëve të Traktatit të Varshavës dhe vendeve perëndimore, një mënyrë për të tejkaluar ndarjen lindje-perëndim. Ndërsa në vitin 1992 u vendosën marrëdhëniet e para institucionale ndërmjet NATO-s dhe vendeve të Azisë Qendrore, në mesin e viteve '90, katër nga pesë republikat u bënë pjesë e programit të Partneritetit për Paqe (PP). Taxhikistani përbënte të vetmin përjashtim për shkak të luftës civile, e cila filloi në vitin 1992. Megjithatë, pas përfundimit të luftës civile dhe pasi vendi u stabilizua ai gjithashtu u bë pjesë e PP-së në vitin 2002. PP-ja u iniciua nga NATO në vitin 1994 si një program për bashkëpunim bilateral praktik ndërmjet Aleancës dhe vendeve individuale partnere. Programi mbulonte një gamë të gjerë aktivitetesh që nga puna që lidhet me mbrojtjen, reformimi i mbrojtjes, politikat dhe planifikimi, marrëdhëniet civilo-ushtarake, arsimit dhe trajnimit, bashkëpunimi ushtarak dhe stërvitjet, e deri te planifikimi i

<sup>2</sup> Daniel Burghart, Theresa Sabonis-Helf (ed.), *In the Tracks of Tamerlane: Central Asia's Path to the 21<sup>st</sup> Century*, Washington, National Defense University, 2004, 343.

<sup>3</sup> KBAV u riemërua Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA) në vitin 1997.



emergjencave civile dhe përgjigja ndaj fatkeqësive natyrore si dhe bashkëpunimi për çështjet shkencore dhe mjedisore. Ajo që bëri tërheqës PP-në për ish-republikat sovjetike është se ato mund të zgjidhnin fushat në të cilat dëshironin të bashkëpunonin me NATO-n dhe nivelin e përfshirjes sipas interesave dhe prioriteteve të tyre për bashkëpunim<sup>4</sup>.

Pavarësisht entuziazmit fillestar, gjatë viteve '90 lidhjet e drejtpërdrejta ndërmjet shteteve të Azisë Qendrore dhe NATO-s ishin të kufizuara. Uzbekistani, Kazakistani dhe Kirgistani morën pjesë së bashku me aleatët e NATO-s më stërvitjet shumëpalëshe të udhëhequra nga ShBA-ja. Partnerët e Azisë Qendrore morën pjesë në një sërë stërvitjesh për ndërtimin e paqes (si për shembull *CENTRABAT/Regional Cooperation*), në stërvitje në kuadrin e PP-së për përmirësimin e përgatitjeve të tyre për menaxhimin e pasojave dhe ndihmën ndaj fatkeqësive natyrore, si dhe ishin pjesëmarrës për shumë vite me radhë në Seminarin Ndërkombëtar për Reagimin ndaj Emergjencave<sup>5</sup>. Të gjitha këto kontakte ishin më së shumti një mënyrë për të mbajtur të hapur dialogun institucional sesa një përkushtim serioz për sigurinë. Siç përmenda dhe më lart, Azia Qendrore ishte në fundin e listës së rajoneve me interes për NATO-n dhe për më tepër republikat favorizuan marrëdhëniet bilaterale për çështjet e sigurisë me shtetet perëndimore (ShBA-në, Gjermaninë) në dëm të marrëdhënieve me NATO-n. Të dyja palët gjithashtu kanë pasur perspektiva të ndryshme për mjedisin e sigurisë në Azinë Qendrore. Nëse për Aleancën, zgjerimi i bashkëpunimit rajonal përbënte faktorin kryesor për sigurinë, për republikat konkurrenca për supremaci rajonale vinte përpara bashkëpunimit për sigurinë. Qeveritë lokale u përpoqën të zgjeronin bashkëpunimin me aktorët kryesorë ndërkombëtarë në baza bilaterale dhe u orientuan drejt një politike mosbesimi ndaj njëritjetrit.

Duke analizuar marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe Azisë Qendrore, duhet marrë gjithashtu në konsideratë edhe mosdashja e Ruisë që NATO të zgjerohej drejt Lindjes. Udhëheqësit Rusë e perceptonin NATO-n si një aleancë ushtarake që drejtohej kundër Ruisë. Ata ende vazhdonin t'i kuptonin politikat ndërkombëtare nga perspektiva e Luftës së Ftohtë si një lojë me shumën 0. Megjithatë, kundërshtimi i NATO-s nuk ishte mundësi. Bashkëpunimi me Aleancën ishte në interes

<sup>4</sup> *The Partnership for Peace Programme, accessed, April 18, 2012, [www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_50349.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_50349.htm).*

<sup>5</sup> *Burghart and Sabonis-Helf, In the Tracks of Tamerlane, f. 347.*

të Ruisë. Si rrjedhojë, në vitin 1997 NATO-ja dhe Rusia firmosën një marrëveshje për bashkëpunimin zyrtar, e cila themeloi Këshillin e Përhershëm të Përbashkët NATO-Rusi (KPP). Megjithatë, kjo zhvendosje politike drejt Perëndimit nuk do të thoshte se politika e Ruisë drejt ish-territorit sovjetik duhej të ndryshonte. Duke përdorur mekanizmat e përbashkët të sigurisë kolektive të dominuar nga Moska, Rusia u përpoq të mbante ndikimin e saj mbi shtetet e afërta jashtë saj si edhe të kufizonte ndërhyrjet perëndimore. Me anë të KSHP-së, Organizatës së Traktatit për Sigurinë Kolektive (OTSK) dhe Organizatës për Bashkëpunim të Shangait (OBSH), Rusia u përpoq të luante rolin e “menaxherit të sigurisë” në Azinë Qendrore. Megjithatë, në kohën kur Vladimir Putini erdhi në pushtet, Rusia dështoi për të luajtur pjesën e saj siç e tregoi dhe rritja e fundamentalizmit Islamik dhe sulmet nga Afganistani.

Në shkurt të vitit 1999, një sërë shpërthimesh u raportuan në kryeqytetin e Uzbekistanit Tashkent. Sulmet u morën përsipër nga një grup ekstremist, Lëvizja Islamike e Uzbekistanit (LIU). Më tej, po gjatë të njëjtit vit, ekstremistët islamikë dhe të tjerë u larguan nga shtypja në Uzbekistan dhe u vendosën në Taxhikistan së bashku me grupet taxhike që refuzuan të çarmatoseshin në kuadër të marrëveshjes së paqes, në Taxhikistan hynë në Kirgistan. Luftëtarët morën pengje dhe pushtuan një sërë fshatrash. Në tetor, qeveria e Kirgistanit lajmëroi se luftëtarët u përzunë me forcë jashtë Kirgistanit nëpër Taxhikistan dhe që andej në Afganistan. Sipas shumë analistëve, kjo ndërhyrje dëshmoi lidhjet ndërmjet terroristëve në Afganistan, Kirgistan, Uzbekistan dhe atyre në Rusi (Dagestan dhe Çeçeni). Në verën e vitit 2000, kryengritësit pushtuan sërish Kirgistanin dhe Uzbekistanin, duke marrë pengje dhe duke sjellë, si pasojë, që qindra kirgizë të largoheshin nga zona. Në fund të tetorit kryengritësit u zbrapsën sërish në Afganistan<sup>6</sup>. Këto ngjarje çuan në një tjetër ndryshim të Politikës së Jashtme të Ruisë kundrejt Azisë Qendrore. Lufta kundër terrorizmit dhe fundamentalizmit islamik u bënë pikat kryesore të agjendës ruse. Kjo situatë paraqiti një mundësi të re për Moskën që të rivendoste ndikimin rus në rajon. Por këto ngjarje gjithashtu tërhoqën vëmendjen e ShBA-së, e cila ofroi ndihmë për mbrojtjen dhe sigurinë për të dyja vendet dhe gjithashtu zhvilloi bashkëpunim me Kazakistanin. Një sërë zyrtarësh Amerikanë vizituan Azinë Qendrore dhe u takuan me udhëheqësit e rajonit. Në krye të

---

<sup>6</sup> Jim Nichol, *Central Asia's Security: Issues and Implications for US Interests*, Washington, CRS Report for Congress, 2010, f. 5-7.

agjendës ishin çështjet e sigurisë rajonale dhe të luftës ndaj terrorizmit. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, në atë kohë lordi *George Robertson*, i cili gjithashtu ndërmoi një vizitë në Kirgistan. Interesi që perëndimi po tregonte për situatën në Azinë Qendrore vendosi Rusinë në një pozicion defensiv. Putini ftoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s për të vizituar Moskën në shkurt të vitit 2000, duke sinjalizuar kthimin e kontakteve të Ruisë me NATO-n, pasi marrëdhëniet ishin ndërprerë në mars të 1999-s për shkak të fushatës ajrore të NATO-s kundër Serbisë. Pas kësaj vizite, ministri Rus i Mbrojtjes lajmëroi se ndërmjet çështjeve të tjera, diskutimet e ardhshme të KPP-së do të përfshinin edhe luftën kundër terrorizmit si një problem global. Dmitri Trenin shkroi në *"NATO Review"*, në vitin 2000, se: "Një rishikim, në bashkëpunim të ngushtë i dispozitave të tij [të KPP-së], do të lejonte secilën prej palëve që të identifikonte nevojat reale dhe të vendoste prioritetet përkatëse, të cilat më pas do të mund të harmonizoheshin dhe zhvilloheshin në një plan pune të arritshëm. [...] Një tjetër subjekt për dialog mund të ishte edhe situata e sigurisë në Azinë Qendrore dhe Afganistan, me kusht që NATO të qetësonte frikërat e Ruisë se NATO po përpqej të zëvendësonte atë si përgjegjës kryesor për sigurinë e rajonit"<sup>7</sup>. Putini përdori përmirësimin e marrëdhënieve me perëndimin si një mënyrë për të mbajtur Azinë Qendrore brenda sferës së influencës ruse. Edhe pse interesi që treguan për Azinë Qendrore, NATO dhe ShBA gjatë vitit 2000 dhe në fillim të vitit 2001, ishte më i lartë se më parë, ai nuk mundi të parashikonte profilin e lartë që të dy aktorët do të merrnin në rajon brenda fare pak muajsh.

## Faktori Afgan

Që prej fundit të vitit 2001, dy ngjarje kanë rritur interesin dhe aktivitetet e NATO-s në Azinë Qendrore. Ndërsa faktori i parë lidhet me politikën e zgjerimit të Aleancës, faktori i dytë i referohet çështjeve të sigurisë në rajonin e Azisë Qendrore. Ndërkohë që shumica e shteteve të Evropës Qendrore dhe Jugore po bëheshin anëtarë të NATO-s, brenda PP-së u gjenerua një ndryshim i optikave. Azia Qendrore, Kaukazi dhe Ballkani Perëndimor ishin rajonet të cilat u vendosën në fokus të këtij organizmi. Ngjarja e dytë ka lidhje me fillimin e luftës

<sup>7</sup> Dmitri Trenin, *"Russia-NATO relations: Time to pick up the pieces"*, *NATO Review* 49, Spring/Summer 2000.

kundër terrorizmit. Inicimi i Operacionit *Enduring Freedom* (OEF) dhe i misionit të Forcës Ndërkombëtare për Asistencë në Siguri (ISAF) rezultoi në shtimin e prezencës ushtarake të NATO-s në Azinë Qendrore. Të gjithë shtetet e rajonit mbështetën operacionet në Afganistan si një mjet për të ruajtur sigurinë dhe stabilitetin në Azinë Qendrore.

Shumë shpejt, pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, udhëheqësit e Azisë Qendrore shprehën vullnetin e tyre për të marrë pjesë në operacionet e udhëhequra nga ShBA-ja në Afganistan dhe për të lejuar trupat e ShBA-së dhe aleatëve të saj që të përdorë ish-bazat ushtarake sovjetike. Kjo dëshirë e madhe për të ndihmuar mund të shpjegohet nga një sërë faktorësh, si: frika për një efekt domino (*spill-over effect*) nga Afganistani, kërcënimi në rritje nga fundamentalizmi islamik, avantazhet ekonomike të sigurisë dhe të mbrojtjes, që do të përfitoheshin nga këto vende për shkak të prezencës së huaj ushtarake dhe pasjen e një mjeti për të kundërshtuar influencën Ruse në rajon.

Edhe për NATO-n, lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar ishte diçka e re. Duke përdorur nenin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, i cili thekson se të gjithë vendet anëtare duhet të mbrojnë së bashku çdo anëtar që sulmohet, ShBA-ja bëri thirrje për një përgjigje të përbashkët kundër sulmeve terroriste në territorin e saj. Për herë të parë, NATO duhej të përballlej me një rrezik global, Aleanca duhet të merrte përsipër role të reja sipas Konceptit Strategjik të NATO-s të vitit 1999. Krahas dispozitave të nenit 5, koncepti strategjik përfshin sfida për sigurinë, si: aktet terroriste, sabotimi dhe krimi i organizuar si dhe shqetësimi ndaj prodhimit të resurseve thelbësore<sup>8</sup>. Kjo gamë e gjerë rreziqesh për sigurinë i mundësoi NATO-s një perspektivë globale, duke qenë se misioni i saj ishte t'i përgjigjej nevojave globale të aleatëve. Kjo, gjithashtu, përfshinte nevojën që NATO të ripërcaktonte marrëdhëniet e saj me Rusinë. Që tani e tutje terrorizmi ishte një rrezik i përbashkët. Rusia ofroi mbështetjen e saj për operacionet e udhëhequra nga ShBA-ja në Afganistan dhe si rrjedhojë marrëdhëniet NATO-Rusi u përmirësuan. Pas shpalljes publikisht të mbështetjes Ruse, Putini zhvilloi një vizitë zyrtare në Gjermani dhe më pas u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s. Raportet nga takimi i 3 tetorit theksojnë bashkëpunimin e ngushtë: "Rreziku global nga terrorizmi ndërkombëtar dhe interesi për ndërtimin e një sistemi afatgjatë

---

<sup>8</sup> NATO Strategic Concept 1999, accessed April 19, 2012, [www.nato.int/cps/en/natolive/official\\_texts\\_27433.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_27433.htm).

dhe të balancuar të sigurisë evropiane dhe asaj globale kërkonin ndryshime të thella në kuadrin dhe përmbajtjen e bashkëpunimit ndërmjet Rusisë dhe NATO-s<sup>9</sup>. Përgjigja e Putinit për situatën e re globale ishte një kompromis: “Ai deklaroi mbështetjen e plotë për operacionin e ShBA-së por pa pjesëmarrjen e trupave Rusë atje. Ai dha lejen e tij që shtetet e Azisë Qendrore të hapnin territoret e tyre për forcat Amerikane, por me kusht që operacionet sulmuese nuk duhej të fillonin prej këtij territori”<sup>10</sup>.

Në fund të shtatorit, trupat e parë amerikanë u vendosën në Uzbekistan dhe më 7 tetor filloi bombardimi i territorit afgan. Qëllimi i OEF-së ishte të ndalonte përdorimin e Afganistanit si bazë për operacionet e terroristëve dhe të sulmonte kapacitetet ushtarake të regjimit të talebanëve siç tha dhe presidenti *George W. Bush* gjatë fjalimit të tij për kombin. Strategjia e OEF-së bazohej në më shumë sesa, thjesht, operacione ushtarake. Ajo përfshinte ndërtimin e aleancave me forcat afgane antitalebane, trajnimin e forcave të opozitës dhe ndihmën humanitare. Ditën tjetër, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, lordi Robertson theksoi hapat praktikë që NATO kishte ndërmarrë për të asistuar operacionet ushtarake: “Në këtë kontekst dhe në vijim të një kërkesë specifike nga Shtetet e Bashkuara, aleatët ranë sot dakord se pesë avionë (*AWACS [Airborne Warning and Control Systems]*) të NATO-s, së bashku me ekuipazhin e tyre, do të dislokohen në Shtetet e Bashkuara për të asistuar operacionet kundër terrorizmit. Ky dislokim, për të cilin u ra dakord unanimisht sot në mëngjes, do të lejojë që avionët e ShBA-së, që aktualisht janë përfshirë në operacionet e brendshme, të jenë në dispozicion të operacioneve kundër terroristëve në vende të tjera”. Gjithashtu, komanda e Forcës Detare të NATO-s në Mesdhe do të vendoset në Mesdheun Lindor.<sup>11</sup>

Të gjitha shtetet e Azisë Qendrore ofruan mbështetje të formave të ndryshme për operacionet në Afganistan. Kjo mbështetje varionte nga dhënia e të drejtës për përdorim të hapësirave ajrore, te lehtësitë për furnizim me karburant, e deri te vënia në dispozicion të bazave ushtarake për anëtarë individualë të NATO-s. Uzbekistani mikpriti një bazë Amerikane në Karshi-Khanabad, dhe Gjermania përdori një bazë në Termez. Kirgistani strehoi një Qendër Tranzitore Amerikane në aeroportin

<sup>9</sup> *Lena Jonson, Vladimir Putini and Central Asia, London, I.B. Taurist, 2006, 86.*

<sup>10</sup> *Ibid, 85.*

<sup>11</sup> *Operation Enduring Freedom and the Conflict in Afghanistan: An Update, Research Paper 01/81, October 2001, House of Commons Library, 30.*

e Manasit (fillimisht kjo ishte një bazë ushtarake), Taxhikistani mikpriti avionë ushtarakë francezë, dhe në vitin 2004 firmosi një marrëveshje për tranzit me NATO-n. Kazakistani “ishte i gatshëm për bashkëpunimin më të ngushtë të mundshëm me ShBA-në dhe me komunitetin botëror për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar”, sipas deklaratave të ministrit të tij të Jashtëm. Në kuadër të neutralitetit të tij, Turkmenistani ofroi përdorimin e hapësirës ajrore për ndihmat humanitare për Afganistanin<sup>12</sup>.

Brenda pak javësh pas fillimit të operacioneve në Afganistan, balanca e fuqive në terren ndryshoi. Aleanca e Veriut arriti të futej në Kabul dhe u formua një qeveri e përkohshme nën udhëheqjen e Hamid Karzait. Më 20 dhjetor 2001, Këshilli i Sigurisë së OKB-së formoi nëpërmjet Rezolutës 1386, Forcën Ndërkombëtare të Asistencës për Siguri (ISAF), e cila do të ndihmonte autoritetin e përkohshëm afgan për të mbajtur sigurinë në Kabul dhe në zonat përreth tij. Vetëm dy vjet më pas OKB-ja aprovoi zgjerimin e ISAF-it në Afganistan. Kjo ishte një arritje e rëndësishme për zhvillimin e marrëdhënive të NATO-s me republikat e Azisë Qendrore. Kur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vizitoi rajonin në vitin 2003, deklaroi se ngjarjet e 11 shtatorit kanë bërë që Aleanca të kuptojë se “siguria jonë lidhet ngushtësisht me sigurinë në rajonet periferike. Azia Qendrore tashmë do të jetë pjesë kryesore e agjendës së NATO-s”<sup>13</sup>. Që atëherë, roli i rajonit në agjendën e NATO-s nuk ishte më vetëm i lidhur me Afganistanin. Azia Qendrore u bë pjesë e një programi afatgjatë, i cili synon të promovojë stabilitet dhe siguri në rajon. Në Samitin e Stambollit të vitit 2004, së bashku me Kaukazin e Jugut, Azia Qendrore u bë një zonë në fokus të veçantë. Udhëheqësit e NATO-s gjithashtu vendosën që të caktonin një oficer ndërlidhjeje në Komandën Rajonale të Almatit, misioni kryesor i të cilit do të ishte mbështetja e zbatimit të programeve të NATO-s në rajon. Për më tepër, gjatë këtij Samiti u krijua edhe pozicioni i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Azinë Qendrore dhe Kaukazin e Jugut. Në shkëmbim të programeve të saj, NATO inkurajoi qeveritë e Azisë Qendrore që të ndërmerrnin reforma politike dhe ushtarake. Dokumenti themeltar i PP-së thekson vullnetin e pjesëmarrësve “për ruajtjen e shoqërive demokratike, lirive të tyre nga detyrimi dhe frikësimi si edhe vendosjen në përdorim të principeve të së drejtës

---

<sup>12</sup> Bertil Nygren, *The Rebuilding of Greater Russia*, London, Routledge, 2008, f. 209-212.

<sup>13</sup> Richard Weitz, “Renewing Central Asian Partnerships”, *NATO Review*, no.3, Autumn 2006.

ndërkombëtare”. Gjatë vizitës së tij në Tashkent në vitin 2004, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s *Jaap de Hoop Scheffer*, rikonfirmoi vlerat e partneritetit: “Ne do të bëjmë çdo gjë që të mundemi për të mbrojtur veçanërisht vlerat demokratike, dhe shpresojnë se këto konsiderata do të merren parasysh edhe në marrëdhëniet tona me Uzbekistanin”<sup>14</sup>.

Ndërkohë që marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe shteteve të Azisë Qendrore u forcuan, u bë e qartë se Perëndimi ishte atje për të qëndruar. Nëse në vitin 2002, marrëdhëniet Rusi-ShBA dhe ato Rusi-NATO dukej se do të përmirësoheshin, vetëm një vit më pas, Igor Ivanov i kërkoi Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të vendoste një periudhë kohore për përfundimin e qëndrimit të trupave të ShBA-së në Azinë Qendrore, duke konsideruar se regjimi i talebanëve në Afganistan kishte marrë fund. Çështja e vendosjes së një periudhe kohore për tërheqjen e trupave amerikane vazhdoi të diskutohej edhe përgjatë disa viteve pasardhës, duke ndikuar edhe marrëdhëniet e Ruisë me ShBA-në, NATO-n dhe me republikat e Azisë Qendrore. Që në vitin 2003, Rusia filloi të rivendoste ndikimin e saj mbi Azinë Qendrore.

## Partnerët e Azisë Qendrore

Bashkëpunimi i NATO-s me Turkmenistanin është më i kufizuar sesa me shtetet e tjera të Azisë Qendrore, edhe pse vendi është anëtar i Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA) dhe i PP-së. Turkmenistani ka ndjekur një politikë të “neutralitetit pozitiv” në luftën kundër terrorizmit. Aleatët kanë të drejtë të fluturojnë në hapësirën e tij ajrore për qëllime humanitare. Neutraliteti konstant i këtij shteti u njoh edhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në dhjetor 1995. Si pasojë, Turkmenistani refuzoi të firmoste ndonjë marrëveshje ushtarake me NATO-n dhe ShBA-në për luftën në Afganistan. Vetëm në vitin 2004 Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u takua me presidentin *Niyazov* për të diskutuar për “mundësinë e sigurimit të korridoreve ajrorë dhe tokësorë nëpërmjet Turkmenistanit për operacionet në Afganistan”<sup>15</sup>. Në vitin 2005 pati thashetheme rreth hapjes së një baze ushtarake Amerikane në Mary, të cilat u mohuan prej zyrtarëve të Turkmenistanit. Bashkëpunimi i Turkmenistanit me NATO-n po zhvillohet nëpërmjet Programeve Individuale të

<sup>14</sup> *Ibidem*.

<sup>15</sup> *Nygren, The Rebuilding...*, f. 212.

Partneritetit (PIP). Fushat kryesore të bashkëpunimit janë kontrolli i kufijve dhe siguria, planifikimi për emergjencat civile dhe planifikimi i mbrojtjes. Gjatë kohës ku *Niyazov*-i ishte në detyrë, marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe Turkmenistanit ishin të kufizuara. Në vitin 2002 vendi mikpritri një sërë kursesh të PP-së për trajnim rajonal për planifikimin e emergjencave civile dhe në vitin 2003 ai u lidh me sistemin *Virtual Silk Highway (VSH)*. Pas ardhjes në fuqi të presidentit Berdimuhamedov, vendi u hap për një bashkëpunim dhe dialog më të madh. Në vitin 2007, presidenti i ri u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s dhe gjatë të njëjtit vit, Turkmenistani mikpritri një skuadër të lëvizshme trajnimi të një projekti pilot të Këshillit NATO-Rusi për trajnimin për luftën kundër narkotikëve për stafin Afgan dhe atë të vendeve të Azisë Qendrore. Në vitin 2008, presidenti Berdimuhamedov mori pjesë në samitin e NATO-s, vitin pasardhës, vendi mikpritri një seminar të NATO-s për planifikimin e emergjencave civile në Ashgabat, dhe në vitin 2010 Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u takua me ministrin Turkmen të Mbrojtjes<sup>16</sup>.

Menjëherë pas sulmeve të 11 shtatorit, Taxhikistani bëri të ditur dëshirën e tij për të "hapur territorin e tij, nëse do të ishte e nevojshme, për fluturime tranzit, ulje dhe për baza ushtarake, ofroi të gjitha vendet e disponueshme dhe ia la në dorë ShBA-së të caktonte preferencat e saj"<sup>17</sup>. Ishin tre aeroporte që diskutoheshin, por vetëm Dushanbe mund të përdorej për rifurnizimin e avionëve të transportit të mallrave. Në dhjetor 2001, trupat filluan të vinin, kryesisht francezë. Në vitin 2002, Taxhikistani u bë pjesë e PP-së. Që prej asaj kohe vendi tregoi një interes në rritje për të bashkëpunuar me NATO-n. Fushat kryesore të bashkëpunimit përfshinin sigurinë dhe paqeruajtjen, sidomos sigurinë kundër terrorizmit dhe atë kufitare, menaxhimin e krizave dhe emergjencat civile. Në vitin 2003, Taxhikistani u lidh me sistemin VSH dhe presidenti *Emomali Rahmon* zhvilloi vizitën e tij të parë në Komandën e NATO-s. Zyrtarë të lartë taxhikë dhe të NATO-s u takuan gjithashtu edhe në vitin 2004, kur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s *Jaap de Hoop Scheffer* vizitoi Dushanbenë si edhe në vitet 2007, 2009 dhe 2010. Në vitin 2004, Aleatët firmosën një marrëveshje tranziti me Taxhikistanin në mbështetje të operacioneve të NATO-s dhe të ISAF-it në Afganistan, në kuadër të një Projekti të Fondit të Besimit të PP-së (PFP, Trust Fund Project). Për më tepër,

---

<sup>16</sup> *NATO's Relations with Turkmenistan*, accessed April 19, 2012, [www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_50317.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_50317.htm).

<sup>17</sup> *Jonson, Vladimir Putini...*, f. 90.



Taxhikistani përfundoi shkatërrimin e mbi 1200 minave tokësore. Vitin vijues, Akademia e Verës në Taxhikistan, e sponsorizuar nga NATO, zhvilloi kursin e saj të parë dhe në janar të vitit 2012 një projekt i ri i Fondit të Besimit të PP-së u paraqit me qëllim sigurimin e municioneve të rrezikshme të mbetura nga lufta civile<sup>18</sup>.

Në 28 dhjetor 2001, parlamenti kirgiz lejoi që trupat ushtarake amerikane të vendosnin një bazë në Aeroportin Ndërkombëtar të Manasit për një periudhë njëvjeçare. Presidenti Askar Akaiev deklaroi se ai ishte i gatshëm për të zgjatur marrëveshjen për prezencën ushtarake amerikane në territorin kirgiz për aq kohë sa do të nevojitej për të stabilizuar situatën në Afganistan. Në janar të 2002-shit, 2000 trupa të NATO-s u vendosën në këtë bazë<sup>19</sup>. Pas revolucionit të parë kirgiz, negocimet e qeverisë së re me ShBA-në mbi një marrëveshje për një bazë të re ngecën për disa muaj për shkak të çështjeve financiare. Një situatë e njëjtë u paraqit në vitin 2009, kur presidenti Kurmanbek Bakiyev lajmëroi mbylljen e bazës amerikane në Manas. Pas negocimit të një marrëveshjeje të re, trupat Aleate mund të vazhdonin të përdornin bazën si një qendër tranzitimi. Për sa i përket marrëdhënieve të Kirgistanit me NATO-n, ato janë përmirësuar vazhdimisht që prej vitit 2001. Hapi më i rëndësishëm u hodh në vitin 2007, kur Republika u bë pjesë e Procesit të Rishikimit dhe Planifikimit (PRP) të PP-së me synim që të punonte më ngushtësisht me Aleatët mbi iniciativat për ndërveprimin ushtarak dhe për planifikimin e mbrojtjes. Pas revolucionit të dytë kirgiz në vitin 2010, qeveria e re rikonfirmoi vullnetin e vendit kundrejt NATO-s. Presidenti i përkohshëm *Roza Otunbayeva* zhvilloi një vizitë në Komandën e NATO-s në shkurt të 2011-s. Përgjatë viteve, Kirgistani dhe NATO kanë bashkëpunuar në fusha të ndryshme, si: siguria dhe paqeruajtja, dhe sidomos masat kundër terrorizmit dhe për sigurinë kufitare, menaxhimin e krizave dhe planifikimin për emergjencat civile. Janë zhvilluar një sërë projektesh të përbashkëta. Në vitin 2007 Forumi Rinor i KBEA-së u mbajt në Bishkek. Në vitin 2008 Kirgistani mikpriti kursin e trajnimit "Përdorimi i Forcës për Luftën ndaj Terrorizmit", dhe në vitin 2009 vendi filloi zyrtarisht në Bishkek një program zyrtar të mbështetur nga NATO për ritrajnim për personelin ushtarak të liruar<sup>20</sup>.

<sup>18</sup> *NATO's Relations with Tajikistan*, [www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_50312.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_50312.htm).

<sup>19</sup> *Nygren, The Rebuilding...*, f. 210.

<sup>20</sup> *NATO's Relations with Kyrgyzstan*, accessed April 20, 2012, [www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_49607.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49607.htm).

Në fund të vitit 2001, Kazakistani i garantoj ShBA-së të drejtat për fluturim mbi hapësirën e tij ajrore dhe ofroi akses tokësor për transferimin e logjistikës në Afganistan. Në vitin 2002, ShBA-ja dhe Astana ranë dakord për caktimin e tre aeroporteve (Çimkent, Lugovoi dhe Almati), të cilët do të mund të përdreshin nga forcat e koalicionit në rast situatash emergjente. Brenda të njëjtit vit, marrëdhëniet NATO-Kazakistan janë intensifikuar, pasi Republika u bë pjesë e PRP-së të PP-së. Fokusimi te mbështetja e proceseve të reformave të brendshme të Kazakistanit është thelluar më tej që prej zhvillimit të planit të parë të Veprimit Individual për Partneritet (PIP) nga Kazakistani në vitin 2005. Shteti i Azisë Qendrore përfundoi ciklin e parë të PIP-së në konsultim me NATO-n në vitin 2008; ciklin e dytë në vitin 2010 dhe aktualisht po zhvillon një cikël të tretë të tij. PIP përfshin disa fusha kryesore, të cilat janë reformat politike, ushtarake dhe të sigurisë. NATO ka rënë dakord të mbështesë Kazakistanin për përmbushjen e këtyre reformave nëpërmjet këshillave dhe asistencës specifike të hartuar sipas nevojave të vendit. Që prej vitit 2005, presidenti *Nursultan Nazarbayev* dhe zyrtarë të tjerë të lartë kazakë kanë zhvilluar një sërë vizitash në komandat e NATO-s dhe gjithashtu kanë pritur Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s në Kazakistan. Në vitin 2009, Kazakistani mikpriti në Astana Forumin e Sigurisë të KBEA-së dhe një stërvitje të NATO-s për reagimin ndaj katastrofave. Në vitin 2010, dy partnerët firmosën një marrëveshje për tranzitimin e ngarkesave jovekdeprurëse të ISAF-it në Afganistan nëpërmjet transportit hekurudhor<sup>21</sup>.

Uzbekistani ka qenë Aleati më i rëndësishëm i Azisë Qendrore në fillim të luftës kundër terrorit. Më 16 shtator 2001, ministri i Jashtëm Uzbek deklaroi se “Uzbekistani ishte i hapur për çdo formë bashkëpunimi antiterrorist me Shtetet e Bashkuara, duke përfshirë përdorimin e mundshëm të territorit uzbek për sulmet mbi bazat terroriste në Afganistan”<sup>22</sup>. Në fund të shtatorit, trupat e ShBA-së u dislokuan në bazën e Karshi-Khanabad, dhe në vitin 2002 Gjermania morri me qira bazën e Termesit për të mundësuar mbështetje për operacionet e ISAF-it në Afganistan. Në shkëmbim të përdorimit të bazave, Uzbekistani mori ndihmë ekonomike për sigurinë jo vetëm nga ShBA-ja, por edhe në kuadër të PP-së. “Në shtator të 2003-shit, Uzbekistani ishte i vetmi vend i Azisë Qendrore që u ftua të merrte pjesë në stërvitjen e NATO-s në Rumani, dhe gjatë një vizite të Sekretarit

<sup>21</sup> *NATO's Relations with Kazakhstan*, accessed April 20, 2012, [www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_49598.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49598.htm).

<sup>22</sup> *Jonson, Vladimir Putin...*, 84.

të Përgjithshëm të NATO-s lord Robertson, Uzbekistani u cilësua si një model për vendet e tjera partnere të NATO-s”<sup>23</sup>. Që prej vitit 2004 dolën në pah një sërë tensionesh në marrëdhëniet Uzbekistan-ShBA dhe Uzbekistan-NATO, për shkak të mosrespektimit të të drejtave të njeriut nga vendi në fjalë, dhe në vitin 2005 marrëdhëniet u përkeqësuan. Kritikat arritën kulmin pas ngjarjeve të majit në Andijan. Këshilli i Atlantikut të Veriut lëshoi një deklaratë që ndalonte “përdorimin e përsëritur të forcës së tepërt dhe joproporcionale nga forcat uzbeke të sigurisë dhe bëri thirrje për hetim ndërkombëtar të pavarur.”<sup>24</sup> Më vonë, përgjatë vitit, Rusia dhe Kina propozuan një takim të OBSH-së, vendeve anëtare, për të firmosur një deklaratë, e cila kërkonte që ShBA-ja të vendoste një periudhë kohore për tërheqjen nga Azia Qendrore. Pas kësaj, Uzbekistani i kërkoi forcave Amerikane të tërhiqeshin nga baza ushtarake e Karshi-Khanabadit si dhe vendosi masa shtrënguese për përdorimin e territorit dhe të hapësirës së tij ajrore për aleatët e tjerë.

Pas fillimit të luftës kundër terrorizmit, marrëdhëniet NATO-Uzbekistan kanë qenë të lëkundura. Gjatë periudhës 2002-2005, Uzbekistani është afruar me NATO-n. Në vitin 2002 ai iu bashkua PRP-së të PP-së dhe morri pjesë në një sërë stërvitjesh të NATO-s. Në periudhën 2005-2008, kontaktet ndërmjet NATO-s dhe Uzbekistanit ishin minimale. Në vitin 2008, Uzbekistani firmosi një marrëveshje për të ndërmarrë një projekt Shkenca për Paqen dhe Sigurinë, dhe në vitin 2010 NATO përfundoi marrëveshjen me Uzbekistanin për tranzitimin e ngarkesave jovdekjeprurëse të ISAF-it në Afganistan. Vizita e Presidentit Islam Karimov në komandën e NATO-s, në vitin 2011, shënoi përmirësimin e marrëdhënieve<sup>25</sup>.

Ky përmirësimi mund të shikohet edhe si rezultat i rolit në rritje të Rrjetit Verior të Shpërndarjes (RVSh). RVSh-ja përfshin një sërë marrëveshjesh për qendrat e tranzitit dhe ato logjistike, të cilat lidhin portet e Detit Baltik dhe atij Kaspik me Afganistanin, nëpërmjet Rusisë, Azisë Qendrore dhe Kaukazit. RVSh-ja është një përgjigje kundrejt përshkallëzimit të problemeve në Pakistan, rruga fillestare kryesore për në Afganistan. Që prej vitit 2008, roli i Azisë Qendrore si një rrugë furnizimi për në Afganistan ka qenë në rritje të vazhdueshme. Nëse deri në vitin 2008 “tranzitimi nëpërmjet RVSh-së llogaritej se zinte vetëm rreth 10% të

<sup>23</sup> Nygren, *The Rebuilding...*, 211.

<sup>24</sup> Richard Weitz, “Renewing Central Asian Partnerships”, *NATO Review*, no. 3, Autumn 2006.

<sup>25</sup> NATO’s Relations with Uzbekistan [www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_22839.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_22839.htm).

ngarkesave të destinuar për Afganistan krahasuar me 90% të këtij volumi që mbulohej nga Pakistani; në vitin 2011 totali i përgjithshëm i tranzitimit nëpërmjet RVSh-së u rrit në 60%.” Në këtë kontekst, bashkëpunimi i NATO-s me Azinë Qendrore është një parakusht për funksionimin e këtij misioni. Përtej rolit të saj kryesor si një rrugë furnizimesh për në Afganistan, zyrtarët e NATO-s dhe të Azisë Qendrore “shprehin shpresat se forcimi i RVSh-së do të gjeneronte gjithashtu përfitime ekonomike në formën e përmirësimit të infrastrukturës tranzitore, teknologjive të tranzitit, duke rritur volumin e tregtisë”<sup>26</sup>.

## Konkluzione

Përfshirja e NATO-s në Azinë Qendrore nuk ishte një opsion për Aleancën, por një domosdoshmëri. Nëse deri në vitin 2000, marrëdhëniet e Aleancës me ish-republikat sovjetike, ishin kryesisht një mënyrë për të mbajtur dialogun institucional të hapur, fillimi i luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe pasojat e saj e ngritën Azinë Qendrore në listën e prioriteteve kryesore të NATO-s. Për republikat e rajonit kjo ishte një mundësi për t'u distancuar nga Rusia. Ishte hera e parë që prej pavarësisë së tyre që këto shtete prezantoheshin me një mundësi të ndryshme lidhur me sigurinë, diçka që nuk ishte një Organizatë Rajonal me dominancë Ruse ose Ruso-Kineze. Reagimi i tyre ndaj këtij mjedisi të ri të sigurisë mori forma të ndryshme. Turkmenistani vazhdoi politikën e tij të neutralitetit, por hapi hapësirën e tij ajrore për misionet humanitare. Kazakistani gjithashtu pati një sjellje të rezervuar. Ai ofroi të drejta tranziti tokësor dhe ajror për Aleatët, por nuk i hapi bazat e tij ushtarake për trupat e huaja. Kazakistani favorizoi një partneritet afatgjatë me NATO-n në këmbim të përfitimeve të menjëhershme. Taxhikistani, Kirgistani dhe Uzbekistani ofruan bazat e tyre për vendet anëtare individuale të NATO-s. Avionët francezë u stacionuan në aeroportin e Dushanbesë. Gjermania mori me qira bazën e Termezit dhe veproi nga baza ajrore në Manasitsi dhe nga baza ushtarake Karshi-Khanabad. Uzbekistani ka pasur një rol kryesor përgjatë viteve të para të luftës kundër terrorit. Pas vitit 2005, Kirgistani dhe Kazakistani dolën përpara, por Aleatët nuk po kërkonin më baza ushtarake jashtë Afganistanit. Tashmë ata po

---

<sup>26</sup> Alexander Cooley, “Rockblocks on the New Silk Road: The Challenges of Externally Promoting Central Asian Economic Cooperation”, *EUCAM Watch*, no. 11, February 2012, 4.

përqendroheshin te gjetja e rrugëve të tranzitimit drejt zonës së luftës. Që prej vitit 2008, shtetet e Azisë Qendrore luajnë një rol kryesor në Rrjetin Verior të Shpërndarjes për në Afganistan.

## Bibliografia

- Brzezinski, Zbigniew, *Marea tablă de 'ah*, Bucharest, Univers Enciclopedic, 2000.
- Bugajski, Janus, *Pacea rece: noul imperialism al Rusiei*, Bucharest, Casa Radio, 2005.
- Burghart, Daniel and Theresa Sabonis-Helf (ed.), *In the Tracks of Tamerlane: Central Asia's Path to the 21<sup>st</sup> Century*, Washington, National Defense University, 2004.
- Cooley, Alexander, "Rockblocks on the New Silk Road: The Challenges of Externally Promoting Central Asian Economic Cooperation", *EUCAM Watch*, no. 11, February 2012.
- Jonson, Lena, *Vladimir Putini and Central Asia*, London, I. B. Tauris, 2006.
- Nichol, Jim, *Central Asia's Security: Issues and Implications for US Interests*, Washington, CRS Report for Congress, 2010.
- Nygren, Bertil, *The Rebuilding of Greater Russia*, London, Routledge, 2008.
- Operation Enduring Freedom and the Conflict in Afghanistan: An Update*, Research Paper 01/81, House of Commons Library, October 2001.
- Trenin, Dmitri, "Russia-NATO relations: Time to pick up the pieces", *NATO Review* 49, Spring/Summer 2000.
- Weitz, Richard, "Renewing Central Asian Partnerships", *NATO Review*, no. 3, Autumn 2006.
- NATO website, [www.nato.int](http://www.nato.int).

**Dr. Klaus Wittmann<sup>1</sup>**

## KONFERENCA E RIGËS

Konferenca e Rigës është një forum i përvitshëm diskutimesh ndërkombëtare të nivelit të lartë mbi çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë, e cila mbahet që prej Samitit të Rigës së NATO-s të vitit 2006. Këtë vit kjo konferencë ka mbledhur disa nga studiuesit, akademikët, gazetarët dhe politikanët më të njohur për të diskutuar mbi sfidat më të rëndësishme në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe të çështjeve ndërkombëtare.

### **1. Një aleancë për shekullin e 21-të? Rishikimi i Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s**

Duket se Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, për të cilin u ra dakord në Samitin e Lisbonës në nëntor të 2010-s, ka shumë funksione për të përmbushur. Këto përfshijnë vetëkonfirmimin e një Aleance të Atlantikut të Veriut, rreth 60-vjeçare, një përkufizim bashkëkohor i qëllimit, karakterit dhe rolit të saj në shekullin XXI, ritheximi e ripërkushtimi prej të gjithë Aleatëve, përgjigjet ndaj sfidave të sotme dhe të ardhshme të sigurisë, pasjen e synimeve konkrete për një reformim të vazhdueshëm dhe mbledhjen e mbështetjes publike. Pyetja që shtrohet është: Sa i suksesshëm është koncepti i ri për përmbushjen e funksioneve të mësipërme?

### **Nevoja për një formulim të ri të misionit**

Traktati i Atlantikut të Veriut i vitit 1949, i cili është dokumenti themelor i NATO-s, konkretizohet në Konceptin e Ri Strategjik të Aleancës, i cili është rishikuar dhe përmirësuar vazhdimisht. Thelbi i Traktatit është ende i vlefshëm për sa i përket angazhimit të tij për

---

<sup>1</sup> Dr. *Klaus Wittman*, gjeneral brigade (në pension), në vjeshtë të vitit 2008, përfundoi 42 vite shërbimi në Forcat e Armatosura Gjermane (*Bundeswehr*). Gjatë detyrës së tij të fundit ai ka qenë Drejtor i Politikave dhe Planifikimit Akademik të Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s në Romë.

paqe ndërkombëtare, siguri dhe drejtësi, si edhe në lidhje me lirinë e popujve, trashëgiminë e përbashkët, principet demokratike dhe qytetarinë, të cilat janë ndërtuar e bazuar te principet e demokracisë, lirisë individuale dhe shtetit të së drejtës, te qëllimet dhe principet e OKB-së, dhe te zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, dispozitat kryesore të Traktatit të Uashingtonit përfshijnë: konsultimin (neni 4), ndihmën e përbashkët në rast sulmi të armatosur (neni 5) dhe hapjen ndaj anëtarëve të rinj (neni 10).

Koncepti i parë Strategjik u miratua në vitin 1991 (pas përfundimit të Luftës së Ftohtë) dhe u rishikua në vitin 1999. Megjithatë, edhe dokumenti i ri ishte paksa i vjetruar, duke qenë se kishte rënë dakord se përpara sulmeve terroriste të shtatorit 2011, përpara misionit të NATO-s në Afganistan, luftës në Irak, konfliktit Ruso-Gjeorgjian si edhe rritjes së ndërgjegjësimit për sfidat globale të sigurisë, për të cilat, zgjidhjet, tërësisht ushtarake, “nuk janë zgjidhje”. Kësisoj, shtrohej pyetja nëse NATO, e cila ka qenë shumë e suksesshme për mbrojtjen e Evropës Perëndimore gjatë konfliktit Lindje-Perëndim, për të kontribuar në stabilizimin e një “Evrope të bashkuar dhe të lirë” dhe për pajtimin e Ballkanit Perëndimor, do të zhvillohej në një Aleancë për shekullin e 21-të, si dhe çfarë kërkohej për këtë?

Për disa vite ka pasur hezitim të madh si në Zyrat Qendrore të NATO-s, ashtu edhe në kryeqytetet e vendeve anëtare për të rënë në një mendje për rishikimin e dokumentit të vitit 1999. Ndërsa ekzistonte frika për “një proces shumë përçarës” mbështetësit e Konceptit të Ri Strategjik e kundërshtuan këtë me argumentin se aleatët nuk kishin ndasi të mëdha për shumë çështje thelbësore që nevojitej urgjentisht “një përpjekje unifikuese”<sup>2</sup>. Për të dokumentuar rëndësinë e vazhdueshme të tij në mjedisin shpërndarës të sigurisë së shekullit të 21-të, ishte i domosdoshëm një formulim i ri dhe bindës i misionit.

## Një proces publik dhe me pjesëmarrje

Kjo është ideja të cilën NATO e shqyrtoi më së fundi gjatë punimeve të Samitit të 60-vjetorit të saj në Strasburg/Kehl në

<sup>2</sup> Klaus Wittmann, *Ein neues Strategisches Konzept*, In “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, 07.07. 2007, p. 9. Klaus Wittmann, *Towards a new Strategic Concept for NATO*. NATO Defense College, Rom, September 2009 (Forum Paper 10). Klaus Wittmann, *NATO's new Strategic Concept should be more than a "Shopping List"*. In “The European Security and Defence Union”, vol. 4/2009; p. 35-37. Shih gjithashtu: Klaus Wittmann, *NATO's new Strategic Concept, An Illustrative Draft*, Berlin, 2010.

prill të 2009-s, ku kryetarët e shteteve dhe kryeministrat ranë dakord për nevojën për hartimin e një Koncepti të Ri Strategjik. Sekretari i Përgjithshëm *Anders Fogh Rasmussen* zgjodhi një procedurë tërësisht të ndryshme nga mënyrat e zhvillimit të dy koncepteve strategjike të mëparshme. Këto procese karakterizoheshin nga negociata disavjeçare ndërmjet vendeve anëtarë për drafte të shumta që kundërshtonin njëra-tjetrën dhe larg vëmendjes së publikut të gjerë, të cilat kishin rezultuar në tekste të mbytur në: formula diplomatike, gjuhë kompromisi dhe “paqartësi konstruktive”.

Kësaj here duheshin marrë parasysh disa vështirësi specifike, si: së pari, angazhimi i NATO-s në një mision gjithnjë e më shumë problematik në Afganistan, ku ajo kishte mbetur me një sërë detyrash që i ishin caktuar nga komuniteti ndërkombëtar; së dyti, mosdëshira e shoqërive “post-heroike”, të lodhura nga kriza financiare dhe ekonomike që të sakrifikojnë sigurinë e tyre; së treti, mungesa e marrëveshjes ndërmjet anëtarëve të NATO-s mbi çështje thelbësore që i përkasin karakterit, rolit, detyrave dhe politikave; së katërti, përshtypja se solidariteti rreth aleatëve po dobësohej; së pesti, duke qenë se ka një aleancë me anëtarësi më të ndryshme, ekzistojnë perceptime të ndryshme të rrezikut mes aleatëve; së fundi, imazhi i NATO-s, sidomos në botën myslimane, si një instrument i politikës, shpesh problematike të ShBA-së, ose perceptimet që kanë popullsitë dhe media e vendeve anëtare të saj për të, si një relik i Luftës së Ftohtë.

Duke qenë se çështja e rëndësisë së vazhdueshme të NATO-s dhe mbështetja e saj nga publiku ishin kaq e rëndësishme, përgatitja e Konceptit të ri Strategjik, u iniciua nga Sekretari i Përgjithshëm, në një “përjasje përfshirëse dhe pjesëmarrëse” dhe në “dialog interaktiv me publikun e gjerë.” U formua një grup prej 12 ekspertësh, i cili nën udhëheqjen e ish-Sekretares Amerikane të Shtetit Madeleine Albright, pas një serie seminaresh dhe konsultimesh, paraqitën raportin e tyre në mes të majit 2010. Dokumenti “NATO 2020”. “Garantimi i Sigurisë dhe Angazhimi Dinamik” reflektoi të qenët në një mendje midis anëtarëve të grupit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se është arritur konsensusi ndërmjet 28 qeverive të NATO-s. Mund të argumentohet se puna për hartimin e draftit nuk krijon konsensus për çështjet e kontestuara. Megjithatë, koncepti duhet të reflektojë rindërtimin dhe rivendosjen e konsensusit për konsultimet politike.

Gjithsesi, duhet pranuar se “Grupi Albright” bëri një punë të mirë për “sheshimin e terrenit”, për përgatitjen e konsensusit, për nxitjen e debatit publik dhe të interesit të publikut për NATO-



n, për përfshirjen e komunitetit strategjik, për sigurimin e transparencës si edhe për të nxitur vendet anëtare që të qartësojnë pozicionet e tyre dhe të “tregojnë ngjyrat e letrave të tyre”. Sekretari i Përgjithshëm ndoshta kishte të drejtë që të mbante nën kontroll draftin e zhvilluar prej tij dhe prej bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë, duke pasur parasysh, ndërkohë, edhe komentet e vendeve të ndryshme, duke u konsultuar në mënyrë diskrete për çështjet përmbajtësose, duke evituar negociatat e drejtpërdrejta që krijojnë përplasje, duke shmangur përfshirjen e një sërë juristësh të burokracive të NATO-s si edhe duke eliminuar përsëritjet e tepërta që prodhojnë një tekst të shpëlarë.

Koncepti i Ri Strategjik u miratua më 19 nëntor 2010 në Samitin e NATO-s në Lisbonë nga kryetarët e shteteve dhe kryeministrat nën titullin “Përfshirje aktive, mbrojtja moderne”. Edhe pse është një dokument me 11 faqe (sa gjysma e madhësisë së paraardhësve të tij) dhe anashkalon një sërë ndasish të vazhdueshme, në tërësi ai mbetet një atribut i procedurës së zgjedhur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe i energjisë së tij politike. Analistët kanë thënë gjithnjë se procesi do të ishte po aq i rëndësishëm sa rezultati. Për më tepër, rëndësi të njëjtë me rezultatin ka edhe fakti se gjatë kësaj pune vendet anëtare të NATO-s, duket se kanë reflektuar politikën e tyre të sigurisë, interesat e tyre, prioritetet e tyre si edhe kërkesat për solidaritet brenda Aleancës. Kjo rezultoi në shumë “dokumente jozyrtare”, që parashtronin prioritetet kombëtare, shumë prej të cilëve kanë gjetur vend edhe në draftin final. Me pak fjalë, Koncepti i Ri Strategjik është një arritje e mirë, duke qenë se ai i mbledh aleatët së bashku, përtej qëllimit të NATO-s, duke i rizotuar ata për atë, si dhe për solidaritetin brenda Aleancës. Se sa solide është kjo do të diskutohet më poshtë.

### **Përmbajtje ambicioze**

Përmbajtja e dokumentit thekson tri “detyra kryesore”: *Mbrojtjen dhe sigurinë; sigurinë nëpërmjet menaxhimit të krizave dhe promovimin e sigurisë ndërkombëtare përmes bashkëpunimit.* Ato u vendosën nëpërmjet principesh të qëndrueshme, si: qëllimi i NATO-s për të mbrojtur lirinë dhe sigurinë e të gjithë anëtarëve të saj, karakteri i saj si një komunitet unik vlerash, konfirmimi i përgjegjësisë kryesore të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe rëndësia thelbësore e marrëdhënieve trans-Atlantike, politike dhe ushtarake në Evropë dhe në

Amerikën e Veriut. E gjithë kjo synon të ritheksojë se: “Aleanca mbetet një komunitet i pakrahasueshëm paqeje, sigurie dhe vlerash të përbashkëta”.

Në lidhje me Mbrojtjen Kolektive (*Collective Defence*), roli thelbësor i nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit (ndihma e përbashkët në rastin e një sulmi të armatosur) është ritheksuar sërish si një zotim “i qëndrueshëm dhe i detyrueshëm”. Ky fakt kishte rëndësi në kuadër të shqetësimeve të shprehura, sidomos prej aleatëve të rinj, se ky zotim do të dobësohej ose do të merrej më pak seriozisht nga anëtarët e NATO-s, të cilët, “të rrethuar nga miq dhe aleatë”, mund të vendosnin në plan të parë operacionet jashtë vendit dhe harmonizimin me Rusinë. Gjatë një procesi të gjatë diskutimesh, ritheksimi nga të gjithë vendet anëtarë të NATO-s, i këtij fakti, u perceptua si një parakusht për çdo aktivitet tjetër të NATO-s. Prandaj është domethënës fakti se Koncepti i Ri Strategjik premtan që “të kryejë trajnimet, stërvitjet, planifikimin e emergjencave dhe shkëmbimin e informacionit që nevojitet për të siguruar mbrojtjen tonë kundër një sërë sfidash konvencionale dhe në zhvillim të sigurisë, si dhe të mundësojë ritheksimin dhe përforcimin e nevojshëm të këtij fakti për këtë, për të gjithë aleatët”.

Duke mos e fokusuar tërësisht këtë detyrë vetëm te mbrojtja territoriale e anëtarëve të NATO-s (zona Euro-Atlantike është në paqe, dhe rreziku për ndonjë sulm konvencional ndaj saj është i ulët) seksioni në fjalë shpalos gamën aktuale dhe të ardhshme të sfidave të sigurisë që përfshijnë përhapjen e armëve bërthamore dhe të armëve të shkatërrimit në masë, raketat balistike, sulmet kibernetike, terrorizmi ndërkombëtar, rreziqet për infrastrukturën energjetike thelbësore dhe teknologjitë në zhvillim. Të gjitha këto janë parë si fusha të solidaritetit të Aleancës, pa nënkuptuar se ato mund të përballohen kryesisht me mjete ushtarake apo në kuadër të detyrimeve që burojnë nga neni 5. Pra, vlerësimi i kërcënimeve është shumë i gjerë, sfidat e sigurisë perceptohen si të përhapura, të ndryshueshme dhe të paparashikueshme, dhe për ndërhyrjet e mundshme të NATO-s duhet vendosur rast pas rasti. Megjithatë, referenca që i bëhet ndryshimeve klimaterike, pasojat afatgjata të të cilave mund të kenë implikacione të mëdha për sigurinë globale është shumë e vagët.

Koncepti i Ri Strategjik nuk **prioritizon** (i jep përparësi) detyrave për mbrojtjen dhe për menaxhimin e krizave. Duke pranuar se krizat dhe konfliktet përtej kufijve të NATO-s mund të ndikojnë në sigurinë e Aleancës. Koncepti i Ri Strategjik thekson si angazhime të domosdoshme të NATO-s si parandalimin dhe

menaxhimin e krizave, ashtu edhe stabilizimin e situatave postkonfliktuale dhe mbështetjen për rindërtim. Monitorimi dhe analizimi i mjedisit ndërkombëtar janë kontribuues të rëndësishëm për parandalimin, i cili bën thirrje për konsultime politike më të gjera dhe më intensive ndërmjet Aleatëve dhe partnerëve për “të trajtuar të gjitha fazat e një krize”.

Megjithatë, pohimi se “NATO do të jetë e përgatitur dhe e aftë të menaxhojë armiqësitë e vazhdueshme” është paksa i ekzagjeruar, duke pasur parasysh përvojën aktuale në Afganistan. Një mësim i qartë që del nga kjo, është nevoja për një qasje të qartë ushtarake, politike dhe civile në mënyrë që ajo të forcohet. Pas debateve të shumta kundërshtuese, u vendos se NATO do të krijonte “një menaxhim të kapaciteteve civile modeste, por efikase” si një “ndërveprim” me partnerët civilë. Me të drejtë është theksuar edhe trajnimi i forcave lokale të sigurisë.

Zakonisht, zhvillimi në detaje i detyrës së tretë kryesore (“promovimit të sigurisë ndërkombëtare nëpërmjet bashkëpunimit”) fillon me kontrollin e armatimeve, por zotimi i saj “për të krijuar kushtet për një botë pa armë bërthamore” kufizohet te qëllimet e Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore. Reduktimi i mëtejshëm i armëve bërthamore lidhet edhe me hapat e ndërmarrë nga Rusia. Për sa i përket kontrollit të armëve konvencionale, formula “për të forcuar regjimin e kontrollit të armëve konvencionale në Evropë” është mjaft e vagët dhe nuk përmban idetë e nevojshme novatore.

Për sa i përket institucioneve që lidhen me sigurinë, përmendet vetëm Organizata e Kombeve të Bashkuara (në kuadër të hartimit të Deklaratës OKB-NATO, 2008) dhe Bashkimi Evropian. Gjithashtu, një pjesë e veçantë i kushtohet marrëdhënies me BE-në. Por, për sa kohë ky bashkëpunim është bllokuar për arsye politike, zotimet mbeten thjesht në kuadrin e fjalëve.

Samiti i Lisbonës u interpretua gjerësisht si një përparim i NATO-s në bashkëpunimin me Rusinë, por edhe si një kontribut për “krijimin e një hapësire të përbashkët paqeje, stabiliteti dhe sigurie”. NATO, duke mos përbërë një kërcënim për Rusinë, është duke kërkuar “një partneritet strategjik”, duke pritur bashkëpunim reciprok nga Rusia. Të bindur se “siguria e NATO-s dhe Rusisë është e ndërthurur”, NATO propozon zgjerimin e konsultimeve politike dhe bashkëveprimit praktik në fushat e interesit të përbashkët, si: mbrojtja nga raketat, masat kundër terrorizmit, sanksionet kundër narkotikëve, lufta kundër piraterisë, si edhe përdorimi i të gjithë potencialit për dialog në kuadër të Këshillit NATO-Rusi dhe ndërmarrja e veprimeve të përbashkëta.

Gjithashtu një dakordësi e kujdesshme “për të eksploruar” çështjen e bashkëpunimit për mbrojtjen ndaj raketave, nga presidenti i Rusisë, i cili ishte prezent në Lisbonë, u konsiderua si një përparësi e rëndësishme në këtë drejtim. Në vijim, NATO nuk e mbivlerësoi politikën e saj të “dyerve të hapura” duke u limituar në shprehjen e në Konceptin Strategjik, vetëm në deklarime konvencionale dhe në parim.

Së fundi, lidhur me “Reformën dhe Transformimin”, Koncepti thekson qëllimet e sipërpërmendura: burimet e mjaftueshme, aftësitë dislokuese dhe qëndrueshmërinë e forcave, planifikimin koherent të mbrojtjes, ndërveprueshmërinë si edhe ngjashmërinë e kapaciteteve, standardeve, strukturave dhe financimit. Gjithashtu, u premtua edhe njëherë për një reformë të vazhdueshme, “për modernizimin e strukturave për të përmirësuar metodat e punës dhe për të maksimizuar efektivitetin”.

### **Një dokument i guximshëm**

Koncepti i Ri Strategjik është një dokument i guximshëm, sepse vë në kontrast *Zeitgeist*-in në disa aspekte. Së pari, pavarësisht nga vizioni për një botë pa armë bërthamore, ai thekson nevojën për përmbajtjen e potencialit bërthamor, për sa kohë ato ekzistojnë. Së dyti, edhe pse shumë sfida të sigurisë globale nuk kanë profil të theksuar ushtarak, NATO zgjeron ambicinet e saj si ofrues sigurie. Së treti, ndërsa mbetet një organizatë rajonale, ajo shmang një perspektivë tërësisht eurocentrike, duke parë drejt një horizonti global. Së katërti, pavarësisht problemeve të fundit me procesin e zgjerimit dhe indinjimit të Rusisë, Aleanca mban politikën e “dyerve të hapura” për vendet evropiane, të aftë të anëtarësohen dhe të japin kontributin e tyre për sigurinë evropiane. Së fundi, pa antagonizuar me Rusinë, ajo merr seriozisht shqetësimet e aleatëve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Zhvillimi i Konceptit të Ri Strategjik nuk ngjasonte me eksperiencën e përgjithshme në kuptimin që zakonisht këto dokumente themeltarë nuk janë vizionarë dhe largpamës. Ato priren të jenë më tepër një kodifikim i vendimeve të mëparshme. Teorikisht theksohet se ngjarjet dhe konceptet përshtaten me realitetin. Kështu ndodhi edhe me Konceptin Strategjik të vitit 1999, ndërsa dokumenti i vitit 1991 përbënte përjashtim për shkak të situatave të reja dhe revolucionare. Është meritë e Grupit të Ekspertëve dhe Sekretarit të Përgjithshëm që Koncepti

Strategjik i Lisbonës është shumë pragmatist dhe i orientuar drejt së ardhmes.

### **Jo gjithçka që shkëlqen është flori**

Gjithashtu mund të ishin shmangur një numër i vogël, por jo i parëndësishëm gabimesh. Zgjerimi i përdorimit të termit “partneritet”, duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave ndërkombëtare (për shembull OKB-në dhe BE-në), zbehin dhe zhvleftësojnë konceptin e suksesshëm të NATO-s për “Partneritetin” (me P të madhe). Gjithashtu, në një kohë kur parandalimi i konfliktit duket gjithnjë e më i rëndësishëm, është vështirë të kuptohet se përse Koncepti i Ri Strategjik nuk përmend as OSBE-në, e për të mos folur pastaj për Unionin Afrikan. Për më tepër, megjithëse qëndrimi i vendosur për armët bërthamore është për t’u lavdëruar, karakterizimi i NATO-s si një “aleancë bërthamore” është i ekzagjeruar dhe mund të jetë joproduktiv. Përveç kësaj, dokumenti pasqyron dobët mësimet e nxjerra nga misioni në Afganistan (që kanë të bëjnë me komunitetin e gjerë ndërkombëtar) si edhe nuk përmend mësimet e brendshme për komandën dhe kontrollin, koordinimin, multinacionalitetin, ndasitë kombëtare etj. Së fundi, duke pasur parasysh se përfshirja më e gjerë e NATO-s në sfidat globale të sigurisë, që theksohet në Konceptin Strategjik, do të duhet të ndodhë duke përdorur rigorozisht nenin 4 të Traktatit të Uashingtonit (konsultimin), do të kishte qenë e logjikshme që tri detyrave të mësipërme (mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave, sigurisë bashkëpunuese) t’i shtohet si “një detyrë e katërt thelbësore” edhe “konsultimi”.

Për më tepër duhet theksuar se teksti elegant fsheh faktin që nuk ka një unitet vërtet solid për një numër çështjesh, si për shembull: nëse NATO është një organizatë rajonale apo globale, natyrën politike dhe ushtarake, balancën ndërmjet mbrojtjes kolektive dhe vendosjes së operacioneve ushtarake jashtë vendit, vlerësimin e disa sfidave të sigurisë dhe theksin në pikëpamjet individuale të disa aleatëve, marrëdhënien NATO-BE dhe bllokimin politik të saj, çështjet e mandateve të OKB-s, përqasjen ndaj Ruisë, politikat për armët bërthamore etj. Në disa nga këto fusha, konsensusi verbal mund të shkatërrohet nën dritën e detyrave konkrete, kërkesave dhe sfidave.

Për sa i përket shtrirjes dhe karakterit të NATO-s, Koncepti Strategjik lë të kuptohet se ajo vazhdon ta konsiderojë veten si një organizatë rajonale, por me perspektivë globale, e cila

përqendrohet te konsultimet ndërmjet Aleatëve, siç theksohet edhe në nenin 4 të Traktatit të Uashingtonit. Për më tepër, debati i përhershëm nëse NATO është një organizatë ushtarake apo politike, duhet më së paku të përfundojë. Ajo është një organizatë politiko-ushtarake e sigurisë që vë kapacitetet e saj unike në shërbim të sigurisë ndërkombëtare. Kapacitetet e saj janë forcat e saj ushtarake, struktura e integruar e komandimit, mbrojtja e përbashkët dhe planifikimi i forcës, eksperiencia e saj në bashkëpunimin ushtarak shumëkombësh dhe ekspertiza në trajnime. Por perceptimi i saj si një “nyje lidhëse” e sistemit ndërkombëtar do të ishte joproductive, dhe vendi i saj në këtë sistem duket se ka nevojë për t’u sqaruar më mirë.

### **Detyra e vërtetë: Zbatimi**

Koncepti i Ri Strategjik do të jetë i mirë në vartësi të nivelit të zbatimit. Në Deklaratën e Samitit të Lisbonës kjo theksohet së bashku me një sërë detyrash urgjente për ministrat e Jashtëm dhe ata të Mbrojtjes, si edhe për Këshillin e Përhershëm. Koncepti i Ri Strategjik duhet të lexohet së bashku me Deklaratën e Samitit dhe, për sa i përket tematikës në fjalë, me deklaratën e përbashkët të Këshillit NATO-Rusi.

Në mënyrë ekzemplare, zbatimi i principeve dhe qëllimeve është kryesor në fushat vijuese (në disa çështje kjo kërkon gjithashtu më shumë punë konceptuale):

Në lidhje me detyrën e parë kryesore, përmbajtjen dhe mbrojtjen, nevojitet një përcaktim i termit vlerë e shtuar, i cili mund të ofrohet nga NATO për sa i përket luftës kundër sfidave “të reja” të sigurisë, për të cilat është rënë dakord se forca ushtarake nuk është e mjaftueshme, si: terrorizmi, rreziqet kibernetike, siguria e energjisë, pirateria, krimi i organizuar dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Nuk përbën sekret se vazhdon të ketë ndasi të mëdha ndërmjet Aleatëve për rolin e NATO-s dhe funksionit të ushtrisë në këto fusha. Lidhur me “sigurimin e të gjithë Aleatëve”, mbetet për t’u parë se deri në çfarë niveli do të zbatohen masat parapërgatitore dhe planet e emergjencës, dhe se sa të dukshme (dhe si rrjedhojë efikase) do të jenë ato. Aktualisht, publikimi nga *Wikileaks* i dokumenteve mbi planet e emergjencës për mbrojtjen e Polonisë dhe të vendeve Baltike shkaktoi protestë nga Ambasadori i Rusisë në NATO.

Ky është një nga aspektet ku marrëdhënia me Rusinë duket delikate. Interpretimi optimist i Samitit NATO-Rusi në Lisbonë del nga “arritja” për çështjen e mbrojtjes nga raketat (megjithëse

marrëveshja “për të diskutuar ndërmarrjen e bashkëpunimit për mbrojtjen nga raketat” duket një hap mjaft i kujdesshëm) si edhe nga planet për të pasur bashkëpunim konkret në një sërë fushash praktike, duke përfshirë “Rishikimin e Përbashkët të “Sfidave të Përbashkëta të Sigurisë të Shekullit të 21-të” si dhe një deklaratë mjaft pozitive për qëllimin e përdorimit të mëtejshëm të Këshillit NATO-Rusi.

A është kjo e mjaftueshme dhe e qëndrueshme? Autori ka menduar për një kohë të gjatë që “rivendosja” e marrëdhënieve me Rusinë është një metaforë e keqe. Ajo që nevojitet nuk është vetëm një fillim i ri, por gjithashtu edhe një “program” i përmirësuar që do të përfshinte njohjen e qartë të pjesës së saj të përgjegjësive nga ana e NATO-s për përkeqësimin e marrëdhënieve me Rusinë. Aleanca ka një perceptim të dobët të psikologjisë ruse dhe frikës së saj ndaj marginalizimit, ka organizuar keq shtytjen më të fundit për zgjerim, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur propozimeve ruse për miratimin e TPE-së, ka dështuar për të prezantuar çështjen e mbrojtjes ndaj raketave si një shqetësim të përbashkët dhe nuk ka kontribuar mjaftueshëm për një përdorim optimal të NRC-së sidomos kur kjo e fundit nevojitet në kontekstin e konfliktit gjergjjan.

Nga ana tjetër, Rusia duhet të mos e perceptojë më NATO-n si “rrezik” ose edhe si “kërcënim”, dhe të mos synojë kufizimin ose ndarjen e saj, të ndajë të njëjtat vlera me të, të respektojë principet e Kartës së Parisit, të kapërcejë kategorizimin e vjetër të strategjive gjeopolitike dhe gjeostrategjike, të heqë dorë nga klishe të Luftës së Ftohtë në lidhje me NATO-n, të heqë dorë nga ideja e pasjes së “një sfere të veçantë influence”, të mos instrumentalizojë “rusët jashtë vendit”, të lërë mënjane revizionimin dhe të ofrojë mbështetje të plotë për sovranitetin dhe pavarësinë e fqinjëve të saj, të kontribuojë vetë për “sigurinë” e tyre, të përqafojë plotësisht sigurinë bashkëpunuese (përkundrejt asaj konfrontuese), të vijojë hapat e parë pozitivë të “historisë së politikës së saj” kundrejt Polonisë (dhe në të ardhmen edhe me të tjerët) dhe të kuptojë se Rusia, kësaj, vetëm mund të “izolojë” vetveten. Së bashku, NATO-ja dhe Rusia, duhet të tejkalojnë të menduarit se ka vetëm një fitues gjatë diskutimeve për politikën e sigurisë, sipas të cilit njëra palë përfiton në kurriz të të tjerëve. Përveç kësaj, NATO duhet të kishte dhënë tashmë një përgjigje substanciale ndaj propozimeve të Medvedevit, duke pasur parasysh faktin se vendi i Rusisë në rendin e sigurisë evropiane ende nuk është përcaktuar mjaftueshëm.

Për sa i përket politikës së armëve bërthamore është e qartë se përgjegjësitë e përfshira në deklaratën e Samitit “për rishikimin

e sjelljes së NATO-s” tregojnë nevojën për një debat thelbësor për rolin e armëve bërthamore, zgjerimin e përmbajtjes së tyre si dhe çuarjes përpara të lëvizjes nga “frenimi nëpërmjet ndëshkimit” drejt një “frenimi nëpërmjet mohimit” të alternativave dhe, për të ardhmen, e “pjesës përkatëse të potencialit bërthamor”. Detyrat e mbetura për NATO-n dhe qeveritë e vendeve të saj anëtare janë pajtimi i pritshmërive të publikut për “zeron globale” (*ang. global zero*) me shpjegimin e kërkesave për parandalim gjatë periudhës (të perceptuar si mjaft të gjatë) të tranzicionit. Aktualisht, gjithnjë e më dukshëm, debati për një botë pa armë bërthamore ka qenë deri tani një monolog perëndimor.

Kontrollit të armëve konvencionale i jepet rëndësi në Konceptin Strategjik dhe Deklarata e Samitit përfshin gjithashtu një rivitalizim të Taks Forcës së Nivelit të Lartë (TNL), e cila ka shoqëruar negociatat për Forcat Konvencionale në Evropë (FKE) në vitet 1990. Por, megjithatë, nuk ka ide të reja dhe “puna për forcimin e regjimit të kontrollit të armëve konvencionale në Evropë” nuk është e mjaftueshme. Traktati për FKE-të, i cili u pezullua nga Rusia ende nuk ka dështuar, ndërkohë që instrumentet e tij për ndërtimin e konfidencës, verifikimin dhe transparencën po shpërbëhen.

Prandaj nevojitet një fillim i ri për kontrollin e armëve konvencionale, çka do të thotë bisedime të gjera ndërmjet të gjithë shteteve evropiane (me shumë gjasa duke përfshirë edhe Rusinë) për forcat ushtarake konvencionale, lidhjen e tyre potenciale me armët bërthamore taktike, perceptimet për kërcënimet, doktrinën, nivelin e forcës, sasinë e armatimeve (duke çuar në negociata për kufizimin e numrit të tyre), kufizimet rajonale dhe masat për transparencë. Një përjasje e tillë e re do të rriste besimin në orientimin tërësisht drejt mbrojtjes të arsenalit ushtarak, do të avanconte sigurinë nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet vendeve evropiane si edhe mund të mbështesë çarmatimin bërthamor dhe bashkëpunimin për mbrojtjen nga raketat.

Duke qenë se sfidat e reja të sigurisë nuk kërkojnë një përgjigje thjesht ushtarake, NATO nuk është i vetmi aktor dhe solidariteti i Aleancës në këtë fushë nuk kërkon domosdoshmërisht “zgjerimin dhe intensifikimin” e përdorimit të nenit 5. Konsultimet, siç theksohet nga Koncepti i Ri Strategjik, janë thelbësore në këtë rast. Por a është kuptuar se kjo nënkupton një ndryshim të mirëfilltë kulturor në NATO? Deri tani shumë çështje të sigurisë nuk kanë arritur në tavolinën e Këshillit për shkak të frikës se mosmarrëveshjet do të interpretohen si një krizë e brendshme. Gjithashtu, për të arritur një përmirësim



cilësor të konsultimeve, nevojitet një analizë shumë më e përmirësuar dhe një vlerësim kapacitetesh në Komandën e NATO-s. Kjo duket së është bërë e njohur me anë të krijimit brenda Shtabit Ndërkombëtar të një “Divizioni për Sfidat e Sigurisë në Zhvillim”. Megjithatë, mbetet ende për t’u parë se sa do të kontribuojë kjo për të prodhuar një analizë politiko-ushtarake të vlefshme, ose për të trajtuar çështjet përkatëse (duke përfshirë pasojat afatgjata të ndryshimeve klimatike) dhe nëse kjo do të mund të kontribuojë për një zgjerim të qëndrueshëm të agjendës së Këshillit.

Detyra për të zhvilluar “një politikë partneriteti më fleksibël dhe më efikase” është e gjerë dhe duhet të përfshijë edhe rishikimin e dokumentit themelues të Partneritetit për Paqe. Njëri prej qëllimeve të kësaj detyre duhet të jetë forcimi i klauzolës së konsultimeve për rastet kur partnerët perceptojnë rreziqe ndaj sigurisë së tyre. Mbetet një pyetje e hapur, nëse NATO do të arrijë përmirësimin e funksionimit të Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA), i cili nuk ka pasur asnjë rol gjatë muajve që paraprinë konfliktin ndërmjet Rusisë dhe Gjeorgjisë në gusht të vitit 2008. Lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit “global” me vendet që ndajnë të njëjtat mendime ose me ata të cilët kanë kontribuar në misionin në Afganistan, kërkohet një transparencë më e madhe kundrejt fuqive si India dhe Kina.

Siç theksohet dhe më sipër, është e habitshme se në kohën që parandalimi i krizës po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe, Koncepti Strategjik nuk e përmend OSBE-në. Është e vërtetë se Samiti i saj i Astanasë nuk ishte i suksesshëm, por, megjithatë, ende mbetet nevoja për të forcuar potencialet dhe instrumentet e kësaj organizate; për të bashkuar forcat me theksin që OSBE-ja vendos te disa çështje të “sigurisë së butë”, si: të drejtat e njeriut, ndërtimi i besimit dhe paralajmërimet e hershme; si edhe (duke qenë se gati të gjithë Aleatët janë anëtarë të OSBE-së) për të bashkuar përpjekjet për një menaxhim më të mirë të krizave dhe parandalimin e konflikteve të dhunshme. Gjithashtu, Unioni Afrikan, i cili përfaqëson qasjen e vendeve të Afrikës për të marrë përsipër pronësinë e problemeve të tyre, meriton të gjithë mbështetjen e mundshme nga NATO, jo vetëm me anë operacionesh konkrete, por gjithashtu edhe me eksperiencën e pasur të Aleancës në fusha, si: konsultimi, bashkëpunimi civilo-ushtarak, edukimi dhe trajnimi, reformat në sektorin e sigurisë, planifikimin e forcave, kontrollin e armëve dhe ndërtimin e besimit.

Megjithatë, një hapësirë e konsiderueshme i është përkushtuar Bashkimit Evropian dhe Politikës së tij të Përbashkët

të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PPMS) si një plotësues i rëndësishëm i NATO-s, duke lejuar që vendet evropiane të marrin më shumë përgjegjësi për sigurinë dhe stabilitetin e kontinentit të tyre dhe të periferisë së tij. Pavarësisht kësaj, deklaratat për një partneritet më të fortë strategjik, për zgjerimin e bashkëpunimit praktik, për thellimin e konsultimeve politike dhe për një bashkëpunim më të plotë në zhvillimin e kapaciteteve, mbetet e vagët për sa kohë që bashkëpunimi ende bllokohet nga Aleatë individualë. Suksesi për përpjekjet e reja nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nga Përfaqësuesi i Lartë që do të raportohet përpara ministrave në prill, është thelbësor për çdo progres.

Së fundi, bashkëpunimi me OKB-në, i cili është thujtë i kënaqshëm për sa i përket misionëve të huaja, kërkon rritjen e konsultimeve në nivelin politik dhe strategjik. Deklarata OKB-NATO, e cila u nënshkrua në vitin 2008, duhet të bërë funksionale. Procedurat e ndërlydhjes dhe praktikat e konsultimeve efektive janë të nevojshme. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Paqes duhet të jetë vendi për bashkëpunimin institucional. Mbetet për t'u parë sesa shpejt këto qëllime të mira do të kapërcejnë mosbesimin mbizotërues kundrejt NATO-s në Kampin Lindor.

Më shumë se çdo lloj konceptualizimi të mëtejshëm, qasja gjithëpërfshirëse kërkon ushtrimin e një bindjeje të dukshme dhe një zbatim më të mirë. Nevojitet njohja e faktit se misionë si ai në Afganistan nuk mund të përmbushin qëllimet e tyre vetëm me përpjekje ushtarake dhe se, përveç karakterit të tyre të përbashkët ndërqeveritar dhe ndëragjencial, ato kërkojnë një bashkëpunim sinergjik të ngushtë me organizatat ndër-qeveritare (ONQ) dhe organizatat joqeveritare (OJQ). Kjo nuk ka të bëjë me hierarkinë. NATO nuk duhet të aspirojë një pozicion mbizotërues ose të dojë të koordinojë të tjerët, por ajo duhet të koordinohet me ta. Duke pasur parasysh se koncepti është vetvetiu i qartë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të bërë që ai të funksionojë si një përpjekje tërësisht e integruar civilo-ushtarake, duke anashkaluar interesat, ndasitë kombëtare dhe ato institucionale. Është thelbësor përmirësimi i ndërveprimit të NATO-s me OJQ-të, por kjo sjell takimin e kulturave institucionale të ndryshme, dhe shpesh "të kundërta", ku ushtarakët duan të kenë kontroll, ndërsa OJF-të përpiqen të ruajnë pavarësinë dhe paanshmërinë si faktorë kryesorë për të pasur sukses. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për një mirëkuptim të ndërsjellë nëpërmjet dialogut si edhe për planifikimin e përbashkët dhe trajnimet.

Në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të NATO-s, Koncepti Strategjik, Deklarata e Samitit dhe “Objektivat për Kapacitetet të Lisbonës” nuk përmbajnë më shumë sesa qëllimet e dukshme (përdorueshmëria, dislokueshmëria, qëndrueshmëria etj.) të njohura edhe nga Nisma për Kapacitet e Mbrojtjes (NKM) në vitin 1999, Angazhimi për Kapacitetet i Pragës (AKP) i vitit 2002 si edhe nga Udhëzuesi Gjithëpërfshirës Politik i vitit 2006. Të gjitha këto dhanë rezultate të kufizuara, dhe (me krizën financiare dhe ekonomike, me shkurtimet drastike që rezultojnë në shumë buxhete të vendeve për mbrojtjen) është e vështirë të shihet se si boshllëku ndërmjet ambicieve dhe mënyrave do të mund të tejkalohet më mirë nga sa është bërë deri më tani. Gjithashtu nevojitet rritja e zhvillimit të përbashkët të kapaciteteve ushtarake dhe të qasjeve ndërkombëtare me kosto efikase.

Në fushën e mbrojtjes nga raketat, përveç ringjalljes së parashikuar të mosmarrëveshjeve ndërmjet aleatëve dhe mosbesimit të Rusisë, kostoja mund të bëhet një faktor pengues për zbatimin pa probleme të një përmirësimi rrënjësor të kapaciteteve mbrojtëse të NATO-s.

Për reformën e brendshme të NATO-s, Koncepti Strategjik dhe Deklarata e Samitit i mundësojnë Sekretarit të Përgjithshëm një mandat më të gjerë dhe autoritet më të madh “për ristrukturimin e strukturave, përmirësimin e metodave të punës dhe maksimizimin e efikasitetit”. Gjithashtu, zbatimi do të jetë testimi kryesor për “reformimin e vazhdueshëm” të NATO-s. Kjo po zbulon se Deklarata (në kontekstin e Strukturës së Komandës dhe Reformës së Agjencive) i referohet dy herë vendimeve të shkëlqyera rreth “shtrirjes gjeografike”, që nuk nënkuptojnë asgjë tjetër përveçse interesat e forta të vendeve individuale për mbajtjen në territorin e tyre të komandave të NATO-s, instalimeve dhe institucioneve të saj.

Ekzistojnë edhe shumë fusha të tjera ku do të ishte me interes të shikohej hapi dhe niveli i zbatimit të Konceptit të Ri Strategjik (ose ku siç u theksua më sipër, nevojitet më shumë punë konceptuale). Përveç atyre që u diskutuan këtu, këto fusha përfshijnë mësimet e nxjerra nga veprimet dhe udhëzuesit për veprime të mëtejshme; përshtatshmërinë për nivelin e ambicieve të NATO-s (NA); kundërrebelimin në kontekstin e NATO-s, progresin me Forcat e Reagimit të NATO-s (FRN); vlerësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shumëkombshëm; ndihmën për trajnime dhe kontributin e NATO-s për DDR-në dhe RSS-në; rolin e NATO-s në mospërhapjen e armëve bërthamore dhe diplomacinë publike.

Gjithashtu ekziston hapësira për një studim të veçantë dhe për formulimin e pozicioneve të përbashkëta të Aleancës, si:

zhvillimet në ligjin ndërkombëtar për sa i përket mbrojtjes nën dritën e sulmeve të mundshme apokaliptike pa paralajmërim; “Përgjegjësia për Mbrojtje” në raste gjenocidi dhe dhunimi masiv të të drejtave të njeriut; probleme të “ndërhyrjes humanitare”; implikacionet e “shteteve të dështuara”; zhvillimi i mëtejshëm i një doktrine parandaluese të besueshme për një botë multipolare me një numër të madh aktorësh shtetërorë dhe joshtetërorë.

## Konkluzione

Pa e anashkaluar vështrimin kritik mbi atë se “Çfarë kupton dhe nënkupton?” Koncepti i Ri Strategjik i Aleancës përbën një rast të mirë për relevancën e NATO-s në shekullin e 21-të. Pas procesit të mahnitshëm të përshtatjes nëpërmjet të cilit ka kaluar kjo Aleancë e Luftës së Ftohtë, pas përfundimit të ndarjes Lindje-Perëndim, kjo fazë shënon një tjetër hap të rëndësishëm transformues nga ana programatike. Tani aleatët duhet të tregojnë vullnetin politik dhe të sigurojnë burimet për zbatimin e asaj që ata deklaruan plot kurajë.

“Pas Samitit është njësoj si përpara Samitit”.

## Bibliografi

- Klaus Wittmann, Ein neues Strategisches Konzept, in “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, 07.07. 2007.*
- Klaus Wittmann, Towards a new Strategic Concept for NATO, NATO Defense College, Rome, September 2009.*
- Klaus Wittmann, NATO’s new Strategic Concept should be more than a “Shopping List”, in “The European Security and Defence Union”, vol. 4/2009; p. 35-37.*
- Klaus Wittmann, NATO’s new Strategic Concept, An Illustrative Draft, Berlin, 2010.*
- Ronald Asmus, Stefan Czumur, Chris Donnelly, Aivis Ronis, Tomas Valasek, Klaus Wittmann, NATO, new allies and reassurance, Policy Brief, London, Centre for European Reform, May 2010.

## Pëteris Veits<sup>3</sup>

### 1. Sfidat e Afganistanit në vitin 2014

NATO ka vendosur më në fund një lloj afati për përfundimin e operacioneve në Afganistan (deri në vitin 2014). Pas kësaj, fokusi kryesor i ndihmës ndërkombëtare do të shtrihet në angazhimin “civil” për ndërtimin e kapaciteteve qeverisëse dhe të rindërtimi. Por ekziston pyetja nëse nxjerrja nga fshehtësia e civilëve do të përbënte ilaçin magjik për të gjitha sëmundjet e Afganistanit të sotëm? Në fund të fundit, vetë këto përpjekje në fushën civile janë ndërmarrë edhe përpara fillimit të luftës aktuale. Vetëm se ato nuk kanë shënuar ndonjë sukses. Për më tepër nëse nuk mbahen parasysh disa mësimet serioze dhe nëse nuk ndërmerren ndryshimet e nevojshme ka shumë pak shpresa edhe për suksesin e tyre aktual.

Gjatë shekullit të 20-të, forcat ndërkombëtare kanë dështuar vazhdimisht në përpjekjet për të lehtësuar stabilizimin e Afganistanit në të gjitha rastet kur janë paraqitur mundësitë më të mira për këtë. Duke kuptuar se është e pamundur të dominosh vendin, lojtarët e përfshirë nuk kanë pasur asnjëherë interes të mjaftueshëm për stabilizimin e tij. Megjithatë, kjo injorancë, ka shkaktuar vazhdimisht efektin *boomerang*, duke riangazhuar aktorët ndërkombëtarë në periudha të mëvonshme dhe nëpërmjet mënyrash me kosto më të lartë për të dyja palët, si për forcat ndërkombëtare ashtu edhe për afganët.

Shtetet e Bashkuara dhe Anglia dështuan për mbështetjen e reformave të mbretit Amanullah në 1920-ën. Shtetet e Bashkuara përsëritën të njëjtin gabim në vitin 1950 duke mos përfillur kërkesat për bashkëpunimin nga kryeministri Dadu dhe vizionin e tij për modernizimin e Afganistanit. Si rezultat, Afganistani u zhyt nën influencën sovjetike. Më vonë, komuniteti ndërkombëtar dështoi për përfshirjen dhe për menaxhimin efektiv të kaosit që pasoi luftën Sovjeto-Afgane në vitin 1990.

---

<sup>3</sup> Pëteris Veits zotëron një diplomë Masteri për Administrim Biznesi dhe një diplomë *Bachelor* në Shkencat Politike. Ai ka 7 vjet eksperiencë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, kryesisht lidhur me politikën e sigurisë dhe misionet e menaxhimit të krizave, duke përfshirë edhe zhvillimin në terren të punës për asistencë në Afganistan. Së fundi, ai ka marrë pjesë edhe në misionet e BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve në Afganistan dhe Sudan.

Në fillim të ndërhyrjes aktuale si Anglia, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara, u zotuan se nuk do të linin Afganistanin të rrënohej përsëri<sup>4</sup>. A mundet që komuniteti ndërkombëtar t'i lejojë vetes të kundërtën?

Në këtë ese do të reflektohet se çfarë është gabuar gjatë përpjekjeve të mëparshme për asistencë civile (çështjet e angazhimit të pamjaftueshëm strategjik dhe mungesa e strukturave të përshtatshme zbatuese) që rezultuan në centralizim të tepruar dhe koordinim të pamjaftueshëm të reformave. Për shkak të këtij fakti dhe të përkeqësimit të situatës së sigurisë, kalimi nga një ndërhyrje ndërkombëtare tërësisht ushtarake në një angazhim ndërkombëtar tërësisht civil, i cili mbart rreziqe të larta për të ardhmen e afërt sepse ngjason me një ikje. Pasojat potenciale të tërheqjes aktuale diskutohen në pjesën e dytë të kësaj eseje. Prandaj njohja e gabimeve të mëparshme dhe strategjitë që orientohen drejt angazhimit të vazhdueshëm në Afganistan, për të balancuar sigurinë dhe zhvillimin e qeverisjes, duket se janë mënyra më pak e kushtueshme për perspektivën afatgjatë.

### **Qeverisja, rindërtimi dhe zhvillimi: ku është gabuar?**

Duket se të kuptuarit e asaj që duhet bërë për të zhvilluar institucione që mirëfunksionojnë, dhe infrastrukturën bazë për një strategji dalëse të suksesshme në Afganistan, është duke u diskutuar që prej fillimit të konfliktit. Të njëjtat çështje si edhe sot janë diskutuar edhe katër vjet më parë dhe gjithashtu edhe më herët. Megjithatë, këto detyra nuk u formuluan asnjëherë qartë dhe nuk u zbatuan si duhet.

Nëse hedhim një vështrim te shtyllat kryesore të misionit të ISAF-it, duket se sigurisë i është kushtuar një vëmendje më e madhe nga Aleatët. Megjithatë ajo nuk mund të jetë e qëndrueshme pa një prani të konsiderueshme trupash ndërkombëtarë. Duket se rindërtimi dhe zhvillimi kanë sjellë progres, por me një kosto të madhe në humbje fondesh të donatorëve, ndërkohë që forcimi i qeverisjes ka dështuar totalisht.

Për një sërë arsyesh, jo dhe aq bindëse, ka pasur një fokusim të madh te zgjidhjet e shpejta. Këto zgjidhje kanë rezultuar në

---

<sup>4</sup> Analiza që zhvillohet në këtë paragraf është marrë nga Amin Saikhal, "Modern Afghanistan, a history of struggle and survival", I. B. Tuaris & Co, 2006.

neglizhimin e zhvillimit të kapaciteteve qeverisëse në Afganistan, në një sistem ligjor të dobët dhe në, thuajse, mosekzistencën e shtetit ligjor.<sup>5</sup>

Askush nuk mund të argumentojë kundër faktit se qeveria nuk mund të bazohet vetëm te ushtria dhe policia edhe kur këto forca funksionojnë mirë (fakt që vështirë të pohohet për Afganistanin). Legjitimiteti i qeverisë do të varet në aftësinë e saj për të ofruar shërbime të shumta, ku drejtësia dhe zbatimi i ligjit janë ndër gjërat më urgjente. Ndërsa, aktualisht, Kabuli nuk është në gjendje të bëjë këtë, talebanët i kanë ofruar këto shërbime në mënyrën e tyre të çorganizuar kohë më parë, si dhe po vazhdojnë ta bëjnë të njëjtën gjë edhe sot.

Historitë frymëzuese dhe rezultatet pozitive të paraqitura për komunitetin ndërkombëtar dhe/ose nga ky komunitet deri më sot vështirë se përputhen me realitetin në terren. Matja e inputeve në vend, të produkteve finale, ka krijuar një iluzion të suksesit. Kjo ofron një panoramë të shtrembër për vendimmarrësit si edhe zhgënjën klientët (afganët), të cilët nuk i shikojnë të materializuara premtimet dhe shpenzimet e mëdha të reklamuar. Të arsyetuarit sipas dëshirave dhe strategjia për hedhje të parave për zgjidhjen e problemeve, atëherë kur ato do të dalin në pah, nuk sjell rezultatin e dëshiruar. Si rrjedhojë nevojitet një qasje më realiste dhe më e orientuar drejt rezultateve.

Fajësia për dështimin për t'u angazhuar në mënyrë efikase (sidomos përmes projekteve të asistencës civile) nuk mund të rëndojë vetëm te qeveria e korruptuar dhe paaftësia afgane. Është e kuptueshme se donatorëve dhe agjencive iu pëlqen ky justifikim, sepse ai është efektiv për të shmangur vëmendjen nga dështimet e tyre. Megjithatë, gjysma ose edhe një pjesë më e madhe e fajit duhet ndarë ndërmjet komunitetit ndërkombëtar. Një sistem vendimmarrjeje tejet i komplikuar dhe jotransparent për projektet e asistencës dhe financimet, ku disa parlamentarë nga vendet donatore zgjedhin edhe projektet e tyre "të përkëdhelura", ka bërë të pamundur ndërmarrjen e një përjasjeje krejtësisht strategjike për ndërtimin e vendit. Rezultati është një ndryshim thuajse vjetor i prioritetëve dhe varësia e niveleve të kontributeve nga konsideratat e brendshme të donatorëve.

Edhe nëse ka pasur një strategji koherente për stabilizimin e vendit dhe zhvillimin e qeverisjes së tij, zbatimi i saj aktual do të ishte një detyrë utopike, duke pasur parasysh sistemin kaotik të

---

<sup>5</sup> Shih *Crisis Group Asia Report 115 "Afghanistan: Exit vs Engagement"*, 28 November 2010.

menaxhimit që funksionon aktualisht. Është e pamundur të flasësh për koordinimin real të asistencës civile në terren. Misioni i OKB-së për Asistencë në Afganistan (UNAMA) nuk është pajisur me asnjë autoritet serioz. Agjencitë donatore dhe zyrtarët që përfaqësojnë të njëjtin vend shpesh nuk komunikojnë as mes njëri-tjetrit. Nuk ka dyshim se koordinimi është sistemik dhe shpesh varet, më së shumti, nga iniciativat individuale dhe nga marrëdhëniet personale. Në fund të fundit kjo nuk duket se ka ndryshim të madh nga rrejetet e patronazhit të stilit afgan, të cilët, donatorëve ndërkombëtarë ju pëlqen që t'i kritikojnë aq shumë nga kryeqytetet e tyre.

Një tjetër aspekt që dëmton përpjekjet për asistencë, për zhvillim dhe për qeverisje është varësia e tepruar prej strukturave të centralizuara dhe të orientuara në Kabul si për qeverinë afgane, ashtu edhe për agjencitë e donatorëve (qeveritare dhe joqeveritare). Afganistani, pavarësisht historisë së tij 250-vjeçare si shtet i unifikuar, asnjëherë nuk ka ecur me sukses në rrugën e një rendi të fortë dhe të centralizuar. Në vend të kësaj, aftësia më e rëndësishme për një udhëheqës të suksesshëm ka qenë kapaciteti për të balancuar një sërë interesash rajonale dhe tribale. Prandaj, eventualisht, fati i qeverive dhe legjitimiteti i tyre vendoset në provinca dhe jo në kryeqytet.

Aktualisht dështimet kryesore të qeverisë janë më të dukshme në provincat dhe rrethet ku degët e ekzekutivit janë të paafta dhe të keqfinancuara, ndërsa ato legjislativë janë ose të parëndësishme, ose nuk janë fare të pranishme në nivel rajonal. Si rezultat, shërbimet nuk shpërndahen dhe popullsia mbetet e zhgënjyer për sa i përket aftësisë për ndryshime të qeverisë në Kabul. Pavarësisht kësaj, shumë agjenci donatore dhe organizata, ende mbështeten në ekspertizat e selive të tyre qendrore të mirënjohura në Kabul, në vend që të zgjerojnë shtrirjen e stafit të tyre nëpër krahina. Ndoshta kjo ndodh sepse arkitektët e një sistemi të tillë menaxhimi të “Kabulizuar” të vendit e kanë origjinën e tyre nga të njëjtat kryeqytete, si shumica e agjencive donatore.

Në të njëjtën kohë, personeli që vepron brenda “realitetit virtual” të fortesave të tyre në Kabul shpesh ka informacion, por të kuptuar të kufizuar të asaj që ndodh në vend. Më e rëndësishmja është se nuk përcaktojnë dot cilat janë nevojat dhe rezultatet e programeve të asistencës që ata menaxhojnë. Për të maskuar këtë dështim kryeqytetet kontribuuese të NATO-s janë pajisur me statistika të pakuptimta dhe gjysmë të vërteta në lidhje me gjendjen reale apo progresin në terren. Kjo nuk përbën vetëm pengesë për aftësinë e tyre për të zhvilluar dhe



ndërmarrë një strategji kuptimplote stabilizimi, e cila të bazohet te siguria dhe ndërtimi i institucioneve, por gjithashtu krijon rreziqe komunikimi ndërmjet vendimmarrësve dhe shoqërive përkatëse të tyre. Herët a vonë njerëzit e kuptojnë që nuk ka një progres real dhe me të drejtë pyesin se ku janë rezultatet përkundër kostove të mëdha në viktima dhe para?

Duke u përballur me këto pyetje që janë të vështira për t'u përgjigjur, pa pranuar më parë dështimet e tyre dhe, duke pranuar se misioni në Afganistan, nëse duhet të përfundojë me rezultat, është ende larg fundit, një numër gjithnjë e më i madh vendesh ndërmarrin një tjetër zgjidhje të shpejtë. Ata largohen.

Shpenzimet që lidhen me detyrat civile të qeverisjes dhe asistencës për zhvillim janë vënë më shpesh në pikëpyetje, sidomos nga vendet e goditura nga kriza ekonomike. Kur njerëzit janë në nevojë në vendin tënd, është e vështirë të justifikosh hedhjen e parave për forcimin e idealeve abstrakte në një vend që ndodhet në cepin tjetër të botës. Megjithatë ekzistojnë disa arsye shumë më praktike për shkak të të cilave vendet zgjedhin të angazhohen me ekspertizë në misione që asistojnë zhvillimin. Afganistani, nëse arrin vetëqëndrueshmëri administrative dhe ekonomike, do të jetë një partner i shkëlqyer për të bërë biznes. Ai ka qenë një rrugë kryesore tranziti për shkak të vendndodhjes së tij dhe ka potencial për ta rimarrë këtë status si edhe ka një pasuri minerale shumë të madhe. Prezenca aktuale atje dhe vendosja e kontakteve do të hapte shumë mundësi për bizneset, për çdo vend (qoftë ky i vogël ose i madh).

Për momentin, vetëm komponenti civil është vështirë që të jetë në gjendje të veprojë pa dispozitat e dhura të sigurisë, ose nëse vendi përfshihet në një konflikt të brendshëm gjithëpërfshirës. Ka pak arsye për shpresë, siç shpjegohet më tej në këtë dokument, që këtë herë situata e sigurisë do të ndryshojë rrënjësisht deri në vitin 2012. Të paktën, jo para se talebanët të jenë dobësuar me të vërtetë dhe të jenë të gatshëm për t'u riintegruar, ose përpara se një forcë e vetqëndrueshme e sigurisë afgane të bëhet operacionale.

## **Sfida e vitit 2014**

Në kontekstin e krizës ekonomike botërore, tranzicioni është me të vërtetë një lëvizje e rëndësishme, e cila është e dobishme si për afganët ashtu dhe për aleatët ndërkombëtarë, duke pasur parasysh edhe rënien dakord për reduktimin e forcave të

kushtueshme të sigurisë që koalicioni ka angazhuar në Afganistan. Megjithatë, siç theksohet edhe më lart, kryerja e këtij veprimi pa ndërmarrë më parë aktivitete të mjaftueshme përgatitore, do të rrezikonte të gjithë investimet e komunitetit ndërkombëtar në Afganistan. Institucionet aktuale të sigurisë afgane dhe kapaciteti i tyre, i cili varet pjesërisht nga partitë politike si edhe nga oficerët udhëheqës që kanë qenë më parë pjesë e milicive rebele, do të kërkojnë më shumë kohë, mbështetje dhe vëmendje prej komunitetit ndërkombëtar për operacionalizimin e tyre të plotë dhe për ngarkimin e tyre me përgjegjësitë për sigurinë dhe mbrojtjen e kufijve.

Ndërkohë, të pasurit e një koalicioni të kushtueshëm që punon në Afganistan, i cili nuk ka arritur rezultate afatshkurtra për vendosjen e sigurisë, përbën gjithashtu shqetësim për qeverinë e Afganistanit. Prandaj tri fushat e mëposhtme duhen konsideruar për strategjinë e tranzicionit. Secila prej tyre do të kërkonte një sasi të ndryshme kohore përpara se të fillonte tranzicioni aktual.

Së pari, është ndërtimi i kapaciteteve në institucionet e sigurisë (ushtria, policia dhe shërbimet sekrete), e cila do të përfshinte tre elementë kryesorë: aftësitë, sistemin dhe artilerinë së bashku me pajisjet e lëvizshme, duke përfshirë dhe kapacitetet ajrore. Duke pasur parasysh problemet kryesore të sigurisë në kufijtë e tij (trafiku i drogës, niveli i lartë i kriminalitetit, përfshirja e milicive lokale në çështjet e politikës së brendshme etj.), që institucionet e sigurisë të vendit të bëhen plotësisht funksionale do të nevojitej më shumë kohë sesa afati i përcaktuar në 2014. Efektet negative të keqfunksionimit të procesit të ndërtimit të kapaciteteve do të përbënin rrezik për qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin afatgjatë të Afganistanit.

Së dyti, është e rëndësishme të ndërtohen mekanizma efektivë për transferimin hap pas hapi të përgjegjësiave për sigurinë te forcat afgane. Vendimet për çështje dhe aktivitete specifike të sigurisë nuk duhen marrë me nxitim, pasi burimet e papërshtatshme dhe mungesa e aftësive mund të çojnë në pasoja të pakëndshme që do të ndikonin negativisht në përpjekjet për të ndërtuar besimin në komunitet. Ndërtimi i besimit kombëtar te qeveria është një detyrë e vështirë dhe gjithashtu edhe tejet e brishtë. Çdo gabim mund të jetë i mjaftueshëm për të tronditur besimin e publikut te qeveria, të cilin njerëzit sapo kanë filluar ta perceptojnë. Dhe përsëri do të duhet më shumë se viti 2014 përpara se ndokush të jetë i aftë të pohojë se ekziston një balancë e drejtë ndërmjet autoritetit në Kabul dhe autoritetit të Kabulit nëpër rajone.

Së treti, është dimensioni i angazhimit civil që ka nevojë të vendoset në planet dhe programet afatgjata të zhvillimit. Megjithatë ka shumë çështje që mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e planeve dhe programeve të zhvillimit dhe që për këtë arsye kërkojnë vëmendjen e menjëhershme të palëve të përfshira. Aktualisht zbatimi i programeve të zhvillimit dhe rindërtimit përfshin në mënyrë të pamjaftueshme aktorët qeveritarë si në nivel lokal, ashtu edhe në atë qendror. Sigurisht ekziston mungesë besimi ndërmjet agjencive ndërkombëtare të zhvillimit dhe qeverisë afgane, çka kërcënon zhvillimin e qëndrueshëm në Afganistan. Prandaj duhet praktikuar përfshirja më e madhe e zyrtarëve nga ministritë përkatëse afgane në menaxhim ose në rolet konsultuese në projektet e zhvillimit. Kjo do të lehtësonte jo vetëm shkëmbimin e informacionit dhe trajnimin në punë për personat e përfshirë, por mbi të gjitha synon të forcojë besimin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin e përbashkët të qëllimeve nga palët e përfshira.

Mungesa e një angazhimi më afatgjatë për zhvillimin ekonomik dhe për zgjerimin është një tjetër çështje që kërkon vëmendje. Në shumicën e rasteve, projektet e zhvillimit janë hartuar për arritjen e rezultateve afatshkurtër dhe afatmesëm, por shpesh në kurriz të efekteve ekonomike afatgjatë. Për më tepër, ndërsa ata shërbejnë si pjesë e strategjisë kundër rebelëve që përfshijnë vendësit në aktivitete të tjera, përveç luftimeve, ata as nuk kontribuojnë për zgjerimin ekonomik dhe as rrisin aksesin publik të shërbimit me rëndësi strategjike.

### **Çështjet rajonale - jo vetëm burim i problemeve, por edhe një zgjidhje potenciale**

Aktualisht, shumë probleme që lidhen me rebelimet në Afganistan janë të ndërlidhura me ngjarjet në vendet fqinjë (dhe ato nuk rrjedhin vetëm nga “koka e turkut” që zakonisht personifikohet me Pakistanin). Agjenda e pajtimit dhe riintegritit ka qenë kohët e fundit një çështje kryesore në kontekstin e Afganistanit. Megjithatë, në mënyrë që procesi i pajtimit të ketë sukses, nevojitet arritja e një qasjeje rajonale që shtrihet përtej kufijve të Afganistanit. Pra, strategjia e tranzicionit duhet të ndërtohet dhe shikohet në kontekstin rajonal. Vendet rreth Afganistanit kanë shumë për të rrezikuar nëse projekti aktual për sigurinë dështon dhe Afganistani bëhet sërish një “bazë e sigurt” për lëvizjet kryengritëse.

Jugu i Afganistanit dhe pjesa perëndimore e Pakistanit po përballen me probleme serioze të politikës së brendshme dhe me kryengritjet. “Prodhimi” i kryengritësve në qendrat fetare nën mbulojën e Islamit po merr mbështetje të gjerë ndërkombëtare. Përveç mbështetjes që kanë forcat pakistaneze nga Shtetet e Bashkuara, në vend nuk ka një strategji të duhur për të mposhtur rebelët. Dyshimet për ndershmërinë dhe suksesin e forcave të Pakistanit bazohen kryesisht në frikën e tij ndaj Indisë, e cila gradualisht po ndërton një partneritet më të ngushtë me Afganistanin.

Në veri, regjimet e republikave fqinje të Azisë Qendrore nuk mundin gjithashtu të tolerojnë që lëvizjet separatiste apo rebelimet që e kanë origjinën nga vendet e tyre të lulëzojnë në “baza të sigurta”, të cilat janë përtej kontrollit të forcave të sigurisë kombëtare. Konkretisht, Lëvizja Islamike e Uzbekistanit është duke vepruar në Pakistan dhe Afganistan. Duke lejuar grupe të tilla të veprojnë lirisht nga baza potencialisht të sigurta do të krijonte rrezik serioz në Azinë Qendrore, sidomos aktualisht me intensifikimin e lëvizjeve antidiktatoriale dhe profetare në botën Arabe.

Në perëndim, Irani gjithashtu po vuan pasojat e trafikut të drogës, fluksin e refugjatëve afganë dhe rritjen e kriminalitetit në zonën e gjerë të shkretëtirës kufitare me Afganistanin. Rikthimi i Afganistanit në kaos, sigurisht që është një perspektivë e padëshiruar nga regjimi aktual i Iranit. Ai nuk do që fqinjët të përbëjnë një platformë organizuese për aktivitetet kriminale si edhe për problemet potenciale politike brenda territorit iranian.

Duke pasur parasysh rreziqet dhe rolin që aktorët në fjalë (Irani, Pakistani, Tashikistani, Turkmenistani, Uzbekistani dhe India) luajnë për stabilitetin e Afganistanit, të gjitha palët duhet të përfshihen në hartimin e suksesshëm të procesit të tranzitimit të sigurisë nga ISAF te afganët, ose edhe te forcat e përkohshme rajonale. Megjithatë, mundësia për negociimin dhe zbatimin e zgjidhjeve rajonale, të cilat kanë shanse për të pasur sukses, nuk duket se ka gjasa të ndodhë përpara vitit 2014.

## Konkluzione

- Përpjekjet e ndihmës civile, edhe pse kjo nevojitet urgjentisht, nuk kanë arritur qëllimet e dëshiruara në Afganistan, sidomos për sa iu përket fushave me rëndësi thelbësore të zhvillimit të një sistemi operacional të qeverisjes dhe atij të drejtësisë.

Rrjedhimisht, sot për sot, këto përpjekje mund të jenë zëvendësuese për misionet ushtarake aktuale.

- Duke kuptuar se zgjidhja eventuale bazohet te arritja e një qeverisjeje operacionale dhe e aftë për të ofruar shërbime në Afganistan, pengesat aktuale për asistencë duhet të njihen dhe të rishikohen. Në këtë mënyrë gabimet do të mund të korrigjohen dhe praktikat aktuale të dobishme duhet të aplikohen. Kjo do të përfshinte një të folur të drejtpërdrejtë si për shoqërinë afgane, ashtu edhe për ato të vendeve donatore për të kundërshtuar skepticizmin e përgjithshëm.

- Nevojitet formulimi i strategjive për asistencë për zhvillimin. të cilat duhet të jenë të drejtpërdrejta dhe të orientuara drejt rezultateve. Nevojitet një koordinim më i mirë i burimeve ekzistuese dhe atyre të së ardhmes, si edhe adoptimi i një qasjeje të decentralizuar dhe me fokus rajonal.

- Edhe pas kalimit të pushtetit tek institucionet afgane, nevojitet prezenca e forcave ndërkombëtare, ndonëse në një nivel më të ulët për të mbikëqyrur funksionimin e këtyre institucioneve. Gjithashtu nevojitet edhe prezenca dhe mbështetja politike e komunitetit ndërkombëtar edhe për disa vite të tjera, përpara se Afganistani të mund të lihet të ecë vetë dhe të bazohet vetëm te kapacitetet e tij.

- Është thelbësor të pasurit e një konteksti rajonal për stabilitetin dhe zhvillimin e Afganistanit sipas planit të vitit 2014. Megjithatë, ky kontekst ende po mungon, duke dëmtuar kështu suksesin e strategjisë aktuale.

**Nga Edlira Osmani**  
*(LL. M. South East European Law and European Integration, Karl Franzens University, Graz, Austria)*

## ROLI GLOBAL I NATO-S: ME NJË FOKUS NË LINDJEN E MESME

### Hyrje

Pjesa e parë e shkrimit mbulon çështjet më të rëndësishme historike të transformimit të NATO-s përgjatë dekadave, në përgjigje të sfidave me të cilat është përballur siguria globale. Një vend të rëndësishëm zënë dhe samitet e NATO-s ku do të cilësoja Samitin e Lisbonës të vitit 2010, në të cilin u paraqit Koncepti Strategjik në Fushën e Mbrojtjes Kolektive dhe Parandalimit si dhe Menaxhimin e Krizave të Sigurisë Globale. Një vështrim i shkurtër rreth agjendës së Samitit të ardhshëm të Çikagos do të shpaloset në pjesën e dytë të këtij shkrimi, ku ndër të tjera do t'i vihet theksi rolit të NATO-s në Lindjen e Mesme. Më shumë se një dekadë më parë, NATO ishte e përfshirë në Europën Juglindore, duke përmendur këtu ndërhyrjen e parë të NATO-s në Bosnjë Hercegovinë dhe më vonë edhe në Kosovë. Por që pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, një situatë e brishtë është shfaqur në rajonin e Lindjes së Mesme dhe NATO, duke qenë një organizatë me një rol të madh në çështjet e sigurisë globale, shtrin veprimtarinë e saj edhe në rajonin e Lindjes së Mesme. Por a do të jetë roli i NATO-s në Lindjen e Mesme ashtu siç ishte në Evropën Perëndimore? Si përfundim do të merren në shqyrtim sfidat me të cilat ballafaqohet siguria globale sot (duke pasur në vëmendje ngjarjet e fundit në Lindjen e Mesme: rasti i Sirisë dhe e ardhmja e Organizatës).

### I. NATO përgjatë dekadave

Me firmosjen e Traktatit të Atlantikut Verior më 4 prill 1949, u themelua Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut<sup>1</sup>. Në fillimet e saj, por edhe në opinionet e mëvonshme, përmendet fakti se NATO u krijua për t'ju kundërpërgjigjur një kërcënimi të

<sup>1</sup> NATO (*English: North Atlantic Treaty Organization*; Shqip: Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (OTAV)).

mundshëm nga Bashkimi Sovjetik i asaj kohe. Në të vërtetë, qëllimi parësor i NATO-s ishte krijimi i një sistemi mbrojtjeje kolektive, ku vendet anëtare të binin dakord që të mbronin njëri-tjetrin në rast se do të sulmoheshin nga një palë e jashtme. Përveç kësaj, Organizata synonte të arrinte dhe disa objektiva të tjerë, si: ndalimin e ekspansionit Sovjetik, ndalimin e ringjalljes së militarizmit nacionalist në Europë, përmes pranisë amerikane si dhe të inkurajonte integrimin politik të Europës<sup>2</sup>.

Situata e Pasluftës së Dytë Botërore, ku vetëm në Europë kishte mbi 36 milionë njerëz të vrarë dhe qytete të tëra të shkatërruara nga bombardimet. Kjo ishte mjaft e rëndë dhe paraqiste mjaft vështirësi për t'u stabilizuar. Plani Marshall stabilizoi disi gjendjen ekonomike të Pasluftës në Europë, por sfera e sigurisë përsëri linte për të dëshiruar. Disa nga shtetet perëndimore kishin ndërmarrë nisma bashkëpunimi në fushën e sigurisë si dhe në atë ushtarake, por përsëri këto nisma rezultuan të vakëta për t'ju kundërvënë agresionit Sovjetik dhe rilindjes së militarizmit nacionalist European. Në një situatë të tillë u pa si zgjidhja më e arsyeshme krijimi i një organizate ndëratlantike dhe, si rrjedhojë, pas debatesh e diskutimesh të shumta, dymbëdhjetë shtete firmosën Traktatin e Atlantikut të Veriut në Uashington DC të Shteteve të Bashkuara të Amerikës<sup>3</sup>.

Me rivendosjen graduale të stabilitetit politik në Europën e Pasluftës filloi të merrte hov edhe stabiliteti ekonomik. Shtete të tjera filluan të bëheshin pjesë e Organizatës duke filluar me Turqinë dhe Greqinë më 1952 dhe Gjermaninë Perëndimore më 1955. Por si një kundërpërgjigje ndaj anëtarësimit të Gjermanisë Perëndimore në NATO, Bashkimi Sovjetik si dhe shtetet e Europës Lindore themeluan Paktin e Varshavës më 1955, çka solli dhe pengesën e parë në integrimin politik të Europës si dhe ndërtimin e Murit të Berlinit më 1961<sup>4</sup>. Kjo përbën dhe periudhën kur NATO hartoi doktrinën strategjike të "hakmarrjes masive" sipas së cilës, nëse Bashkimi Sovjetik sulmon, NATO do të përgjigjet me armë bërthamore. Kjo doktrinë do të kishte dhe anën e saj pozitive sepse do t'ju lejonte vendeve anëtare t'i përqendronin fuqitë e tyre në rritjen ekonomike dhe jo në krijimin e ushtrive të mëdha.

<sup>2</sup> <http://www.nato.int/history/nato-history.html> (parë, më 20.4.2012).

<sup>3</sup> 12 shtetet firmëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut, më 4 prill 1949, ishin: Britania e Madhe, Franca, Italia, Islanda, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Belgjika, Portugalia, Danimarka, Kanadaja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

<sup>4</sup> <http://www.nato.int/> (historiku i NATO-s).

Vitet 1960 do të sillnin të tjera preokupime për Organizatën. Tensionimi i situatës në Kubë ndërmjet SHBA-ve dhe Ruisë, si dhe tërheqja nga komanda ushtarake e Francës më 1966, në shenjë proteste ndaj dominimit amerikan në komandim, si dhe më 1967 zhvendosja e zyrave të NATO-s nga Parisi në Bruksel, vuri në dukje se NATO është një organizatë fleksibël, cilësi që do t'i sjellë sukses dhe jetëgjatësi.

Më 1990 do të nënshkruhej një marrëveshje ndërmjet NATO-s dhe Paktit të Varshavës si dhe do të publikohej një deklaratë e përbashkët mbi joagresionin. Kjo marrëveshje do të ishte jetëshkurtër, duke pasur para sysh faktin se Pakti i Varshavës shpërbëhet më 1991, andaj dhe NATO ndërmerr një tjetër nismë, duke formuar një Këshill Bashkëpunimi Veri-Atlantik për të realizuar bisedime brenda anëtarëve të NATO-s, shteteve të Evropës Lindore si dhe me ish-Republikat e Bashkimit Sovjetik.

Vitet 1990 ishin të karakterizuara jo vetëm nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, rënia e sistemeve komuniste, por edhe nga shpërbërja e Jugosllavisë, çka do të sillte luftëra dhe konflikte në Ballkan. Periudha pas Luftës së Ftohtë ishte një periudhë që paraqiste mjaft destabilitet. Më 1992 NATO shprehet e gatshme për të ndërmarrë veprime për ruajtjen e paqes në ish-Jugosllavi, dhe më 1994 krijon Partneritetin për Paqe (PP). Sipas PP-së vendet joanëtare të NATO-s lejoheshin të shkëmbenin informacion me vendet anëtare, si dhe të modernizonin ushtritë e tyre sipas standardeve demokratike. PP do t'u hapte rrugën vendeve partnere për t'u anëtarësuar në NATO. Në samitin e Uashingtonit më 1999, tre vende partnere të NATO-s fituan statusin e anëtarëve me të drejta të plota.

Më 1995, NATO ndërmerr operacionin e parë ushtarak në Bosnjë Hercegovinë, ndërsa më 1998 NATO ndërmori sulme ajrore kundrejt Serbisë pas një sërë dështimesh në tentativat për të zgjidhur krizën ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Sulmet ajrore të NATO-s kundrejt Serbisë, pushuan vetëm pasi filloi tërheqja e trupave serbe nga Kosova. Ngjarjet e Bosnjë Hercegovinës dhe Kosovës treguan se rëndësia e NATO-s ishte prezente dhe në këtë periudhë organizata filloi të transformohej dhe të merrte hapa më dinamikë dhe më të përgjegjshëm. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë ajo çka ishte parashikuar se do të sillte destabilitet në të ardhmen, kishte të bënte me rreziqe komplekse, duke përfshirë konfliktet ndëretnike, rënien ekonomike dhe të rendit politik si dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

Sulmet e 11 shtatorit 2001 do të sillnin një tjetër rrezik të sigurisë botërore, rrezikun ndaj sulmeve terroriste. Sulme të tilla



do të ndiqeshin nga ngjarjet e përgjakshme të 11 marsit 2004 në Madrid dhe të 7 korrikut 2005 në Londër. Por sulmet e 11 shtatorit 2001 do të risillnin në mendje nenin 5 të Statutit të Organizatës, ku sanksionohet se: “Sulmimi i njërit prej anëtarëve të NATO-s do të thotë sulm ndaj të gjithë anëtarëve”. Si kundërpërgjigje ndaj sulmeve të 11 shtatorit, një koalicion shtetesh, përfshirë dhe shtete anëtare të NATO-s, ndërmorën ndërhyrje ushtarake në Afganistan me qëllim që të parandalonin dhe shkatërronin bazat terroriste të Al-Kaedës.

Ndërkohë, më 2002, në Samitin e Romës, ministrat e Jashtëm të shteteve anëtare të NATO-s formojnë Këshillin “NATO-Rusi”, në mënyrë që Rusia dhe shtetet e NATO-s të kenë një rol të barabartë në vendimmarrje dhe të bashkëpunojnë si partnerë të barabartë për çështje me interes të përbashkët në fushën e sigurisë. Në Samitin e Pragës (2002), NATO shpalos sërish perspektivën për zgjerim, duke u ofruar shteteve, si: Lituania, Letonia, Estonia, Bullgaria, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia mundësinë t’i bashkohen NATO-s. Këto shtete u anëtarësuan më 2004. Gjithashtu, po më 2004, NATO prezanton Iniciativën e Bashkëpunimit të Stambollit, në mënyrë që t’u ofronte ndihmë vendeve kufitare me Lindjen e Mesme. Në Samitin e Bukureshtit më 2008, Shqipëria dhe Kroacia ftohen t’i bashkohen NATO-s, dhe më 2009 bëhen anëtare të Organizatës.

Samiti i Lisbonës më 2010, do të sillte një kthesë të rëndësishme në historinë prej gjashtë dekadash të NATO-s. Në këtë Samit do të ndërmerreshin hapa vendimtarë që do të kenë ndikimin e tyre në shekullin XXI. Në këtë Samit, NATO kërkon të vazhdojë të ketë prezencën e saj në zonat e konfliktit si dhe vazhdimin e bashkëpunimit strategjik me Rusinë. I një rëndësie të veçantë paraqitet edhe bashkëpunimi NATO-BE në fushën e sigurisë. Bashkimi Europian është një partner i rëndësishëm në fushën e sigurisë, dhe duhet pasur në konsideratë fakti se trupat e BE-së kanë marrë pjesë në misione ushtarake në disa vende, duke përfshirë jo vetëm shtetet e Europës, por edhe në Afrikë dhe Azi. Por jorrallëherë NATO dhe BE kanë implikuar rolet e tyre në fushën e sigurisë. Sipas disa komenteve, rritja e rolit të BE-së në çështjet e sigurisë do të dëmtonte Organizatën<sup>5</sup>. Bashkimi Europian në Traktatin e Lisbonës (2007) ka vendosur rritjen e rolit të tij, nga ana tjetër, Samiti i Lisbonës, i NATO-s (2010), do të prezantonte Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s ku do të vihej në pah rëndësia e zhvillimit të vizionit të organizatës si dhe përpjekjet për më tepër

<sup>5</sup> *The future of NATO and European Defence, House of Commons, Defence Committee, Ninth Report of Session 2007-08, f. 6.*

efektivitet, për t'u ardhur në mbrojtje vendeve anëtare dhe për të luajtur rol në menaxhimin e shpejtë të krizave<sup>6</sup>. Me rastin e prezantimit të Konceptit të Ri Strategjik, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha: "NATO është një komunitet i pashembullt lirie, paqeje, sigurie dhe vlerash, por bota po ndryshon dhe ne po përballemi me kërcënime dhe sfida të reja. Ky Koncept Strategjik do të na sigurojë se NATO do të mbetet po aq efektive në mbrojtje të paqes, sigurisë dhe prosperitetit tonë."<sup>7</sup>

## II. NATO në Lindjen e Mesme

NATO, në fillimet e saj shfaqet e fokusuar në çështjet e Luftës së Ftohtë dhe më pas në zgjidhjen e krizave në Evropën Juglindore dhe vetëm në dekadën e fundit mund të themi se rrezja e veprimit të saj është zgjeruar, duke përfshirë dhe vendet e Lindjes së Mesme. Ky qëndrim i NATO-s ka ardhur pas sulmeve të 11 shtatorit, ku një shtet anëtar i NATO-s u sulmua dhe Organizata për të parën herë vuri në zbatim nenin 5 të statutit të saj, sipas të cilit, një sulm kundrejt një anëtari të NATO-s është sulm kundrejt gjithë anëtarëve të Organizatës.

Sot NATO po e shtrin gjithmonë e më tepër veprimtarinë e saj në Lindjen e Mesme dhe pyetjes se pse po ndodh një gjë e tillë mund t'i përgjigjemi fare thjeshtë: "Sepse atje janë krizat"<sup>8</sup>.

Koncepti strategjik i NATO-s, që nga fillimet e organizatës e deri më sot është përditësuar dhe kjo ka ardhur sepse rrjedha e ngjarjeve globale e ka sjellë një gjë të tillë. Disa nga problemet që shqetësojnë botën sot janë: parandalimi i përhapjes së armëve bërthamore, siç është rasti i Iranit; lufta kundër terrorizmit, rasti i Irakut dhe Afganistanit, si dhe vendosja e paqes, sërish rasti i Afganistanit. Për parandalimin e tyre NATO duhet të përqendrohet në rajonin e Lindjes së Mesme dhe nuk mund të fokusohet më vetëm në rajonin e Europës Perëndimore, sepse nëse nuk do e bënte një gjë të tillë, NATO do të shkonte drejt fundit të rolit të saj si organizatë ndërkombëtare efektive<sup>9</sup>. Shtetet anëtare të NATO-s bashkërisht vendosën se duhet të ndërhyenin në këto zona konflikti dhe si rrjedhojë filloi edhe rritja e rolit të NATO-s në Lindjen e Mesme. Që pas sulmeve të 11 shtatorit roli i Organizatës në

<sup>6</sup> *Strategic Concept 2010, NATO Publications.*

<sup>7</sup> [http://www.nato.int/cps/en/natolive/news\\_68172.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/news_68172.htm) (parë, më 20.4.2012).

<sup>8</sup> *Philip Gordon, NATO's Growing Role in the Greater Middle East, The Emirates Center for Strategic Studies and Research, f. 4.*

<sup>9</sup> *Ibid, f. 4*

rajonin e Lindjes së Mesme u zgjerua ditë pas dite, duke filluar me forcat paqeruajtëse dhe atyre kundër terrorizmit në Afganistan, forcat ushtarake në Irak, ndërhyrjet humanitare në Pakistan e në Sudan si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme në bisedimet politike dhe çështje të sigurisë në Gjirin Persik dhe në Afrikën e Veriut.

#### *Misioni i NATO-s në Afganistan*

Misioni më i madh i NATO-s në Lindjen e Mesme është ai në Afganistan. Përfshirja e NATO-s në një mision të tillë jashtë Europës, nisi në gusht të 2003-shit. Ndërsa më 2005, Këshilli i Atlantikut të Veriut ra dakord që të zgjerohej roli i Organizatës në Afganistan, duke rritur numrin e trupave ushtarake dhe duke çuar atë deri në 15 000.<sup>10</sup> Objektivi kryesor i misionit në Afganistan është që t'u mundësojë autoriteteve afgane siguri efektive në gjithë vendin dhe të parandalojë që Afganistani të kthehet përsëri në një strehë terroristësh<sup>11</sup>. Për të bërë të mundur një gjë të tillë, ISAF<sup>12</sup> ka ndërmarrë operacione sigurie si dhe ka trajnuar forcat e sigurisë kombëtare afgane.

#### *NATO në Irak*

Qëllimi i NATO-s në Irak ka qenë për të angazhuar Irakun në krijimin e forcave të armatosura efektive që do t'i sjellin siguri vendit. Për këtë arsye NATO, më 2004, dërgoi në Irak një mision trajnimi, ndërsa më 31 dhjetor 2011, NATO u tërhoq përfundimisht nga Iraku.

#### *NATO dhe Siria*

Në një konferencë për shtyp të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, më 18 prill 2012, në lidhje me çështjen e Sirisë, ai është shprehur se “situata në Siri është mjaft shqetësuese dhe se NATO dënon vrasjen e civilëve në këtë shtet, po ashtu është shqetësues edhe fakti që një vend anëtar i NATO-s është shtet kufitar me Sirinë dhe si rrjedhojë mund të preket nga ajo që po ndodh atje”. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm, NATO po e vëzhgon situatën, por nuk do të ndërmarrë ndonjë nismë për të ndërhyrë.

Në Samitin e Çikagos, që pritet të mbahet në maj të këtij viti, çështjet e Lindjes së Mesme do të jenë në shqyrtim. Së pari, Samiti pritet të fokusohet në çështjen e angazhimit të NATO-s në Afganistan, në sfidat që paraqet shekulli XXI si dhe në forcimin e partneritetit të NATO-s në arenën globale. Sidoqoftë roli i NATO-

<sup>10</sup> *Ibid*, f.10

<sup>11</sup> [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_69349.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_69349.htm).

<sup>12</sup> *International Security Assistance Force (ISAF)*.

s në Lindjen e Mesme do të jetë prezent përderisa rajoni vazhdon të shfaqë destabilitet dhe mungesë sigurie.

## Përfundime

Historiku i shkurtër i NATO-s na risolli në mendje se Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut ka fuqizuar rolin e saj në arenën globale me kalimin e dekadave. U krijua si një organizatë që pjesërisht synonte t'i kundërvihej ekspansionit sovjetik dhe të ndërmerre nisma në mbrojtje të vendeve që do të aderonin në të. Si organizatë politiko-ushtarake pati rolin e saj në Luftën e Ftohtë, por kthesën vendimtare në sigurimin e jetëgjatësisë së saj do ta merre me ndërhyrjet në Bosnje Hercegovinë si dhe në Kosovë. Ndikimi që pati në Europën e pasviteve '90, e sidomos me ndërhyrjet për pushimin e konflikteve ndërmjet shteteve të ish-Jugosllavisë, në njëfarë mënyre treguan se NATO mund të lunte një rol të rëndësishëm në zgjidhjen dhe parandalimin e konflikteve. Por sulmet e 11 shtatorit së bashku me mijëvjeçarin e ri do të sillnin dhe të tjera probleme, të cilave duhej t'u bëhej ballë. Rreziku terrorist dhe lufta kundër tij do të shtrinin veprimtarinë e NATO-s në rajone ku organizata nuk kishte ndërhyrë më parë. Lindja e Mesme dhe misionet që NATO do të dërgonte në Afganistan dhe Irak do të bënin që NATO të ndërmerre më tepër veprimtari sesa kishte ndërmarrë që nga krijimi i saj. Edhe Samiti i ardhshëm i NATO-s që do të mbahet në Çikago pritet të vendosë theksin sërish në sfidat që paraqet shekulli XXI si dhe në forcimin e partneritetit të NATO-s në arenën globale. Dhe ajo çka Shefer, ish-Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ka thënë mbetet aktuale edhe sot: "Kërcënimet me të cilat përballemi ne sot nuk janë individuale, ato janë të njëjta në të gjithë botën dhe asnjë nga vendet tona nuk është imun ndaj tyre". Por mund të them se të gjithë bashkë mund të përballemi me këto kërcënime dhe të gjithë bashkë mund të kontribuojmë më mirë për një botë më të sigurtë".

## Bibliografia

- The future of NATO and European Defence, House of Commons, Defence Committee, Ninth Report of Session, 2007-2008.*  
*Strategic Concept 2010, NATO Publications, 2010.*  
*Gordon, Philip, NATO's Growing Role in the Greater Middle East, The Emirates Center for Strategic Studies and Research.*  
<http://www.nato.int/> (faqja zyrtare e NATO-s).

## ABSTRACTS

### **Chris SMITH** **EU-NATO relations**

This EuroBroadMap working paper focuses on relationship between NATO and EU. Changes involved by the end of the Cold-War, and evolution of European Union's foreign policy are here examined. The 'Arab spring' and especially the intervention in Libya helps to highlight main differences and expectations regarding these two institutions. The task repartition (hard power for NATO and soft power for EU?) is also examined in a critical way.

### **Michael F. Harsch** **NATO and the UN, Partnership with Potential?**

NATO member states have struggled from the beginning with the question of how the Alliance can be made compatible with the United Nations. Since the early 1990s, NATO-UN relations have changed dramatically and both sides have jointly engaged in multiple international crises from the Balkans to Afghanistan and Libya. The underlying reason for this development has been NATO and the UN's growing interdependency in crisis management.

The organizations' collaboration has remained restricted to a limited number of operations of mutual interest. However these operations are usually critical for international security. It is therefore important to understand under which conditions NATO and the UN tend to cooperate effectively.

The paper argues that NATO and the UN cooperate closely when both sides perceive the need to access external resources to fulfill organizational goals. As organizations tend to have strong aversions towards infringements on their freedom of action, they must also lack politically and financially feasible alternatives to cooperation. Potential alternatives are the procurement of

sufficient capacity and expertise to act independently, or justifying to “go it alone” based on claimed operational necessity or moral imperatives. Finally, it takes two to tango: cooperation can only be effective if both sides commit to it.

### **Dorjan Gjozi**

## **NATO and EU competence on Cybercrime and Cyberterrorism sector.**

Nowadays internet and computer technology represents one of the main instruments not only in the development and administration of economic relations and electronic payment systems, but also in the administration of strategically important defensive relations related to particular national and international interests.

Attacks against private, public and international organizations' computer systems, organized in most of the cases from international criminal organizations or during “armed” conflicts and tensions from state authorities, have given to the “cyber-security” issue a great attention, due to the increasing probability that terrorist attacks in conflicts times concentrate on IT systems of strategically important structures for the protection of NATO and EU member states.

The first part of the article focuses on the legal definition and analysis of dogmatic categories and concepts of “cybercrime” and “cyber terrorism”, based on international normative acts that regulate cyber crime. The analysis draws attention on the importance of these phenomena in NATO and EU strategic policies and on the individualization of legal basis of these organizations' treaties which allow for their intervention.

While confronting different opinions, the author tries to assess if it is legally possible that cyber attacks against control and command systems or energy and telecommunication networks of NATO or member states, may be considered as an armed attack, and consequently, to legitimize from a defensive prospective, necessary measures, including the use of armed forces according to article 5 of NATO Treaty.

In conclusion, a special attention would be dedicated to Albanian legislative and legal measures in fighting cyber crime, while focusing on remaining changes in the Albanian normative system and cyber legislation in order to strengthen legal and technical instruments against cyber crime and to effectively contribute, as member of the Alliance, in the new policies and actions undertaken by NATO in the Cyber-security sector.

## **Anamaria Gheorghe**

### **NATO's role in Central Asia's Security Environment**

The aim of this paper is to show how the relations between NATO and the five Central Asian republics have evolved over the last two decades. In doing so, I will analyze the factors which shaped the Alliance's agenda towards this region and also, the way in which these states understood to relate to NATO. The beginning of the war on terror was the main catalyst for the deepening of relations between the two parts, especially after 2003, when NATO took over the command of the International Security Assistance Force in Afghanistan. However, the organization could not fully rely on its Central Asian partners, as the Andijan events in May 2005 in Uzbekistan have show. The Andijan crackdown has revealed the frail relation between NATO and the region's republics and uncovered the need of rethinking the Alliance's agenda towards Central Asia.

**Dr. Klaus Wittmann**

#### **RIGA CONFERENCE Papers:**

### **1. An Alliance for the 21<sup>st</sup> Century? Reviewing NATO's New Strategic Concept**

Self-ascertainment of the 60-year-old North Atlantic Alliance, a modern definition of NATO's purpose, character and role in the 21st century, recommitment and reassurance of all Allies, answers to today's and tomorrow's security challenges, concrete goals for a continuous reform, rallying of public support: NATO's new Strategic Concept, agreed at the November 2010 Lisbon Summit, has many functions to fulfill. How well does it succeed?

**Pèteris Veits**

### **2. Afghanistan: The Challenge of 2014**

NATO has finally set a sort of deadline on its combat operations in Afghanistan – year 2014. After that the primary focus of international assistance will be laid on “civilian” engagement in governance capacity building and reconstruction. But there is a question of whether bringing civilians out of the underground will become a magic panacea for all of the ills of today's Afghanistan? After all - the very same civilian efforts have

been present ever since the beginning of the current war. It is just that they have not really been successful. And unless some serious lessons are acknowledged and appropriate changes are pursued, there is very little hope that they will succeed now.

During 20th century, the international forces have repeatedly failed to facilitate the stabilization of Afghanistan when crucial opportunities arise. Having realized that it is impossible to dominate the country, the players involved have never had sufficient interest in stabilizing it. However, this ignorance has repeatedly caused the boomerang effect, making international actors re-engage later in much more costly ways for both - the international forces involved and Afghans as well.

In this essay it will be reflected on what went wrong with the previous civilian assistance attempts; the issues of insufficient strategic commitment, and lack of appropriate implementation structures, which resulted in over-centralization and under-coordination of reforms. Due to this fact and the deteriorating security situation the shift from military-dominated to purely-civilian international engagement bears high risks for the near future and resembles fleeing. The potential outcomes of actual fleeing are discussed in the second part of this essay. Therefore, the acknowledgment of previous mistakes and strategy oriented towards continued engagement in Afghanistan to balance security and governance development may appear to be the least costly way in the long-term perspective.

**Edlira Osmani**

### **NATO's Global Role: with a focus on the Middle East**

The first part of the article will cover historical issues and will analyze the NATO's transformations as a reaction to new security challenges. The importance of NATO Summits such as the Lisbon Summit in 2010 where NATO presented 'the new Strategic Concept on collective defense and deterrence, crisis management and cooperative security' has a great significance for the scenery of the next decade. A short overview on the upcoming summit agenda, 'Chicago 2012 commitments' will terminate the first part of the article to pass the focus in another important part: the NATO role in the Middle East. More than a decade ago NATO was cautiously involved in the Southeast Europe, recalling here the first military intervene of NATO in Bosnia and Herzegovina and later on in Kosovo. Nowadays a fragile situation is appearing in the Middle East and NATO has a



major role in the world's security issues but will NATO be a security alliance for the Middle East as it was for the Western Europe? In a nutshell will be discussed about the challenges facing the global security nowadays (paying attention on the recent events in the Middle East), and the NATO approaches for the mentioned issues.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM  
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 21

---

Formati: 15.5x24 cm  
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA  
Tel: + 355 4 22 40 116  
Tiranë, 2012